Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi

D I J A

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 17/2018, viti XVI, Ulqin
Numri 1 doli më 2003

Kryeredaktor
Gazmend ÇITAKU

Redaksia
Dr. Gani KARAMANAGA
Dr. Simë Gj. DOBRECI
Dr. Maksut HAXHIBRAHIMI
Dr Bahri BRISKU
Ma Liridona SINISHTAJ
Mustafa CANKA
Jaho KOLLARI
Ali LLUNJI – Prishtinë
Gjovalin ÇUNI – Shkodër
Ali GJEÇBRITAJ

ISSN:2336-9310: Dija
COBISS.CG.ID 22278416

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.
Është themeluar më 12 nëntor 2002, në Ulqin.
U riregjistrua: Ministria e Punëve të Brendshme,
Podgoricë, Vendimi nr. 6308, më 13.02.2013.

Ky numër u botua me ndihmën e:

Dje isha i zgjuar, ndaj doja të ndryshoja botën.
Sot jam i mençur, ndaj po ndryshoj veten time
Xhalaledin RUMI

PËRMBAJTJA

IN MEMORIAM
Adem DEMAÇI (1936-2018)
Fjalimi i plotë i Demaçit pasi mori çmimin "Sakharov" në vitin 1991 11

LETRARE

POEZI

IN MEMORIAM
Basri ÇAPRIQI (1960-2018)
Ec në hapësirën e gjallë që s'dridhet 17

POEZI PËR BASRI ÇAPRIQIN

Asllan BISHA
Poetit Basri Çapriqit 18
Jaho KOLLARI
Vargu i fundit 19
Hajredin KOVAÇI
Çoni fjalë! 19
Argëzon SULEJMANI
Ai nuk e ka për herë të pare 20
Gëzim MUÇOLLI
Basri Çapriqit 20

POEZI SHQIPE

Ibrahim RUGOVA
Me varg në shpirt m`çeli pranvera 22
Jaho KOLLARI
Zgjim zhgjëndrre 23
Arjola Zadrima
Magdalena 24
Edi SHUKRIU
(Jo)njerëzorja 25
Arian LEKA
Kapedan 26
Argëzon SULEJMANI
Sari 27

Nexhat HALIMI
Vjen galera e nuk arrin 27
Ibrahim BERJASHI
Ulqin 28
Eri OMARI
Nji grusht ujë 29
Ali PODRIMJA
Ah, krizat e tua… 29
Hajredin KOVAÇI
Kosovës, i ra një yll 30
Andi KOSTA
Requiem 30
Ilir MUHARREMI
Vdekja e fëmijës 31
Dorian LEKA
Solo e pazëshme 32

POEZI E BALLKANIT
Vitomir NIKOLIQ
Intime 33
Dina MURIQ
Më quajnë çun 33
Sllobodan VUKANOVIQ
I pesti tha, u nisa për atje 34
Stanka RAGJENOVIQ
Mungesë 34
Dragana TRIPKOVIQ
Shtatë 35

POEZI BOTËRORE
Paul VERLAIN
Ëndërra ime e zakontë 37
Charles BUKOWSKI
Një buzëqeshje për t'u kujtuar 37
Alda MERINI
Velat e këngës 38
Zhak PREVER
Për ty dashuria ime 39

Maria Teresa MANTA
Ndoshta 39
Mary Elizabeth FRYE
Mos qëndro duke qarë mbi varrin tim 40
Konstantin KAVAFIS
Duke pritur barbarët 40
Pablo NERUDA
E humbëm dhe këtë ndajnatë 41
Salvatore QUASIMODO
Rrugicë 42

PROZË
Zija ÇELA
Dashuria është më e fortë se vdekja 43
Jaho KOLLARI
Zdrëmja 50
Gazmend ÇITAKU
Likaceni 55
Vildana Dibra ZHUBI
Dulçinea, Don Quixote dhe bukuria që t'verbon 61

PROZË BASHKËKOHORE MALAZEZE
Vladimir VOJINOVIQ
Ikona 65
Tanja SEKULIQ
Vajza flokëbardhë 73

PROZË BOTËRORE
Mario Vargas LLOSA
Pesë qoshet 79
Virginia WOOLF
Një aventurë londineze 84

ESE
Jovan NIKOLAIDIS
Shqiptari im 89

EX-LIBRIS

Dr Rrustem BERISHA
Porosi mobilizuese për qëndresë 93

Fatmire DURAKU
Demi i tërbuar 97

Dr. Nail DRAGA
Vizione, shoqërore, politike dhe fetare 102

Adriana HOXHA
Pazari i gjytetit 103

prof. dr. Hulusi HAKO (Tiranë)
Revista ulqinake, DIJA–Enciklopedi, sui generis, e botës shqiptare 108

LIBRI/GJUHA

Dr. Eljon DOÇE
Migjeni, receptimi i munguar/deformuar 125

Daniela-Carmen STOICA, Ph.D.
Të drejtat gjuhësore në Shqipëri , Mal të Zi dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) 129

STUDIMORE

HISTORIKE

Anton LULGJURAJ, arkeolog
Fortifikimi në gjytedzen e Lloparit 139

Dr. Erenestina Gjergji HALILI
Udhëtim i shkurtër nëpër historikun e provincës françeskane 142

Sadik PELINKU
Tyrbja e Fanit në Ulqin - dëshmitë historike 146

SOCIALE

Msc. Arjan KALLÇO
Tiparet e njeriut të fundit në këndvështrimin e Fukosë 158

Majlinda KURT
Shëndeti mendor – stabiliteti emocional 166

Arlinda SUKALIQI
Si të menaxhojmë një klasë të suksesshme
dhe si të jemi menaxhues të mirë 169

TRADITË

Ali GJEÇBRITAJ

Etnografi – veshja popullore e Krajës 171

Muhamet NIKA

Ceremoniali i dasmës Anamalase 174

ARKITEKTURË

Shkëlzen SULEJMANI, arch. i dipl.

Banesa tradicionale në rrethinën e Anës së Malit 181

JUBILE – VITI 2018 VIT I SKËNDERBEUT

Qani OSMANI

Gjergj Kastrioti Skënderbeu
(Me rastin e 550 vjetorit të vdekjes) 199

Gazmend ÇITAKU

Pelegrinazh në varrin e Mara Kastriotit me rastin
e 550 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut 206

PORTRET

Prof. dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI

Jeta dhe vepra e hafëz Ali Riza Ulqinakut (1855 – 1913) 214

Dorian KOÇI

Filozofi i paqëtimit 222

Kristaq BALLI

Tre hierarkë korçarë të fotografisë 225

PREZANTIMI I AUTORËVE SHQIPTARË NGA MALI I ZI

FJALËT PËRSHËNDETËSE

RECENSIONET

Prof. dr. Klara KODRA

MBI TREGIMET E ANTON GOJÇAJ-t -TREGIME (SI)
MIKRODRAMA 235

DR.Moikom ZEQO
VARREZAT NË ANË TË MALIT – ULQIN 238

Dr. Olimbi VELAJ
"NË DERË TË OBORRIT", 242

Sazan GOLIKU
TA KUNDROSH DETIN ME SYTË E FËMIJËS 248

Gjokë DABAJ
ZËDHËNËS DHE ZËMBROJTËS I SHQIPTARËVET
NËN MAL TË ZI 250

Xhevat LLOSHI
NJË ROMAN ME RRËFIM TË VEÇANTË 257

Emil LAFE
"KRIJIME POPULLORE SHESTANASE" 260

Liridona SINISHTAJ
ÇMITIZIMI NË *FSHATI I HESHTJES* DHE
KULLARËT E FUNDIT NË *LIGJI I MASKAVE* 263

FOTO ALBUMI 267

Shaban HASANGJEKAJ
Liqenit të Plavës i rrezikohet ekzistenca 270

IN MEMORIAM

ADEM DEMAÇI (1936-2018)

FJALIMI I PLOTË I ADEM DEMAÇIT PASI MORI ÇMIMIN "SAKHAROV" NË VITIN 1991

Zoti kryetar, Zonja e zotërinj deputetë të Parlamentit Evropian. Në këto momente historike për Evropën dhe Ballkanin, duke më nderuar me çmimin "Sakharov" keni nderuar popullin tim të shumëvuajtur, por prore liridashës, paqedashës e krenar.

Duke nderuar popullin tim, para historisë, keni nderuar edhe këtë institucion të lartë, sepse të mbrosh një popull të pafajshëm nga pushtuesit e shtypësit, gjithmonë ka qenë e është lavdi e nder i madh. Në Librin e shenjtë thuhet: "E para ishte fjala".

Në kohën tonë mund të thuhet: "E para është fjala e lirë" si hapi i parë dhe i domosdoshëm drejt demokracisë. Pa fjalë të lirë s'ka dialog, pa dialog nuk mund të zbulohet e vërteta, kurse pa të vërtetën nuk ka progres. Zoti Kryetar, zonja e zotërinj deputetë, falë fjalës së lirë ju e zbuluat të vërtetën e hidhur për shqiptarët në Jugosllavi. Pikërisht se fjala e Lirë e shpartallon errësirën, flak tutje mjegullën dhe çjerr të gjitha maskat.

Të gjithë pushtuesit e puçistët, punën e parë që e bëjnë është robërimi i fjalës. Prandaj të gjithë ata që janë ithtarë të fjalës së Lirë, të gjithë ata që janë, të them me një fjalë pak si poetike – dashnorë të fjalës së Lirë, kanë qenë e janë të përndjekur, të dënuar e të burgosur, të ekzekutuar e të masakruar nga robërues të fjalës së lirë.

Por, zoti Kryetar dhe Ju, zonja e zotërinj deputetë të Parlamentit Evropian, do të guxoj të them se edhe ju të gjithë jeni dashnorë të fjalës së Lirë dhe prandaj më keni ftuar që në këtë sallë të mrekullueshme ta dëgjoni tingullin e fjalës së Lirë shqiptare. Mirëpo, më vjen keq që nuk kam fatin t'ju them asnjë fjalë të gëzuar e të ëmbël nga hapësirat e asaj që ende i thonë Jugosllavi. Në Kosovë pushtuesit serbomëdhenj, hegjemonistë e militaristë, përmes dhunës më të egër, po i presin një nga një arteriet jetëdhënëse të popullit shqiptar duke rrënuar pa mëshirë e plotësisht sistemin informativ, arsimor, shëndetësor, kulturor, sistemin bankar-financiar, sistemin ekonomik, juridik dhe përfundimisht u gjet i rrënuar e i shkallmuar i tërë sistemi politik. E tërë Kosova është shndërruar në një megaburg ku shqiptarët nuk gëzojnë as sigurinë më të vogël fizike, as juridike.

Duke çmuar kohën tuaj, nuk mund të ndalem tani në hollësira, por Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut nga Kosova, përditë

dërgon në shumë qendra të botës informata të argumentuara. As në Maqedoni, shqiptarët ende nuk po trajtohen në frymën e plotë demokratike, në Mal të Zi, gjendja e shqiptarëve është edhe më e keqe, kurse populli boshnjak është gjithashtu viktimë e hegjemonizmit serbomadh. Por, zonja e zotërinj të nderuar, dashnorët e fjalës së lirë janë dashnorët më të pasionuar, dashnorët më të flaktë që njeh bota, prandaj edhe janë të pathyeshëm e sypatrembur.

Njëri nga këta dashnorë të panumërt të fjalës së lirë ishte edhe akademiku Andrej Sakharov, të cilin as izolimet, as syrgjynosjet, as acari i Siberisë nuk qenë në gjendje ta ndanin nga fjala e lirë. Fjala e lirë e këtij kolosi e kampioni të humanizmit, hapi rrugën e Lirisë për shumë njerëz e shumë popuj në Perandorinë Sovjetike.

Sakharovi ndërroi jetë me fjalën e lirë në gojë, por ai vdiq, sepse fjala e lirë nuk i tradhton dashnorët e vet, ajo mbetet përgjithmonë me ta dhe i bën të pavdekshëm. Edhe vëllëzërit e mi Mandela e Marçenko, janë dashnorë të fjalës së lirë, si edhe zoti Dubçek; edhe motra ime Aung San Suu është një dashnore e madhe e fjalës së lirë; prandaj që të gjithë edhe u nderuan në mënyrë dinjitoze nga ky forum i lartë. Sa për tragjedinë të cilën është duke e përjetuar populli mik kroat, besoj se nuk ka nevojë të them ndonjë fjalë.

Kasaphana rrëqethëse që është duke u zhvilluar në hapësirat e Kroacisë është në fokusin e mediumeve informative ndërkombëtare. Bota mbarë është shumë e çmeritur dhe nuk mund t'u besojë syve e veshëve të vet se si është e mundur që në këtë kohë, në zemër të Evropës, pas konferencave të Helsinkit, të Parisit, të Kopenhagës, të Moskës, të ndodhin gjëra kaq pikëlluese. Bota me të drejtë pyet si është e mundur që pikërisht në Jugosllavi, e cila është nënshkruese e Kartës së OKB-së, nënshkruese e Kartës së Parisit e të dhjetëra e dhjetëra konventave e Marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut e të popujve, si është e mundur që pikërisht në këtë vend të ndodhin gjëra kaq monstruoze.

Bota pyet, si është e mundur që pikërisht pas fillimit dhe gjatë zhvillimit të Konferencës paqësore në Hagë, lidhur me Jugosllavinë, plasën dhe u zhvilluan luftimet më të përgjakshme në hapësirën e Kroacisë. Pa e kuptuar esencën dhe karakterin e pushtetit të sotëm serbomadh e militarist, as këto gjëra nuk mund të kuptohen, prandaj më lejoni që me pak fjalë ta jap ndihmesën time modeste për sqarimin e këtij problemi.

Pushteti i sotëm serbomadh e militarist është i gërshetuar, përveç tjerash, edhe nga tri komponente kryesore: nga burokratët, nga parazitët dhe mafiozët. Burokratët nuk munden dhe as guxojnë të shikojnë as majtas as djathtas për të parë se ç'faktorë të rinj janë shfaqur brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare; burokratët nuk munden as nuk guxojnë të bëjnë analiza objektive, të gjithanshme e të thelluara, duke pasur parasysh të

gjithë këta faktorë të rinj. Ata nuk guxojnë, se një analizë e këtillë do të kërkonte nga ata që të hiqnin dorë nga objektivi i tyre i përcaktuar që më parë të mbeten në pushtet përgjithmonë.
Parazitët, nuk munden as nuk duan të ndahen nga jeta plot privilegje e përfitime, të ndahen nga parajsa të cilën e kanë ndërtuar mbi mjerimin dhe varfërinë e popullit. Mafiozët, për t'i arritur të gjitha këto nuk zgjedhin mjete, i shembin të gjitha urat prapa vetes dhe tërë popullin e vet e shtyjnë dhe e detyrojnë të bëhet kriminel kolektiv. Në Kosovë e bëjnë këtë duke i shkelur shqiptarët, duke i zëvendësuar shqiptarët e flakur nga puna me serbë, duke ua marrë shqiptarëve të gjitha të drejtat njerëzore e kombëtare, i kanë konfrontuar keqas dhe në mënyrë të rrezikshme këta dy popuj, kurse në Kroaci përmes një propagande të shfrenuar, të gjithë serbët e atjeshëm i frikësuan, i hipnotizuan dhe i bindën se ata atje ishin gjoja të rrezikuar nga pushteti i ri demokratik kroat. Pastaj i cytën me të gjitha mjetet duke mos ngurruar edhe para shantazheve më të ndyra, i armatosën deri në dhëmbë me armët më moderne dhe i hodhën serbët në luftë totale kundër popullit kroat. Në këtë mënyrë, duke rregulluar tërësisht marrëdhëniet e bashkëjetesës me kroatët vendas, serbëve të atjeshëm nuk u mbetet mbështetje tjetër përveç Serbisë dhe armatës jugosllave. Dhe ky është njëri nga burimet e luftës për jetë a vdekje ndërmjet serbëve dhe kroatëve. Të njëjtën gjë parazitët serbë janë duke e përgatitur edhe në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë e Maqedoni. Zoti Kryetar, zonja e zotërinj deputetë, Dëshiroj të besoj se nuk do të më qortoni për dëshirën time të flaktë që ta forcoj me ju miqësinë duke Ju bërë të ditur edhe ndonjë veprim Tuajin që ne shqiptarëve, nuk na duket i drejtë. Për lëshimet që i ka bërë dikur Evropa, Serbisë, në kontekst të ngjarjeve e rrethanave të atëhershme, Evropa e ditëve tona nuk është dhe as nuk mund të jetë fajtore, por për rastin më të freskët, për Konferencën e Paqes për Jugosllavinë në Hagë, nuk më duket se është krejt pa gjynahe.
Dihet se udhëheqja serbe, si kusht për pjesëmarrjen e saj në konferencën e Hagës, pat shtruar kërkesën që në këtë konferencë të mos ftoheshin përfaqësuesit legjitimë të tre milionë shqiptarëve, përfaqësuesit e Krahinës së Kosovës, e cila gjatë gjithë kohës së ekzistencës së kësaj Jugosllavie, ishte element ndërtues e konstitutiv i kësaj bashkësie. Një kërkesë e tillë e Serbisë është pritur gjithsesi, por një pajtim me këtë kusht nga Bashkësia Evropiane nuk është pritur kurrsesi. Ky lëshim joparimor që i bëri Evropa Serbisë, krijoi tek pushtetmbajtësit hegjemonistë serbomëdhenj, iluzionin se Serbia qenka fuqi e madhe dhe se mund të konfrontohet edhe me Bashkësinë Evropiane. Ja edhe një burim i përpjekjeve të dëshpëruara të hegjemo-nizmit serbomadh, për ta vazhduar luftën me shpresë se edhe pse bën një luftë pushtuese e të pamoralshme, edhe mund të ndodh që ai të dalë fitimtar.

Zoti Kryetar, zonja e zotërinj,
Ne e kemi plotësisht të qartë se edhe Bashkësia Evropiane është gjendur para një problemi tejet delikat e të ngatërruar: si të shkarkohen nga pushteti burokratët, parazitët e mafiozët serbë e malazezë e të mos dëmtohen në tërësi popujt e Jugosllavisë, përfshirë edhe popujt serb e malazez, të cilët edhe vetë edhe janë duke hequr të zitë e ullirit nga ky pushtet i mallkuar. Ua bëjë të ditur me kënaqësi të posaçme, se në Serbi e Mal të Zi, përkundër kushteve tejet të vështira, janë duke vepruar me guxim demokratë të vërtetë si arkitekti Bogdan Bogdanoviç, profesori Zhivotiç, poeti i guximshëm Jevrem Bërkoviç, regjisori i talentuar Llazar Stojanoviç, profesoresha zonja Zagorka Golluboviç, avokati Sërgja Popoviç e shumë të tjerë. Siç shihet, në Jugosllavi, ka probleme të mprehta e fort komplekse, mirëpo unë kam besim të plotë se Bashkësia Evropiane ka potenciale kolosale njerëzore e materiale, për t'i zgjidhur të gjitha problemet që shtrohen para Evropës së sotme.
Prandaj, zoti Kryetar dhe ju, zonja e zotërinj të këtij forumi të lartë, në emër të të gjithë djelmoshave të të gjitha kombeve që masakrohen në këto luftëra absurde e anakronike, në emër të nënave e baballarëve jo vetëm shqiptarë, por edhe atyre serbë e malazezë, kroatë e boshnjakë, hungarezë e maqedonasë, në emër të të gjithë prindërve që humbin krijesat e tyre më të dashura nëpër luftërat shkatërruese, ju lutem shumë që ta vëni në lëvizje tërë energjinë Tuaj që ta ndalim së bashku gjakderdhjen e panevojshme dhe ta largojmë një herë e përgjithmonë nga skena politike bastionin e fundit të diktaturës ushtarako-policore, të regjimit shovinist e hegjemonist serbomadh, ta tejkalojmë përgjithmonë rrezikun e një lufte shfarosëse ballkanike e evropiane.

Zoti Kryetar, zonja e zotërinj,
Më lejoni që ta përfundoj fjalën time me një mendim të thellë të një miku tim të sinqertë që thotë: "Logjika e blloqeve bllokon logjikën". Prandaj ju thërras juve dhe gjithë botën; le t'i flakim tej të gjitha blloqet, ato raciale, fetare, kombëtare e ideologjike dhe midis popujve e njerëzve të ndërtojmë rrugë të bashkëpunimit, të respektimit të interesave të ndërsjella, të hapim shtigjet e dashurisë e të harmonisë gjithënjerëzore, që ta krijojmë një botë në të cilën të gjithë njerëzit do të jetojnë pa frikë, pa privime dhe me të drejta të barabarta njerëzore e kombëtare.
Faleminderit për mirësinë dhe vëmendjen tuaj.

4 dhjetor, 1991
Adem Demaçi

LETRARE

POEZI

IN MEMORIAM

Basri ÇAPRIQI (1960-2018)

EC NË HAPËSIRËN E GJALLË QË S'DRIDHET

Kështu të vdekshëm njerëzit
mund të ecin gjatë
dhe mos të takojnë gjë të gjallë
që dridhet në hapësirë
mund t'i lagë shi i rëndë si plumbi
kah kthehen tek janë nisur
për plaçkat e lëna si dëshmi
se s'janë frikësuar nga ylberët
e qiejve të murmë
kështu të vdekshëm njerëzit besojnë
më shumë se kurrë se s'ka gjë
të pavdekshme s'ka gjë se s'arrijnë
ta bindin as veten e kapërcyer
s'ka gjë se s'u nënshtrohen më
kryqëzimit të ngjyrave të thekshme
dhe s'shkrepin gjë së rëni plot gaz
kështu të vdekshëm njerëzit lëvizin
si lumi dhe lahen diku në një pikë
dhe s'vdesin hiç po t'u mbushet mendja
po t'i kujtohet gjë
nga koha që gjendet para tyre e gjelbër
se njerëzit janë të vdekshëm
si rrugët që na humbin në njerëzit
e renditur në të dy anët e
magjistrales si plepat e tharë
vitin e kaluar kështu të vdekshëm njerëzit
mund të ecin gjatë të nxehtë
të përvëluar
gjithnjë dhe s'ftohen po t'u mbushet mendja
së vdekuri
si rëndomë
pa u bindur se mund t'u rriten bimët
me një frymë
kështu të vdekshëm njerëzit
mund të ecin tehut të rrugës
së prerë përgjysmë
me duar në xhepa duke pështyrë
në atë humnerë të mbuluar me gjethet e thara
rënë vjeshtës që shkoi

POEZI PËR BASRI ÇAPRIQIN

Asllan BISHA

POETIT BASRI ÇAPRIQIT

Dy vargje për Ty
Ike
Në Dardani
Luftove armikun
Me poezi.

Në verë
Dritarja e hapur
Të priste Ty.

Më shkrove
Rri pakë.
Kthehem
Pas Vitit të Ri.

O, Zot s'besoja
Sëmundja të
Të rrëzoi Ty.

Ti mbete në Dardani
Këndej edhe
Pranvera vonohet
Loton për Ty.

Ulqin, 21 mars 2018

Jaho KOLLARI

VARGU I FUNDIT

Do të shihemi sërish
Kur përjetësia të më rrëmbejë
Të më ngreh zvarrë
Deri te vargu i fundit
Të mos hapej zdrëmë
Se vargu i fundit
Vargu i parë (s)është
Kemi një dëshirë të flaktë
Të na rizgjohet kujtesa
Atëherë kur "takimit"
Të ia rikthjejmë shpinën...

15.01.2018

Hajredin KOVAÇI

ÇONI FJALË!

Sot fjalët janë në grevë
edhe germat s'kanë rehati
sapo morën një lajm të zi!
Ah, tinëzare, tinëzare, he zuzare
ku e gjete poetin
pse ia këpute vargun
fjalët në fyt ia zure
e Ai akoma pat diçka pë të thënë!
Çoni fjalë gjithë miletit
sot pushoi së shkruari
penda e poetit!
(U prehsh në paqje miku im Basri Çapriqi)

Argëzon SULEJMANI

AI NUK E KA PËR HERË TË PARË

Ai nuk e ka për herë të parë
Ka vdekur sa herë që
Nuk e kuptonin nuk donin ta merrnin vesh
Nuk i jepej zë nuk i shqiptohej fjala
Nuk bënte dot punë nuk nxjerrte mujore
Nuk mbushte shportat nuk gëzonte fëmijët
Nuk i gjente paqe vetes komshisë njerëzisë
Ai nuk e ka për herë të parë
Ka vdekur sa herë që
Një i tij ka ndërruar jetë në luftë në paqe rrugëve mërgatës
Ka parë fëmijë gra pleq të luajnë macen e dromcave
Ka parë zonja zotërinj me kostume kollare të paimunizuar nga mesjeta
Prijësit e vendit të tij tek ngriten ngrihen duke u shitur dhjerë fikur
Kopshteve ka vuere partizanë të vegjël të marrive të mëdha
Ai nuk e ka për herë të parë
Ka vdekur sa herë është ndier poet i dërguar të vuajë të thotë deri në vdekjen e fundit(!?)
Ne e kemi për herë të parë
Një vdekje të Tij
E shihni sa fort sa thellë dhembin shembin
Vdekjet e poetit.

Gëzim MUÇOLLI

BASRI ÇAPRIQIT

sot qenkan bërë bashkë
deti me qiellin
për t' ia dëgjuar dhimbjen
miqve mbi tokë
në takim ditëlindjesh
vdekja tinëzisht
me ndërkëmbëzën e saj

rrëzon edhe njeriun
që deshi njësoj valën e detit
erën e qiellit
dhe aromën e tokës
mik i dashur
të ruaja në kujtime
të Prishtinës
kur rreshtonim vargje poetike
studentore
me frymëzim lirie
në vitet e shkelura tetëdhjetë
në kohë tanksesh
demonstratash e ëndrrash
lirie
ah ti e doje shumë lirinë
kur na flisje për ulqinakët
dhe Ulqinin
dhe matnim autoktoninë
iliriane
me mijëvjeçarët e ullinjve
të qytetit tënd
në verën e fundit të
rinisë sime
para jetës së kurbetit tim
buzë ranës
në qytetin e ulkonjave
ti mu bëre ciceron
që njihte edhe gurët në kala
atëherë kur
ulqinakët mësynin
Amerikën
e te moli i kalasë
motrat dhe nënat
mbushnin detin me lot
i njëjti det
që do të më kujtojë
vargjet e tua plot diell
miku im Basri.
Lamtumirë Poet.

Padova, 14 janar 2018

POEZI SHQIPE

Ibrahim Rugova

ME VARG NË SHPIRT M`ÇELI PRANVERA

Me varg në shpirt m`çeli pranvera.
Desha t`jetoj gjithmonë i neshtë.
Më bëhet se do të vajtoj përhera,
Kur po hyj me të madhe në vjeshtë.
Ah, stinë e verdhemtë, stinë e venitur
Vallë, Ty të mallkoi mëma -natyrë?
Që bashk t`shkrihemi kështu t`nemitur,
Mos jemi të mjer në krijatyrë?
Po ëndrrove me këngë të rritesh,
Dhe ajo jetës përpara t'i flasë.
E di. Me dëngë plot do t`goditësh.
E ngado të endesh veç do të vrasë.
Athua Zoti i madh diti të gjykojë
Që njomaket të kalben shi në vrug.
Apo secili barrën e vdekjes të peshojë
N`zjarr të heshtjes i vetmuar si murg?
I ngopur me të vërtetën në gji,
Vëllau im dole n`mesin me erë.
Mbi fytyrën e re t`ra nji vel i zi –
T`nxuer e t`futi n`kuvli përherë.
O kujt t`i falem n`këtë orë t`vështirë,
Kujt t`ia kërkoj hijen e njomsisë?
Pa frikë. Prore do t`jetë djellamirë –
Pikllimi im, kasnec i gjallë i fuqisë.
Dua të iki fushës e malit-
Jetën e shof si grusht t`rendë.
Jo, s`dua të iki. Dua si shpirt djalli
Të ngjitem së bashku në vend.
Bën që per vargjet e mia t`përvëlimit,
Të më quajnë edhe njeri fare t`prishtë.
Po heret i vranë sytë e shtrembërimit,
Se e flas t`vërtetën e kam çiltërisht.
Por nji ditë të dihet se zemra e poetit,

N`dimër a n`verë s`di të ngurrë
Dhe kur e ndjen valën rreth vetit –
Qan e qesh nuk qetësohet kurr.
(Cerrcë 1960)

Jaho KOLLARI

ZGJIM ZHGJËNDRRE

Kombi im i madh
mos e harro Ulqinin e vogël
-Ulqinin e madh që i takon një kombi të vogël
që mbase s´i ka mbetur as gjysma
-as gjysma e popullatës
kur ishte një mesoburrë
tani burrec me rrudha
që s´i shkojnë më vaktit
as të djepit as të varrit
as vaktit të jetës s´i shkojnë përshtati
Zotynë, s´i besohej më as krijuesit as shkatërruesit
zullumqarë, zullumqarë, zullumqarë...
në bash t´zamanit jemi, jeni, janë...
aman, zaman kujt t´i besohej tradhëtia
-zaman të mirren të pabërat
muranë e shkulur nga dheu
i të parëve, i të dytëve, i dreqit të mallkuar...
Kombi im i vogël
mos e harro këtë emër të madh
që mbase (s´)i ka mbetur gjysma (medet ç´vetasgjësim)
që është mrrudhur si plak matuf
që s´i njeh më birët, bijat, nipat, mbesat...
as veten
-s´e njeh më as vetveten
dhe s´është ëndërr-ankth
zhgjëndërr është që ta çon mishin kokërr
-medet Ulqin zgjoje zhgjëndrrën...

(Ulqin, maj 2018)

Arjola Zadrima

MAGDALENA

S'jam grue sot,
më shihni bluzën, format e saj,
nën të kam gjoksin,
çoj peshë stuhi,
thyej mendjet e verbueme.
Fshij jargët
ky gjoksi i shejt mëkon jetë,
a mundesh me ju gjunjëzue?
Para këtyne syve që dijnë me të dëftue botën
je i vogël,
i pambrojtun,
une s'përdor duert, shikimin
ai të përbuz,
të don,
të rrok,
të njesh edhe me tokën.
Krej forca jote asht njai çast që m'ke zgju bishën,
druje, jam përbindshi që s'njeh.
Ti krijese e ashpër, i pabesë,
je njaq i vogël sa pikërisht aty ku lindesh,
zhytesh
zhgrryhesh
shtyhesh
zgjahesh
aty qan, kullon
pikon e zvoglohesh.
Të sundoj, edhe kur para syve të mi
zhburrnohesh,
njisoj sikur atë ditë qe u linde i paburrë.
Une s'jam grue sot,
por prej asaj dite ku nën kambë çilen lulëkuqe,
kjeshë grue edhe pse virgjën,
sot jam Magdalena!

Edi SHUKRIU

(Jo)njerëzorja

1.
Nëse e shihni
një burr
që bredh udhëkryqeve
duke kërkuar veten e humbur
Ta dini,
është ai
që ia masakruan fëmijët në luftë
Është mirë ta lini të qetë
nëse nuk mund t'i ndihmoni
2.
Nëse e shihni
një grua
të strukur
e që ik nga bota
Ta dini,
është ajo me shumë shoqe
që është përdhunuar
e ti dhe unë
nuk i dolëm në ndihmë
Është mirë ta lini të qetë
nëse nuk mund t'i ndihmoni
3.
Nëse e shihni
një grua
që duket se heq qime
nga robat e trupit
Ta dini,
është nëna e vajzës
që kërceu nga kati i shtatë
e dashakëqijtë thonë
Kush e di se për çfarë arsye
Është mirë ta lini të qetë
nëse nuk mund t'i ndihmoni
4.
Nëse e shihni
një burr

duke bredhur plehërave
Ta dini,
gërmon hedhurinat tuaja
që t'i ushqejë fëmijët
Është mirë ta lini të qetë
nëse nuk mund t'i ndihmoni
5.
Nëse e shihni
një njeri
duke u krekosur kryeqytetit
me makina kokëboshe
e luks të pamerituar
Mos iu përkulni
e mos e lini të qetë
nëse doni t'i ndihmoni
vetes…

Arian LEKA

KAPEDAN

Lundro nëpër venat e mia
kapedan ulqinak,
s'do e shohësh dajlanin në Bunë,
direku bashit
të mbiu në dorë - gisht i gjashtë;

Varrose velierën tek unë.

Veliera jote
do t'ma mpiksë gjakun
në zemrën do ngecë
si në cekëtì.
Varrose velierën tek unë,
kapedan
dhe prit një kohë më të mirë.

Argëzon SULEJMANI.

SARI
(Kosovës dhjetë vjeçare)

Dua të festoj bashkë me ju
Më jepni të pijë, të bëj dashuri
Mbase do të mpakem a shembëm diku
E më vinë tek sytë gjashtë yje shkëndijë.

Bashkë me ju dua të festoj
Më jepni ca tym, më bëni fort trim
Ndoshta nëpër qiej nisë e kalëroj
E diell i kafshuar bëhet ylli im.

Të festoj bashkë me ju dua
Pranoj të më flini, dëshirat t'i ngini
Bunën ta përpijë si të ishte përrua
E të më bëhet qiell juaja kaltërsi.

Nexhat HALIMI

VJEN GALERA E NUK ARRIN

me galerën gjysmë të djegur arrita në ulqin
ta përfundoj këtë shkrim të ik prapë detit
kaq vjet tash pres kthimin e e përjetoj robërinë
pashprehshëm shtrirë rrënjës së gjakut

ulqini të lidh me ullirin mijëvjeçar të ngrirë
ndihesh i lumtur pse je rob i zjarrit mbi hi

i përplasjes së detit dhembjes e hijes tjetër

çel portën gjysmë djeg` nën dritare të vjetër
trembet qeni veshëprerë e leh kafkën e hënës
e gjarpri i etjes së gurit s`lëviz nga frëngjia

unë ngjitem në kështjellë shkallë më shkallë
e detit gjithnjë vjen galera e s`arrin në krruç

kaq vjet më vonë vjen dhe gjergj elez alia
e flutura e gjakut fër e fër gjithësisë së instiktit
e feniksi zgjohet përsëri nga hiri i vet

oh ulqin ti kala ulqin ti pafundësi zot ti det

Ibrahim BERJASHI

ULQIN

Sa i madh që je
O ,Vigan
Plagët e Gjergjelzalisë
I ke bartur mbi supe
Tremijë vjet
Edhe mallin e Ymer Agës
Edhe hingëllimën e Kalit të Trojës
Gjallë je
Emri yt
Nuk përtypet
As shtrohet
Desert
Në tryzën e piratëve
Gurët
Betohen
Para biografisë sate
Një puthje vere
Kam ruajtur për ty

Eri OMARI

NJI GRUSHT UJË

Nji grusht ujë
i mbartun në gjoks prej dekadave
pa shterrë kurrë
Lidhi duert e e ndiej tue dihat
A thue jam pus?!
Uji më buron në gjoks
e disa here në ditë e mbledhi ndër pllambë
për me marrë jetë
Dalun prej burgut të vetes teme t'rrejshme
uji
rreket me hap porta te reja
ndër damarët e zemrës
Kruspull mblidhem
e ndjehem gjallë
ndërsa uji më kndon në gjoks
fjalë Dashnie

Ali PODRIMJA

AH, KRIZAT E TUA…

Ah, krizat e tua,
dhimbje e sfidë
janë për mua!
Që t'u ngjitem,
të mos u shqitem,
pa ngurrim t`u vërtitem,
pa pushim të përpëlitem,
për ty pa fund të vritem.
Kundër tyre të kacavirrem,
gjer në gjak gjatë të çirrem,
mendtë mos më merren,
fuqitë të mos më bjerren,

sytë të mos më erren,
shpresat të mos më teren.
Ah dhimbje e sfidë
janë për mu
Krizat e tua!

Hajredin KOVAÇI

KOSOVËS, I RA NJË YLL
(Fadil Vokrrit)

Ti, më i miri nuk ishe, por
Kosova më të mirë se Ti
nuk kishte!
Fizikisht Ti, më nuk je me Ne
i përjetëshem qoftë kujtimi
i lehtë të qoftë ai dhê!

Andi KOSTA

REQUIEM

Drenushë në ikje Hëna!
E fshehin dhe e çfshehin retë
në qiellin tim të magjepsur prej
hijes në të shuar dhe
dritës në të lindur.
Po shuhen të rraskapitur
edhe ata fare pak yje mbetur!
Ky qielli im i vogël, i madh
shtriqet i magjepsur
prej dritës në të lindur
dhe hijes në të ngjizur!...
Hëna,
drenushë në të ikur!...

Ilir MUHARREMI

VDEKJA E FËMIJËS

(kushtuar Rebekës)

Fëmijët kur provojnë vdekjen para prindërve
Nuk është e rëndë për fëmijët
Më e rëndë për prindërit
Ata dergjen nën kujtime
Disa pinë tentojnë të varrosen bashkë me fëmijën
Nuk heqin dorë nga jeta e tyre
Më e madhe jeta se vdekja
I donë fëmijët si Rembranti të cilit i vdiqën
Nuk u varros vazhdoj me jetën
Nuk bënë të vuash por të jetosh
Të jetosh nën pikëllim
Kufomë e gjallë
Zgjidhja prapë të jetosh
Vazhdo merri forcat nga toka jeta
Por prapë jeton në pikëllim
Ke humbur spermën tënde
Mos harro para teje nuk ishte
Me ty ishte
Kjo ka rëndësi
Për kërshëndella ja uron
Vjen viti ri prapë ja uron
Çdo çast flet për të
Muret i ke mbushur me fotografi
E ti jeton, ai ose ajo jo
Mos harro jeta ka rëndësi tash
Gjysmak vazhdon e kuptoj
Nuk po them dehu të marr forcë, por jeto
E thyer ecën nën qiellin blu
As ai se kupton dhimbjen tënde
Nuk e meriton të qash nën qiellin
Fëmija nuk të dëgjon
Mos shpreso se do ta takosh ndonjë herë
Se ke njoftuar as kur erdhi
Takimi është i anuluar
Mos shpreso
Jeto me jetën tënde

Jashtë është ftohtë bie borë
Ti e pyet; bebe a e ke ftohtë?
Ajo nuk të dëgjon
I takon të mos të dëgjoj
Po harron shpirti yt është akull
Engjëjt nuk e kanë ftohtë
Bebja është e mbrojtur
Bebja nuk vdesë
Me dekore ja ke mbush varin
Si kujtim jete
Pajtohu si tash si një jetë e tërë
Vdekja na merr me vete
Njëjtë është
Mos harro sonte është ftohtë
Varri i bebes është i ftohtë, por shpirti shumë i ngrohtë
Është më i ngrohtë se në çdo shtëpi
Engjëjt nuk i mbron Zoti
Nuk ekziston
Po të kishte ekzistuar bebja s'kishte vdekur
Zoti nuk ekziston

Dorian LEKA

SOLO E PAZËSHME

Me majat e gishtave preku bregun e lotëve
Dhimbja mendimet volli pa fre
Ku ja tronditi Olimpin e Zotëve
Qanë dhe ata, por veç me rrufe.

Shkrepëtima s'e trembi ajo zgjati duart
Dallgët e absurdit ta mbytnin më mirë
Si dreqin vajtojnë njerëzit kur duan?!
Ku ja brenda saj vret e s'pipëtin.

...me thembra firmosi solon e pazëshme.

POEZI E BALLKANIT

Vitomir NIKOLIQ (Mali i Zi)

INTIME

Dua që sonte dikush të më dashurojë,
më duhet një grusht mirësie e kujtdoqoftë;
Sonte do t'i harroj e tejkaloj të gjitha
dhe të kthehem në prehër të qiellit.

Unë isha i kafeneve dhe askuji më
isha i urryer dhe i zbrazët – i padëshiruar porsi varrmihësi.
Sonte vetes do i dëshiroja – t'i ngjaja çunakut
dhe përsëri të më thonë se sa i mirë jam.

(përktheu Gazmend Çitaku)

Dina MURIQ (Mali i Zi)

MË QUAJNË ÇUN

Por unë nuk jam i tillë
Atje lartë, është nëna dhe qielli i zi
Sa më mungon, por mos i thuaj askuj.

Edhe pse nuk kam lëshuar shtat që të jem sa një burrë
Më mungon ajo përkëdhelja kur qaja, më mungon brisku në dorë
S'kam lesh në gjoksit e as mjekërr
Por, jam burrë!
Nën qiellin e zi si varfanjak i dënuar në ndërgjegjen e vendit të vet

Dikur shpresoja, e ndoshta edhe dëshiroja
Por sot me ta së bashku në urën e drinës, pres goditjen në kokë
E trupi im të notoj në gurpin e të njejtëve dhe kurrë askush s'do ta mësojë.
(përktheu Gazmend Çitaku)

Sllobodan VUKANOVIQ (Mali i Zi)

I PESTI THA, U NISA PËR ATJE

U ktheva pas treqind vitesh
Ishte errësirë
Dita e dytë, e tretë, e pestë pa dritë
Në kodrën e tretë takova njeriun e parë, në të gjashtën të dytin, në të nëntin
të tretin, në të pesëmbëdhjetin të katërtin. Me kafkë të fosfortë në dorë secili ndriçonte rrugën e vet.

Ky është ndriçuesi im, tha i pari.
U nisa për atje, tha i pesti
Diçka kam humbur, por nuk më kujtohet se çka, tha i njëzet e treti.
Të gjithë udhëtojnë, assesi të takohen
S'desha të hyj në trupat e tyre
Po shkoj, do kthehem pas treqind vitesh. Besoj se i pesti do arrijë
Atje, i njëzet e treti do gjejë atë që ka humbur.
E Unë?
Unë do lë gjurmë të patrup në borën e motit.
(përktheu Gazmend Çitaku)

Stanka RAGJENOVIQ (Mali i Zi)

MUNGESË

Sot ma thuani
një fjalë të mirë
lehtë le të pikojë
në ditë;
me të tilla fjalë njeriu
mundet të jetojë!

Sot ma thuani
ndonjë fjalë jo të zakonshme

si ëndërr shiu
në mantelin e vjeshtës!

Gjejeni sot
një fjalë të ngrohtë
në të cilën do t'i mbërthejë
të gjitha mëngjeset me diell!

Sot, vetëm pëshpërisni
një fjalë të ëmbël -
magjibërëse,
që nga asgjëja krijon gjithçka!

Por, mos luani
me fjalët e buta;
nganjëherë ato
vrasin njeriun!

(përktheu Gazmend Çitaku)

Dragana TRIPKOVIQ (Mali i Zi)

SHTATË

Këtu nuk do të ketë vend
as për njërin e as për numrin tjetër
që nuk është i denjë për shtatë çudira.
Pas horizontit të shtatë
me siguri do jenë edhe shtatë të tjerë.
Shkurtabiqët avanturistë vraponin
me sopata, marrëzisht e kërkonin
pas çdo maje kodre të mjegullt.
Ato shtatë kodra
i rrëmbyen shtatë kusarë
që vinin prej Atyre detërave të cilët
domosdo nuk kishin dëgjuar
për shtatë mëkatet vdekjeprurëse
që t'i njihnin dhe

tani do u bënin të pabërat…
Deri sa nuk bërtiti:
”Nuk kam frikë nga e keqja,
se ti je me mua”,
Vdekja e shtatë e macjes
do ta dëbojë mallkimin nga anija…
Do t’i duhen edhe shtatë rrena të Kleopatrës
si dhe shtatë helmet e Borxhijas
që të mund sërisht të hajë molla.
Shtatë dashnorë të neveritshëm
bien të dehur nga kënaqësia
dhe këtu do mbaronte rrëfimi,
pot ë mos pyeste se sa
sekunda ka deri te ferri.
Shtatë sorrat e Po-së
njëzëri thanë: Shtatë!

(përktheu Gazmend Çitaku)

POEZI BOTËRORE

Paul VERLAIN

ËNDËRRA IME E ZAKONTË

Shpesh natën më çudit një ëndërr, më sëmbon,
Një grua që s'e njoh, q'e dua dhe më do,
Që s'është kurdoher' as fare gjithajo
As fare tjatër, dhe më do, më kupëton.

Më kupëton, dhe zemrën si kristal të kjartë
Ma di vetëm ajo, edhe ma zgjidh problemn' e saj
Vetëm ajo; ballin e zbet' e dirsur valë
Vetëm ajo ma alladit me lot' e saj.

A ësht' e zeshk' a blonde ruse? Nukë e di!
Ç'i thonë? Emr' i saj i ëmbël tingëllin
I dashur dhe syrgjyn prej jetës plot me zi.

Ka sy si të statujës, edhe zën' e ka
Të larkmë dhe të qetë, plot me rëndësi
Dhe me lezet, si zë që s'bën më shamata.
Shqipëroi: Fan Noli

Charles BUKOWSKI

NJË BUZËQESHJE PËR T'U KUJTUAR

Ne kishim ca peshq të kuq,
Dhe ata vërtiteshn rreth e rrotull,
Në tas, mbi tavolinë, pranë perdeve të rënda,
që mbulonin pamjen që dukej prej dritares,
Nëna ime, gjithmonë duke buzëqeshur,
na donte të gjithëve të ishim të gëzuar,
Më thoshte; -Ji i gëzuar Henri!
Dhe kishte të drejtë,

është më mirë të jesh i gëzuar kur mundesh,
Por babai vazhdonte ta rrihte,
atë dhe mua,
disa herë në javë,
Ai nuk arrinte të kuptonte çfarë e sulmonte së brendshmi,
Nëna ime, peshk' i shkretë,
donte të ishte e gëzuar,
ashtu e rrahur dy apo tri herë në javë,
Duke më thënë mua të isha i gëzuar,
-Buzëqesh Henri!
përse nuk buzëqesh kurrë?
Pastaj ajo do të buzëqeshte për të më treguar si…
Dhe ishte buzëqeshja më e trishtë që kisha parë ndonjëherë…
Një ditë peshqit e kuq vdiqën, të gjithë, të pestë…
Ata pluskonin mbi ujë me sytë ende hapur,
Dhe kur babai u kthye në shtëpi,
ia hodhi ata maces,
Atje në dyshemenë e kuzhinës,
Dhe ne pamë se si nëna buzëqeshi…
(Përktheu Arlinda Guma)

Alda MERINI

VELAT E KËNGËS

Kam braktisur çdo grua
si të ngjashmen e vetme
zhytyr në fatin e vështirë.
Arti është më i miri i zejeve.
Arti më ka dhënë të ngjashëm,
ngjyra të forta rinie
nën një mantel të freskët,
e me këta të rinj ngrita
velat e këngës sime
dhe u nisa për në detet blu
me një rremë të vetme
që janë kujtimet e mia.
Përktheu Gerta Bandilli

Zhak PREVER

PËR TY DASHURIA IME

Shkova në treg zogjsh
Dhe bleva zogj
Për ty
dashuria ime
Shkova në treg lulesh dhe bleva lule
Për ty
dashuria ime
Shkova në hekurishte
Dhe bleva pranga
Pranga të rënda
Për ty
dashuria ime
Dhe pastaj shkova në treg skllavësh
Dhe të kërkova
Por nuk të gjeta
dashuria ime
(Përktheu nga frëngjishtja: Rexhep Ismajli. Prishtinë, 1971)

Maria Teresa MANTA

NDOSHTA

Me yje të shndritshëm do t'i ndez
Netët e mia të errëta, o hënë,
Flamujtë e ëndrrave do t'i ngre
Në tokën e dëshirave të mia,
Do të kalëroj nëpër shkëmbinjtë e thepisur
Dhe më fort do të lutem
Mes hepave të humnerave të tua
Në detet e tua të akullta do të gjej
Burimin e qetësisë sime…
Përktheu Arjan Kallco

Mary Elizabeth FRYE

MOS QËNDRO DUKE QARË MBI VARRIN TIM

Mos qëndro duke qarë mbi varrin tim
Unë nuk jam aty. Unë nuk flej.
Unë jam mijëra erëra që fryejn.
Unë jam shkëlqim diamanti mbi borë.
Unë jam rreze dielli në grurin e pjekun.
Unë jam rigë shiu vjeshte.
Kur zgjohesh në mengjezin e heshtur
Unë jam shtysja (motivi) që disponon
Zogjt në rreth të fluturojnë lehtë.
Unë jam yjet që shkëleqejnë gjatë natës.
Mos qëndro mbi varrin tim dhe mos qaj;
Unë nuk jam aty. Nuk kam vdekë
Përktheu Zhaklina Henci

Konstantin KAVAFIS

DUKE PRITUR BARBARËT

Çfarë presim, të mblidhen në shesh ?
Sot mbërrijnë barbarët.
Përse ky pasivitet në Senat ?
e përse senatorët rrinë ulur dhe nuk bëjnë ligje?
Sot mbërrijnë barbarët.
Çfarë ligjesh duhet të bëjnë Senatorët ?
Kur të vinë, do t'i bëjnë barbarët.
Përse perandori është zgjuar
kaq herët, dhe solemn qëndron në fronin
e portës kryesore të qytetit me kurorë?
Sot mbërrijnë barbarët.
Perandori do t'i bëjë pritjen zyrtare
udhëheqësit të tyre dhe e ka gati
dhuratën në një pergamenë. Ku
i ka shkruar shumë tituj dhe epitete.

Përse dy konsujt dhe pretorët tanë
dolën sot në mëngjes veshur me toga të kuqe
përse mbanin bylezikë me gurë të çmuar
unaza me smeraldë të shkëlqyer përndritës?
Përse po mbajnë bastunë elegantë
punuar aq bukur në ar e argjend?
Sot mbërrijnë barbarët
dhe të mbahesh kësisoj u bën përshtypje barbarëve.
Ku janë oratorët e talentuar
të deklamojnë fjalimet e tyre si gjithnjë
Sepse barbarët mbërrijnë sot
dhe ata janë të mërzitur nga retorika dhe të folurit në publik
Përse ky hutim i papritur, ky konfuzion?
(sa serioze fytyrat e njerëzve janë bërë.)
Përse rrugët dhe sheshet u zbrazën në mënyrë kaq të shpejtë,
të gjithë duke shkuar në shtëpi të humbur në mendime?
Por nata ra dhe barbarët nuk mbërritën
dhe disa prej njerzve tanë nga kufiri thonë
nuk ka më barbarë, barbarë nuk ka më.
Po tani çdo të bëhet me ne pa barbarët ?
ata njerëz ishin një lloj zgjidhje.
Përktheu Elida Buçpapaj

Pablo NERUDA

E HUMBËM DHE KËTË NDAJNATË

E humbëm dhe këtë ndajnatë,
Askush s'na pa në perëndim të diellit
të zënë dorë për dorë.

Nga dritarja tani unë shoh
perëndimin- buja e qiellit e skuqur si furrë.

Më pas, si një monedhë
Dielli ndizet mbi duart e mia.

Po ku më ishe ti në atë çast?
Me ç'njerëz? Dhe ç'fjalë thoshe?

Nuk e di përse; dashuria më buçet atë çast
Kur përkrah meje shtrohet trishtimi
Dhe ty s'të kam pranë.

Më bie libri nga dora, çdo mbrëmje
një libër marr në dorë.
Poshtë këmbëve të mia struket mushamaja
si një qen i plagosur.

Dhe të më largohesh gjithmonë e më tepër
Atje ku muzgu të bën të dukesh statujë

Salvatore QUASIMODO

RRUGICË

Nganjëherë më grish sërish zëri yt
e s'di ç'qiej e ujëra
më zgjohen përbrenda:
një rrjetë dielli tek shthuret
mbi muret e tu që mbrëmjeve ishin
një nanuritje llambash
dyqanesh të mbyllur vonë
plot erë dhe trishtim.

Kohë tjetër: një vegjë rrihte në oborr,
e natën dëgjohej një vaj
këlyshësh e fëmijësh.

Rrugicë: një kryq shtëpish
që përmenden ngadalë
e s'dinë se ç'frikë është
të mbetesh vetëm në terr.
Përktheu Zimo Krutaj

PROZË

Zija ÇELA

DASHURIA ËSHTË MË E FORTË SE VDEKJA
("Për dashurinë shkruhet pas vdekjes")

I gjithë njerëzimi, sado që pa ndonjë biletë në dorë, është pjesëmarrës në një lotari të përbotshme, ku orë e çast hidhet shorti më i fshehtë. Rezultatet nuk komunikohen, ato vetëm ekzekutohen. Paradoksi është se humbet ai që fiton. Kështu, një ditë prej ditësh, ne e humbëm djalin tonë. Kur mbylli sytë, dy prej miqve në Tiranë ua dërgova lajmin me SMS me të njëjtin tekst. Në mos gaboj, nuk e përmendja fjalën vdekje, por njoftoja ndryshe: "Na ishte njëherë një baba e një djalë që çudisnin dynjanë, kaq miq të ngushtë ishin. Tanì ky djali nuk është më." Ndajfolja tanì ka homonimi me emrin e shkurtuar të Dritanit, pra me Tàni. Andaj teksti mund të lexohej edhe kështu: "Na ishte njëherë një baba e një djalë që çudisnin dynjanë, kaq miq të ngushtë ishin. Tàni, ky djali, nuk është më."
Se kur e si kishte nisur kjo miqësi, zor të thuhet. Më vjen të besoj se ishte e lindur. Dritani, Tani, Tanushi, siç e përkëdhelnim qysh herët, ka qenë fryt pasioni, fëmijë dashurie dhe rinie. Prindërit e tij ishin njëzet e katër vjeç, kur ai erdhi në jetë më 11 janar 1970. Sidoqoftë, me kohë, miqtë e mi u bënë edhe miqtë e Dritanit, dhe miqtë e tij u bënë edhe të mitë. Thjesht, jam një baba që pata kohën e vullnetin, por sidomos pata fatin të mësoja nga im bir, këtë e pranoj pa rezerva. Unë mund ta kem mësuar në fillim se jeta duhet jetuar me dinjitet, ndërsa ai më mësoi pastaj se kaq nuk është e mjaftueshme, duhet që edhe të vdesësh me dinjitet.
Ende në Itali, për aq sa më rrejti gjumi me dritën ndezur, pashë një ëndërr të vogël. Isha me time shoqe në ashensorin e spitalit. Dera u mbyll dhe, që nga rrënja, ma zuri jashtë krahun e djathtë. Ma zuri për të ma këputur. Mesnata sapo kalonte dhe me këtë vegulli, fanitjen e supit cung, dola në ballkon. Aty, nën një qiell dimri që fusha ia zmadhonte përmasat, m'u dynd me forcë një ide e pazakontë, e cila dhe herë tjetër më kishte shkarë në mendje. Të nesërmen ne do të ktheheshim bashkë me arkivolin dhe në Tiranë, nëpërmjet gazetave dhe ekraneve televizive, ngjarja e përmortshme tashmë ishte bërë gjerësisht e njohur. E ndoshta pikërisht prej përfytyrimeve të atjeshme, teksa prisja të gdhinte

mëngjesi, m'u ripërtëri ideja që në derën e shtëpisë të afishohej sa më njerëzishëm një lajmërim ftues: "Ju jeni të mirëseardhur, zonja dhe zotërinj, ju keni gjithë mirënjohjen tonë të thellë dhe dhëntë Zoti t'ua kthejmë në të mira, por jeni të lutur që të mos provoni për të na ngushëlluar."
Ishte nata e tretë pa Dritanin.
***
Lajmin e vet, atë të shtrimit në spital, na e fshehu në fillim, mbasi celulari ndihmon për ta tjetërsuar vendndodhjen. Dinim vetëm se kishte porositur biletat e avionit (më vonë, në jermin e tij, do të bëhej aeroplan) dhe, në fund të qershorit, do të vinte për pushime me Kevin, të birin dhe me Elionën, të shoqen shtatzënë me Livian, që do të lindte në nëntor dhe ne do t'ia çonim në spital për ta mbajtur në prehër. Përfytyronim një verë me plane të këndshme për shtëpinë tonë, prisnim ditë bashkuese. Në të njëjtën kohë, nga Graci i Austrisë do t'ia mbërrinin Karagjozatët, ime bijë Riviera, bashkëshorti Luli (Bardhyli) dhe dy nipat e vegjël. Edhe lëvizja gjatë pushimeve ishte përcaktuar: Tiranë – Durrës – Himarë. Qiell vere, qiell ëndrrash dhe det ndjellës, det i jugut. Kaq peng do t'i mbetej ajo verë Kevit katër vjeç e gjysmë, sa edhe pasi gjithçka ishte prishur, dhe ishte prishur në mënyrë të pandreqshme, në shtëpinë e tij në Castelnovo më thoshte, gjysh, kam një fjalë te veshi, a shkojmë nesër në det? Më duhej t'i thoja jo, është e pamundur, sepse nuk doja ta gënjeja, por edhe t'ia shpjegoja gjëmën që sapo kishte nisur me sëmundjen e rëndë, e kisha të pamundur. Qysh atëherë më ka mbetur ndjesia se gjuha ka dy rrënjë, në gojë dhe në zemër.
***
Punë ditësh, derisa morëm vizat në ambasadën austriake, në spital përparuan analizat. Dritanin e vizitoi një mjek onkolog, doktor Franciosi, me të cilin na priste një rrugë e gjatë më pas, dhe e njoftoi se mund ta transferonin në pavijon tjetër, domethënë, në atë më të frikshmin. I sigurt se çfarë trazimesh mund të shkaktojë te çdo i sëmurë një lajm si ky, i fola gjatë në telefon, mos u tremb, Tanush, ai ujk që po të ndjek nuk duhet të të kafshojë prapa shpine, prandaj vërja shpatullat murit, shihe drejtpërdrejt në sy dhe kacafytu me të: duke shkuar në onkologjik, nuk do të thotë se medoemos e ke atë sëmundje, por nëse e ke vërtet, vetëm aty mund të diagnostikohesh e të kurohesh.
Po, po, miratoi në anën tjetër.
Veçse nuk mund t'ia shihja se çfarë i shkruante fytyra e bukur pas thirrjes sime patetike për luftë të shpallur, një luftë të pabarabartë dhe

mizore, jo me ujkun por me kuçedrën me shtatë koka, së cilës mund t'ia presësh njërën, mund t'ia presësh edhe tjetrën, por nuk mbeten pesë, bëhen prapë shtatë, sepse i dalin të reja.
E tamam në katin e shtatë do ta çonin.
S'di si nuk m'u tha goja atë çast, si munda ashtu, pa asnjë parapërgatitje dhe pa e kaluar fare në palestër, ta ftoja djalin për t'u hedhur drejt e në arenë. Brishtësia e tij, durimi dhe intuita e tij e vetëmjaftueshme, përveç dhembjes së hatashme, do të na bënin pastaj rreptësisht të kujdesshëm, aq sa gjithë të vërtetën e sëmundjes do t'ia paraqisnim me një ambalazhim që e vishte tebdil.
***
Kur arritëm, kishte dalë me leje nga spitali për të na pritur në shtëpi. Ishte prapë e shtunë, si dita kur iu drejtua urgjencës prej diplopisë së syrit të djathtë, që tash ia kishin mbyllur me garzë. Syrin e majtë ma lini jashtë, sikur më murmuronte një zë nga llagëmet e folkut. Ma lini jashtë një sy, sa t'i shoh prindërit që më vijnë nga larg, ngulmonte zëri prapë.
Duket paksa fatale, por të shtunat përvëluese do të na ndiqnin deri në fund dhe, sido të interpretohen, nuk dua të fsheh asnjë rastësi, do të na ndiqnin deri tek e shtuna kur Dritani mbylli sytë (edhe të majtin, pra), madje deri në ditën e sotme, kur po nis këto shënime, 25 mars 2006, fiks tri javë nga ditëvdekja e Dritanit, fiks e shtuna e ditëlindjes sime, kur mbush gjashtëdhjetë vjeç rrumbullak.
S'e kam kapur asnjëherë atë çastin e shkurtër, i cili i mjafton lules për të çelur. Por buzëqeshja e Dritanit gjithnjë më kujton vetëm një çelje, atë të trëndafilave. Ishte goja e tij dhe lezetet e fytyrës së tij që ma japin këtë përfytyrim. Na priti duke buzëqeshur dhe e kuptova se kërkonte të na jepte zemër, por edhe se ishte ende pa teprime ngarkesash, ende i painformuar plotësisht për sëmundjen e vet. Bandën që ia vuloste syrin e trajtonte shpërfillshëm (do të rezultonte si damka pyjore që vulos drurin e caktuar për t'u prerë), dhe nuk e jepte veten, megjithëse krahu i majtë, që i shkaktonte dhimbje në çdo lëvizje, tashmë i rrinte si i varur. (Derisa të sharrohej trungu, druri do të pritej me copa, degë pas dege.)
Aty për aty, edhe pse diku i shtypur, nuk m'u qas as mua mendimi i vdekjes. Veçse flokët e tij, forma e flokëve, për çudi më sillnin pamjen e dhëndrit, atë pamje që kishte pasur në dasmën e vet dhe që, të regjistruar në video-kasetë, e shihnim në Tiranë për të hequr mallin. Leja që kishte marrë në spital, ishte si një leje që i kërkohet Vdekjes. Ia kishte marrë për t'i pritur prindërit me një darkë festive, darkë me mish e verë të kuqe, por që me gjithë përpjekjet e dyanshme, prapëseprapë nuk

po gazmonim, nuk po arrinim t'i jepnim atmosferën që ndizej zakonisht në takimet tona. Aty, në tryezë, u kujtua sërish dhe na drejtoi po atë pyetje, të cilën na e kishte bërë sapo hapnim çantat e udhëtimit. Dukej se nuk ishte bindur nga fjalët tona dhe pyeti se përse nuk ia kishim sjellë romanin tim të ri, që kishte dalë nga shtypi prej pak kohësh. (Shkrimin më të parë për të, që arrita ta lexoja në FJALA përpara se t'i drejtoheshim ndonjë agjencie udhëtimi, Elvana Zaimi e kishte emërtuar mistershëm: "Ku priten bileta për në Parajsë".) Të thamë se e harruam, iu gjegj po njëlloj e ëma, e kishim vënë kastile në tavolinë, por në çastin e fundit, nga nxitimi, na doli nga mendja që ta fusnim në çantë. Lëvizi njërin cep të buzëve, sa për të thënë se kjo harresa ishte një finte, pasi ai na kishte kujtuar gjithnjë, madje dhe në telefonatën e fundit, kam qejf ta shoh si ka dalë dhe kam gjithë kohën e mundshme për ta lexuar shpejt, kishte thënë. Pa i përmendur ende me zë ato përqasjet e tjera të kobshme, në atë situatë vetë titulli "Las Varrezas" na kishte ndaluar për t'ia çuar.

Për të gjithë njerëzit jeta është e shkurtër, me përjashtim të atyre që vdesin të rinj.

O Zot, si më hypi në kokë ky paradoks që nuk po më ndahet?! S'është çudi që, së pari, të më ketë ardhur në mend asaj nate në tryezë, me verën e kuqe, bukën si naforë dhe Dritanin përballë. Në atë darkë nuk mund të përjashtohej një efekt transustanciacioni, çka përfshin edhe idenë se kush vdes i ri, do të thotë se ka vdekur për dikë tjetër. I zbehtë, i bukur, i pakonsumuar. Ku do t'i nguleshin gozhdët, kur të gjakosej duke u kryqëzuar në shtrat? Sa hemorragji do të kishte?.. Por do të vinte dhe ky çast, gjakun do ta shihnim me sytë tanë dhe do t'ia fshinim me duart tona.

Për fat të mirë, miqtë nuk e panë ashtu. Të ngurosur para fotos së tij në format të madh, asaj që u përdor për homazhe, gratë do të kujtoheshin deri për metamorfozën, që një prind e paskësh vërejtur para nesh: O bir, të pati nëna njeri, tash të ka fotografi! Ndërsa disa të tjerë, të cilët nuk e kishin takuar më qysh nga dasma, do të pohonin: E pamë dhëndër dhe po e shohim në mort.

***

Me kalimin e kohës, çfarë po ndodhte me Tanushin?.. Në fund zhvillohej lufta e trurit, ku kishin vërshuar metastazat, me zemrën e një tridhjetë e gjashtëvjeçari. E re për nga mosha, e blinduar për nga vullneti, pompa vitale nuk donte të jepej. Rreth dy pëllëmbë e ndajnë trurin nga zemra dhe zemrën nga truri. E shkurtër kjo rrugë për t'u

përshkuar, po sa e largët nganjëherë, madje aq e largët, sa dhe njerëzimin e ka ndarë në dy pjesë: qysh nga Epikuri dhe Zenoni, gjysma shkojnë kah u thotë zemra, kurse gjysma tjetër kah u thotë truri. Tash kishte ardhur koha e betejës finale, hakmarrjes dhe pajtimit përmbarues.
Përveç tensionit arterial, infermierja e natës vinte për t'i matur me aparat sasinë e oksigjenit në mushkëri. Deri vonë e kishte 90, pra në normë, kur binte në 87 i vinte maskën e oksigjenit. Por oksigjenin më shpesh e përdornim vetë, ia ushqenim herë pas here nëpërmjet hundës, ashtu si buzët ia mbanim gjithnjë të njoma. Në kërkim të rënies së kadifejtë, nuk donim të vdiste i asfiksuar por i ngopur me ajër, shpresonim se edhe zemra e ka një qendër komandimi në tru dhe kështu, si duke ulur një çelës, zemra do të merrte komandën e ndalimit.
Një copë herë prita se mos thoshte ndonjë fjalë, diçka që të mund t'ia shkoqisja kuptimin ose ta merrja me mend, diçka nga ato që quhen amanetet e fundit. Qoftë dhe tërthorazi, atëherë kur kishte patur kohë edhe forca, nuk më kishte lënë asnjë porosi. Kam pyetur të shoqen dhe të ëmën, asnjë as atyre. Megjithëse i mbytur në lot, ende e administroja situatën në dhomë, madje pyeta veten se mos ishte çasti t'i thoja diçka. Ne nuk do t'i kërkonim të na falte, ne na duhet t'i shlyejmë vetë mëkatet tona, ndërsa atij nuk kishim çfarë t'i falnim, ai mbetej Engjëlli ynë. Siç po i qëndroja te koka, u përkula më shumë edhe nisa t'i flisja. Asgjë e përgatitur, vetëm çfarë më vinte aty për aty. Të faleminderit biri im, të faleminderit miku im, u mundova të shqiptoja qartë, jam i sigurt se ti të gjithëve na njeh mirë, por edhe ne i njohim mirë dëshirat e tua, ti nuk i thua, por as ka nevojë t'i thuash, rri i qetë, Tani, më e mira do të bëhet, do të bëhet më e mira, o shpirt!..
Kisha bindjen se po i përcillja pikërisht çfarë duhej, sepse në ato çaste, dhe s'mund të ndodhte ndryshe, përveç gazepit për prindërit e të afërmit, e përvëlonte gazepi për fëmijët, Kevinin e Livian, doemos për të shoqen, Elionën tridhjetëvjeçare.
***
Pak nga pak po thyhesha. Megjithëse kisha qenë unë, që ua kisha ndaluar të tjerëve të qanin në dhomë, burri i rreptë kishte filluar ta lëshonte veten. E kjo kuptohej nga ngashërimat që më tradhtonin. Përkundrazi, gratë po bëheshin më të forta. Ime motër nuk guxonte sërish, por vetë ime shoqe më kujtoi se duhej të dilja, ndoshta ka ardhur çasti që të na lësh vetëm, tha.
A kishte ardhur vërtet? A i kisha thënë unë Zotit: Po, tashti O Zot po ta jap tim bir!.. Mos ishte pikërisht prania ime që nuk po e linte Dritanin të

jepte frymën e fundit? Isha përpjekur gjithnjë, me sa kisha mundur, t'i fshihja lotët prej tij dhe mendimi se ai më dëgjonte teksa po e qaja për së gjalli, më bëri të dorëzohesha.
Por as në dhomën-sallon nuk mund të prisja dot… Aty jashtë çapitej përkrah meje Giancarlo, infermieri robust me sytë ngjyrë deti. S'po përmbahej as ai, më përfshiu ndër shpatulla dhe më tërhoqi përgjatë korridorit. E çfarë t'ju them, signore Çela, foli i ngashëryer duke i lejuar vetes një mëkat profesional, ja, në këtë dhomën këtu dy plaka janë të shtruara, aty ngjitur po pleq, edhe më tej pacientë të moshuar ka, por vdekja po na merr Dritanin! Foli si të thoshte Britanin, se një britmë ishte gati t'i dilte nga goja.
Nuk isha i zemëruar me askënd, askujt nuk ia doja të keqen, përveçse, teksa dilja në platformën metalike dhe ngrija sytë nga qielli, kuptova se isha krejt fillikat, krejt i kotë, krejt i pafuqishëm. Sado që ishte e pamundur të arrinin deri aty, veshët sikur më gjëmonin nga rënkimet nëpër dhomat e pavijonit. Për herë të parë u ndjeva i braktisur nga Zoti. Dhe kur të lëshon besimi te Zoti, dihet se kush e merr pushtetin në dorë. Më kaploi një dyndje djallëzore, dyndje imazhesh të papastra, që më sollën para syve thertoret e Çikagos. Kisha dëgjuar se atje përdoren teknika të larta, deri edhe thundrat përpunohen, asgjë nuk shkon dëm, përveç britmës së derrave.
E si kështu, fola me zë, të ikin njerëzit si derrat?! Po këtu nuk jemi në thertore!
Askush nuk më dëgjoi, isha një vetmitar i dërrmuar para Zotit dhe Djallit, të cilin po kërkoja ta shkelmoja nga vetja. S'pashë si i hodha ato hapa, as si hapa dyert, atë të paradhomës dhe të dhomës. Po hyja për të mos u shkulur më. Por kishin mbetur vetëm minutat e fundit. Matjet e mëparshme kishin treguar se tensioni po binte dhe, megjithëse duart dhe trupin ende i kishte të ngrohta, shputat e këmbëve po i ftoheshin ngadalë. Tashmë nuk kishte asnjë lëvizje, as të vullnetshme e as të pavullnetshme, krahët i mbante shtrirë, afruar me trupin. Po të mos çoja në mend se çfarë kishte ndodhur, po të dëgjoja vetëm heqjen e tij që ishte zbutur mjaft, do të mund të besoja se Dritani po flinte, se unë kisha dalë vetëm përkohësisht në korridor sa ta zinte gjumi dhe, për të mos e zgjuar, do të dilja sërish në majë të gishtave, do të përdorja atë marifetin për derën, pastaj do të rrija gjatë aty, duke pritur e duke vëzhguar. Pse, a nuk është gjumi një vëlla i vdekjes dhe vdekja gjumë i përjetshëm?!
***
E kërkoj nganjëherë, e thërras në emër. Sidomos në muzg. Në muzg dal

në ballkonin tjetër, atë që sheh nga Dajti dhe malet e tjera shpatull më shpatull. Më shkon koka djathtas e majtas, gjithë vargorin e ndjek me sy, pamja më përthyhet prej lotëve, pastaj më ngjan se befas një aeroplan po del nga grykat dhe Tani më përgjigjet: "Mos u habit, u nisa nga Perëndimi e po kthehem nga Lindja, sepse sido të nisesh, bota e rrumbullakët është. Ngado kalova pashë se fati ishte qorr dhe vdekja bënte kërdinë!" Atëherë dylli ndizet, ai qiriu i brendshëm merr shkëndijë papritur. Fap-fap ia bën flaka, fap-fap edhe lotët, por aq përvëlueshëm, sa më shtyjnë t'u flas me zë atyre që nuk i njoh, por e di se janë anembanë. E keni një lutje prej meje, sivëllezër të dhembjes, askënd nuk do të doja ta shihja të përlotur, ma lini mua lotin dhe të jeni të sigurt se, kur qaj Tanin tim, qaj dhe bijtë e botës.

***

Vdekja është ajo që e dimë, por që nuk e kemi provuar dhe, kur ta provojmë, prapë nuk do ta njohim. Çdokujt i mbetet vetëm një mundësi: ta njohë duke parë si largohen të tjerët. Prandaj bota rrudhet vërtet sa herë që vdes një njeri, por rrudhet edhe më shumë kur zvogëlohet vetë njeriu.

Sot na ka ftuar në këtë drekë ai që quhe(t)j Dritan Çela, na ka ftuar për të ngrënë dy kafshata, na ka ftuar thjesht për të na parë bashkë, pa asnjë amanet tjetër, se ai nuk u mor me amanete, nuk tha as më kujtoni, as mos më harroni, la vetëm të nënkuptohej: Për sa kohë që ju nuk mund të jeni me mua, do të jem unë me ju. Dhe ka shumë gjasa për dyvendësinë e Shpirtit, këtë e besoj.

Por a ka gjasa për mua në betejën e pabarabartë, përleshjen shkallmuese me kohën? Është lufta e senseve të kundërta. Dritani do të mbetet i ri, ashtu përgjithmonë, ndërsa mua më duhet të plakem duke mbetur i ri, në mënyrë që ditën (mos do të jetë e shtunë?) kur të bëhemi prapë bashkë, unë të jem i denjë për Miqësinë e djalit.

E këtu mjaft, po mbyllen këto shënime, që i rrëfeva bashkë me time shoqe. Sa ishte gjallë, s'e patëm zakon t'i flisnim gjindjes për Dritanin. Mund të thotë ndokush se tash është vonë. Por ç'të bëjmë pra, në këtë mënyrë na habiti jeta, gjithë jeta na shkoi duke u dashur. Në fillim ne deshëm ta jetonim dashurinë, pas vdekjes u kujtuam se hidhet edhe në letër.

Tiranë, 25 mars – 17 korrik 2006

Jaho KOLLARI

ZDRËMJA

(Fragmet nga romani në dorëshkrim me të njëjtin titull)

Filloi t´u japë veresie njerëzve që s´i njihja dhe të cilët më dukeshin të dyshimtë. Vëreja se përpiqej t´u ndihmojë rrugaçëve, gënjeshtarëve, njerëzve, pra, që më të dashur e kishin gotën e rakisë se kalamanjtë në shtëpi, me fjalë të tjera: njerëzve që s´kishin brekë në birë të bythës! Duli me të madhe shënonte në një fletore të trashë dhe i dukej sikur bënte një gjest të mirë. Mua më thoshte se duhej ndihmuar njerëzia, sidomos ata që ishin në zor. Por hajt dije a ishin në zor, sot askush s´e ka kollaj! *Neve është duke na rënë plasja, ore Dul! Jemi duke e tepruar*, i thoja, *ne s´kemi ç´i bëjmë botës, s´jemi organizatë humanitare*! Por Duli i njihte ata tipa, meqë dikur nëpër kafené kishte pirë me ta. Këtë gjë ma pranoi vetë, duke më thënë se *i njeh mirë* dhe se *me kohë do t´i sjellin paratë*!? Kështu një ditë prej ditëve erdhi motra e Dulit së bashku me të shoqin (ajo ishte e martuar diku në një fshat aty afër) dhe mbushën bagazhin e automjetit përplot mall nga dyqani ynë. Madje edhe u ndihëmova t´i bartnin deri tek automjeti. Unë prit se po i pagojnë, kur ata më thanë t´i shkruaj në defter se, ashtu ishin marrë vesh me Dulin?! Atë bëra dhe, kur arriti ky i fundit, i tregova. *E rregulloj unë atë punë*, ma bëri.

Dita-ditës prisja që bota të nisë të na e kthejë borxhin, meqë faturat e mallit të marrë nga grosistët duhen paguar. *Por prit gomar të dilte bar*, ata vinin përsëri për të marrë plaçka kurse ortaku im u jipte. Kur motra e katundit sërish erdhi *për t´i rënë qarit*, e mora vesh masllahatin: ai u kishte njerëzve borxhe dhe tani, në vend të parave, mirrnin mallra. Po atë gjë bënte edhe motra e tij. Kisha rënë në pikë të hallit; ndodhesha në mes të një skene ku luhej një tragjikomedi! Si të shkëputem nga kjo vorbullë, Imzot!? Ortaku im më shitej se e ndihmon botën, pranoi vetëm borxhin që ia kishte motrës.

Kur bota të ka borxh e nënshtron dhe e poshtron atë, e bën për vete dhe bën me të çfarë të duash! Unë kam mendim që të bëj hamej nga ata që më kanë shumë borxhe, e që s´mund ta kthejnë me kohë. Pastaj nga-njëherë është më mirë të kesh punë me të tillë njerëz se sa me njerëzit e farefisit!?... Këtë thoshte Duli në çastet kur jargonte filozofi të rëndë, e cila aq thekshëm dërrmonte çdo gjë timen sa pyesja veten ç´dreqi bëj këty, përse s´e këpus qafën por nuhas gjithë ato pordhë të qelbura!?

Një ditë prej ditësh u hëngra mirë me Dulin. Shkak ishte veresia e tepruar që u jipte njerëzve. Konstatimi im se në këtë mënyrë do të humbasim myshterinj, në njëfarë dore, e bindi atë. Njerëzit që të kanë borxh tregtojnë cikërrima si, bukë, qumësht, duhan... në ndonjë dyqan tjetër, e në sendet e imëta fitohen para të mëdha. Duli *u bind* aq tepër sa vendosi ta vë në jetë idenë e stërmarrë: *të bëjë hamej nga borxhlinjtë* (si jeni duke e vërejtur, ai që moti ishte bërë hamall dhe sa vinte e ngarkonte *thasët e turpit* mbi kurrizin tim)! Këtë të fundit do ta modifikonte e ndërronte që t´ia përshtasë nevojave dhe vizioneve të veta. Si do të rrjedhë kjo dreq pune do të zbulohej së afërmi.
Pra, u kafshuam fjalësh me ortakun tim. Pothuaj të gjitha idetë ia hodha në fund të pusit. Ai nga protesti mori automjetin dhe u zhduk. Tallja e koqeve ishte stili tij i posapjekur...

* * *

Dita-ditës vëreja se isha bërë një person, i cili pak kujt i besonte (në anën tjetër as mua s´më besonin). Kjo ishte rrjedhojë e kacafytjeve të reshtura që kisha kryesisht me njerëz të këqinj, me njerëz të pabesë, me hajna e mashtrues. Më i madhi ndër ta ishte, pa dyshim, ortaku im. Sado tipare të mira të ketë njeriu, kur ka punë me të tillë njerëz humbet tepër shumë nga mirësia e bujaria. T´i kundërvihesh të keqes me të mirë humbet shumë në shtigje të shkurtëra. Ajo fjala e urtë se *buka e mund gurin* çdoherë nuk qëndron! Pikërisht për këtë edhe isha bërë i prerë dhe i paskurpulltë ndaj disa njerëzve, meqë ku do të veja po të veproja ndryshe!? Isha i vetëdijshëm se jeta i kishte *nëntë kopilí e një trimëri* dhe se të jesh i mirë ndaj të pacipëve nga të tjerët konsiderohesh si budalla që s´e kupton mirë jetën. Në biseda që kisha me njerëz të sjellshëm, të cilët i njihja prej kohësh, e shkapetnim nganjëherë edhe këtë problematikë duke përqafuar çdo këshillë të sinqertë. Shpeshherë i thoja njerëzve, të cilët e kishin njohur babanë tim të ndjerë, se jam shumë më i varfër se kishte qenë ai! Ata nuk më besonin, meqë e shihnin se unë sot kisha më tepër se babai im ndonjëherë. Ai vërtetë nuk ishte i pasur materialisht dhe çdoherë kishte jetuar keq, por në shpirt pati qenë shumë më i pasur se isha unë sot. *Ke të drejtë*, më thonin disa.
Nëna e Dulit ishte një grua e moçme dhe shumë e mirë. Ajo nuk më ndante prej djalit të saj. Nga goja e saj dilnin vetëm fjalë të ëmbla, nga dora saj kisha hëngër disa herë bukë. Kisha ngrënë, pra, bukë derisa Duli m´a zuri në fyt!
Më tha: *Vali! Nuk di a je në dijeni por në shtëpinë time nuk dëshiroj të*

pihej akooli (isha duke pirë një birrë)!?
Mbeta i ngrirë. M´u shtang edhe dora me të cilën haja edhe goja e hapur. M´u duk sikur u ngri kafshata në fyt, birra në gotë... Më ra terr para syve. Me shpejtësi marramendëse më shkonin e vinin mendimet. Disa ishin të bardha, disa të zeza... As nuk isha ai që vazhdoja të ha, as ai që ngrihem. Megjithatë brofa... Thash:
Kërkoj ndjesë që s´e pata ditur se shtëpia jote na qenka bërë xhami dhe se nuk guxohej të bëhet kjo punë e shëmtuar që isha duke bërë...
Pas këtyre fjalëve mora të dal jashtë. Duli tha:
Jo, mos u ngrit! Vazhdo të... - nuk arriti ta përfundojë fjalinë meqë ia prita:
Burrë i dheut! Ti ma zure kafshatën në fyt! S´ka Zot që më bën sërish të ulem. Nëse e paske për gjynah që në shtëpinë tënde të pihej alkooli, përse ma the këtë gjë pikërisht në sofër?!
Mora shishen në të cilën kishte mbetur pak birrë, të mos i lë mbeturina aty, dhe dola jashtë. Duli s´u dëgjua. Si dukej truri i tij gjenial s´arriti të pjellë ndonjë prapësi të atypëratyshme! Nuk e kisha pritur prej tij t´i lëshojë fjalët si lopa bajgat, sidomos jo në sofër dhe në shtëpinë e vet. Se ç´kishte ky njeri!? Ishte përplot komplekse apo kishte një strategji me të cilën dëshironte të më zinte ngusht dhe të më zhbënte!? Një njeri që deri dje vetë e pati keqpërdorur alkoolin më qet bishta që piva një gjysmëbirrë në kuzhinën e shtëpisë së tij! Ky fakt më bënte të mos ndihem mirë dhe të bluaj çkamos. Pas pak erdh, më rrahu supeve dhe tha:
Mbase u preke!?...
Në fjalët e tija kishte kërcënim, ironi, injorancë, nënçmim, përbuzje, poshtërsi, mospërfillje, shtazari, megalomani, trashamanësi, idiotizëm, paburrëri, indiferentizëm, snobizëm, kënaqësi të sëmurë, superioritet, mburrje të stërtepruar... Ishte e pamundur që njëkohësisht të luftohej kundër të gjitha këtyre të këqijave. Mendoja më mirë do të ishte të ngrihem dhe të shkoj diku ku njerëz nuk do të shihja një kohë të gjatë. Të bëhem eremit për t´u shëruar sadopak nga sindromi *njeri*! Ai deshi të më thotë diçka por unë u ngrita dhe i thashë se dëshiroj të largohem. Më pyeti *përse* dhe *ku*? *Përsenë e di*, i thashë, *kurse ku, është punë për mua!* Kështu u largova që andej, duke e lënë Dulin si të përmjerrur mu në tarracën e dyqanit të tij.

* * *

Nëse s´jeni mërzitur do të ju rrëfej rreth veturave, të cilat Duli i ndërronte si këmishat. Mua nuk më pyeste. E përse të bëhej ajo punë:

këmisha të ndërrohet a pyetej kush!?
Duli im shihte shkurt dhe s´i hante palla ç´fshihej pas kodrës. Ishte mësuar, i lumi ai (për mend të kresë), të mirrej vetëm me pasoja dhe shpeshherë me nervozizëm pyeste: *kush është fajtor*, apo: *nga na shkojnë paratë*, ose: *ta kalojmë këtë urë një herë pastaj të shohim e të bëjmë.* Me këtë bënte përpjekje të më bindë se bota ishte mbushur me të çmendur; *merr sa të duash, nuk të pyet kush!...* thoshte shpesh. Me shkaqe nuk mirrej kurrë Duli, nuk kishte kohë për vetvete ai. Të rruhej-rruhej rrallë, të qethej-qethej rrallë, vetëmse e rruanin e qethnin pa brisk ´ pa thikë, e mua më bënte pyetje: *ku na shkojnë paratë*!? Pa dyshim se dikush prej nesh e kishte dorën me vërimë, apo kokën të shpuar! *Bota ha bar*, i thoja ngandonjëherë, *ha, besa-besë, ore Dul! Botës i duhej të hante bar, përndryshe ç´do të bëhet me ne!? Ti lopën e shite dhe mullarin e sanës, e po duhet të kullosë njerëzia. Po neve, a do t´na kapëdijë kush... të na mbllaçisë lopa e kushëririt tënd, të na bëjë bajgë... Në ëndërr të keqe s´shihen këto që është zhgjëndrra jonë, more Dul!...*
Sikur të ishte kjo e tëra?
Kishte kohë që nëna e Dulit i qe qepur shtratit. Saherë ndihej mirë, dilte në tarracë para dyqanit. Kur s´kisha aq shumë për të bërë, bisedonim së bashku. Gati çdoherë më pyeste se ku e kishte të birin. Unë trilloja gjëra të mira për Dulin, çka bënte që kjo plakë e sëmurë, makar për një çast, të ndihej mirë (ndonëse dyshoja se ajo ndihej mirë). Këtë them nga arsyeja se ma kishte zënë syri që i biri e përzënte nënën e vet nga tarraca e dyqanit, ngaqë *i sillej nëpër këmbë*. Kjo sjellje e tij nuk më pëlqente hiçfare, e sidomos ajo që ky *thente qafën* e nuk kisha haber se ku ndodhet. Ishin mjaft momente irituese kur nëna, bashkëshortja e tij apo të tjerët më pyesnin: *ku është Duli*? Ç´t´i thoja?! Se ka vajtur në *rrotë të samës*! Natyrisht që gënjeja, ndonëse valoja nga brenda, më tepër nga fakti se ai nuk tregonte respekt ndaj meje, si bëhej karshi një partneri të barabartë. KU ËSHTË DULI, ishin fjalët më të urryera që mund të dëgjoja e, megjithatë, përçdoditë të lume m´i zinte veshi. Mund të merrni me mend sa vështirë është kur të pyesin për dikend se ku ndodhet, të cilin ti e pret gjysmë dite, e ai me veturë tall bythët duke shpenzuar karburant, e përrugë fiton edhe dënime, ngase i grah makinës pa leje shoferi... Deri tani e pata mbajtur humorin lart (sidomos para gruas, meqë nëna e tij më pyeste shumë më rrallë), por një ditë pas asaj të uryerës: *Ku është Duli*, ia ndava të shoqes së tij se: *unë nuk e ruaj Dulin tënd!* Kjo që i thashë nuk ishte e parëndësi, meqë ajo ishte pak si torollake, mbase xheloze (ndaj Duli duhej ruajtur të mos humbasë

asgjëkundi), dhe nuk e kuptonte ç´do të thotë që pothuaj çdo ditë të parashtrohej po e njëjta pyetje. Ajo besa u nxe dhe murmuriti diçkafën, por nuk i vura vesh. Isha regjur me të tilla prapësi.

Ortaku im ishte në vazhdën e avazit të moçëm; humbiste sa as vetë i mallkuari nuk kishte haber se ku qëndronte i strukur. Gruaja e tij tashmë tepër rrallë më pyeste: *Ku është Duli*? Në vend të kësaj ajo vinte dhe shpesh zënte të *çante dërrasa* me mua. I shoqi i saj s´çante bythën për të, për nënën, për mua, për dyqanin... Ai ishte i stërngopur me vetvete dhe mbase ishte kapabër të bënte çmos për ta ruajtur statuskvonë. Ezmerja ende punonte te ne. *Punonte*?!... Më mirë të thuhej: *tallte felet*...

Ishte verë e madhe dhe bënte vapë e papërmbajtur. Megjithatë bashkëshortja e Dulit mbante të veshur një fustan me mëngë të gjatë. Nuk e kisha zakon të shikoj ç´veshin njerëzit, as më tepër gratë e huaja, por kjo gjë i kishte rënë kujtdo në sy. Kjo e fundit dukej disi e trishtuar, gjë që vërehej dita-ditës. Njëherë zuri të më bisedojë disa gjëra (të cilat nuk dëshiroja t´i dëgjoja) dhe ta mallkonte të shoqin. Isha më se i bindur se diçka e mundonte. Në ata momente nuk kisha nerva të rrekesha me shkaqet dhe arsyet përse ajo, në njëfarë dore, u hap para meje. Njëherë kujtoja se e kishte nga mendja e zezë, për të cilën gjë, jo rrallë, ankohej Duli.

Në njërën prej ditëve, kur ajo i kishte shpërvjelur paksa mëngët e fustanit, më zunë sytë disa njolla mavi në të dyja duart e saja. E dija se nuk i kishte nga përkëdheljet. Ajo ishte shtatzënë asobote, ashtu që me vështirësi e pranova faktin se Duli e zdëpte.

Një ditë e vërtetova me sytë e mi marifetin; i pashë në oborr të shtëpisë, haptas ku i shihte tërë bota, duke bërë gallatë. Duli i jipte gruas shtatzënë dajak me thepa. Një skenë mjaft lebetitëse. Desha të ndërhyej, meqë më vajti mendja te fëmija i palindur. Por ortaku im fashiti sjelljet dhe erdhi drejt dyqanit. Ndërsa e shoqja e tij u fut në shtëpi e përvajtuar, ai nga mllefi as që më vërejti, përveç që hyri në automjet dhe këputi qafën...

Më kot i thoja; *avash arkadash*, ky e kuptonte marifetin si gomari turçen...

(Surahammar, Suedi 1993)

Gazmend ÇITAKU

LIKACENI

Ulqinakëve, të njohur si lundrues të shkathët, u janë thurrë përralla e legjenda. Legjenda këto, pra, mbi detarë të mëdhenj, të cilat edhe sot e gjithë ditën qarkullojnë prej gojës në gojë. E vërteta, figura e Likacenit nuk lidhej me përralla e legjenda, emri i tij është një legjendë më vete! Emri i vërtetë i këtij trimi legjendar është Ali Kaceni, por ky emër me kohë ndryshoi sa sot në përrallat që tregojnë gjyshet tona zihej në gojë vetëm si Likacen.

Si bisedojnë ulqinakët e moçëm, Likaceni nuk qe veç një detar i rëndomtë, ai ishte një Ujk i vërtetë deti, i cili kur dilte në ujërat e hapura të detit, ekuipazhi i tij përbëhej kryekresë nga gjemxhinj ulqinakë. Kur Likaceni pas një lundrimi të gjatë kthehej në Ulqin, ahengu nuk ndalej tri ditë e tri net. Anëtarët e ekuipazhit, përveç pagës që mirrnin nga kapidani, shpërbleheshin poashtu edhe me peshqeshe të ndryshëm. Kthimit të Kapidanit i gëzoheshin të gjithë qytetarët ngaqë pothuaj për të gjithë kishte dhurata, sidomos fëmijët jetimë, baballarët e të cilëve kishin humbur jetën në det, më së shumti i gëzoheshin Ujkut të detit.

Vit pas viti, përveç tregtisë që bënte, Likaceni jo rrallë i ndodhte të përleshej me anije të ndryshme, që lundronin nën flamurin e Venedikut por edhe nën flamuj tjerë. Kapidan Likaceni falë shkathtësive të veta lundruese ia dilte që anijet konkurrente t'i zaptojë, të gjithë mallin që kishin ta përvetësojë, të cilin pastaj, pasi kthehej në Ulqin, ta ndante në hise. Një hise obligative mirrte administratori i qytetit, një hise tjetër e ndante barabar mes ekupiazhit, kurse një pjesë të konsiderueshme e jipte për bamirësi. Likaceni si detar nuk përleshej, pra, vetëm me anijet që mbanin flamurin e Venedikut por edhe me ato të Perandorisë Osmane, kështu shpesh i sillte kokëçarje edhe vetë Sulltanit në Stamboll.

Në një rast, kur sulmet e piratëve të kohës u bënë të padurueshëm, kupën e mbushi sulmi i piratit grek, Karallampo. Ky sulmoi anijen që çonte pelegrinë, të cilët ishin nisur në haxhillëk. Pirati famëkeq, jo vetëm që i plaçkiti të gjithë, por ua fundosi edhe anijen kështu që të gjithë humbën jetën. Hidhërimi i Sulltanit arriti kulmin, në ç´rast dha urdhër për zënien e piratit mizor dhe ai që do të bënte këtë gjë do shpërblehej mirë.

Për shkak të telasheve që më parë ia kishte sjellur Sulltanit, Likacen-Ulqinaku vërejti këtu një rast të volitshëm të rehabilitohej, që pastaj i lirë të vazhdojë lundrimet si në Adriatik ashtu edhe në Mesdhe, pa drojë

që t´i hyjë therrë në këmbë. Prandaj vendosi ta ftojë në dyluftim piratin mizor. Në Ulqin u përhap lajmi për vendimin guximtar të Kapidanit ulqinak dhe tellalli thirri:

Oj gjidi hoj, oj gjidi hoj!

Pa dëgjoni ju o popull:

Kapidan-Likaceni ka vendos´ që të dalë në det dhe të ftojë në dyluftim piratin Karallampo. Lundrimi do të jetë shumë i rrezikshëm dhe ka mundësi që të mos kthehet më në Ulqinin tonë. Ekuipazhi standard, me të cilin gjithmonë lundron, nuk është obligativ! Le ta shoqërojnë ata, të cilët janë të gatshëm për luftë fyta-fytas...

Ooooj gjidi hoj, ooooj gjidi hoj!

Pa dëgjoni ju o popull:

Likaceni tha: ***Në rast se gjallë nuk kthehem mos më qani por më kujtoni si gjithmonë me këngë e valle!***

Pas lajmit, heret në mëngjes para velanijes së Kapidan-Likacenit, ishte mbledhur i gjithë ekuipazhi pa dallim moshe e përvoje si dhe të gjithë detarët tjerë ulqinakë, të cilët ëndërronin që së bashku me detarin e famshëm të luftojnë kundër Karallampos. Likacenit iu bë zemra mal kur pa turmën që ishte mbledhur, në ç´rast i falendëroi të gjithë bashkë-qytetarët e vet për besimin e dhënë. Pa u menduar gjatë, mori ekuipazhin e vet të përhershëm, ngriti velat e anijes dhe iu vërsul gjerësisë së detit. Atë ditë moti ishte shumë i mirë: fryente një erë e lehtë, e cila disi u jipte një ndjenjë ulqinakëve se pas këtij momenti asgjë nuk do të mbetej ashtu siç ishte më parë...

Anija e ulqinakut të rryer qëllimisht lundronte nëpër ujërat që i "takonin" pirati Karallampo, mirëpo ky i fundit nuk shihej gjëkundi. Pas një jave anijet u takuan. Pasi Karallampoja famëkeq territorin e Moresë e konsideronte të vetin, ftoi Likacenin që para dyluftimit të jetë mysafir i tij. Ky i fundit pranoi ofertën.

Në mbrëmje Likaceni vajti në anijen e Karallampos. Në kabinën e nikoqirit ishte shtruar një darkë e veçantë. Në ndërkohë piratët e Karallampos sollën një fuçi baroti, që pastaj mbi të të vendosin një qiri të ndezur. Këtë veprim Karallampoja e bëri me qëllim që të frikësojë ulqinakun. E gjithë kjo dështoi, meqë trimit ulqinak nuk iu tremb syri. Ky bëri sikur ky lloj veprimi s´i bën përshtypje, darkoi si mos më mirë duke injoruar edhe atëherë kur qiriri u shua fare mu aty mbi fuçinë e barotit! Karallampoja e pa se kishe të bënte me një Ujk të vërtetë deti, të cilit syri çap nuk i bënte.

Pasi që mirë e mirë hëngrën e pinë dhe pas llafeve e muhabeteve që kishin bërë, erdhi koha që Likaceni t´i kthehej anijes së vet. Për t´ia kthyer mikpritjen piratit famëkeq, ky vendosi ta ftojë Karallampon të jetë nesër mysafir i tij.
Të nesërmen Karallampo shkoi në anijen e ulqinakut. Pa hyrë në kabinën e Likacenit vërejti që e tërë anija ishte përplot me barot dhe qirinj të ndezur, gjë që paraqitte rrezik që kjo çdo çast të fluturojë në erë. Refuzimi i Karallampos dha të kuptohej se veprimi i Likacenit e tmerroi. Kjo frikë bëri që ulqinaku i rryer t´ia zaptojë zemrën Karallampos.
Në dyluftimin që pastaj ndodhi ndërmjet tyre, Ujku ulqinak doli fitues.
Kapidan-Likaceni dha urdhër që bashi i anijes t´i drejtohet Stambollit duke u kujdesur që koka e Karallampos të vendosej në një vend ku do të ruhej mirë dhe për një kohë më të gjatë.
Posa mbërriti në Stamboll i dërgoi fjalë Sulltanit për qëllimin e ardhjes së tij.
Ky menjëherë e ftoi në pallatin e vet. Kapidanit ulqinak, si dhe të gjithë ekuipazhit, i shtroi një darkë dhe aheng të paparë me vallëtare nga Armenia, zbutës tigrash nga India, akrobatë nga Samarkandi... Edhe pse njëri prej piratëve më famëkeq tashmë kishte vajtur në histori, Sulltani nuk ishte i kënaqur ngaqë kishte urdhëruar që të robërohej Karallampoja dhe të sillej i gjallë në Stamboll! Për sjelljen e vetëm kokës së piratit, Kapedani ulqinak hetoi pakënaqësinë e Sulltanit, por nuk mundi të vërejë dredhinë e këtij. Sulltani kishte urdhëruar që gjatë darkës në mënyrë të fshehtë t'i hidhej pluhuri i gjumit në pije, që Kapidani të humbë ndjenjat dhe pastaj të rrasej në qelinë më të errët të kullës jugore të kazamateve në Pallat. Kështu edhe ndodhi. Në mëngjes Likaceni u zgjua në burg. Këtij asgjë nuk i kujtohej, përveç bukuroshes armene, e cila natë më parë para tij kishte vallëzuar dhe kënduar. Ekuipazhi ulqinak ishte mbledhur në anijen e vet dhe priste Kapidanin të kthehej që të marrin drejtimin e Ulqinit.
Kaloi një ditë, kaloi e dyta, e treta dhe kështu më radhë, por Likaceni nuk shfaqej.
Biruca e qelbur e burgut, ku ky ndodhej, i dha të kuptojë që Sulltani dinak e kishte tradhtuar dhe që s´pritej gjë tjetër përveç që edhe koka e tij të fluturonte. Në morinë e mendimeve iu kujtua një dredhi, të cilën vendosi ta vëjë në jetë. Thirri gardianin e burgut dhe i tha se po ta lironte do ta shpërblejë me aq flori sa që me pagën, të cilën ia jep sulltani, do t´i duhej një ymër insani për ta mbledhur. Në fillim gardiani refuzoi. Nga frika e ndëshkimit nuk dëshiroi të dëgjojë. Mirëpo lajkat e ulqinakut dhe

oferta e tij me fjalë bindëse që i përdori, bëri që gardiani të luhatej**.** Ky qe çasti që Likaceni shfrytëzoi. I tha gardianit që tinëz të shkojë në anijen ulqinake dhe t´u thotë detarëve të bëhen gati, ngaqë shumë shpejt Kapedani i tyre do të kthehej për të lundruar për në shtëpi.
Kështu u tha dhe kështu u veprua. Gardiani shkoi në anijen e Likacenit dhe përcolli fjalët e këtij. Haliti, nipi i tij, falënderoi kasnecin, vajti në kabinën e Kapidanit dhe ia solli gardianit një qese plot flori. Gardiani mbeti i habitur me sasinë e florinjëve, por mendja menjëherë i shkoi te tradhtia. Mirëpo Haliti, i regjur edhe ky në jetë dhe det, ia lexoi mendimet gardianit dhe vendosi t'i japë disa këshilla. U ulën në tavolinën e improvizuar në kuvertë. Nipi i Kapidanit nisi t'i tregojë gardianit se këta ishin në dijeni se ky e kishte jetën e vështirë, se kishte shtëpi në lagjen Topkapi, ku jetonte me bashkëshorten Nazlijen dhe me dy vajzat adoleshente, të cilat ishin shumë të bukura. Andaj, po t'i ndodhte diçka e papritur Kapidanit ulqinak, as familja e tij më nuk do të ishte e sigurtë! Tosun-agës iu çuan flokët peshë. Vërejtja e Halitit e mbushi frikë, mllef por edhe vendosje. Kishte dëgjuar për trimërinë dhe besën shqiptare andaj ofertën që shpërblehej edhe me dy qese të tjera ari e mori me shumë seriozitet dhe u zotua se enkas do të angazhohet që Likaceni të mbërrijë shëndosh e mirë.
Sapo u takua me Likacenin, Tosun-aga e njoftoi me planin e ikjes dhe rrugën se nga duhej të kalonte. Pasi planifikuan ikjen pikërisht me rastin e marrjes së ushqimit, pas daljes nga qelia së pari duhet t´i ngjitej murit të lëmuar të kullës së burgut deri në majen e saj, ta çarmatoste rojen. Pastaj duhet të nisej drejt bedeneve veriore dhe prej kullës së tretë, nga një lartësi prej 30 metrash, të kërcejë në det. Sanalli, me detarë në shërbim shpëtimi, do ta presë aty.
Me ndihmën e Tosun-agës dhe falë shkathtësisë dhe përgatitjes fizike që kishte, Likaceni arriti që misionin ta çojë deri në fund. Ky i fundit falendëroi ish-gardianin e tij për gadishmërinë për ta ndihmuar duke ia dhënë edhe 2 qese florinj. Njëherit, duke qenë i vetëdijshëm për shkathtësitë dhe gjetshmërinë e Tosun-agës, i ofroi këtij të vijë me tërë familjen e të jetojë në Ulqin që t´i shmangej hakmarrjes së hyqymetit. Pasi u përshëndetën u zotuan se pas tre muajsh sërish të takohen në molin e Stambollit ku Tosun-agën do ta ndihmojë për t´u shpërngulur për në Ulqin.
Ndërkohë rojet zbulojnë ikjen e Likacenit dhe jipej urdhëri të ngritej zinxhiri mbrojtës në portën kryesore, në mënyrë që asnjë anije të mos mund të hyjë e as të dalë pa u vërejtur dhe pa marrë lejen paraprake. Me

qenë se më heret, për qëllime tregtie, Kapidani ulqinak kishte mbushur hambarin e anijes me grurë të blerë, jep urdhër që, para se të mbërrijnë te zinxhiri mbrojtës, tërë sasinë e grurit ta zhvendosin në pjesën e kiçit. Duke vepruar kështu, bashi i anijes u ngrit shumë lart dhe falë shpejtësisë që kishte, në të arritur te zinxhiri mbrojtës, anija hipi deri në gjysmën e vet mbi zinxhirin mbrojtës ku edhe u ndal. Në atë moment Kapidani jep urdhrërin tjetër që shpejt e shpejt grurin ta zhvendosin në pjesën e përparme, në bash të anijes! Barra e rëndë e grurit batoi anijen në dretim të kiçit dhe me këtë manovër, që ishte një dredhi e rryer e Likacenit, arritën ta kalojnë pengesën. Osmanët mbetën të stepur nga kjo ide, ngaqë deri më atëherë qenë të bindur se zinxhiri ishte pengesë që s´kapërcehej. Ekuipazhi posa kaloi pengesën lëshoi dy plotune nga topat e anijes në mënyrë që të përshëndetej Sulltani.

Me shpejtësinë më të madhe, anija mori drejtimin e Ulqinit, ku lajmi për burgosjen e Likacenit dhe për tradhtinë e Sulltanit tashmë kishte arritur. Ulqinakët, duke mos shpresuar më se do ta shohin të gjallë Likacenin, kishin vendosur t'i piqnin hallvë dhe ena në të cilën kjo e fundit bëhej të ishte aq e madhe sa të përzihej me rrem të gjemit.

Kur anija e Likacenit u paraqit në horizont, i pari që e ndjeu prezencën e saj ishte detari-plak i verbër, i cili sytë i kishte humbur në një përleshje mes anijesh. Ky filloi të thërrasë emrin e Likacenit dhe ia nisi këngës si në vijim:

Ç'janë këto gjama që po bjen era
Po luftojnë dy barka me vela
Priten burrat merren krena
Likaceni trim si rrfeja
Shumë grekinja la të veja

Na ka dal nji harap prej detit,
Shum haraç pa naj lyp dauletit
Karallampon kush e myt
I nap mall sa i shofin sytë
Karallampon kush ma bje të gjallë
I nap xhevahirë i nap ar
Gjithë gjemxhitë pa baxhdar

A e di mor Li Kacen
Ai është rrezik e tmerr
Prej tij dridhet dhe vet sulltani
S'ka çi ban as venecijani.

Nuk jam unë sultan as venecian
Por ulqinak detar i rrallë
Karallampon piratin zullumqar
Si trofe n'dyrek do ta var.

Gjithmon bashk kena qen, o Li Kacen
Edhe tesh na me ty jemi
Eni shokë ta ngrejmë velin
Po i thërras edhe detarët per rrem
Në rrugë të gjatë të na përcjellin

Këtë luftë që po ndini sat
Paska has zjarmi n'barat
Barka tuj lundru nëpër valë
Llampoja para n'aj ka dalë
Dorzonu more shqiptarë

Li Kaceni qenka nalë
U gatu megjithë detarë
U ba gati heq taganin
Llampos po i lyp mejdanin.

Likaceni trim me halle
Ç´e muloj grekun me marre
Karallampos i bani ballë
E lidhi me gjithë detarë
Ja kallxoi xenatin grekut
E lidhi n'maje t'dyrekut

Likaceni ujk i gjallë
Si vetimë detin ka marrë
Zullumqarin Llampon e zi
Do t'ia çojmë sulltanit dhunti.
Mrrin në portin e Stamollit
Likaceni si zag sokolit
Përpara i dalin dy javera
Dhe ja çun sulltanit te dera
Hyni te ai dhe u njoftue
Ali Kaceni më thojnë mue
Nji peshqesh ta kam prue.
N´dyrekë t'barkës e kam varë
Karallampon grek zullumqar

U ndal Sulltani bani mendim
Ky arnaut qenka shumë trim
Mas ma leni mu kthy n'Ulqin
Nuk i nap këti asnji flori
Asnji grosh asnji inxhi...
Me ferman tha: Kyt gjygym
Menjiher mi fut n'syrgjym
Kërclloi dhamtë Sulltani turk
Likacenin e hedh n'burg!

Likaceni trim sokoli
Thej burgun edhe doli
Rraplloi barka me detarë
Natës ´errët t'uj çu valë
Tuj këndu për këtë t'mirë
I takoj barka n'sinxhirë...
Edhe turqit kishin ba be
Gjallë s'dalin në Mesdhe.
Në bash mallin e batojnë
Prej sinxhirve mirë pshtojnë

Lamtumirë mare Sulltan plak
S'paske pas ti besë aspak
Nuk ke pa azgan ulqinak
Qi s´i lidh hapsi e s'hajnë dajak
Si kajnë frigë kulshedrat e detit
Ja se ja këlyshat e dauletit

Shkëlqej dilli nelt n'hava
Çou Ulqin e kënda me za!
Shend më të madh për ne nuk ka
Nëpër tym, neper tallaz.
Ka ardh Li Kaceni në Vardanas
Zhungullon kënga anë e mbanë
Li Kaceni erdhi në Ranë
Gërset pushka, ushton deti
Mendon turku se u ba gazepi.
Li Kaceni përmi barkë
-Mirë se ju gjeta ulqinakë
-Mirë se na vjen trimi jonë
-Ty të paçim përgjithmonë

Li Kacen, mar Li Kacen
Po t'përzihet hallva me rrem
E po të hahet me dyzen!

Vildana Dibra ZHUBI

DULÇINEA, DON QUIXOTE DHE BUKURIA QË T'VERBON

Aty pra ia fillon e gjitha.
Në lashtësinë e shekujve, legjendave, këngës, puhisë, valëve të detit dhe gërshetimit të së bukurës me atë që vret.
Zgjohem nga gjumi, hap një sy por drita nuk me lë dhe i mbylla sytë përsëri. Një erë e mbasdites që edhe gurin e pëlcet nga malli nuk ndalet. Frynë lehtë e bukur dhe më fshinë djersën nga balli. Disa zogj me cicërrimat e tyre garonin me gjinkallën e kopshtit jeshil se kush e ka zërin më të bukur.
Herë dëgjoj zogun herë gjinkallën dhe shoh një gjarpër që fishkëllon duke u dredhur si djalli dhe mundohet t'a prishë gjithë bukurinë. Për çudi nuk u frikësova, se ne Ulqinaket e njohim gjarpërin shumë mirë. E dijmë mirë se kush është.
Po nuk prishen momentet magjike për gjarpërin. Ata janë kudo.
Era nuk ndalet, herë dëgjoj gjethet e fikut, herë të ullirit mijëvjeçar para shtëpisë vjetër dhe diku më larg lajmërohen edhe ato të gështenjave afër kronit Kajushit.
Më zë gjumi nga bukuria dhe flladi verës .
Sikur zanat më vien në ëndërr të gjitha!
Së pari një plak i vjetër shumë i vjetër më thotë " unë jam Iliri plak, jam gjuha jote, jam më se 2000 vjeçar i vjetër, jam feja, jam djepi yt. Më ledhaton ballin lehtë dhe zhduket.
E thërras të kthehet, çirrem në gjumë, por kot.
Miguel de Servantes është aty, më thotë një zë i panjohur, ai po kërkon strehim nga plaku. Një zë tjetër më thotë shko dhe kërko në labirinthin e rrugëve të citadelës, aty i ke.. Shiko aty afër altarit të Artemidës.
Sillem vërdallë përreth Pallatit Venecia, afër rezidencës të administratës Venedikase. Vazhdoj në tregun e robërve. Shoh disa fytyra të vrenjtura që nga malli i pikojnë lotët mbi faqet që shëndrisnin nga dielli që përvlonte dhe hedhin vallen afrikane. I shtrijnë duart e zeza të gjora me sytë e frkësuara të trumcakut që kërkon çerdhen e re ke plaku. Kërkojnë një emër dhe mbiemër nga Zoti i detit që i solli këtu në hapsirën e hyjnive. Më thonë se plaku ka një hall. Dolçineja e bukur e magjepsi një rob të huaj dhe plaku duhet të jetë aty. Serveti pra, ai vet! Se një

kryevepër botërore po lind në gjirin e plakut. Don Quixote po lind në duart e plakut dymijëvjeçar.
Sillem si e habitur. Po ky, nga doli. Sabbatai Zevi. Se çka lyp ky në gjirin e plakut? Smyrna e Turqisë së largët ishte për te edhe pse këtu ky u strehohet?
Vazhdoj të lexoj mbishkrimet iliro-pellazge, latine, greke, venedikase, osmane dhe fishkllimeve të gjarpërit. Sheshi i mbushur me robër. Sillen majtas-djathtas, pa u ndalë në vallen e gyrbetit! Nga një uh i del nga zemra por vallja nuk ndalet.
Obobo, po kush e kupton ndojgjë këtë plak?
Shoh diçka shkëlqen në gurët e Kalasë.
Ulem, shikoj monedhën e Ulqinit, në revers Agnus Dei dhe avers Zonja e bekuar me Jezu Krishtin në duart e veta. Hajde, kuptoje tani. Kush vjen e kush shkon. Plaku i urtë i përballon të gjitha. Luftërat, furtunat, piratët, venedikasit, ormanët, knjazat e mbretërit madje edhe të birin e djallit.
Plaku mbanë krenarinë. Unë sorollatem gurëve të historisë e habitur. Shikoj pak më poshtë, Arnold von Harffi po shkruan diçka por nuk ndalova. Kërkoja plakun. Edith Durham diçka nuk e ka të qartë. Ajo vjen nga një kulturë tjetër dhe fascinohet me bukurinë tonë! He merre vesht ti tani? Edith Durham po mahnitet?
Gjethet nuk ndaleshin. Flladi herë më përvlonte herë më freskonte. Vinte vale-valë mbi ballin tim. Freskia vinte nga gjethet që dridheshin si zemra voglushes kur sheh ëndrra.
U zgjova. Diku nga larg dëgjohej urimi "Vajzës filanit i urojmë fejesën me djalin e filanit me këngëtaren e XY".
I mbylla sytë fort. Dëgjova fishkëllimën e gjarpërit. Mbylla gojën mos me bërtitë. Mbylla vesht por më kot! Zëri fishkëllues i gjarpërit sa vinte e më shurdhonte edhe më tepër!
Ku isha e ku erdha?
Pa fejohet filanja. Për djalin e filanit djalë kanakut besa. Me shpi, tamabil me 200 rranxë ullinj. Kryesorja ullishtë kishte. Pa ullishtë s'ban.
Pa qofshin me nefakë moj i pastë nana jaaarebi se si plluma të dy. Vajzë e mirë e bukur si kakonë, par edhe dhanrri djalë kanakut.
Zani nuk ndalej .
Filanja nuk e paska pa djalin, por kryesorja, djali ka ullishtë pra. Intelegjenca, bukuria, mosha e djalit matej me masën "rranxë ullinit". Sa çudi! Sa më shumë rranxë ullini aq më intelegjent e ma i bukur! Rritej

kualiteti me ullirin sepse edhe ashtu është dru i shenjtë.
Mos t'flas për Ulqinin është njësoj si mos t'flas për William Shakespeare, Tibetin apo lartesinë e Himalajeve.
Ama mos t'i përmend *shinjat, pajën, dhuntinë, pasinë, natën e varzave* dhe më vonë kreditet deri në fyt me u kry të gjithat këto, nuk merr bojë. Janë karateristikat e Ulqinakut, por plaku… eh plaku po lypë bukurinë e lashtë dhe po ik diku, po distancohet nga ne.
Pa sa bukur moj paja filanes, edhe nji hilallyk botë me marrë. Aman arin e unazat që kan çu ata mas t'munohet kush ma. Pa bylyzykun aman moj! Si perri ma nusja. Kakonë e gjallë. (Ç'farë ofendimi, kakonë e gjallë)! Havrën moj ma a ja ke pa, ojma bardh si bora, me fjak e at lule si mi pas bi n'at havër. Mas qoftë ma mirë çe bukur ka dalë. Veç edhe dhandri si pllum. Ball ullishtën e at babë ç'e ka. Nanën ……hanko filanja edhe aja besa gru dagrihe.
Nusja e ngrirë i çon ngapak sytë se mos pa hiri e sheh dikund djalin me emrin dhandër, por jo sepse ende se dinte cili është. E bukur si kakonë nusja paraftyron dhëndrrin si një dru ulliri dhe kaq mjaftonte!
Dhe zëri vazhon. Një urim kryhet nisë tjetri. Zërat përzihen në gjithë qytetin dhe po sa ia nisë hoxha n'minare se di ma kush u feju e kur ja nisë jacia.
Historia u bë lëmsh .
Plaku i lashtë me kulturën, bukurinë, madhështinë flokët e thinjura si syrmi, vie dhe përfundon në fishkllimën e gjarpnit që kafshon.
I mbyll sytë fort, fort.
Kërkoj at plakun në ëndërr. Kërkoj ullirin, gështenjat, detin, shegat, Gjeranat, Kalanë, diellin që ndriçon veç për ne, valët e detit, Don Quixot-in, anijen me vela *Gloria* të familjes Shurdha që në shekullin 19-të fitoi garat dhe sot qëndron si kryevepër në pëlhurë në shtëpinë e vjetër të Gjeranave. Kërkoj babën tim me fytyrën më të bukur në botë, njalat që na i sillte pa nderpre, nënën me zanin e engjëllit, tavën e kublave delikatesin me të përsosur në botë dhe erën e gjellërave të saja. Dorën që ma përkëdhelte ballin dhe flokët. Kërkoj bukën nga duart e Xhavit Millës që sa herë ofrohem më thotë me zërin e tijë fisnik dhe buzëqeshjen e ëmbël, "Filja vogël". Ashtu ai më thërriste!
Kërkoj familjen time të dashur, kushërirat, shoqet, Tofik Shurdhën me tregimet e pafund…Kërkoj Memen, Nuren, Fijen, Fatimen, Fahrijen dhe Vehiben e ëmbël si mjalta!
Mbylli sytë fort, se Ulqinin po e mbysin ulqinakët. Bukuria që vret, më zgjoi nga gjumi dhe plakun e urtë nuk e gjeta më. Iku i shkreti dhe po

kërkon librin që ia vodhën nga duart që i dridheshin nga mosha!
E ndau koha Ulqinin nga ulqinakët.
Urimet vazhdojnë, filanja me filanin, shinjat, pasija, paja, hilallyku, dhuntija, bakllavaja, gurrabijat e forta si guri, peta e hallume me gjel.
Nji t'pritun aman ma, prej sallate deri n'hashaf, si aja ma, madonë edhe nji shoqe nuk ja gjinë.
Kënga kumbon në gjithë qytetin, herë ezani e herë fishkëllima e gjarpnit …..uluron me lutje dhe lot mbi kupën e qiellit dhe detit të kaltërt të bukur si vet Perëndia!
Era e lehtë nuk ndalet dhe unë shpesh zgjohem por prap bie në gjumë dhe iki diku larg me ëndrrën time në zemrën e voglushës që ngadalë po plaket me të njëjtën ëndërr!

PROZË BASHKËKOHORE MALAZEZE

Vladimir VOJINOVIQ

IKONA

Tridhjetë herë ka gjëmuar në Ditën e Shën Ilisë, mbi malin e Trebjeshës.
Gjithë ditën, Zoti e ka vrarë, fluturuar e mbifluturuar. Është gjuajtur Kisha e Kuvendit. Është kthyer gjithnjë derisa varret nuk janë bërë si gropa të mëdha. Janë ngatërruar në to eshtra dhe kufoma të njoma, i ka zënë era e keqe aq sa as minjtë nuk kanë mundur t'u marrin erë.

Dhe kur këtë zhurmë e gllabëroi qielli, dhe tymi u shtri nëpër kryqet e thyera, në dukje më parë doli qeni i larmë. Lëkundi nofullën e fryrë nga derdhja e një lopate të nxehur pardje me ujin e kazanit të Popadijes (gruas së Popit) dhe siç ka qenë mësuar hungëroi në ajër, dhe që atëherë asgjë nuk mund të nuhasë dhe të pijë i pagëzuar, ndaj u stërzgjat së pari në këmbët e para dhe më pas në të prapmet dhe u nis drejt varreve.

Dhe duke ecur rrugës mes varreve, pa se nga një gropë dukeshin të zhveshura, kofshë të kuqe. Do të jenë të atij komunistit të cilin, ditën e hënë, para nisjes e kanë nxjerrë nga burgu dhe e kanë pushkatuar para syve të fotografit të qytetit, - dhe u fut deri në fund e u shemb si thes mielli dhe filloi, o vëlla, të tërheqë.

Nuk kaloi shumë dhe u lëshuan drejt kufomave zogjtë dhe macet. Filluan në të gjitha anët goditje dhe kërcitje dhëmbësh, krahësh dhe sqepash. Ka pasur punë për të gjithë, ndaj gjithkush u mor me fatin e vet.

Dreqi e di si u gjet aty Branka Gjurgjevac nga Lukova. Sa kaloi varrezat e qytetit, u ndal nën një bredh, u kap për një kryq, foli diçka, fare pak dhe atëherë u zhduk drejt pallatit. Të them drejt, i u duk e çuditshme. Dhe unë e ndala pak ata gjak me një leckë dhe thashë me vete: Shkova të shoh, ku do ajo fatkeqe në këtë marrje të Zotit.

Ndërsa para kishës ka filluar të mblidhet një popull i madh. Kanë ardhur edhe nga qyteti, edhe nga Dukla, edhe nga Rastoku. Njëri ka sjellë një trung të madh dhe aq sa i zë goja thërret:

- *Popull, dëgjo popull, nuk na duhet të bëjmë diçka të tillë, por kthehuni nga keni ardhur*.

Mundohet i shkreti të thotë diçka, ndërsa djersa ia mbulon ballin. Nuk përfundoi fjalën, kur nga kisha së pari nxorën një tavolinë, dhe më pas një kuti për të hollat – njëri, besa, kish ngarkuar edhe një arkivol, ku shtrihen të vdekurit në ditën e varrimit.
Popi nuk dukej askund, as për bisht ta kapish.

Tërheqin njerëzit ashtu atë hyjnoren, ndërsa Branka shikoi pak, kaloi gardhin, dhe përsëri mori drejtimin nga pallati. Unë shkova pas saj.

Dhe, shkova unë pas pallatit, kur atje, ...një mur i shembur. Duket mirë, i shembur nga sipër poshtë, duken plloçat e etazheve, telat elektrikë dhe tubat e ujit. Disa fëmijë kanë hipur deri sipër dhe banjën e nxjerrë e tërheqin nëpër dyshemetë, duke synuar prej ku ta hedhin në tokë. Ndërsa njerëzit e rritur, sipër, hiq e hiq nuk lanë asnjë libër. Tërheqin sa mundin dhe nga pallati ikin drejt malit, më keq se ajo nga kisha, gjithçka e mori dreqi. Ja.... njëri mbart stolin, tjetri një kolltuk, i treti tavolinën, ndërsa asnjërit nuk i shkoi mendja se mund të dënohej për të.

Branka rri si përmendore. Edhe mes sorrave gjithmonë do të ndodhet një, që për një pikë nuk mund të niset nga tjetra, dhe ajo, si ndonjë zog ka mbetur, duket, se ka vdekur nga frika. Dhe, pastaj, bëri një hap, të dytin, iu afrua murit dhe fryu në të sa pati fuqi. Mbeti edhe një minutë, dhe pastaj me duar e këmbë filloi t'u ngjitej grumbujve të gurëve. Nuk kaloi shumë dhe e shoh Brankën duke shkuar nga dhoma në dhomë, ndeshet me fëmijët dhe njerëzit, gjithçka prek dhe shikon qosheve. Dhe pastaj hyri në zyrën e Backoviqit dhe mbeti si para xhelatit, ra në gjunjë dhe bëri kryq. Nuk ja shoh fytyrën, por diçka mendohet, ndoshta qan. Ja se si i dridhet shamia, nuk e dëgjoj, por edhe para Zotit do isha betuar se ajo po vajtonte.

Pastaj u përmblodh, kushedi, më fal o Zot, deshi të përulej, të puthte dyshemenë, dhe i ra me ballë. Dhe vuri duart në kryq dhe shembi atë kërdhokullën e sëmurë, dhe mezi u ngrit disi. E pastaj iu afrua murit, u mbajt me të dyja duart dhe diçka lëvizi.
Kur dikush bërtiti:

- *Ikni o njerëz, po vijnë xhandarët.*

Unë u tërhoqa poshtë kishës dhe prita se mos shoh diku Brankën. Dhe nuk e gjeta. E humba dëshirën, kur nga ajo masë, sikur të dilte nga ndonjë lumë i zi, doli pikërisht ajo. Diçka kish mbështjellë në gji dhe vraponte sa kish fuqi dhe gjithnjë lëkundej në atë këmbën e sëmurë, sikur e dëgjoj që këtu si futet kërdhokulla në ashtin e kalbur dhe rënkon.

Gjithë ditën jam sjellë pas saj në fushën e Nikshiqit. Jam fshehur në

gëmusha dhe në sinore. Më vonë u dhashë këmbëve në shkëmbinjtë e Llukovës. Më ishte ndalur gjaku në dorë, por plasën thembrat. U ndala dhe shikova teposhtë, dhe gjithçka poshtë meje në gurë me gjurmë të kuqe. Si të kalonte dikush andej me një thes të plasur me qershi dhe kish ngjyrosur rrugën e ngushtë të udhës. Ndërsa më poshtë, më larg, nja një gjysmë ore ecje, macet kërcejnë se cila do ta lëpijë më parë gjakun pas meje.

Unë asgjë, por vazhdova. Dhe arrita tek shtëpitë e para të Llukovës. Dhe duke menduar se Brankës nuk do t'i futem më në gjurmë, kur nga shtëpitë, sipër, dëgjoj familjarët që e përshëndesin dhe i thonë *mirëdita*, kurse prej saj asnjë përgjigje me zë. I barta atëherë këto shpatulla gjynahqare rrugës mes atyre shtëpive dhe u ndala para një kolibeje. Në kolibe një dritare, ja kaq, jo më e madhe se kjo pëllëmbë gungaçe. Drejtohem drejt një vrime dhe pashë se kur Branka mori një çekiç druri dhe një gozhdë, dhe filloi të godasë sa kish fuqi dhe kur atëherë në të vari një kornizë, afroi qiririn, e ndezi dhe e vuri midis dy trarëve. Heshti pak, lëshoi një lot, dhe pastaj gjeti një gozhdë tjetër dhe sipër asaj kornize i ra dy herë dhe në të vari kandilin. Solla kokën lart e poshtë, por nëpër atë vrimën e dreqit nuk munda kryqas të shoh as murin dhe jo më prenë e Brankës. Ndërsa nata po binte. S'pata ku dhe u ktheva prapa tek varret.

Plot dy dimra dhe dy vera i kam mbushur atë gropa, kam trembur zogjtë dhe macet nga kufomat, kam kthyer kryqet në varre dhe kam lyer ndonjë shkronjë. Kam sheshuar varret, kositur dhe sjellë gjithçka si duhet... Edhe ushtria e re ka vendosur aty të varrosë të vrarët e saj. Kanë gdhendur stolin e kishës, përgatitur kutinë për të hollat dhe një arkë, në të cilën do të ekspozohen të vdekurit. Popi është trashur, popadia është rritur gjithashtu.

Atë mëngjes ishte shi i madh. Erdhi popi dhe më thotë: - Hape varrin e Martinoviqit, ajo është familje e vdekur, ai rreziku ka shkuar partizan, dhe thotë, atij as Zoti më nuk mund t'i ndihmojë, dhe në qoftë se dikush do të thotë ndonjë fjalë, do ta kemi lehtë, vetëm sa të kalojë kjo ushtri, se, thotë, do të kalojë edhe kjo si të tjerat deri në këtë kohë, atëherë do t'i heqim eshtrat, dhe do t'i hedhim në gropë, nëse duhet. Asgjë më prej tij vetëm se bëri me dorë dhe vuri atë çadrën mbi kokë dhe u zhduk.

Tamam kur bombën e tridhjetë e vunë në grumbull, ai mori kazmën që me të të hapë dheun e Martinoviqëve, kur tek dera u duk Bllazhoja.

- A dëgjove, - thotë, për Llukovën.

- Jo, - i them, - çfarë a dëgjove?

- I është shfaqur asaj fatkeqes Brankës, ndaj u ndihmon njerëzve. Shko edhe ti, mor i shkretë, dhe mjekohu.

- Mua, - i them unë, - as zoti nuk mund të më ndihmojë, tamam ashtu si atij fatkeqit nga Martinoviqët, sikur të gjitha varret e kësaj bote të kosit, të rregulloj kryqet dhe të bëj gjithçka sipas dëshirës së Popit, nuk ka për mua, Bllazho, bekim në këtë botë, - ndërsa gjithnjë mendoj, se çfarë mund t'i jetë shfaqur Brankës.

Gjithë mëngjesin, dheu i lagur më është kapur për kazmë dhe lopatë, dhe kur e hapa varrin, fillova të tërheq ata arkivolat e rinj,... akoma u vinte era smollë dhe dërrasat e kalbura dhe kockat, ndërsa gjithë mbulesa rreth varrit e prishur, sikur ta kishin gjuajtur me diçka nga lart. Shiu pushoi diku rreth drekës, u dëgjuan kambanat në kishë dhe përplasja e dyerve të saj. Pra, - mendova, - e kanë nisur të vdekurin për në varreza. Ndaj mora veglat dhe shkova tek kasollja, ndërsa Popi me kolonën e njerëzve po mbërrin dhe më kryqëzon rrugën.

E shihe dreqin, mendojnë se tani do të duhet ta dëgjoj, ku punova gjithë ditën e gjatë. Filloi Popi të lexojë ungjilli kështu, ungjilli ashtu. Dëgjoj njërin nga masa e njerëzve që thotë: - Sikur ta dinte i vdekuri se sa do të lexonte Popi ynë, as nuk do t'i shkonte ndërmend të varrosej me këto zakonet tona. Ajo qeshje nën gushë, Popi flet ndërsa gjithçka rreth dridhet, vetëm ushtria dhe oficeri rrinë të qetë. Por ai si qiriu dhe shikon mbi kokat tona duke drejtuar shikimin mbi bedem. Pranë tij rri edhe Backoviqi, i duket çudi, i qeshet ai mustaku i shkurtër, dhe e shikoj mirë se nuk guxon me gjë tjetër të lëvizë.

Asgjë më dhe Popi përfundoi. Në të njëjtën kohë murmuritën nja dhjetë veta. Njëri dha një urdhër të shkurtër, lëvizën me pushkë, lart poshtë me to, shënuan në ajër dhe gjuajtën tri herë. Sapo gjuajtën, sorrat që rrinë gjithmonë sipër varreve u nisën nga kisha. Popi u vrenjt në fytyrë, sikur ta shtrëngonte diçka në bark, ndërsa Backoviqi e fshehu kokën pas krahut të oficerit. E mora ngadalë për ane arkivolin. Mu duk shumë i lehtë, sikur nuk kish asgjë brenda, vetëm çizmet dhe kapela. Unë e shtyva në gropë, e mbulova me dhe. Kur mbarova me pastrimin e veglave, pashë se të gjithë kishin shkuar. Vetëm Backoviqi kish mbetur ende dhe duke shkuar mes varresh me atë oficerin, u ngul si cjap dhe kërceu nga guri në gur që t'i thotë diçka. Ndërsa oficeri hesht dhe shkon nga kryqi tek kryqi, sikur lexon ato shkronja, sikur tremb mizat nga vetja, niset drejt Backoviqit.

Të nesërmen fryu një veri i fortë. Ka fryrë, vëlla, më keq se atë ditën e Shënkollit kur kemi varrosur Ruzhën e Teodorit. Është shtrirë

qeni laraman bri meje, mendon se jam lopë dhe do të ngrohet pranë meje, ndërsa nga unë veç i ftohti më i madh e rreh. Rrimë heshtur të dy, vetëm era fishkëllen nëpër dërrasat e kasolles. Më kishte kapur kruajtja e brinjëve. Më dhembin sa edhe kafsha do të bërtiste nga mundimet. Por, diçka flas me vete, duhet të shkoj tek Branka. Ja, i gjithë qyteti shkon deri në Llukovë, dikush pret gishtin, dikë e kafshon gjarpri në këmbë, dikujt i shtrembërohet qafa, ndërsa dikujt i ngatërrohet kërthiza. Dikujt nuk i lind gruaja, dikujt lopa shterpë, dhe të gjithë njësoj shkojnë tek Branka. Nuk kaluan as dy ditë kur Bllazhoja më thotë:

- Ajo do të të shërojë, more qyq, të mos më sillesh andej si bullar i matufosur. Do të të japë ilaçe, do t'i lutet Shën Nikollës, para ikonës, për ty dhe pastaj do të bëhesh si vajzë.

E mora unë atë gunën. E vë në shpinë dhe zë derën. Qeni laraman më shikoi dhe sikur më qeshi pse jam aq i marrë sa të dal në këtë kohë të keqe, tundi kokën dhe u fut më tej në qoshe. - Mirë, - i them unë, - plak i marrë, kur do të kthehem, nuk do të më njohësh.

Më ka rrahur shiu atë ditë si kurrë në jetë. U futa disi deri në Llukovë, dhe mes shtëpive, deri tek shtëpia e Brankës. Dhe në gjithë atë akull të madh, populli priste në radhë.

Ata që kanë kapur pak vend nën mbulojë mirë ishin, por kish edhe të tjerë që rrinin në erë përballë. Dhe mbanin radhën. U ndala dhe unë ashtu.

Nata kish ardhur, kur unë kisha mbërritur tek dera, kur doli një plakë shtrigë që tha:

- Branka është keq dhe duhet të çlodhet.

- Çka të pushojë, nuk kam ardhur unë nga qyteti për të më qarë kockat në këtë erë të ftohtë, por i thuaj të më pranojë se jam keq. Ajo hyri dhe më pas doli Branka që tha:

- Hajde.

Nuk pyeti se çfarë kisha. Më uli mbi një gur, më dha një shami ta vendos mbi gjunjët dhe pastaj më lagu me ujë mbi qafë.

- *Pije tani këtë,* – tha. Unë e piva dhe ajo më pyeti se mos pata ndonjë vështirësi.

– Jo, - i thashë. Ajo rrotulloi kokën dhe filloi përsëri:

- *Nuk vlen, nuk vlen, nuk vlen...*

Si moj e shkretë nuk vlen.

- Mirë, - thotë, - nuk vlen, duhet t'i lutesh Shën Nikollës.

Dhe mbeti para atij muri, që as tani nuk munda ta shoh shenjtin. U ul, bëri kryq tri herë dhe filloi diçka të shushurijë nëpër dhembë,

megjithëse çdo gjë më është dukur si bekimi i Popit. U ndal. Atëherë, sikur të zgjohej nga gjumi më i thellë, kryqëzoi duart, i zgjati dhe hapi sytë e gojën.

- Ja ku i ke këto ilaçe. Zieji dhe tri herë në ditë t'i pish. Nëse deri në Vidovdan nuk do të jesh më mirë, ec që t'i lutem përsëri Shën Nikollës.

Gjithnjë, kur po kthehesha rrugës, nuk munda të përcaktoj se çfarë ish ajo në shtëpinë e Brankës dhe më dukej se edhe ato dhimbjet në brinjë po më hiqeshin. Thashë, shih se ku më ndihmoi ajo fantazmë dhe mezi pres që të qeshem me laramanin, ama nuk do të më njohë, kur do të futem në kasolle.

Ka kaluar dimri dhe kanë filluar nxehtësitë e para dhe vetëm tri herë jam shtrirë nga dhimbjet. Diku para Vidovdanit, dhimbja më ra në kryqe dhe në kërdhokulla, aq shumë sa kam thënë se nuk do të më shohë më njeri në këmbë. Unë po rrija shtrirë, kur vjen Blazhoja përsëri.

- *Branka,* -thotë, *-vdiq. Dhe Popi nuk lë që të varroset me familjarët e tjerë. A mundesh,* - thotë ai*, - që t'i lutesh popit ta pranojë në varreza?*

Mua mu err vetëdija. Ku vdiq tash, vdistë e marrë. Ngrihem unë dhe drejt e tek Popi dhe i lutem që ta varrosim në varreza.

- Le të bëhet, - tha Popi, vetëm mua aty, ata të Llukovës, nuk do të më shohin.

Lopata më ka mbetur nga babai, por as ai nuk pa aq shumë popull në varrim. Kanë ardhur nga të gjitha anët. Ja edhe nga ushtria, ja edhe profesorë, edhe Backoviqi, ja edhe të varfrit. Të gjithëve Branka u ka ndihmuar në shërim, prandaj të gjithë, me përjashtim të Popit, do lëshohen deri në varreza. Dhe të gjithë prisnin të vinte kortezhi me Brankën.

Në radhën e parë deri tek gropa rrinin oficeri dhe Backoviqi. Oficeri shënon murin, ndërsa Backoviqi e sheh në sy dhe i thotë, në gjuhën tonë, se fukara më të madh se Popi ynë s'kishte parë, se nëse dikush duhet ta ketë vendin aty, ai duhet të jetë Popi dhe jo një mundimtare e zotit të varrosej si një qen pa vlerë. Oficeri nuk foli por heshti.

- Nuk ka, - tha Backoviqi që ta dëgjojnë edhe më të largëtit, - popull të tillë në të gjithë botën, popull të tillë mosmirënjohës. Pse Popi nuk e shëron kaq popull, pse ai nuk ndihmon, por trashet nga paratë tona, - tha. Por, a është njeri edhe Popi si ne? Është.

Oficeri e ktheu shikimin nga ai, e pa nga koka te thembra, ndaj Backoviqi heshti.

Ndërsa nga sipër mbërrinte kortezhi. Në ballë ecën një djalosh me kryqin. Një kokëmadh ecën pas tij dhe mban një fotografi dhe pas tij me radhë të afërmit, komshinjtë që janë skuqur nga bartja e gjatë e kufomës. Qëndruan. Disa gra u ulën pranë arkivolit, vajtojnë si askurrë për heroinën. Thirrën vaj edhe dy-tre burra nga Llukova. Oficeri vetëm shikoi më duket mua i ngopur nuk mund të mbikëqyrë. Backoviqi është zverdhur në jeshil. Ka bërë me gisht drejt kokëmadhit që mbante fotografinë, dhe me vështirësi foli:

- *Unë jam ai*.

Pastaj e tërhoqi oficerin nga dora dhe i thotë: *Unë jam ai.*

Oficeri shikoi foton, pastaj Backoviqin, pastaj prapë foton. Dhe filloi të tundë kokën.

- Unë jam, ajo është e imja – thirri Backoviqi. Ajo është fotoja ime, hajdutë, të kishit kthyer gjithçka, të gjithë do të shkoni në burg, soj i keq!

I u afrua pastaj një plak, me vetulla dhe mustaqe të bardha, i cili i thotë Backoviqit, me zë të ulët, për të mos prishur punën, se nuk është ai, por ikona e Shën Nikollës e Brankës, të cilën Branka ka kohë që e ka në shtëpi dhe me të i ka ndihmuar popullit. Ndaj, thoshte, u a ka lënë amanet të afërmve që të varrosej me të.

- *O, njerëz,* thërret Backoviqi, – *cili Shën Nikollë, ajo është fotoja ime, që një fotograf i qytetit më ka fotografuar para lufte dhe e kam mbajtur në murin e zyrës. por, gaboheni, o njerëz*, klithte Backoviqi, - *por shkoni dhe pyeteni Popin, se a është ky Shën Nikolla.*

Gjithë ditën është çjerrë Backoviqi, por Brankën e varrosëm sipas amanetit.

Shkoi edhe ajo ditë, shkoi dhe ushtria, ndërsa Backoviqi njësoj nëpër varrime dhe kafene fliste se Brankën e kanë varrosur me fotografinë e tij. Askush nuk ja vinte veshin për këtë. Iku ajo ushtri, erdhi tjetra, ndërsa Backoviqin e vunë në vend të sekretarit të Komunës.

Pop dhe popadije një mëngjes nuk pati më. E unë i ardhur prej në dreq më është thënë së në varr nuk guxojnë të vendosin kryqe.

- *Mirë,* i them,- *po shkronjat.*

- *E, shkronjat munden, kurse sipër shkronjave të vësh këtë shenjë, a është e qartë?*

- *Po.*

- *Mirë, dhe të paraqitesh në gjyq, atje të kërkojnë* – i tha.

Unë u nisa drejt gjyqit. Qeni pas meje deri në shesh, dhe pastaj, sikur të kish frikë u zhduk, shikoi para masës ndërtesën e "Zahumles"

dhe u shtri. Sikur thotë: aj, ti i marrë, unë vdekjen edhe prej këtu mund ta shoh.

Më çuan tek një zyre dhe nga brenda dikush thotë: Përpara. Kur aty ai fatkeqi Martinoviq. Më thotë i nervozuar se tani ai është në qeveri, se varret do të duhet të rregullohen, se ka shumë punë të papërfunduara atje në varreza, se Popi ka bërë çfarë nuk do ta bënte një njeri normal dhe se si nga eshtrat e huaja duhet të pastrohen varret tona.

- *Ka,* - i them unë, - *edhe disa derra të paplasur që kanë mbetur nga ai kiamet nga qielli, mund t'i shtyjë qeni në gropë dhe pastaj edhe ne, edhe varret të kërkohen në fushën e Nikshiqit.*

Ai bëri me dorë. *Do të vijë dikush që ta mbledhë atë.*

Nuk zgjati kjo shumë, dhe unë e qeni laraman fjetëm mbi derrat gjithnjë deri sa erdhi Martinoviqi. Atë mëngjes u duken tek dera e kasolles edhe ai, edhe sekretari Backoviq. Kërkojnë nga unë që t'u tregoj varrin se ku është varrosur ai komunisti i pushkatuar. Shikova qenin, dhe ai u afrua. Shoh mirë se edhe tani i kam parasysh ato gropa dhe ato kofshët e komunistit, dhe kofshët me të cilat i kam shpërblyer kur nga gropa e kam nxjerrë mezi. - Ja,- u them, - tani po ua tregoj. Dhe unë i çoj drejt e në varrin e Martinoviqëve.

Kur u afruam, Martinoviqi ra mbi atë pllakën. Filloi të puthë ato shkronjat në kryq. E shihja mirë se si e shikonte Backoviqi. Fillova të çvarros. Pastaj u ula poshtë, e kap dhe e tërheq arkën e atij ushtarit të huaj.

- Ja ku janë eshtrat, - u them. Backoviqi më pa, e pashë edhe unë atë. Të dy heshtëm, tamam si edhe sorrat nga çerdhet e tyre.

E morën arkën. Të nesërmen erdhi prapë sekretari Backoviq, i vetëm.

- *Hajde të hapim varrin e Brankës!* Unë nuk e kam pyetur për asgjë.

Kemi mihur fshehurazi, kemi hequr dheun dhe kemi gjetur fotografinë. Ai e mori, e shkundi dy herë, e shikoi atë dhe mua, e mblodhi në gjoks dhe shkoi.

Unë hodha përsëri dheun në varr, e shtypa fort me këmbë dhe thirra qenin. Ai vetëm më shikoi. Sikur donte të më thoshte, *eja, bre, të shkojmë të flemë me derrat.*

Marrë nga libri "Tregimet e Montanarit", përktheu Dimitrov Popoviq

Tanja SEKULIQ

VAJZA FLOKËBARDHË

Mëngjes. Nëna është duke përgatit drekën e unë dal jashtë. Para ndërtese nuk shoh askend. Pas ndërtese njejtë, askush. Shkoj te pishat mes banakëve të tregut, ndoshta ia arrij të mbledhi ndonjë farë "boçe"[1]. Shkoj ngadalë, kokëulur. Gjeta një boçë pishe, e marr dhe filloj ta shkund. Nuk del asgjë. As edhe një farë boçe e pishave. Vazhdoj më tutje dhe më duket se shoh diçka të zezë mes gjembave të thatë të pishave. Përkulem dhe shikoj. Me të vërtetë "fara boçe pishash". Dëgjoj një zë:

- Çfarë po bën?

Ngrej kokën dhe para meje shfaqet një vajzë.

- Po mbledh fara nga boçat e pishave?
- E ç'farë janë këto fara të boçave të pishave?

Unë hap shuplakën e dorës, dhe ia tregoj tri fara të boçes së pishave.

- Pse i ke duart e pista?
- Nuk janë të pista, janë nga farat e boçeve.
- Çka do të bësh me to?
- Do t'i ha.
- Po ti a ke mama?
- Po, kam.
- Po pse pra nuk t'i jep ajo për t'i ngrënë po i mbledh ashtu të pista nga toka?

Kuptoj që me te nuk do t'ia dalë shumë lehtë. Është e vogël dhe do detyrohem t'ia shpjegoj të gjitha.

- Sa vjet ke ti?

Çon katër gishta dhe thotë:

- Kaq, po ti?
- Gjashtë.
- Si e ke emrin?
- Vanja. Po ti?
- Manja.

Erdhëm deri para banese dhe unë i tregova se si hahen farat e boçave të pishës. Se si duhet së pari të thyhen me gurë dhe pastaj atë brendësinë e bardhë ta hash.

[1] Boçë pishe

E provoi, filloi të qeshet dhe tha:

- Mua më shumë më pëlqen akullorja.

Pastaj kaluam nëpërmjet barakave dhe shkuam në ëmbëltoren e Arifit dhe blemë nga një akullore.

- Unë tani po shkoj, i thashë.
- A do të vish neser të luajmë së bashku?
- Nuk e di.

Dhe mirë e dija se do të vija pasiqë Velkoja ishte në shkollë.
Po flokët seç i kishte të bardha si bora dhe e vogël si një kukull!
Të nesërmen kur dola para ndërtese, ajo ishte aty. Shkuam pas barakave të mbledhnim xhama dhe kapak shisheje që kishte pafundësisht shumë sepse aty pranë ishte një pijetore. Të gjitha këto cikërrima që i mblidhnim i groposnim. Së pari hapnim vrimën, fusnim kapakun e përmbi te xhamat dhe prapë e mbulonim me dhe. Këtë e quanim thesar.
Në ato baraka jetonin disa plaka të cilat gjithmonë na përzenin. Në fillim iknim prej tyre, por me kalimin e kohës fillluam as të mos lëvizim vendi. Njëra nga këto plaka kishte një vajzë të cilën ne e quanim ”mushka e vogël”. E quanim kështu ndoshta nga fakti se vishte pantallona dhe flokët i kishte të prera shkurt. Gjithmonë na fotografonte.
Shoqja ime e vogël një ditë më tha:

- Eja ke unë të hajmë çokolatë. Dje e kam pasë ditëlindjen.

Shkuam në shtëpinë e saj. Hapëm frigoriferin, e brenda tij njëra mbi tjetrën të vendosura çokolatat *Dëshirat më të mira*. Kishte shumë.
Fillova ta pëlqej këtë shoqen time të vogël me flokë të bardha e që ishte e qeshur gjithmonë.
Në hyrjen e ndërtesës sonë ishin nëntë shkallë. Në të majtë ishte një pushimore, hapsirë e ngritur në të cilën mbështeteshim. Nuk kishte gardh në atë pjesë dhe kjo ishte shndërruar në teatër nga ne. Aty ne aktronim, luanim, këndonim, silleshim në rreth! Një ditë ashtu duke u sillur asaj iu morën mendët dh era nga ajo lartësi. Shpejt u bë rrëmujë. Xha Tomoja e ngriti nga toka dhe e futi në tristaqin[2] e vet ngjyrë kafje dhe e dërgoi për në spital. U kthye pas disa ditësh me kapakë syrit të nxirë. Shumë shpejt gjithçka u harrua dhe vetëm mua më dukej se syri i saj i majtë shpesh ikën nga qendra. Për një moment ndoshta.
Një ditë më pyeti:

- Kur e ke ti ditëlindjen?

[2] Tristaq – emër përgdhelës për veturën Zastava 1300 të vitetve 1970-80

- Eja të të tregoj! Kur në këtë pemë të rriten frutet atëherë unë do mbushi shtatë vjet dhe do filloj të shkoj në shkollë.
- Po edhe sa ka deri atëherë?
- Nuk e di!
- A e di se si quhet kjo pemë por nga mbrapsht?
- Quhet man. Por pse nga mbrapsht?
- Po, a nuk e sheh se degët i rriten në drejtim të tokës e jo në drejtim të qiellit?

Nuk iu përgjigja asgjë, pak u turpërova që mu këtij druri degët t'i rriten në drejtim të tokës e jo sikurse të tjerëve.

- Po, por kur të bie shi mund të fshehesh poshtë degëve të tia!
- Mirë, tha ajo.

Pas kësaj me ditë të tëra vinim të kontrollonim se mos kishte ndonjë frut në këtë pemë. Por, asgjë. Shpejt u dorëzuam. Mendoj se nuk më besoi por shtirej se çdo gjë është në rregull me këtë ditëlindjen time.

Ky dimër na kaloi duke pritur fëmijët tjerë që të kthehen nga shkolla dhe pastaj të gjithë së bashku luanim para hyrjes së ndërtesës fshehtas ose miu i verbërt. Hyrja buçiste nga zhurma që bënim kurse ne ishim porsi mizat në kavanozin e mbyllur.

Atë vit në dyqane u shfaq euro-kremi. E quanim akullorja e dimërit. Voglushes, shitëset gjithmonë ia falnin nga një e ajo qeshej ne të madhe në mënyrë ngjitëse.

Kaloi një kohë. Filluan ditët e nxehta. Ajo pema fitoi frutet, së pari iu skuqën e pastaj filluan t'i nxihen dhe unë fillova të shkoj në shkollë e ajo mbeti e vetme.

Më vonë prindërit e saj u zhvendosën. Për një kohë të gjatë nuk jemi takuar. Bëhesha gati për mbrëmjen e matures dhe vajta ke floktarja.

E shoh aty me përparëse; në duar kishte gërshërët kurse në xhepa krehërit.

Më tha se punon në këtë floktore, se ka lënë shkollën dhe se së shpejti do të vendoset prapë në ndërtesën tonë.

Filluam prapë të shoqërohemi. Takoheshim çdo ditë dhe shpejt u bëmë të pandara. Ritregonim ngjarjet e fëmijërisë si dhe ato çka na kishin ndodhur në ndërkohë.

E dua shumë. Përsëri qeshet ashtu ëmbël. Në dhëmbin e përparmë lartë ka një njollë të bardhë, andaj kur qeshet kjo pikë e bardhë i shëndrit porsi barku i bokvës[3] nga shkëlqimi i hënës në cekëtirën e detit.

[3] **Bokvë** (*Boops boops*), peshk i vogël njëherit më i përhapuri në Adriatik dhe Mesdhe. i përket familjes (*Sparidae*)

Dilnim çdo mbrëmje. Prisnim që prindërit e saj t'i zërë gjumi dhe pastaj merrnim veturën e tyre dhe bënim gjiro nëpër qytet…
Ajo punonte në shtëpi si floktare ndërsa unë përgatitesha për diplomim. Që të dyja kishim rënë në atë kurthën klasike "pritja e detarit që të kthehej nga lundrimi".
Çdo ditë bëhej ftohtë e më ftohtë, veriu të nginte kockat e ne ende bënim gjiro me veturë.
Detari i saj erdhi. Filluam të dalim së bashku me te… E braktisi… Filluam të dalim vetë.
Erdhi detari im dhe filluam të dali me te… E braktisa… Filluam të dalim vetë.
Pastaj diplomova dhe vendosa të shkoj në Londër. Në mënyrë që të shkoj mu desht të punësohem. Paketoja duhan dhe fillova të kursej. Zgjohesha në pesë të mëngjesit dhe shkoja të paloj në dengje gjethet e duhanit, gjethe këto që i ngjanin pergameneve.
Vazhduam të dalim për çdo natë, e unë shpeshherë gari sa nuk flija në kafeteri. Edhe atë natë më ndodhi e njëjta gjë. Erdha ta marr… U bë gati. Gjithmonë ishte e veshur bukur, e qeshur dhe me flokë të rregulluara. Kundërmonte mirë. Gjithmonë… Atë natë sytë i kishte të trishtuar, flokët pothuaj se nuk ishin të sajat. Të thata… Të venitura.

- Mos u bëj e trishtuar, do të të kaloj, i thashë.

E bëja të qeshej dhe ajo qeshej, por nuk ishte ajo e qeshura ngjitëse por një tjetër buçitëse. Kërciste disi, nuk cingërronte ashtu si më parë.
Atë mbrëmje në kafeterinë që dilnim kishte festë. Pihej shumë duke thënë edhe një, edhe një u bë ora dy pas mesnate. Unë nuk mundja të qëndroja në këmbë e para syve më dilte gjithçka e verdhë porsi gjethet e duhanit.

- Unë po shkoj të flej, i thashë
- Rri edhe pak.

Ia bëra qefin. Dyert e kafeterisë u hapën dhe brenda u fut shoku ynë i bërë tokë nga pija. Nuk mundte të ecte dhe u detyrova ta ndihmoj deri në shtëpi sepse po ta lija aty do ta mbyste alkooli.

- Më duhet ta dërgoj në shtëpi dhe po shkoj me fjet, I thashë.
- Në rregull. Shihemi nesër, u përgjigj.

Shkova, mora shokun tone dhe vazhdova për në shtëpi.
Fjeta dy orë, pastaj i erdhi koha duhanit, thasëve… pastaj pashë babain dhe motrën të cilët nxitonin dikund. Më kapi për dore dhe më tha:

- Manja, ka psuar ndeshje në trafik, është në gjendje të rëndë.

Asgjë nuk kuptoja.

- Cila Manja, çka flet o baba?

Para ndërtese kuptova gjithçka…

Pyeta:

- A është gjallë?

Të gjithë heshtnin. Manjaaaaa, klitha. Vrapova në krevat dhe mbulova kokën me jorgan kurse në jastëk thërrisja emrin e saj.

Në kishëz për here të fundit e putha në ballin e saj akull. Ishte e shtrirë dhe e veshur me fustan të bardhë, duart e bëra kryq përmbi krahëror. E bukur. E qetë.

Pas disa ditësh u nisa për Londër.

Londër, 1989.

Ndodhem në pyllë. Drurët kishin shtrirë degët kah qielli mu ashtu siç Manja kishte dëshirë dhe papandehur dëgjoj një zë të letë që thërriste:

- *Eja.*

Çoj kokën dhe shoh Manjën. Nisem drejt saj. Shoh një barrakë të vogël në lëndinë. Një rrugicë e gjitha me lule më çonte drejt saj. Një përrua derisa pyllit i vinte era pishë. Pa saj shkonte vëllau I atij detarit që qtëbotë e braktisi… Ata dy së bashku u futën në barrakë.

E thirra: Manjaaaa!

Bërtita:

- *Nuk mund të kthej sot, do vij një here tjetër!*

Më përshëndet me dorë dhe buzëqesh.

Mendova se sa bukur ishte aty sikurse në parajsë…

Vitat kaluan. U ktheva nga Londra. Shkova në Spanjë dhe më pas në Pariz.

Pariz, 2006.

E premte, 13 tetor

Mbrëmi isha ke Manja në barrakën e ngrohtë… pranë përroit të pastërt.

- *Kaherë nuk ke qenë, më tha.*
- *Jetoj larg,, ia ktheva.*

E mërkurë, 18 tetor

Manja dhe unë vozitemi me veturë, përgjatë një rruge të rrëshqitëshme dhe të pjerrët. Dëborë. Ajo vozit shpejt. Tenton të pakrohet, humbet kontrollin ndaj veturës, rrëshqasim e bëjmë tetëshe… Poshtë nesh është humnera. Shihet deti i bërë zi futë. Ajo ia arrin që ta shpjerë veturën deri në një kodër. Është dimër. I ftohtë i tmerrshëm. Në horizont dielli shuhet në detin e errët… Parkohet dhe fillon të qeshet.

E enjte, 19 tetor
Edhe mbrëmë u përgatitëm për të dale në qytet. Kthyem ke Danilloja… Ai na tregon shpikjen e tij të varur në murë nga e cila varej një raft. Në raft një kuti, e pranë saj dy enë të vogla për ujë. Kur je nën raft, uji fillon të derdhet nga njëra enë në tjetrën. Kurse kur je para kutisë, në te e sheh tërë jetën tënde.
Unë i them:

- *Eja të shohim a do na e tregojë atë kenën kur 'mushka e vogël' na fotografoi? E ne ulem galuç, përqafuam shoqja-shoqen… E ne ekranin e asaj kutisë me të vërtetë dolëm ne kur ishim të vogla… Të ulura galuç me buzëqeshje duke përqafuar njëra tjetrën. Pastaj skenat shkojnë më tutje dhe shoh një pjesë të rrugës nga krahu i kundërt, sikurse koha të kthehej mbrapshtë. Kurse atë natë fishkëllonte veriu sikurse kurrë më parë.*

U nisa, e ajo më tha:
Mos prit që të të thërras, por eja vetë kur të duash.

(Përktheu nga gjuha malazeze Gazmend Çitaku)

PROZË BOTËRORE

Mario Vargas LLOSA

PESË QOSHET

1. **Një vizitë e papritur (Fragment nga romani)**

Sapo e pa të hynte në zyrën e tij, inxhinieri Enrike Kardenas – Kike për të shoqen dhe miqtë e vet – ndjeu një shqetësim të çuditshëm. Çfarë e bezdiste tek ai gazetar që po i afrohej me dorën e shtrirë përpara? Lëvizjet e tij tarzaneske, duke tundur krahët dhe duke lëkundur tërë trupin, si mbreti i xhunglës? Buzëqeshja prej miu që ia rrudhte ballin poshtë atyre flokëve të llangosura me xhel dhe të ngjeshura pas kafkës, si një kaskë metalike? Pantallonat prej kadifeje ngjyrë manushaqe e ndezur dhe të ngushta, që, si një dorashkë, ia shtrëngonin trupthin e hollë? Apo ato këpucët e verdha me tabanët e trashë, për t'ia rritur ca figurën? Gjithçka tek ai iu duk e shëmtuar dhe spitullaqe.

– Është një kënaqësi e madhe për mua, inxhinier Kardenas, – i zgjati dorën e flashkët dhe të vockël, që e lagu atë të tijën me djersën e vet. – Më në fund, pas shumë përpjekjesh nga ana ime, po më jepni mundësinë t'ju shtrëngoj dorën.

Kishte një zë cijatës që të jepte përshtypjen sikur përqeshte dikë, ca sy të veckël e të lëvizshëm, një trupth rakitik, por, veç këtyre, Enrikeja ndjeu edhe një erë të qelbur sqetullash apo këmbësh. A thua ishte nga ky kutërbim që, qysh në fillim, mezi e duronte këtë tip?

– Më vjen keq, e di se keni telefonuar shumë herë, – u shfajësua, sa për të shkuar radhën. – Por nuk mund t'i pres dot të gjithë ata që më telefonojnë. Ju nuk mund ta merrni me mend se ç'agjendë të ngarkuar që kam. Uluni, ju lutem.

– E marr me mend shumë mirë, inxhinier, – tha njeriu i vockël; këpucët e tij me takat e larta kërcisnin, mbante një xhaketë të kaltër shumë të ngushtë dhe një kravatë të ylberizuar që dukej se po e mbyste. Çdo gjë tek ai ishte e vockël, përfshi edhe zërin. Vallë, ç'moshë do të kishte? Dyzet, pesëdhjetë vjeç?

– Ç'pamje fantastike paskeni që këtu, inxhinier! Ajo, tej në fund, është kodra San Cristobal, apo jo? Jemi në katin e njëzetë, apo të njëzetenjë?

– Në të njëzetin, – saktësoi ai. – Paskeni pasur fat, sot ka diell dhe mund të shijohet pamja. Zakonisht, në këtë stinë mjegulla mbulon tërë qytetin.

– Duhet t'ju japë ndjesinë e një pushteti të pakufishëm, ta keni Limën

nën këmbë, – bëri shaka vizitori; sytë e tij të vegjël e të murrmë lëviznin, të paqetë, dhe Kikes iu duk se, e gjithë ajo çka thoshte, tregonte një mungesë të thellë sinqeriteti. – Ua, ç'zyrë elegante, inxhinier! Më lejoni t'u hedh një sy këtyre pikturave.
Tani, vizitori po shëtiste duke shqyrtuar gjithë qetësi vizatimet mekanike të tubacioneve, të çikrikëve, të depozitave të ujit dhe të shatërvanëve, me të cilat dekoratorja Leonorsita Artigas kishte stolisur muret e zyrës, me argumentin: "A nuk duken gravura abstrakte, Kike?". Hijeshimet e bëra nga Leonorsita, që të paktën i kishte kombinuar ato vizatime të kota dhe hieroglifë me fotografi të bukura me peizazhe peruane, i kishin kushtuar një djall e gjysmë.
– Po prezantohem, – tha më në fund personthi. – Rolando Garro, tërë jetën gazetar. Drejtoj revistën javore Destapes.
Gjithmonë me atë buzëqeshjen gjysmake dhe atë zëthin cijatës si prej flauti, që dukej sikur paskej gjemba në fyt. Kjo ishte ajo që e bezdiste më shumë tek vizitori, tha me vete Enrikeja: jo era e keqe, por zëri i tij.
– Ju njoh, zoti Garro, – u përpoq të ishte më i përzemërt, sipërmarrësi. – E kam parë ndonjëherë programin tuaj televiziv. Ua mbyllën për arsye politike, apo jo?
– Ma mbyllën nga që thosha të vërtetën, diçka që nuk durohet shumë në Perunë e sotme dhe të përhershme, – pohoi gazetari gjithë hidhësi, por pa e fshirë nga fytyra buzëqeshjen. – Më kanë mbyllur disa programe në radio dhe në televizion. Herët e vonë do të ma mbyllin edhe Destapes-in, po për të njëjtën arsye. Por s'më bëhet shumë vonë. Janë rreziqet e zanatit, në këtë vend.
Sytë e tij të zvogëluar e shikonin sikur donin ta sfidonin dhe Enrikeja u pendua që e kishte pritur këtë tip. Pse e kishte bërë? Sepse sekretarja e vet, e lodhur nga tërë ato telefonata, i kishte thënë: "Atëherë, t'i them se nuk do ta prisni kurrë, inxhinier? Më falni, por nuk mund ta duroj dot më. Po na luan mendsh të gjithëve këtu në zyrë. U bënë javë që po telefonon nga pesë-gjashtë herë në ditë". Ai kishte menduar se, në fund të fundit, një gazetar, nganjëherë, mund të jetë i dobishëm. "E gjithashtu, i rrezikshëm", arriti në përfundim. Pati parandjenjën se kjo vizitë nuk do t'i sillte hiçgjë të mirë.
– Më thoni, si mund t'ju ndihmoj, zoti Garro, – tha dhe vërejti se gazetari pushoi së buzëqeshuri dhe ia nguli sytë me një vështrim të përulur dhe sarkastik. – Në qoftë se bëhet fjalë për reklama, shpejtoj t'ju them se ne nuk merremi me këtë. Kemi një marrëveshje me një kompani, e cila administron tërë reklamat e grupit.

Por, qartësisht, vizita nuk ishte për reklamat. Tani, shkurtabiqi qe shumë serioz. Nuk thoshte asgjë; e kundronte në heshtje, sikur të kërkonte fjalët që do të përdorte më tej apo të donte ta mbante pezull bisedën për ta bërë nervoz Enriken. Dhe, në fakt, ndërsa priste që Rolando Garro të hapte gojën, Enrikeja, përveçse i acaruar, nisi të ndihej i paqetë. Ç'dreqin kishte në mendje ky spitullaq?

– Po ju, pse nuk mbani truproje, inxhinier? – e pyeti papritur Garro.

– Epo të paktën, nuk janë të dukshëm.

Enrikeja, i habitur, mblodhi supet.

– Jam fatalist dhe e çmoj shumë lirinë time, – iu përgjigj. – Çka për të ndodhur, do të ndodhë. Nuk do mund të jetoja dot i rrethuar me truproje, do të ndihesha si i burgosur.

Mos kishte ardhur t'i bënte intervistë, ky tip?! Nuk kishte për t'ia dhënë dhe do ta nxirrte përjashta një orë e më parë.

– Është një çështje tejet delikate, inxhinier Kardenas, – gazetari e kishte ulur zërin, a thua se do ta dëgjonin muret; fliste me një ngadalësi të llogaritur, ndërkohë që, në mënyrë diçka teatrale, po hapte një çantë prej lëkure të çngjyrosur, që e kishte me vete, dhe nxori andej një dosje të mbërthyer me dy kapëse të trasha të verdha. Nuk ia dha menjëherë; e vendosi mbi gjunjë dhe përsëri ia nguli sytë e veckël prej miu, tek të cilët, Enrikes tani iu duk se dalloi diçka të turbullt, ndoshta kërcënuese. Si dreqin ia dha mendja që t'ia linte atë takim? Më e arsyeshme do të kishte qenë që ta kishte pritur një nga asistentët e vet, ta dëgjonte dhe ta përcillte. Por tani ishte vonë dhe më e shumta thjesht mund të pendohej.

– Do t'jua lë këtë dossier që ta shqyrtoni me kujdes, inxhinier, – tha Garro, duke ia zgjatur me një solemnitet të tepruar. – Pasi t'i hidhni një sy, do ta kuptoni se pse doja t'jua sillja personalisht dhe jo ta lija në duart e sekretares suaj. Të jeni të sigurt, zotëri, se Destapes kurrë nuk do ta publikonte një poshtërsi të tillë.

Bëri një pauzë të gjatë, pa ia ndarë sytë, dhe, me zërin e tij të hollë, çdo herë e më të ulët, vazhdoi:

– Mos më pyesni se si mbërriti kjo në duart e mia, sepse nuk do t'jua them. Është një çështje deontologjie gazetareske, ma ha mendja që e keni të qartë se ç'është kjo. Etikë profesionale. Unë i respektoj gjithmonë burimet e mia, edhe pse ka gazetarë që ua shesin ofruesve më të lartë. Por ajo çka dua t'ju them përsëri është se kjo ishte arsyeja e këmbënguljes sime për t'ju takuar personalisht. Ju duhet ta dini mirë, se në këtë qytet ka njerëz që duan t'ju bëjnë keq. Për shkak të prestigjit, fuqisë dhe pasurisë tuaj. Këto gjëra janë të pafalshme në Peru. Këtu,

smira dhe mllefi lulëzojnë më me forcë se në çdo vend tjetër. Vetëm dua t'ju siguroj se ata që duan të njollosin reputacionin tuaj dhe t'ju dëmtojnë, kurrë nuk kanë për ta bërë nëpërmjet meje dhe Destapes-it. Duhet të jeni i sigurt për këtë. Unë nuk merrem as me maskarallëqe e as me poshtërsi. Thjesht, është mirë ta dini se nga çfarë duhet të ruheni. Armiqtë tuaj do të përdorin këto dhe poshtërsi më të këqija se këto, për t'ju kërcënuar e për t'ju kërkuar Zoti e di çfarë.

Bëri një pauzë për t'u mbushur me frymë dhe pas disa sekondave, solemn e duke mbledhur supet, vazhdoi:

– Natyrisht, në qoftë se unë do të kisha qenë i gatshëm për këtë lojë të ndyrë dhe do ta përdorja këtë material, do ta kishim trefishuar apo katërfishuar tirazhin e gazetës sonë. Por, ende kemi mbetur disa gazetarë me parime të shëndosha në Peru, fatmirësisht për ju, inxhinier. E dini pse e bëj këtë? Sepse unë besoj se jeni patriot, zoti Kardenas. Një njeri, që përmes punës së vet si sipërmarrës, ndërton atdheun. Se, ndërsa shumë të tjerë, të trembur prej terrorizmit, po ia mbathin në dhera të huaj duke marrë me vete edhe parat e tyre, ju po qëndroni këtu duke punuar e krijuar vende pune, duke i bërë ballë terrorit, duke e ngritur këtë vend. Po ju them edhe diçka tjetër. Nuk dua asnjë shpërblim. Edhe nëse do të ma ofronit, kurrsesi nuk do t'jua pranoja. Kam ardhur t'jua jap këtë fëlliqësi që ju vetë ta hidhni në koshin e plehrave dhe të mund të flini i qetë. Asnjë shpërblim, inxhinier, përveç ndërgjegjes sime të pastër. Tani po ju lë. E di se jeni një njeri tejet i zënë me punë dhe nuk dua t'ju marr më nga koha juaj e çmuar.

U ngrit në këmbë, i zgjati dorën dhe Enrikeja, i hutuar, ndjeu sërish në dorën e tij lagështirën që i la prekja e atyre gishtave dhe e asaj pëllëmbe, të flashkëta dhe të lagura nga djersa. E këqyri burrin e vogël tek largohej drejt derës, me ato hapat e guximshme e të sigurta, tek hapte derën, tek dilte dhe tek e mbyllte prapa vetes, pa e kthyer më kokën.

Ishte aq i çoroditur dhe i pezmatuar sa, para se të shikonte dosjen, mbushi një gotë me ujë dhe e rrëkëlleu me një të kthyer. E kishte aty, mbi tryezën e punës, para syve, dhe iu duk se po i dridhej dora, ndërsa i hiqte kapëset që e mbanin mbërthyer. E hapi. Ç'mund të ishte kjo? Asgjë e mirë, po ta gjykoje nisur nga ligjërata e atij tipit. Vuri re se ishin foto, të mbështjella në një letër mëndafshi të tejdukshme. Foto?! Ç'foto mund të ishin?! Filloi ta hapte me kujdes letrën e mëndafshit, por, aty për aty, e humbi durimin, e shqeu letrën dhe e flaku në kosh. Çmeritja që i shkaktoi imazhi i parë qe aq e madhe saqë e lëshoi nga dora tufën me foto dhe ato ranë nga tryeza në dysheme, duke u shpërndarë gjithandej.

Rrëshqiti nga karrigia dhe, i ulur galiç, nisi t'i mblidhte. Ndërkohë që i mblidhte, i shikonte, duke e mbuluar menjëherë çdonjërën me atë që vinte prapa, i trullosur, i tmerruar, duke u kthyer sërish tek e mëparshmja, duke kaluar tek tjetra edhe më e mëparshme, ndërsa zemra ia godiste gjoksin me forcë dhe ndiente se i zihej fryma. Vazhdonte i ulur përtokë, me njëzet fotot në duar, duke i kaluar njëra pas tjetrës pa pushim, pa u besuar syve për çka shikonte. Nuk ishte e mundur, nuk ishte e mundur. Jo, jo. E megjithatë, fotot ishin aty, tregonin gjithçka, madje dukeshin se tregonin akoma më shumë nga çfarë kishte ndodhur atë natë në Chosica dhe se tani po ringjallej sërish, kur ai besonte se kishte kohë që e kish harruar jugosllavin dhe atë ngjarje.

Ndihej aq keq, aq i tronditur, saqë, sapo u ngrit, vendosi fotografitë mbi tryezë, hoqi xhaketën, liroi kravatën dhe u lëshua e ra mbi kolltukun e vet, me sytë e mbyllur. E mbytën djersët. U përpoq të qetësohej, të mendonte me kthjelltësi, ta shqyrtonte me gjakftohtësi situatën. Nuk ia doli dot. Mendoi se mund të pësonte një atak zemre, nëse nuk arrinte të kthjellohej. Ndenji një copë herë ashtu, me sytë e mbyllur, duke menduar për nënën e tij të gjorë, për Marisën, për të afërmit e tij, ortakët, miqtë e tij, opinionin publik. "Dreqi e mori, në këtë vend më njohin edhe gurët". Mundohej të merrte frymë normalisht, duke thithur ajër me hundë dhe duke e nxjerrë nga goja.

Sigurisht, një shantazh. Në mënyrë idiote, kishte qenë viktimë e një kurthi. Por ajo kishte ndodhur para nja dy vjetësh, ndoshta pak më shumë, atje në Chosica, patjetër që i kujtohej. Kosut, quhej ai jugosllavi? Po pse po i rishfaqnin tani këto foto? Dhe pse pikërisht nëpërmjet këtij tipi të neveritshëm? I tha se kurrë nuk do t'i publikonte dhe se nuk donte kurrfarë shpërblimi, por, sigurisht, kjo ishte një mënyrë për t'i bërë të ditur se po planifikonte krejt të kundërtën. Ngulmoi t'i tregonte se qe një njeri me parime, me qëllim që ta lajmëronte se në të vërtetë bëhej fjalë për një keqbërës të paskrupullt, i cili kishte vendosur t'i merrte shpirtin, ta rripte, duke i kallur tmerrin me gogolin e skandalit. Mendoi për të ëmën, atë fytyrë aq të denjë dhe fisnike, të dërrmuar nga e papritura dhe tmerri. Mendoi për reagimin e vëllezërve, kur t'i shihnin ato foto. Dhe iu bë zemra copë, kur përfytyroi fytyrën e Marisës, akoma më të zbehtë se zakonisht, të mavijosur, me gojën e shqyer dhe sytë bojë qielli të mbufatur nga të qarët e pasosur. E pushtoi dëshira për t'u zhdukur. Duhej të fliste me Lusianon, sa më parë. O Zot, sa turp!

Përktheu nga origjinali spanjisht Erion Karabolli

Virginia WOOLF

NJË AVENTURË LONDINEZE

Askush mbase nuk ka ndjerë ndonjë pasion për një laps. Por ka rrethana në të cilat mund të bëhet e dëshirueshme ta zotërosh një të tillë; momente kur dëshiron të kesh një objekt, si një përligjie për të ecur përmes Londrës midis çajit dhe drekës.

Ashtu si një lojtar golfi luan me qëllim që të zgjerojë hapësirat, kështu që kur dëshirat na pushtojnë qoftë edhe për të blerë një laps si pretekst, na vjen të themi sakaq "Vërtet, më duhet të blej një laps", a thua se nën velin e këtij shfajësimi mund të plotësojmë kënaqësinë më të madhe të qytetit në dimër duke ardhur vërdallë rrugëve të Londrës.

Çasti duhet t'i takojë mbrëmjes dhe stinës së dimrit, sepse në dimër shkëlqimi i ajrit nëpër rrugë është vërtet shumë i këndshëm.

Nuk na përqeshin më si në verë me atë dëshirën e madhe për të gjetur pakëz hije dhe vetmi, pse jo edhe pak ajër të freskët.

Ora e mbrëmjes, gjithashtu, na sjell një mungesë përgjegjshmërie që na dhuron errësira dhe drita e llampës.

Nuk jemi më të qetë me vetveten. Teksa dalim nga shtëpia gjatë një mbrëmjeje të këndshme midis orës 4 dhe 5, takojmë miqtë me të cilët njihemi dhe bëhemi pjesë e asaj morie të pafund republikanësh e endacakësh anonimë, shoqëria e të cilëve është kaq e pranueshme pas vetmisë që përjetove nëdhomën tënde.

Qendrojmë aty të rrethuar prej objekteve që shprehin gjithmonë thagmën e temperamenteve tona dhe përforcojnë kujtesën nga përvojat tona jetësore.

Ajo vazo e sergjenit mbi oxhak, p.sh. është blerë në Mantua në një ditë kur frynte shumë erë. Po largoheshim nga dyqani, kur një grua plakë na preku mbi shpatulla dhe tha se në një nga këto ditë mund të vdiste nga uria, por "merre!" bërtit ajo dhe na e ngeci vazon në dorë, a thua se kurrë nuk do të kishte dashur të kujtohej për bujarinë e saj donkishoteske.

Kështu, i zënë në faj, por edhe duke menduar se sa keq ishim mashtruar, e morëm em vete në hotel, ku, mu në mes të natës, hanxhiu u grind dhunshëm me gruan e tij, saqë ne të gjithë dolëm për të parë ç'po ndodhte dhe pamë hardhitë midis shtyllave dhe yjet e bardha në qiell. Në çastin që u duk se gjërat u stabilizuan, u duk sikur u vulosën si një monedhë e pashlyeshme mes 1 milionë të tjerave që kalojnë krejt pa u

parë. Aty ishte dhe melankoliku anglez, i cili u ngrit mes filxhanëve të kafes dhe tryezës së vogël prej hekuri dhe nxorri në shesh sekretet e shpirtit të tij ashtu siç veprojnë gjithnjë udhëtarët.
Ky mëngjes alla italian, plot erë, hardhitë kacavjerrëse të gërshetuara rreth shtyllave, anglezi dhe sekretet e shpirtit të tij, u ngritën lart mbi re nga vazoja prej porcelani. Aty, teksa sytë tanë ranë mbi dysheme, u duk një njollë ngjyrë kafe mbi qilim. Z. Lloyd George e kishte bërë atë. "Ai njeri është shejtan!" tha z. Cummings, duke e vendosur çajnikun poshtë për të mbushur ibrikun, saqë dogji edhe një unazë të errët mbi qilim.
Por kur dyert u mbyllën, gjithçka u venit. Shpirtrat tanë kishin sekretuar gjithçka, duke krijuar një lloj forme të dallueshme nga të tjerët, e cila u thye dhe u zhubros në një lloj vrazhdësie perceptimi të një syri vigan. Sa e bukur është ajo rrugë në dimër! Dikur doli në shesh, kur ishte e panjohur. Turbullt, këtu një njeri mund të shohë shtegun simetrik dhe të drejtë të dyreve dhe dritareve; këtu, nën llampa po notojnë ishujt nën një dritës të zbehtë përmes së cilës shpejt kalojnë burra dhe gra, të cilët me gjithë varfërinë, që i bën të vishen rrecka-rrecka, tashmë kanë një pamje jashtë realitetit, si në një triumf, i kanë dhënë pak më shumë jetë këmishave të brendshme, në mënyrë të tillë që jeta, e mashtruar prej presë së saj, ecën verbas pa ato.
Por, mbi të gjitha, ne jemi duke kaluar mbi sipërfaqe duke rrëshqitur. Syri nuk i përket një minatori, as ndonjë palombari, as ndonjë që kërkon thesarin e djegur. Ajo rri pezull poshtë një rrëkeje; duke pushuar, truri mbase është duke fjetur.
Sa e bukur është rruga në Londër, me gjithë ato ishuj plot drita dhe korijet e gjata të territ nga njëra anë, hapësira plot bar të rritur ku po mbështillet nata brenda vetes së saj për të fjetur natyrshëm dhe, teksa dikush kalon hekurudhën, mund të dëgjojë kërcëllitjen e lehtë dhe përzierjen e gjetheve njëra-tjetrën, që duken se mendojnë për heshtjen e fushave rreth tyre, një buf këlthet dhe larg dëgjohet edhe rrapëllima e trenit në lëndinë. Por, kjo është Londra, në fund të fundit, këtë kujtojmë edhe ne; lart midis pemët e zhveshura janë varur kornizat drejtkëndëshe të dritës së kuqërremtë në të verdhë – dritaret; ka edhe shumë vende me shkëlqim që duken si yje të ulët – këto janë llampat; ky vend i boshatisur, që mban gjithë vendin dhe paqen brenda saj, është thjesht një shesh i Londrës, me plot zyra dhe shtëpi, ku në këtë orë dritat vezullojnë fuqishëm mbi harta, mbi dokumente, mbi tryeza ku punonjësit e zyrave rrotullohen me gishtin e lagësht tregues dosjet e pafundme të korrespondencës; lëkundjet e dritës së zjarrit dhe të dritës binin mbi

intimitetin e disa dhomave të gjumit, ku dukeshin madje edhe karriket, letrat, vazot prej porcelani, tryeza e brendshme dhe silueta e një gruaje, më me saktësi dukeshin edhe një numër i caktuar lugësh çaji, të cilat ajo i shihte në derë si të kishte dëgjuar një zile poshtë shkallëve dhe dikush që pyeste, a ndodhet ajo brenda?

Por këtu na duhet të ndalojmë në mënyrë të pakundërshtueshme. Ne jemi në rrezik nëse gërmojmë thellë e më thellë sesa na aprovon syri; kemi pengesa për rrugën poshtë rrëkesë së ulët, duke prekur disa degë apo rrënjë.

Në ndonjë moment të caktuar, ushtria e fjetur mund të rigjallërrohej dhe të zgjoheshin mes nesh në mijëra violina dhe trumbeta; ushtria e qenieve njerëzore mund të gjallërrohet dhe të mbrojë thagmën dhe vuajtjet, por edhe neverinë. Le të dëfrejmë pak më shumë, t'i gëzohemi ende sipërfaqeve – shkëlqimit të motorëve dhe autobusëve; shkëlqimit mishtor të dyqaneve të kasapit me cepa ngjyrë të verdhë dhe biftekë ngjyrë vjollcë; buqetat ngjyrë blu dhe të kuqe me lule gjendeshin në gotën prej koraceje të dritareve të luleshitësit.

Syri ka një karakteristikë të habitshme: ai ngec vetëm tek bukuria; si një flutur ajo kërkon ngjyra dhe prehet në ngrohtësinë e diellit.

Gjatë një nate dimri si kjo, kur natyra ka sjellë vuajtje për të pastruar dhe lëmuar veten, ajo kthen pas edhe trofetë më të bukura, ndalet te plisat e vegjël të smeraldit dhe koraleve, a thua se toka është e përbërë prej gurëve të çmuar. Gjëja që nuk realizohet dot është përbërja e këtyre trofeve në mënyrë të tillë që të zbulohen pikëpamjet më të errëta dhe marrëdhëniet njerëzore. Prandaj, pas një diete të tejzgjatur të kësaj pagese të thjeshtë e të sheqerosur, të bukurisë së dlirë dhe të pakompozuar, ne bëhemi të vetëdijshëm për ngopjen. Ndaluam në derën e dyqanit të këpucëve dhe u justifikuam, gjë që nuk kishte aspak të bënte me arsyen e vërtetë, asaj të mbështjelljes së sendeve personale të shndritshme të rrugëve dhe anulimi i disa dhomave të errëta që të ishim aty ku na kërkonin, teksa ngritëm këmbën e majtë të bindur mbi tezgë: "Çfarë, pra, do të thotë të jesh një xhuxh?" Ajo u fut e shoqëruar nga 2 gra, të cilat kishin masa normale, por dukeshin si gjigante dashamirëse pranë saj. Duke buzëqeshur në dyqanin e femrave, ata dukeshin se po hiqnin dorë nga deformimi dhe po e siguronin atë se do ta përkrahnin. Ajo përballoi takimin me grindavecin por shprehja shfajësuese e pazakontë në pamjen e deformuar. Ajo kishte nevojë për dashëmirësi dhe mezi po duronte.

Kur thirrën shitësen, që buzëqeshte, i kërkuan këpucë për "këtë zonjë"

dhe vajza e mbante stendën përballë vetes, shkurtabiqi nxorri këmbën jashtë me vrull, që dukej se pretendonte për vëmendjen tonë.
Shikoje këtë! Shikoje këtë! Ajo dukej se na kërkonte të gjithëve mendim, teksa shtynte këmbën jashtë, si një grua e mirërritur. Ishte e djallëzuar, ishte aristokrate. Sjellja e saj ndryshoi teksa ajo po vështronte ashtu e ngritur në këmbë. Dukej e vërtetë dhe e kënaqur. Sjellja e saj u bë më e sigurt.
Ajo solli këpucë pas këpuce; provoi palë pas pale. U ngrit dhe bëri një piruetë para një xhami, që reflektonte këmbët vetëm kur vishte këpucë të verdha, këpucë me lëkurë hardhuceje.
Ajo ngriti paksa fundin dhe tregoi këmbët e vockla. Po mendonte se, pas së gjithash, këmbët janë gjëja më e rëndësishme për njeriun; gratë, tha me vete, i kanë dashuruar vetëm kur i kanë parë këpucët dhe këmbët. Duke mos parë gjë tjetër, veç ëkmbës, ajo po imagjinonte mbase pjesën tjetër të trupit të kombinuar me ato këmbë të bukura.
Ishte veshur pothuaj me rrecka, por ishte gati të paguante shtrenjtë për këpucët.
Ky ishte i vetmi rast, kur po frikësohej ngaqë po e shihnin, por kërkoi vëmendje pozitive, ishte e gatshme të përdorte ndonjë mekanizëm për të zgjatur sa më shumë kohën për të zgjedhur dhe për t'u përgatitur. Ajo dukej sikur thoshte "shikoje këpucën time" teksa bëri një hap dhe më pas edhe një hap tjetër drejt. Shitësja me humor të mirë dukej lajkatuese deri diku, por papritur fytyra e saj u ndriçua nga ekstazia. Por, mbi të gjitha, viganet, ashtu mirë- dashëse siç dukeshin, kishin edhe ato problemet e tyre; ajo duhej të ishte e përgatitur; ajo duhej të vendoste se çfarë të zgjidhte. Si gjatësi, i kishte zgjedhur me numrin e duhur dhe teksa ecte midis kujdestareve, ekstazia po venitej, vetëdija iu kthye, zemërimi po ashtu, edhe apologjia e vjetër dhe me kalimin e kohës ajo arriti në rrugë përsëri, por tashmë ishte shndërruar në një shkurtabiqe.
I kishte ndryshuar gjendja shpirtërore dhe humori; i kishte bërë thirrje ekzistencës së atmosferës, teksa po e ndiqnim në rrugë. Dukej sikur kishte një xhungë në kurriz, si me bërryl, e deformuar. Dy burra me mjekër, vëllezër në dukje, po mbanin njëri-tjetrin duke u mbajtur mbi kokën e një djaloshi të vogël që ecte mes tyre dhe më pas marshuan poshtë rrugës.
Ishin të palëkundur, por të ndruajtur prej verbërisë, që dukej se po shtonte avitjen e terrorit dhe pashmangshmërinë e fatit që i kishte kapluar.
Teksa po kalonin, duke ecur vetëm drejt, vargani i shkurtër dukej se po

ndahej më dysh – më pas erdhi momenti i heshtjes, i gjëmës. Në të vërtetë, shkurtabiqja kishte nisur një kërcim grotesk çalë-çalë që po e ndiqnin të gjithë në rrugë: zonja e fortë dukej sikur kishte lëkurë foke; djaloshi debil po thithte majën e shkopit të tij; plaku po rrinte galiç dhe papritmas erdhi në vete nga absurditeti i spektaklit njerëzor, që ishte ulur ta shiht e– të gjithë u bashkuan për të shijuar kërcimin e shkurtabiqes.
Këtu, mbi dhomat e vogla të shtëpive antike midis Holbornit dhe Sohos, ku njerëzit kanë emra të dyshimtë dhe kanë profesione të habitshme, janë njerëz të pagdhendur. Ata banojnë aty dhe duket sikur zonjat me xhaketë lëkure foke duhet ta jetojnë jetën me tolerancë, ta kalojnë kohën me burrat e pagdhendur që luajnë fizarmonikë; jeta që është kaq fantastike e nuk mund të jetë kaq tragjike. Ata nuk na durojnë dot, ne mendojmë për prosperitetin; kur, papritmas, duke u kthyer nga cepi, u afruam tek një hebre me mjekër, i egër në pamje, i ndezur prej makutërisë së tij; kaloi më pas një plakë me kurriz të dalë, e braktisur, që ecte pranë ndërtesës publike veshur me një mantel, si ato që vendosin mbi trupin e ngordhur të ndonjë kali a gomari.
Në vështrime të tilla forca e shpinës dukej si e montuar artificialisht; një shkrepje e papritur vringëllonte në sytë tanë; një pyetje ngrihet, kur nuk merr kurrë përgjigje. Shpesh këto dëshira të braktisurve shtrihen mbi një gur të flakur nga teatrot antikë, brenda organeve si cilindër, pothuajse kur nata afrohet, brenda prekjes së pelerinës me temina dhe këmbëve të ndritshme të darkuesve dhe kërcimtarëve. Ata shtrihen afër dritareve të dyqaneve ku tregtia i ofron botës së plakës së shtrirë nëpër shkallare, të verbërve, shkurtabiqëve që ecin çalë-çalë divane që mbrohen nga qafa e praruar e mjellmave krenare; tryezat në brendësi me shporta shumëngjyrëshe; bufe me ngjyrë gri të mermertë, që mbajnë peshën
e kokës së derrit të egër; dhe qilima aq të butë, saqë boja e karafilit pothuaj venitet nën detin e zbehtë ngjyrë të blertë.
Duke ecur, duke hedhur shikime të shpejta, çdo gjë duket si aksidentale, por në mënyrë të mbinatyrshme si e spërkatur me bukuri.
Pa ndonjë synim për blerje, syri është sportiv dhe mjaft fisnik; ai krijon; zbukuron; zmadhon. Duke qëndruar jashtë në rrugë, njeriu mund të grumbullojë të gjitha ndarjet në në shtëpi të imagjinuar dhe arrin t'i furnizojë ato me mobilje, me divanë, tryeza, tapete. Ky tapet përshtatet më së miri me korridorin.

përktheu Rudina Dahri

ESE

Jovan NIKOLAIDIS

SHQIPTARI IM

1.
Thonë se miqësitë e vërteta lindin dhe zgjasin aqë sa njeriu është i ri dhe i forte, dhe të tilla mbesin deri në vdekje. E ndoshta mbesin të ruajtura edhe pas saj, dreqi e di, nëse është e vërtetë ajo që thonë predikuesit se ekziston jeta pas vdekjes dhe se kjo jetë është vetëm kalimtare dhe duhet duruar vuajtjet e kësaj jete në mënyr që të shijojmë ato të përtejmës, atje lart ku Zoti ka gjithë komoditetin e vet do takoheshin këta dy miq të cilët do kenë mundësi të vazhdojnë diskutimin pafundësisht. Miku, të cilin e zëni në moshë të thyer, i bie si lehtësim në bashkëudhëtimin për në lehtësirat e përtej të kuptueshmes, në hapsirat e asaj ane të jetës. Këta njerëz dinë të na bindin me urtësinë e vet që mirësia, të cilën e kemi shpërndarë për të gjallë, e ruajtur dhe na pret që në te të zhytemi sikurse në nirvanë. Mund të jetë?! Sidoqoftë, miqësia e zënë në moshë të thyer, të cilën e forcon përulja e dyanshme është një pasuri e vërtetë e me te edhe më e çmueshme sepse është më e rrallë. Kjo është e mirë sikurse ato dhuratat që keni gjetë në njerëzit që ke njoftu në rini. Duhet çdonjëri prej nesh ta dijë se sa është i lumtur që ka gjetë dhe ruajtur dy gjëra të çmueshme: shokët nga fëmijëria dhe miqtë e pleqërisë.
Miqtë nga rinia një nga një më kanë vdekur, më presin në mbretërinë e premtuar. Prej tyre në këtë anë të fushës përplot me gjëmba e lot më kanë mbet vetëm plagë të njoma e cila nganjëherë therin zemrën. Kurse shiprti e ka më lehtë, ajo është e mbështjellë me afërsinë e mbetur nga këta, vëllezërit përnga idetë, shokët nga kështjella e realitetit, miqtë që më dha pleqëria. Duhet falenderuar rastësisë që të falë miqë në pleqëri. Sdi a u kam thënë: një të tillë e gjeta në Shqipëri dhe sot e ruaj që ditët në vijim të mos ma rrëmbejnë. Kam frikë mos e lëndoj, sepse është i birshtë sikurse unë por shumë më i mençur, ate e besa as mua jeta nuk na ledhatoi por ai mbrohet me fisnikërinë e vet më shumë seç kam mundur unë ndonjëherë.

2.

I nderuari mik Jovan,

Këto ditë lexova parabollën për një predikues i cili nxënësve të vet u ligjëronte misticizmin (aqë sa misticizmi mund të mësohet – pasi që unë mendoj se misticizmi lind dhe përfundon me njeriun). Deri sa mjeshtri fliste, pasuesit çuan sytë nga qielli: panë një njeri duke fluturuar nëpër qiell. Mjeshtri i predikimit u tha:

- Mos e shikoni më. Koncentrohuni në fjalët e mia.

- Pse mos ta shikojmë, thanë nxënësit?

- Mosni, i paralajmëroi mjeshtri. Nuk është kjo asgjë e veçantë dhe çuditëse. Ai ishte nxënës sikurse ju. Si nuk po e njihni? Pak më parë ishte këtu.

- Por, ai po fluturon, mjeshtër. Si të mos e shikojmë këtë mrekulli.

- Thjeshtë, tha mjeshtri. Prap mund ta përsëris. Ate jam duke e mësuar se si të dashurojë.

3.

Për here të parë u takuam në panairin e Lajpcigut. Pjesëmarrja ime atje ishte së bashku me shkrimtarët tjerë të këtyre hapësirave në tribinën e quajtur ”Nata ballkanike” (“Balkan Nacht”). Ky është panairi i rinisë: interesimi i rinisë gjermane për letërsinë është shumë e fuqishme – përplot mbushen sallat, rrugëve të qytetit sheh kolona të rinjësh që marrin udhën e tempullit të dijes, trolejbusët përplot të rinjë e të reja të veshur në kostume të heronjve nga letërsia. Librave kult dhe më të lexuara.

Salla mbushet përplot. Në rreshtin e pare zyrtarët nga Serbia (ministri i kulturës dhe dy ambasadorë). Prej të mijëve nga Mali i Zi, si zakonisht askush. Në anën time të djathtë është i ulur – ai. Poeti shqiptar, përkthyes dhe profesor i arteve të bukura në Universitetin e Tiranës. Zonja Alida Bremer mbanë fjalimin. Më vie radha edhe mua. Flas për xhelozinë të cilën ndjejnë banorët e Europës ndaj neve, ballkanasve. Karikaturizoj, luaj me pamjet që na pasqyrojnë si të egër dhe primitiv. Liri e egër dhe bukuri. A thua kjo është ajo që bën qytetarin europian të tmerrohet nga jeta jonë e papërmbajtshme? Një miks i shoqërive të mbyllura, por e mështjellur me shumë ngjarje hyjnore, të ndaluara për ta. Mjaltë e gjak, ekzotikë e vendeve të lëna pas dore e cila del nga paqartësia dhe varësia. Si rëndom gjithmonë e teproj gjatë elaborimeve e kjo vie sepse mundohem të zbus qëndrimin e rreptë me një humor të lehtë.

Ku i erdhi radha atij që të flasë, shqiptari u përkul dhe nën karrige nxorri një fishek pushke. Plumb pushke prej së vërteti. Ia tregoi publikut dhe duke e sjellë mes gishtash tha: po, ky është një nga simbolet e Ballkanit. Po për çfarë mund të shërbejë ai në Lajpcig, në tribinë? (As sot e gjithë ditën nuk e kam kuptu se: atë plumb me të vërtetë e gjeti nën karrige apo ishte pjesë e performansit të tij?) Ishte konciz por poetik, fliste në mënyrë diskrete duke aluduar në fatin e errët të popullit të vet. Kisha përshtypjen se disa fjali ua drejtonte edhe musafirëve nga Serbia, apo edhe ndoshta gabohem pasiqë askush nga ta nuk reagoi.
Më vonë iu afrova, u prezantova dhe kështu filloi shoqërimi ynë: me bisedë të pafund. Respektin ndërmjet njerëzve së pari e zbulon biseda. Kishte të drejtë Hygo kur kishte thënë se: për vlerësimin e një njeriu kryesori është takimi i parë dhe përshtypjet që merren atëherë. Në atë mbrëmje çdo gjë shkonte drejt asaj se kishim gjithçka të përbashkët. E më vonë kam vërejt se natyra jonë ballkanike ishte ajo që do na afronte edhe më shumë e që gjithashtu edhe për këte kishte biseduar atë mbrëmje. Të lehtë e kanë njerëzit e arsyeshëm të mbajnë dhe të zhvillojnë raporte të mira. Mos vë në peshore mirësinë që ia jep mikut dhe mos pyet më shumë se është nevoja, mu atëherë kur të pyes është e panevojshme. Nga njerëzit e mençur përgjigjet më së shumti fitohen kur nuk vendosen pyetje. Ka procedura. Pa pyetur më së shumti fiton përgjigje.
Biseduam për gjithçmos. Perspektiva e Ballkanit, afërsia ataviste e shqiptarëve dhe malazezëve, për kusherinjtë e gruas së tij që i kam fqinjë në sokakun e kasabës sime, kultura europiane dhe literatura provinciale, lidhjet dhe ngjashmëritë, pyetjet e spiritualitetit, mistikës, tema nga muzika. Biseda të gjata dhe të matura të cilat ardhmëria i kishte përgatitur për ne që t'i zhvillojmë. Për politikë nuk biseduam, për te ai nuk shprehte interesim pavarësisht tendencës sime që nganjëherë të politizoj edhe për atë që nuk e kishte vendin. Fjalët e tija ishin: "Urat e miqësisë kemi me shumëçka tjetër t'i ndërtojmë". Pas disa muajsh më ftoi të marr pjesë në festivalin ndërkombëtarë të poezisë në Durrës. Më dha mundësinë që ta njoh më shumë Shqipërinë dhe të përforcojmë miqësinë. Për të gjitha këto sot deri sa po shkruaj këto rreshta për shqiptarët gjykoj sipas dhuntisë hyjnore.

I dashur dhe i nderuar!
Pse të mos e pranoj: kam gjet mikun sikurse kur të bie lotaria: paramendo numrin të cilin fati ta ka përcaktuar, e ty të bie premia

kryesore. Vëmendja ime tash të posedon. Fjala dhe mençuria yte i janë të nevojshme pleqërisë sime. Shumëçka e bukur më erdhi nga ti. Po të mos ishte vullneti yt i mirë, kur do ta njohja aqë mirë Shqipërinë unë?! Tash më shkruan: Jovan, kjo është toka jote, ti po i kthehesh shtëpisë tënde. E pse të mos e pranoj një gjë të tillë, kur mes jush gjithmonë ndjehem mirë. Durrësi, Berati, Elbasani. Vende të qeta që zbulojnë mistere. Më pret Korça, qendra e paraardhësve të mi. Bisedat që do zhvilloj në Tiranë me ty dhe të njohurit tonë nuk dyshoj se do të jenë një dhuratë kuriozitetit tim. Shpeshherë mes jush ndjehem porsi ai fëmija që është i rrethuar me dhurata. Konsideroj, se sa ta kem rolin e fëmijës, të tillit vdekja i rri shumë larg. A kam të drejtë?

4.

Lajmin të cilin e mora pas disa muajsh posaçërisht më gëzoi: libri im ”Rruzaret e fosforit” ishte përkthyer në gjuhën shqipe. Për këtë ai ishte meritor. Korrespodenca u shpeshtua. Mu bë shprehi që çdo mëngjes së pari të shikoj në ekran të kompjuterit - mos më ka shkruar miku im? Me kohë, mësova kompleksitetin e personalitetit të tij. Dituri e përgjithëshme dhe mënyra se si e parashtron është shumë e madhe. Mendimet e qarta dhe bukuria e stilit të tij ishin kulmore. Sensibilitet i matur në fjalitë e tija. Zbuloja njeriun me disciplinë çeliku i cili kishte prirje për humor, i çiltër dhe kurreshtar. Shqiptar me manire anglezi e krenari gjermani. I mençur dhe zemërmirë, i afërt dhe joimponues, i sinqertë dhe njejtë i matur.

Për babanë e vet më ka shkruar dhe shpesh më fliste me ngazëllim. Dëshironte të më njoftonte me te, mendonte se kishim pikëpamje të ngjashme për jetën; nganjëherë në korrespodencën tonë do krahasonte veprimet e mia me të babasë. Babai i kishte lundruar me anije të flotës tregtare të Shqipërisë. Privilegj i rrallë që një pjestari të një bashkësie të mbyllur pjesërisht t’i hapet bota. Kur arrinin në skele, detarëve shqiptar u kufizohej mundësia e lëvizjes. Më tregonte se si babai i tij i sillte miqve të vet shishe vere me etiketa në të cilat ishin gjurmët e një bote tjetër: - timonieri me një shkrim të keq do shënonte vendin dhe datën se ku e kishte blerë verën.

(Marrë nga libri Shqiptarët dhe unë, përktheu Gazmend Çitaku)

EX-LIBRIS

Dr Rrustem Berisha, Instituti albanologjik, Prishtinë

POROSI MOBILIZUESE PËR QËNDRESË

Jemi më të pasur me një libër, **Përmbledhje Vlerash Njerëzore**, të Dr Simë Dobrecit, i cili sjell zërat dhe faktet kulturo-historike të viteve dhe shekujve të bashkuar në polifoni me jehona krenare, me jehona bukurie, me jehona gazmore, me jehona të peshës tragjike, momente e fate gjithfarëshe që fati ua caktoi shqiptarëve dhe të parëve të tyre, ilirëve.

Në qoftë se i shikojmë gjymtyrët e librit, duhet ta shohim punën që është bërë aty. Janë shkrime të shumta të profesor Dobrecit, janë të përgatitura nga profesori, janë të autorëve, të cilët i bashkohen zërit të profesorit, janë të atyre që dëshirojnë të çvleftësojnë dhe të mbrapshtojnë veprën e profesorit. Por, ky shumëzërësh bashkohet në një pikë, në epiqendrën që do t'i themi: *Porosi mobilizuese për qëndresë*. Përmbajtja e tyre do të mund të përkufizohej me fjalë domethënëse, shprehëse kuptimesh me përqendrim të fortë në ndodhjet historike e kulturore dhe në aspektin e asaj që synon profesori të arrihet. Do të mund të themi se shkrimet dëftojnë për tronditje vitesh e shekujsh, do të ishte, po ashtu e drejtë, të themi se na sjellin jehonën e historisë, do të na dukej e arsyeshme t'i kualifikonim mesazhe për ruajtjen e identitetit shqiptar.

Të gjitha këto ligjërime i poston ky libër te lexuesi, madje, edhe më shumë rrëfime që prej pragut të sotëm deri para 2000 vjetësh.

Në të gjitha shkrimet dhe përgatitjet e shkrimeve, në të gjitha ligjërimet e autorëve të ndryshëm që paraqiten këtu, del e qartë këmbëngulësia e profesorit që çështja ta ndjek rrugën e duhur: mos e bëni pa zot vendin tuaj, bëjeni me zot vendin tuaj.

Në shkrimet e profesorit shkruhet me dhjetëra e qindra herë për gjuha shqipe, gjuha e nënës, gjuha e Buzukut, gjuha e të parëve, gjuha shestanase. Vetëm ky hap lëvizjesh të fjalës gjuhë shpreh dashuri deri në pafundësi. Me dhjetëra qindra herë insistohet në shkollim në gjuhën amtare, prej fillores e deri në superioren. Insistohet të shkruhet gjuha shqipe në çdo vend e rrethanë ku jetojnë e veprojnë shqiptarët. Ngulet këmbë për shkollim në gjuhë amtare në mënyrë që shqiptarët të emancipohen ashtu sikurse janë emancipuar popujt fqinjë dhe popujt e kontinentit.

Ai përmend personalitete shqiptare, siç janë ato humaniste, luftarake, krijuese, që barazohen me vlera me personalitete të popujve të përparuar në mënyrë që shqiptarët të shërohen nga ndjenja e inferioritetit dhe të ndihen

krenar për faktin se janë komb me vlera.
Përmenden fshatra me jetë idealiste, dikur me plot banorë, bagëti, pemë, e, tani ''pa frymë njeriu të gjallë', shtëpi me kulme të rrënuara, me mure të shkapërderdhura, kisha si murana, kroje të batallisura, ara djerrina. Fshatra me tërë banorët shqiptarë, ku është folur e kënduar shqip. Po tash s'janë më. Shkon më larg në kohën e pushtimit malazez ku plot fise u shkombëtarizuan, kur mbiemrat shqiptarë u deformuan me –iq dhe –viq.
Përmenden veshje grash e burrash që të nxisin përjetime të këndshme, që i mahnitshin të huajt e që ishin mburrje, por nuk do të thotë që i do koha sot, sepse emancipimet kudo në botë ndryshojnë edhe rrobat. Por, ato nuk do harrohen, sepse ishin fakte në jetën e banorëve.
Me maturinë e qetësinë e njeriut human, njeriut demokrat, çka tash në Ballkan janë të rrallë, kërkon nga shteti malazez kujdes, interesim, veprim që t'i zhvillojë viset me shqiptarë me përkrahje, me investime, me ligje të avancuara për të drejtat e popujve.
Është, profesori, njeriu që nuk shpreh zemërim, mëri, urrejtje, nënçmim, kundër të tjerëve popuj, aq më pak kundër shtetit në të cilin jeton. Ai e din padrejtësinë që u bëri Evropa shqiptarëve e i solli në pozitë të pafatshme, por e kupton se po të krijohet këtu jetë e përparuar e shqiptarëve të gjitha të tjerat do të bëhen më të lehta.
Profesor Dr. Simë Dobreci, si demokrat dhe human e kupton të kaluarën, por si demokrat dhe human, ashtu si vepron bota që e gëzon demokracinë, kërkon me ngulm, me bindje, me mbështetje në të drejtat që nuk mohohen kurrsesi – zhvillim, ndihmë, kujdes për shqiptarët.
Kërkesat e tij në asnjë aspekt, nuk mund të kundërshtohen dhe të mohohen.
E kanë kot intrigantët e shpifësit, të cilët Dr. Simën e paraqesin si njeri që ndërron kombin si rrobën, apo si njeri që nxit shpesh urrejtje kundër popujve tjerë. Dr. Sima nuk i lejon vetit një zbritje të tillë vlere. Ai ka profesion ku punën e ka filluar me betim dhe e ka përfunduar nën betim. Është njeri i formuar, është intelektual komplet që nuk i lejon unit të tij zbritje vlerash.
Në qoftë se preferon, që predikimi në gjuhën shqipe të mbahet në kishë, çfarë të keqe ka? Lutja drejtuar Perëndisë për mëshirë, ndihmë, kurrë nuk ka vra njerëz. A ka arsye të kundërshtohet? Kënd e dëmton vocërraku që mëson e shkruan në gjuhën e nënës, kënd e dëmton shkollari që mëson, dëgjon mësimet në gjuhën shqipe. Kënd e dëmton studenti që përcjell ligjërata në gjuhën e vet, që merr mësime akademike në gjuhën e vet?
Shteti këto kërkesa duhet t'i arsyetojë e zhvillojë, sepse vetëm i tillë i plotëson standardet e shtetit me demokraci të avancuar.
Profesori ecën në rrugën më njerëzore që lyp e zgjedh intelektuali i vërtetë. Ndërkaq, kundërshtarëve u mbetet të zgjedhin mënyrën dhe mundësitë që të

shërohen nga mënyra i qeverisjes së kralave, knjazëve dhe komunistëve, të cilët i sundonin popujt me forcë e dhunë, i dënonin me skenare për armiqësi si shkatërrues të rendit dhe të drejtësisë. Kush nuk heq dorë nga ato metoda, është i sigurt, nuk ka çka pret tjetër, pos vdekjen në aspektin moral dhe human si njeri. Profesori është i vetëdijshëm se zhvillimet pozitive të dobishme për çdo popull nuk do të ndalen, nuk e ngarkon vetën me brengat që ia ngarkojnë spiunit dhe shpirtprishurit.

***

Libri ndahet në dy kapituj dhe secili pagëzohet bazuar në përmbajtjen që ligjëron, në konstatimet e faktet që i thotë dhe i përcjell te lexuesi. Më duket se është renditje e qëlluar, por padyshim se në radhitje ka ndikuar edhe botimi i punimeve nëpër publikime dhe në **Buzukun** ku lypet ruajtur edhe radha e kronologjisë.

Kapitulli i parë mban titullin, i cili shpreh strukturën e materialeve: *Dromca për gjuhën shqipe, për traditën dhe historinë*. Këto janë shkrime të shkurtra, telegrafike. Pra, janë të natyrës së komunikimit lakonik. Për lexuesin e zakonshëm, i cili gjërat do t'i kuptojë qartazi, shpejt dhe bindshëm, këto punime duhet të jenë të përshtatshme dhe mbresëlënëse. Është renditja e shkrimeve që gëzojnë gjithmonë popullaritet dhe lehtësi në përvetësimin e porosive, bindjeve dhe të vërtetave.

Po ta hiperbolizojmë pak, mund të thuhet se prof. Dr. Simë Dobreci gjuhën shqipe e përmend dhe e nderon pa e hequr kurrë nga goja. Gjuha e nënës për profesorin është ylli më i bukur e më i ndritshëm në qiellin e vendit të tij, thënë simbolikisht. Ai e thotë ndryshe: *po flas në gjuhën shestanase, po shkruaj në gjuhën e ëmbël të nënës*. Këto shprehje e rrisin dashurinë e tij aq shumë, sepse ai ka mundur të thotë po flas në gjuhën shqipe standarde, por kjo ia largon aromën e nënës dhe aromën e Shestanit.

Ata që e kanë bjerrë këtë gjuhë që flasin *nashke* i kthen në vlerat e gjuhës shqipe, duke u thënë se gjuha shqipe e bëri veprën e parë para pesë shekujsh, me atë gjuhë u kënduan këngë të bukura, u bën dasma e gazmende të bukura dhe nuk ju takon të turpëroheni e të largoheni prej saj.

Sa i takon traditës ai shënon fakte nga subjektet vendase, i sjell ato që kanë shënuar hulumtuesit, viziton fshatrat që të njihet atje me burimin e gjallë të jetës ideale të këtyre viseve. Dhe, në vazhdimësi i zë në gojë shqiptarët e shpërngulur në Itali dhe në Zarë që ruajtën gjuhën autentike shqipe. Të bazuar në atë të folme albanologët tanë e të huaj dhanë kontribute të shkëlqyeshme për shkencën. Ai e zë pa ndarë në bisedë ***Mesharin*** si një tryezë që i jep ushqim të mirë e të bollshëm gjuhës sonë.

Kështu vepron me dromcat e traditës me dromcat e historisë, duke sjellë fakte prej historianëve antikë e deri te dijetarët bashkëkohës siç janë Edith Durham, Aleksandër Stipçeviq e të tjerë të kohës së re. Me këto hulumtime

deri në imtësi merren albanologët e përkushtuar, por për fat të mirë është marrë edhe doktori i mjekësisë i cili në profesionin e tij ka zhvilluar veprimtari solide praktike e shkencore dhe është shpërblyer e dekoruar nga institucione shtetërore e kulturore në Kosovë, Shqipëri, në Ulqin dhe në Amerikë. Kështu, autori i librit bëhet një simbol i veprimtarisë së gjerë dhe të vlefshme edhe me kontributet albanologjike.

Kapitulli i dytë me shkrime, polemika dhe vlerësime është, të themi, me shkrime më komplekse. Aty botohen shkrime që çmojnë punën e Dobrecit në shkencën e medicinës, në praktikën mjekësore, që ka ushtruar, në daljen zot kur shemben mbi shqiptarët në Kosovë shkëmbinj të rëndë të padrejtësive dhe presione të përcjella me krime nga Serbia.

Ka shumë gjëra, por krijuesit dhe intelektualët, gazetarët që bëjnë shkrime, vlerësime, intervista, portrete të doktorit, e mbulojnë me epitete të shkëputura nga natyra e gjerë e lartë si Rumia.

Këto epitete, po them kështu, janë shëndet moral e intelektual për Simë Dobrecin. Edhe vetë ndihem entuziast në momentet kur e lexoj e mendoj librin, prandaj i arsyetoj të gjithë ata që doktorit i rrinë përkrah në punën e tij dhe shprehen në lartësinë për personalitetin e tij në trajtat piedestale.

Doktori, nuk ka pikë dyshimi, në punën e tij, ka ushtruar ndikim të kënaqshëm jo vetëm në radhët e intelektualëve të Ulqinit, të cilët e duan shumë, por edhe në Kosovë e në Shqipëri prej kah vinë këto shkrime. Shkrime e letra përkrahëse e adhurimi na radhiten këtu edhe nga njerëz të zakonshëm nga Tivari, Italia, Amerika, Zelanda e Re, pra shtete e kontinente të ndryshme. Të shkoj zëri për të mirë në tërë këto anë, është vlerë e s'ka tjetër.

Titujt e shkrimeve në libër janë shumë, pra edhe ligjërimet e tyre janë plot sinqeritet dhe e mbulojnë fushën e njohurive më të vërteta historike. E tepërt do të bëhet të komentohen të gjitha. Besoj se përmbledhjes këtu i është dhënë arkitektura, që ndërton veprën me synimet e saj që të ndihen gjallë, të bëhen të gjallë e të fortë, të bëhen fortesë si moti, këto vise dhe populli i autorit.

Shqiptarët e kanë të drejtën të zhvillohen dhe të përparojnë njësoj si populli malazias me të cilin jetojnë.

Të mos u vonohet as e drejta as agimi i tyre i çiltër i përparimit.

Fatmire DURAKU

DEMI I TËRBUAR

Nexhat Halimi "Demi i tërbuar", roman, botoi Shtëpia Botuese "Fad" 2018

Proza e Nexhat Halimit rrjedh në disa shtresa. Sidomos kjo e romanit. Ka inserte të lidhura, mozaikë ngjyrash dhe dhembjes së përhershme. Në këtë mënyrë autori e nis dhe prozën e fundit, të rrjedh ndërmjet dokumentares së pastër dhe imagjinatës së thellë. Me disa shtresime, në disa rrjedha, shumë natyrshëm, në mënyrë mjeshtërore, autori ia del të bën kalimin përgjatë gjithë tekstit nga e kaluara në të tashmen. Kjo gjë e zgjon te lexuesi lidhjen e kohës, e bën rrëfimin kaq tërheqës dhe të përjetohet vetëm me nuanca.

Një tekst dramatik dhe kaq i shtjelluar bukur.

Kaq ndihet ajo që pritet. Fillimi i vdekjes dhe dhembja për jetën.

Kjo e keqe e kanosë mbarë rejonin.

Libri është ndarë në tri pjesë, të cilat – secila në mënyrën e vet, e flet luftën, jetën dhe vdekjen. Pjesa e parë i kushtohet Asim Vokshit dhe është emëruar "Fuente del Ebro", pjesa e dytë bën fjalë për jetëshkrimin e Xhemail Kadës dhe është emëruar "Letra e birit të vdekur", në bazë të një shkrimi të poetit tonë të shquar Esad Mekulit, i cili ndanë kujtime për heroin e Spanjës, me të cilin jetoi te motra e vet në të njëjtën shtëpi me të në Pejë, ku kreu gjimnazin, ndërsa pjesa e tretë "Dashuri e paepur", është pjesa e cila gërshetohet me rrëfimet e atyre që u përgjakën e mbetën të gjallë të tubuar tash në Kongresin e V të luftëtarëve të Spanjës, si dhe pjesa më e prekshme në shpirtin e lexuesit është rrëfimi – në shtatëmbëdhjetë unaza, ku autori në bashkëveprim me një kolege të gazetës "Miagar Szo" njihet me historinë në të cilën frymojnë, flasin për ullirin tre mijëvjeçar, për Pallatin e Dioklicianit, për mitet e legjendat, të cilat ndrisin shumë detaje nga jeta e ikur dhe e tashmë e mbetur kujtim.

Rrëfimi në këtë mënyrë është i gërshetuar dhe zgjon jetën e vdekjen.

Përshkruhet deri në detaje gjaku i derdhur.

Zgjon etja për jetën.

Në Spanjë shpërthen lufta. Ballafaqohet e zeza kudër të kuqes, kacafyten për vdekje. Në rrugët e Madridit, të Barcelonës, të Andaluzisë,

të Belçitës gjurmë të mëdha të gjakut, kërpudha të flakës tmerrojnë fshatra e qytete. Tronditet bota paqedashëse, bota revolucionare. Shfaqet solidaritet i paparë në të pesë kontinentet; mbahen demonstrata në mbrojtje të atyre që mbrojnë lirinë, kërkohet të mos ndërhyjë askush nga jashtë, të ndalet kasaphana e re. Mblidhen barëra, ushqime, veshmbathje, sheqer e qumësht për fëmijët, për të moshuarit e nënat, të cilët u bënë mur para fashizmit në Spanjën martire!

Arrijnë nga të pesë kontinentet dhe vullnetarët e parë, të vdesin për ideal!

Shfaqet kështu dashuria e madhe e lirisë së një gjenerate; për bukë e paqe, pa kërkuar asgjë, vetëm një armë dhe një vend në front. Lulëzon zjarr i ri në gjakun e secilit, të përbirojë kokën paepur drita e përgjakur e Spanjës tri vjet me radhë, në fund të digjet, ndër kaq vdekje në fushat e betejës...

Dy pika lot i ndrisin Bijes nën sy.

"... Unë po shkoj, sikur po shkojnë nga të gjitha anët e botës, i bindur se kështu jap kontributin tim, sado të vogël!" E rikujton ajo ndarjen me Asimin, i cili do të ik mes atyre që kapërcenin dete e oqeane, male e fusha, për në tokën e kastanjetas dhe të flamengos; të radhitet në brigadat internacionale dhe deri në frymën e fundit në Spanjë të mbrojë Republikën. Ai nuk do të kthehet më. Do të mbetet mes atyre-në një varr të përbashkët, që me gjak shkruan epopenë e paharruar, do të mbetet në Fuente del Ebro.

Të njëjtën gjë do ta bëj dhe Xhemal Kada.

Për këta të dy dhe për shtatëdhjetë të tjerë, të cilët do të përgjaken në Spanjë, autori do ta shkruaj romanin e vet të pestë.

Romani "Demi i tërbuar", i punuar ndërmjet jetëshkrimit të Xhemal Kadës e Asim Vokshit, ka tendenca të jetësojë tri shtylla e rrjedha të shpirtit të paepur e human të shqiptarit në kohë dhe hapësira të caktuara. Shkrimi i autorit tashmë të njohur, përmes atyre që nuk e kursyen gjakun e vet për lirinë e Spanjës demokratike, shpreh lashtësinë e trungut arbëror, është gjysmë dokumentar, natyrisht i begatuar me imagjinatën dhe mrekullinë e prozës mjaft lirike. Kjo prozë nuk është e zhveshur nga figurat e metaforat, të cilat gjithnjë e begatojnë rrëfimin dhe ashtu të rrjedhshëm e natyrisht të kapshëm. Gjithë kjo e realizuar, përmes gjurmëve të ngurta dhe atyre që ende marrin frymë. Rrëfim i shtrirë ky në disa treva, në disa shtete të Evropës dhe me inserte jete e vepre të personazheve nga mbarë bota, gjithnjë prej nga vijnë ata të luftojnë për lirinë e demokracinë. Romani pikënisje i ka dy figurat e

shquara të Kosovës, Xhemalin e Asim, por dhe ngjarjet e një jave në Split, gjatë tubimit të vullnetarëve nga të pesë kontinentet e botës - luftëtarë të Spanjës. Me sukses, autori ia ka dalë të përqendrohet dhe në elemente, rrënjë e trungje të lashtësisë, të paraqes mbetjet ilire në truallin në të cilin mbahet kongresi i tyre i pestë, pra në Split të Kroacisë, buzë detit të mrekullueshëm, në hotelin "Lav".

Gjatë rrugës për në Split autori takohet dhe me reporterin e gazetës "Magiar szo" të Vojvodinës, ndërsa vetë është reporter i Rilindjes për të shënuar rrëfimet e atyre që ia bënë lavdinë për vite Spanjës demokratike. Ata humbën luftën, por lavdia mbeti të jehojë ndër kohë e breza. Në tubimin në Split, ai e ajo, të dytë reporterë, përveç ngjarjeve tronditëse të atyre që luftuan sypatrembur në Spanjë do të kenë kohë dhe natyrisht kureshtje e etje t`i gjejë gjurmët e lashta, të cilat dëshmojnë për paraardhësit e banorëve të sotëm aty. Ata vendosen në hotelin Split dhe gjatë kohës së angazhimeve të luftëtarëve të Spanjës do të vizitojnë shumë eksponate në muzeun e qytetit, para të cilave do të shpreh mahnitje dhe habi të papërshkruar reporteria hungareze. Ajo do të shfaq jo vetëm interesim për lashtësinë, por do të tregojë mahitje me shtrirjen kaq të madhe të Pallatit të Dioklecianit. Miku i saj tashmë, reporteri i Rilindjes, përveç shënimeve në prospekte do ta njoftojë atë me prejardhjen e pronarit të parë të pallatit, për copat e viseve të shkëputura të tokës ilire, për Teutën e figura të tjera madhore, të cilat do të lënë gjurmë në kohë e hapësirë, në histori. Ai, ndonjë herë do të mbyllet në vete, do të meditojë herë heshtur herë me zë për ullinjtë mbi dymijë vjeçar, të cilët dëshmojnë dhe sot lashtësinë e ndonjë herë përmes ndonjë gjurme dhe brezat e ikur, të cilat lanë prapa shumë relikte. Përveç bisedave të gjalla për t`i ndriçuar jetëshkrimet e Vokshit e të Kadës në Gjakovë e në Pejë, ai do t`i përshkruajë me durim kullën rrëzë Çabratit, me anëtarë brezash të ndryshëm të Asimit, siç është halla Bija, vëllai Miftari dhe Flaka, e bija tij, Ali Olloni etj. Reporteri gjatë rrjedhës së romanit do të gjej kohë të rikujtojë dhe ndonjë pjesë të ecjes së vet në jetë, që dëshmon për etjet që i kishin, për demonstratat e fundit të viteve të shtatëdhjeta të shekullit të ikur, apo për demonstratat e më vonshme, për të qenë të njëjtë me të tjerët që këtë trevë e mbanin prej kohësh të robëruar.

Ngjashëm ndodh dhe me bisedat në familjen e Xhemal Kadës, me sinënën e Xhemalit-Sheqeren, me Mahirin, vëllain e vogël të dëshmorit, si dhe me kujtimet e shkruara enkas të poetit të shquar Esad Mekuli, i cili shkollimin e mesëm e mbaroi në Pejë, duke e njohur për së

afërmi dhe mjaft mirë Xhemalin. Rrëfimi i Esadit është dhënë me besnikëri dhe ndrit shumë çështje të kohës. Kështu ndërlidhen shumë çështje dramatiket dhe jepet një pasqyrë mjaft e ndritshme rrëfimi për kohën, për njerëzit dhe bëmat e tyre në hapësirë të caktuar. Një kujtim lidhur me Xhemalin, një kujtim të bartur nga brezi paraprak, e thotë dhe Sh. Grabovci... Veçmas janë interesante insertet e Asimit në Spanjë me autorin e romanit "Hasta la vista" të Petro Markos dhe çastet e fundit të Skënder Laurasit e të Xhemal Kadës në Spital. Laurasi kujton: *"E kthyen nga pavijoni i operacionit për vdekje të shtrirë, nën fasha.*

E vendosën në shtratin e majtë të dhomës nr. 47, në Spitalin e Barcelonës. Arriti ta lëvizte dorën, ta shprehtë dëshirën e fundit: kërkoi të takohet me ndokënd që flet shqip. Me ndonjë shqiptar.

-Të flas në gjuhën e nënës me të, - bëri përpjekje të thoshte. Infermierja që kujdesej për të, kërkon dhomë më dhomë, mos do të gjej ndonjë shqiptar. Nuk gjen. Ama fatit nuk i dihet. Ajo takon aty profesor Skënder Luarasi, i cili gjendej në Spanjën e ndezur flakë; shërbente përkthyes, sidomos nga gjuha gjermane. Punonte në zyrat e brigadave internacionale.

Ai menjëherë do të shkojë të takohet me Xhemalin, i cili dëshironte ta informonte dikush për gjendjen në front. Ta njoftonte për shokët, me të cilët krah për krah luftoi. Ai do të habitej me atë çfarë e preokuponte Xhamalin në çastet e fundit të jetës.

-Më ke thirrur, - i tha Skënderi.

Ai nuk mundi t`i kthejë përgjigje. Vetëm pakëz lëvizi gishtat e dorës".

Përfundon çdo gjë. Lufta kaherë është mbyllur.

Autori rri vetëm në një gur. E shikon mjeshtrin nga e punon mozaikun para ndërtesës së vet në Split. Veten e sheh nga qëndron me respekt përballë ullinjsh dy mijëvjeçar në ullishtat e Ulqinit dhe Tivarit. Aty fle shpirti im i copëtuar, - thotë. Natyrisht, i lidhur me Teutën në Rizonë, te burimi nga ende buron uji në një shpellë dhe hove-hove nxjerr para të imta në shkulmat e veta dhe prapë i merr.

Rrethi Polka gjithnjë mbetet magjik, shkruan.

Ama, ta harroj këtë punë e të nis të ta shkruaj poezinë e ndarë në pjesë, përmes së cilës rrjedh kurrizi i vjetërsisë dhe dashurisë së paepur ndër vite. Aty fle shpirti im e qan për nënë tash sa të ketë shpirt ky ujë, ky ajër, kjo tokë e dru ulliri, ky zjarr.

Lulja e mermertë

Tash është qiell me lule të mermertë
Mbi gjirin e bardhë jashtë murit

Aty të vij zemra e vetmuar e të qajë
Të krenohet ylli me kalanë e varur mbi bunë
Të pi vogëlushi qumësht
E të rikrijojë besim te zoti

Ta thërras e thërras nënën që s`kthehet
E gjithmonë do të jetë aty me cicat jashtë
Vetëm t`i vihet themeli agut

Tash është veç lule me aromë

Do cekur se autori Nexhat Halimi është dëshmuar vite me radhë publicist, poet, dramaturg dhe romansier. U lind në fshatin Dumnicë të Poshtme të Podujevës, është nga një familje, e cila, para thikës serbe-në verë të vitit 1878, iku nga fshati Tullar i Toplicës.

Vite me radhë qe gazetar, reporter dhe redaktor në të përditshmen "Rilindja". Për një kohë redaktoi faqet e kulturës e të letërsisë në "Zëri i rinisë", në gazetën e përditshme "Yliria post" qe redaktor i shtojcës për kulturë, letërsi dhe art, pastaj redaktor përgjegjës në gazetën "Pavarësia...", në të cilën redaktoi dhe shtojcën për kulturë dhe letërsi, disa vite redaktoi revistat për fëmijë "Zog mëngjesi" dhe "Mollëkuqja", ndërsa në revistën letrare "Verbi' redaktoi poezinë. Është autor i një varg librash me poezi, proza e drama.

Është përkthyer dhe përfaqësuar me poezi dhe prozë në shumë antologji në gjuhën shqipe dhe në shumë gjuhë të botës.

Librat e tij kanë zgjuar interesim të kritikës dhe të lexuesit.

... Ky shkrim, romani "Demi i tërbuar", e dëshmon dhe një herë përvojën dhe talentin e autorit Nexhat Halimi.

Dr. Nail DRAGA

VIZIONE, SHOQËRORE, POLITIKE DHE FETARE

Trajtimi i çështjeve të ndryshme shoqërore ka kohë që është bërë preokupim i sociologut Qani Osmani. Pas librit të parë *"Demokracia dhe partitë politike shqiptare në Mal të Zi"* tani opinionit i paraqitet me botimin më të ri, me titull *"Vizione, shoqërore, politike dhe fetare".* Libri është përmbledhje e artikujve, vështrimeve dhe opinioneve të cilat autori i ka botuar viteve të fundit në mediat shqipe të shkruara dhe online.

Lënda e prezantuar trajtohet nga dimensioni shoqëror, politik dhe fetar. Në këtë perceptim janë edhe artikujt e prezantuar me qasje jo vetëm sociologjike por edhe intelektuale. Në saje të temave të prezantuara, autori iu ka mundësuar lexuesve meditimin e tyre personal nga gama e gjere e temave të trajtuara, të cilat janë preokupuese jo vetëm në momentin aktual për të gjithë ne. Si i tillë ky botim ofron mundësi të një debati me lexuesit, dukuri e cila mungon në shoqërinë tonë pluraliste. Vetëm me qasje të tillë e pa paragjykime mund të tejkalohen deformimet shoqërore të cilat janë të pranishme në çdo pore të shoqërisë, me pasoja për të tashmen dhe të ardhmen.

Pikërisht nga ky aspekt duhet përgëzuar autorin sepse ai nuk është statik në analizën e dukurive të ndryshme shoqërore, por, përkundrazi, është kritik me qëllim që çështjet përkatëse të avancohen dhe të jenë të pranueshme për shtresat e gjera. Ai nuk vuan nga paragjykimet dhe qasjet lokaliste, përkundrazi çështjet i trajton edhe në dimensionin mbarëkombëtar. Po ashtu ai është kundër politizimit të dukurive të ndryshme, me një qëndrim intelektual duke i prezantuar çështjet ashtu siç janë dhe me vizionin për ndryshime cilësore.

Vetëm qasja intelektuale eliminon konformizmin dhe servilizmin, dukuri këto të njohura për shoqëritë në tranzicion, të cilat nuk janë të panjohura edhe në hapësirën shqiptare. Andaj vetëm intelektualët me kuptimin e plotë të fjalës, dhe indvidët e guximshëm, pa hipoteka nga e kaluara mund të kritikojnë deformimet shoqërore, duke ofruar ide për zgjidhje të çështjeve kontestuese. Në këtë dimension duhet lexuar dhe analizuar këtë botim, i cili paraqet një kontribut me vlerë në publicistikën në gjuhën shqipe.

Adriana HOXHA

PAZARI I GJYTETIT

"Kurrë mos u mundo
me pyetjen: si të mbijetosh
por si të mos vdesësh
pas të gjitha vdekjeve."[4]

Thonë se njeriu pa njohuri rreth së kaluarës, origjinës dhe kulturës së vet është njëlloj si pema pa rrënjë. Poashtu, thonë se kultura e një kombi fle në zemrat dhe në shpirtin e popullit të tij[5](Gandhi). Kështu, i pasionuar pas lashtësisë, jetës, ndodhive e bukurive të Ulqinit, dr. Gani Karamanaga parreshtur shkruan e shkruan, me qëllim që e shkuara jonë të mos tretet pa lënë gjurmë. Kur fillimisht u takova me shkrimet e dr. Karamanagës, pata ndjesinë se po flisja me të kaluarën. Kuptova që nëpër fletat e librit të tij nuk është Ulqini në të cilin bie e gdhihem çdo ditë. Sot shumë gjëra janë ndryshe.
Ganiu në librin më të fundit "Pazari i Gjytetit" përqëndrohet në kala, ku me shumë hollësi tregon dimensione muresh, shtëpish, flet për pamjen e dikurshme të Ulqinit që ai shumë mirë e kujton. Ndonjëherë duket e pamundur që pas kaq shumë vitesh njeriu të kujtojë aq shumë detaje dhe në shikim të parë të krijohet përshtypja sikur të dhënat që tani na shpalosen, autori mund t'i ketë pasur të shenuara diku në ndonjë ditar. Ai flet me përpikmëri. Është i shkurtër në përpilimin e mendimeve dhe gjërat i thotë prerazi. Gjuha që ai përdor anon më shumë nga e folmja e qytetit, ndoshta me qëllimin që çdo pamje e çdo histori të gërshetohet edhe me gjuhën e folur, e cila i sjell edhe autenticitet veprës.
Nëse ndalemi pak për të krahasuar librat e dr. Karamanagës, do të shohim që stili i tij shkon duke u përmirësuar. Mirëpo, shkrimet e tij nuk kanë shumë nota artistiko-letrare. Ai qëndron përherë tek thjeshtësia, duke mos komplikuar shumë gjuhën shprehëse. Ruan shprehje popullore, njësi frazeologjike, fjalë arkaike e të huazuara, etj. Copëzat e rrëfimeve të "Pazarit të Gjytetit" janë të tubuara në disa grupe të ndryshme si p.sh. Pazari i gjytetit, Kujtime, Kohëra të vështira, Mërgimi, Ulqini dhe Shkodra dhe e përfundon librin me Anekdota, Folklor dhe

4 Miroslav Mika Antić - Besmrtna pesma
5 Mahatma, Vol. V, (1952), f. 12

Lirikë. Pra, siç mund të vërehet, fillohet me tema e trajtime më serioze dhe përfundohet me të qeshura e me lotë.
Në librat e dr. Ganiut ndeshim një shumësi personazhesh, të cilët shtegtojnë nga një vepër në tjetrën. Ai më së shumti flet për familjarët e vet, të pranishëm në secilën vepër, pastaj kalon tek kushërinjtë, miqtë e shokët, kolegët, përfshinë pastaj edhe persona të tjerë të njohur, të cilët i ka takuar apo për të cilët ka dëgjuar nga të tjerët, por që sipas gjykimit të autorit, kanë rëndësi dhe bartin një vlerë, ndaj edhe meritojnë të përfshihen në vepër. Shtojmë se personazhët e Ganiut janë herë persona tashmë të ndjerë, e herë individë që akoma jetojnë. Thënë më shkoqur, Dr. Karamanaga shkruan për secilin dhe njerëzit tashmë e kanë kuptuar këtë. Mbase ka të tillë që marrin librin në duar plot kurreshtje duke pritur se mos do të gjejnë në libër ndonjë rrëfenjë për familjarët a veten e tyre.
Pse autori parreshtur këmbëngul dhe na flet për njerëz të thjeshtë?
Ne shpesh gjatë jetës përhumbemi duke i kushtuar rëndësi të tjerëve më shumë sesa vetes dhe harrojmë se jeta jonë ka poaq vlerë. Harrojmë që në rrethin tonë shoqëror, në gjirin familjar, madje edhe diku në një cep të botës, faniten e lulëzojnë histori jetësh drithëruese, të suksesshme, të bukura e të trishta. Mirëpo, secili është një pikë dritë, një pikë ndriçimi, një dije, secili e ka një vend, një mision, një arsye për të rendur në këtë botë. Secili ka vlerë! Ndaj, njerëzit e thjeshtë nuk janë më pak të rëndësishëm sesa ata që gjatë jetës së tyre u bënë të njohur, patën poste të mira, apo bënë ndonjë çudi tjetër.
Njeriu, ashtu si edhe çdo send tjetër, ka një kohëzgjatje. Kështu ngadalë ndërrohen gjeneratat duke humbur gjurmë sikur asnjëherë të mos kenë ekzistuar. Mirëpo, cfarë është ajo që quajmë harresë a vdekje dhe ku kështu u tretka njeriu?
Kur lexoj veprat e Karamanagës, kujtoj idenë e Danillo Kishit në veprën e tij "Enciklopedia e të vdekurve", kur tenton të përmirësojë të padrejtën njerëzore dhe të gjithë krijesave të Zotit t'i japë vend të barabartë në përjetësi[6]. Ndoshta me këtë ide udhëhiqet edhe autori ynë, ndoshta ai tenton t'i tregojë secilit se jeta e tij nuk ishte e kotë, se akoma ka njerëz që mbajnë shenim dhe vlerësojnë secilën jetë njeriu, secilën vuajtje[7], sepse "kurrë asgjë nuk përsëritet në historinë e qenies njerëzore, çdo gjë që në shikim të parë duket si njësoj, mezi është e ngjashme; çdo njeri është yll për vete, çdo gjë ndodh gjithmonë dhe kurrë, çdo gjë përsëritet

6 Danilo Kiš, „Enciklopedija mrtvih", Narodna Knjiga, Podgorica, 2010, f. 41
7 Po aty, f. 60

pafund dhe papërsëritshëm.”[8]
Të duash dikë nuk do të thotë vetëm të ushqesh shpirtin me dashuri të madhe. Të duash vërtetë dikë do të thotë të sakrifikosh, të bësh diçka për gjënë tënde të dashur. Ndaj ne mund të rrahim gjoksin sa të duam dhe të ulërasim se e duam Ulqinin, por çeshtja është më e komplikuar se kaq. Çfarë kemi bërë ne për dashurinë tonë, Ulqinin?
Këtë dilemë dr. Karamanaga e ka zgjidhur. Ai Ulqinit është duke i dhuruar tërë kohën e mundshme, duke dhënë kontribut në ruajtjen e çdo gjëje autoktone ulqinake, nisur me ruajtjen e traditës, kulturës, zakoneve të vjetra, pasqyrimin e mënyrës së jetesës, ruajtjen e të folmes stërgjyshërore...
Ndaj, ju lexues të vendosur që të shfletoni këtë libër, do gjeni në këta rreshta jetë, përjetime, histori dhe mos u çudisni kur në po këta rreshta të gjeni edhe veten tuaj.

8 Po aty, f. 47

prof. dr. Hulusi HAKO (Tiranë)

REVISTA ULQINAKE, DIJA – ENCIKLOPEDI, SUI GENERIS, E BOTËS SHQIPTARE

. –

Konsiderata, mbresa, refleksione -

Revista **DIJA** –Shkencë, Kulturë, Art, 16/ 2017, botim i përvitshëm i **Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë** në Ulqin, dalja në dritë e të cilës përkoi dhe me 15 vjetorin e themelimit të atij Bashkimi (nëntor, 2002), erdhi me një informacion dhe zgjerim të pamatë dijesh, të entuziasmon së tepërmi, të lë dhe mbresa të pashlyeshme. Duke mbajtur shënime të dobishme, lexuesi kujton edhe atë porosinë e hershme, që vinte nga lart për të lexuar "me laps në dorë". Mesa duket, kjo qënka një metodë e frytshme, sidomos për të pozicionuarit si hulumtues e krijues. Po, për më tepër, ajo të grish edhe për të shkruar, prandaj po i shpalos disa shënime, me dorë në zemër, me dashuri vëllazërore dhe solidaritet të plotë.

Me çfarë t'a ushqen mendjen, në ç'drejtime e vë atë në lëvizje, numri i fundit?

1.Dija ka vend-lindje Ulqinin e lashtë e të bukur, i denjë për historinë e vet dhe kalanë kreshnike; në atë "të vlueshmin, të dehurin e të ëmblin, për bri detit të njelmët e magjepsës", me aq shumë ngjarjesh e fantazi legjendash. Ai, me histori detarie të theksuar e të bujshme, i banuar edhe prej kolonësh helenë, romakë, dalmatë, po ashtu dhe me ndërthurje kulturash përkatëse, rezistencë të denjë të pashembullt dhe vitalitet rrezatues. Ku ka histori, traditë.kulturë e atdhetari, aty edhe spiralja e tradtave dhe zhvillimeve kulturore, vjen duke u intensifikuar e duke u nritur. Ulqini, pse i ka këto zhvillime, kërkon edhe më shumë t'i thellojë dhe zgjerojë, njëllloj si disponusi i një kapitali, që synon t'a investojë, për t'a shtuar.. Kësaj veprimtarie të vyer të bashkëkombasve ulqinakë, gjegjesisht, Bashkimit të krijuesve, kësaj daljeje me vizion e horizonte, iluministe shumë-dimensionale, me vlera shkencore, me mision e përkushtim, mund t'i përshtatej, edhe aforizmi "nga ferra e vogël, del lepuri madh". Po deduksioni më substancial, është se kudo që liria, të drejtat, jetesa, natyrshmëria, ndrydhen e pengohen, atje edhe vullkanet bëhen më intensiveë e shpërthyes. Fjalët e vargjet në Ulqin bëhen më bombë e flamur, "netët poetike" atje tingëllojnë më melodioze, sepse nëpërmjet korpusit të poezive e legjendave, kalon edhe dashuria për detin, historinë e kalanë, për betejat e çështjen kombëtatare. Gjeografikisht ai gjendet ne periferi, por jo dhe për potencialin,

gjallërinë krijuese e kohezionin mbarëkulturor që rrezaton dhe vizionet gjithpërfshirëse.
Krenohemi shqiptarisht me Ulqinin; është legjitime të ndjehet edhe ai krenar me kontributet e konsiderueshme, të tilla, që përcjellin potencial, përkushtim e pathos atdhetar mbarëshqiptar. Ai jep dhe mesazhin se një qeveri apo shoqatë, që nuk përqëndrohet në çështjet dhe problemet më të përgjithshme, shoqërisht të përbashkëta e të dobishme, ajo lë shumë për të dëshiruar. Përballë Tiranës zyrtare, përshembull, e cila edhe në shekullin tone, të 21, tregohet entuziaste që po ngre midis qytetit xhami me katër minare, ku varrosen me milona dollarë, në vend që ta kthejë timonin në zhvillimin ekonomik, arsim e shëndetësi; që e ka mendjen të financojë me disa miliona edhe kryesitë e një tufe komunitetesh fetare, gjithnjë në kurriz të taksapaguesve (edhe pse shumë prej tyre nuk besojnë), dhe jo të mbështeste ndonjë Lidhje Shkrimtarësh e Artistësh (madje, ka sjellë vërdallë edhe Akademinë e Shkencave), revista ulqinake, qëndron shumë lart, rezulton të jetë shumë më tepër se një eveniment kulturor-artistik. Në botën shqiptare nuk dimë të ketë një organ tjetër të këtyre përmasave, - panshqiptare, ballkanike e botërore. Kjo e bën atë unikale. Çdo shqiptar, kudo nëpër planet thotë: "**Dija** është imja, është shkruar për mua".
2.Vula e Ulqinit, dashuria për të, janë rrënjët, po dhe starti i **Revistës** për të kaluar në dashuri të tjera më të mëdha, duke u bërë shumëdimensionale. Ajo të kuadron në botën e gjerë kombëtare, rajonale e botërore. Ajo të mban dhe në një dinamikë magnetike, të këndshme, kërshërore, nga e cila vetëm ndonjë force madhore mund të të shkëpusë. Vërtetë, mbështetja financiare nga Komuna e Ulqinit dhe entet e tjera, është vendimtare e domethënëse, po, para së gjithash, mbetet vetë puna përgatitore e Redaksisë, angazhimi i përzgjedhjes së materialeve, përkthimet dhe kompozimi tërësor, mund e lodhje kolosale, po se po, por një vepre të tillë i hyjnë, veçse misionarë të përkushtuar, me atdhetarizëm të kulluar. Nëse bleta punëtore eksploron një hapësirë të kufizuar, për prodhimin e saj, aq të vyer e të shumë-dëshiruar. hartuesve të **Dijes** u duhet "të shtegëtojnë" nëpër trojet amtare e Ballkan, nëpër Europë e në mbarë botën. Mbledhja e materialeve kërkon dije, kohë, lodhje e sakrifica, mjete materiale-financiare; investime, por që justifikohen plotësisht me prodhimin e një fruti kaq konstruktiv e të shëndetshëm. Përpjekjet për të, mund t'i përfytyrojmë edhe si "dhimbjet" e lindjes, të cilat nënat i minimizojnë, të ndërgjegjshme se i japin jetë një njeriu, (për mos të thenë se në lindjen e pare, ato arrijnë të

përjetojnë dhe euforinë e "shpikëses" së tij!) Revista të mban, të bën edhe për vete, se është heterogjene në tematikën cilësore e stile, me larmi e thyerje, pa njëtrajtshmëri monotone, me dallgëzimet nga poezia në prozë, mandej në skica; nga krijimet agolliane, në poezi të tjera shqipe, të Ballkanit ato botërore; në prozë vendase, malazeze e botërore; në rubrikat "Libri", "Historike", "Gjeografi", "Sociale", "Traditë", "Arkitekturë", "Portret" etj, Gjen në të ç'dëshiron, apo ç'të intereson. Ndaj dhe titulli i shkrimit, nuk është adekuat me përmbajtjen tërësore të veprës, shpreh aspektin kryesor, se edhe **Spinoza** është shprehur: çdo përkufizim, është dhe një kufizim.

3.Shqiptarinë, si ide kombëtare dhe ndjenjë e fuqishme, tanimë, e kemi të pranishme e të rrënjosur. Kuptimplote është se këtu e çon fort ujin edhe **Dija**, me shpalosjen, nëpër faqet e saj, të krijimtarisë e problematikës së përmasave mbarëkombëtare. Tregues tipik është nisja e këtij numri me shpirtin agollian, in memoriam, që dëshmon se ky shpirt është rrënjosur e shpërndarë në çdo qelizë të kombit shqiptar, dhe dhimbja e vdekjes së **Agollit** tonë, u ndje e u përjetua si humbje mbarëkombëtare. Me të veçantën time, si bashkëkohës e bashkënxënës në gjimnazin 'Asim Zeneli" të Gjirokastrës, si në një familje të madhe, që hanim në një çanak e flenim në një konvikt, përjetoj emocione dhe krenari të pa matë, kur vërej që ish shoku i klasës, ka pushtuar zemrat mbarëkombëtarisht dhe është bërë, të paktën, një qelizë e identitetit tonë shqiptar. Me poezi të ndjera, të dhimbjes, optimizmit e krenarisë, i këndojnë vdekjes së tij, ashtu siç e dha shembullin që desh t'a konte edhe vetë atë. Trokun e mendimit, n'dallgë vitesh, e bëre zap; që t'mos vërshojë turbullt në vrullet hapërdare; që n'kthjelltësinë e qiellit, dielli të rrezojë prapë; të përndritë virtytin e t'gremisen veset hileqare". "Lajmi i hidhur mori dhenë, Kombi ra në zi; u dridh toka, uji u turbullua, Ylli i jetës u shua". I cilësuar "sundues si mbret i mirësisë, shpresë e vegjëlisë", autor i poezive me "Gërmat e fjalët të qëndisura me fije ari; asaj "penë mes gjishtave të rreshkura, që ja kalon edhe jataganit të Skënerbeut"; të ndarit prej të gjithëve, secili nga ne i thotë : "Të kam në shtëpi, këtu do të jesh" etj; këto janë shprehje fijesh të integrimit shpirtëror mbarëkombëtar. Nëse Poeti e bëri të vetën për Kombin denjësisht, në Revistën **Dija**, flet kështu zëri i Kombit, që evokon madhështinë dhe vlerat e birit të vet. Jetën dhe historinë e mbajnë dhe e bëjnë popujt, po nga gjiri i tyre dalin pak individë, që hedhin dritë, tregojnë rrugët, mjetet e mënyrën e zgjidhjes së problemeve e nyjeve gordiane, që u thur historia dhe jeta. Konsideratat e shprehura prej skajit

ulqinak të trojeve amtare, dëshmojnë se shpirti mbarëkombëtar shqiptar, jeton dhe vepron thellësisht e gjerësisht. Me tematikën e objektet e studimit, Revista është shtrirë lehtësisht në hapësirat mbarëkombëtare, shtjellon çështjen tonë jetike, madhore, duke u bërë, kështu, një model i misionit integrues mbarëshqiptar, në shërbim të aspiratave të një kombi, kaq rendë të persekutuar nga historia, deri në atë fare feje, me mënyra e mjete barbare, që përbëjnë një rast pa precedent në këtë planet. Për fatet e Atdheut e të kombit tonë nëpër shekuj, faktori i jashtëm, ka luajtur, shpesh, një rol të madh, deri dhe vendimtar; ka venitur e mposhtur edhe forcat e veprimet brendshme, të natyrshme. Patriarkalizmi i fuqive të mëdha, është evident edhe në kohën tone të demokracisë moderne. Po kohët janë që sovrani popull të ketë dhe timonin e fateve të veta. Kjo është rrjedha dhe logjika objektive e jetës. Ç'problem ka jeta, e zgjidh mendja, ç'është në mendje bëhet realitet. Del krejt sipas Hegelit, se "çdo gje racionale, bëhet reale në dinamizmin e saj". Në mullirin e kësaj natyrshhmerie e racionaliteti e çon ujin edhe Revista Dija.

4.Proceset globalizuese e integruese, bashkë me frymën pannjerëzore të shkencës, kulturës e artit, vërtetë janë evidente e vepruese, po brenda kësaj prirjeje të madhe, planetare, qëndron çështja e pazgjidhur e integrimit tonë shqiptar, e kombit, e asaj nyjeje gordiane të krijuar artificialisht, kur faktorët e jashtëm, gjeopolitikat imperialiste-agresive (osmanët, fuqitë europiane, shtetet ballkanike), i bënë shqiptarët viktimën kryesore. Ata i favorizuan tendencat shoviniste dhe na imponuan, të jemi, në stadin e sotëm, të copëzuar e hallakatur në 6 shtete, dy shqiptare, me katër pjesë hapësirash etnike të konsiderueshme nën juridiksion të fqinjëve, ku s'ka rreshtur fushata e egër e asimilimit, e dëbimit dhe emigacionit të detyruar. Në tërë këto gjymtime historike të trungut shqiptar, u përfshi edhe Ulqini ynë, me atë histori të lashtë e të trazuar. Çdo kulturë e art, që në embrion, ka shpirtin kombëtar, vetë pasuria krijuese, siç bëhet, ashtu mbetet atribut i qenësishëm identiteti; po kështu, nëpërmjet shtrirjes sa më masive, ato veprojnë edhe si përftuese, konstituese të këtij identiteti. Sikurse Rilindja jonë kombëtare, pa lënë pas dore rolin e pushkës, përparësi i dha Diturisë, përvetësimit të gjuhës amtare, çeljes së shkollës, botimit të librit shqip, insistoi deri dhe në zgjedhjen e llojit të alfabetit, të cilat u bënë mjetet dhe mënyra e vetme e gatimit dhe gjallërimit të identitetit kombëtar; ashtu edhe sot intensifikimi i integrimit të kulturës sonë, i shërben gatimit të kulturës së integrimit, ndërgjegjësimit sa më të gjerë masiv, se një popull, me një gjuhë e histori, me një kulturë e traditë, me një konstitucion etno-

shpirtëror, përbën një familje të madhe, të cilës, natyrshëm, i përket dhe qenia e organizuar në një shtet, bazuar jo thjesht etikisht, por bash juridikisht, në të drejtën e popujve dhe kombeve për vetëvendosje. I duhet shtet-kombi, ajo mënyrë jetese e organizimi, që u krijua kahershëm dhe është bërë realitet i fuqishëm i krejt botës, njësi bazë e faktor progesi. Familja është qeliza e shtet-kombit, kombi është indi i organizmit botëror. Ndërsa u shpërbë sistemi botëror kolonial, i krijuar egërsisht, nëpërmjet pushtimeve ushtarake, grabitjeve e tregëtisë së skllevërve, natyrës dhe praktikës së krijimit të po atij sistemi, i përket edhe coptimi i trojeve tona shqiptare, prandaj, revokimi i kësaj gjendjeje, nuk është luks e pretendim, por imperativ historik, e drejtë demokratike, njerëzore. Kënga shqiptare merret edhe me "liri pindarike", po më fuqishëm buçet për të drejtën kombëtare e humane: "Moj Europë, moj mizore, kthena borzhin që na more". Sot që synojmë në Bashkimin Europian të kombeve, Evropa duhet të ndjehet me ndërgjegje thellësisht të vrarë, si autore e çintegrimit mizor të kombit shqiptar në periudhat imperialiste të politikave të saj. Ballkani ynë, posaçërisht perëndimori, me paqëndrueshmërinë karakteristike dhe konfliktualitetin ciklik, brendashtetëror e ndërshtetëror, po bën përpjekje të sforcuara të zbusë prapambetjen nga Europa në çështje të sigurisë e stabilitetit, zhvillimeve ekonomiko-shoqërore dhe lëvizjes së lirë të njerëzve, kulturave, kapitaleve e mallrave.

Jemi pjesë e këtij gadishulli, të cilit poetja **Katjusha Pogaçi** (Tiranë), më 2001 i ka thurur vargjet: Ballkan me kaq male, Ballkan me kaq halle, Pyje e lumenj, popui e kufij, gjuhë e liqenj, zjarr dhe shkëndi, nëntola flet, mbitoka gjëmon, njëra rizgjohet, e tjetra përgjon. S'je veç gjeografi, je dhe ti një botë, ku bien lahuta, e përplasen dallgë, brigjeve tragjikë. … Retë kreshpërohen, erërat ngatërrohen, e gjuhët këlthasin; kurse thellë në shpirt, ti me shpresën luan. Shpresa jote e madhe, bukuri e hajthme …

5. Kauza e aspirata jetike, ndihet e fuqishme e me aktualitet edhe në faqet e cilitdo numuri të **Dijes**, sepse gatimi i saj bëhet në trevat, ku, tradita e lavdishme, e luftrave të përgjakshme të rezistencës shqiptare, vazhdon të spikat qartë edhe sot, kuptohet me mjete demokratike-paqësore. Ne s'jane me koherat e heroizmave, kur kendohej: E japim jeten per atdhe, te barabarte sikur me le, kembengulja per te drejtat mbetet aktuale. Ja dhe një arsye më shumë që Revista i mshon kësaj teme. Kështu, përshembull, edhe pse me subjekt arkitekturor, për Ublën (pus, sternë) e Krajës, autori, nuk kalon pa evokuar edhe ndërgjegjen kombëtare për kuazën e madhe të çështjes shqiptare të pazgjidhur, kur

thekson se: “Kraja është treve shqipare e Malësisë së Mbishkodrës, (nga e cila është ndarë padrejtësisht, një pjesë nga Kongresi i Berlinit -1878-, tjetra nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër -1913), dhe, aktualisht gjendet nën juridiksionin malazez. …Ubla e saj ngërthen rrebeshet e historisë…është dëshmitare e luftrave të përgjakshme në kohë të nryshme,, e ndryshimit të kufive, më afër apo më larg saj, e kushteve të vështira të jetesës, shpërnguljeve të pandalshme, deri dhe mjerimeve ekonomike, politike, shoqërore e kulturore të kohëve të fundit” (f. 215). Me gjithë rezistencën e gjatë, gjendja e shqiptarëve në Mal të Zi nuk ka arritur në parametrat optimale, megjithëse republika e vogël ballkanase, është edhe vetë e interesuar për normalitet të plotë, deri në shembullor. Megjithse bashkëpunimi ndërshetëror, në kohët tona, vërtetë ka sjellë një atmosferë të favorshme në fushën arsimore-kulturore, por pezmatohemi, kur mësojmë se, ato ç’ka garanton ligji, përkatësishht, “lendët mbi vetëdijen, përkatësinë, kulturën, historinë dhe traditën e tyre kombëtare, nuk ua mundësojnë programet dhe tekstet ekzistuese” (f.). Para këtij konstatimi për një çështje madhore, nuk habitemi me faktin e mosfunksionimit të bashkëpunimit shqiptaro-malazez për studimin hidrologjik të sistemit Buna-Drini-Liqeni i Shkodrës. Edhe apeli për krijimin e një Muzeu Detar në Ulqin (gjë më se e denjë për këtë qytet bregdetar me tradita të konsiderueshme, shumë i bukur e domethënës), mund të gjej jehonë deri në organet lokale. Podgorica nuk mund të tregohet aq altruiste, sa të ringjallë e të materializojë një traditë të mirëfilltë shqiptare. Ndërsa gjetje të shumta arkeologjike, dëshmojnë për autoktoninë e hershme dhe shtrirjen e gjerë ilire në Ballkan, sllavomania nuk mund të durojë të bëhen dëshmitare edhe objektet nënujore e dukuritë detare. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për restaurimin e mirëmbajtjen e ublave (puse, sterna) të Krajës, të Beledeje-Medresesë, të shtëpisë së Pashës në Ulqin etj, që janë në para-shkatërim. Me një fjalë, vëzhgimi dhe studimi i procesit dialektik të zhvillimit të shqiptarëve në trojet amtare, trajtimi me kompetencë shkencore i një sere çështjes madore të hisrtorisë kombëtaare, në kuadrin e kushtet edhe të gjendjes ndërkombëtare, janë guri i rendë i mendimit shkencor shqiptar, përfshi dhe **Dija**-n. Përvoja e historise ka provuar se popujt “Për të arritur të mundshmen, gjithmonë duhet të bëjnë përpjekje, deri për të pamundurën” (Hermann Hesse). Statuseve dhe fateve të vendeve e popujve të vegjël, të këqijat dhe shkatërimet u janë bërë lehtë e të menjëhershme, veprat e punët e mira kalojnë në një proces më të vështërë e të ngadaltë. E pushton relativisht lehtë e shpejt një vend të

tillë, po sa mund, sakrifica e kohë kërkohet për zbrapsjen e të keqes! Aq më tepër krijimi i komb-shtetit, edhe pse një gjë e tillë, është krejt në linjën e proceseve të natyrshme, të përbotshme.

6. Për trashëgiminë tone në trojet nën juridiksione të huaja, s'kemi kujt t'i drejtohemi me sugjerime, përveçse të bëjmë vetë maksimumin e mundshëm. Parë problemin edhe me gjerë, restaurimi e mbrojtja e trashëgimisë historike-kulturore, ka vlerën dhe rendësinë për konfirmimin e identitetit tonë. Por edhe kjo, për këtë rast, mbetet mjet ndaj qëllimeve më madhore kombëtare. Përkundrejt tendencave sllave, që përdorin edhe ndërimin apo zaptimin e faltoreve, si mënyre dhe mjet ekspansionist, ne shqiptarët, synojmë autoktoninë e natyrshme, jo thjesht dhe vetëm për të ruajtur status cuonë, por për të hedhur hapa drejt shtetit kombëtar, për të garantuar atë siguri kombëtare që na takon. Kombet që rrethojnë shqiptarët, që i kanë, një pjesë, edhe nën juriksionin e tyre shtetëror-politik, kanë mbetur egoist mbi normat dhe parametrat normale, një delir që po nuk u frenua, kthehet në kronike. Grekët dhe sllavët e kanë të qartë, si buka që hanë, se Fuqitë e Mëdha, në Ballkan kanë bërë peova me gjeopolitikat e tyre dhe se janë zgjeruar në kurriz të kombit shqiptar, duke kryer genocidin më të egër ndaj tij. E çuditshme deri në absurditet kjo mendja politike sllavo-greke: tekstualisht çi njeh e pohon vetes, (deri dhe pretendimet absude), me mendje-lehtësi ua mohon popujve e kombeve të tjera, edhe kur kërkesat janë të drejta të natyrshme! Nëse do të shtronim pyetjen ku e sa çalon kjo demokracia moderne, na del fryrja e egoizmit nacional deri në pretendime shoviniste. Shqiptarët, përkundrazi, mbeten të vetëdijshëm e krenarë për historinë e vet, konservojnë identitetin dhe synojnë aspiratën shekullore të bashkimit kombëtar, të gatuar me vendosmëri për mbrojtjen e dinjitetit e prosperitetit kombëtar, për mirëqenie e paqe. Pa hyrë në detaje, një shtet shqiptar në krejt trojet etnike, bëhej garanci i sigurisë sonë kombëtare, po ashtu dhe faktor stabiliteti në Ballkan. Nuk duhet ndonjë filozofi e madhe për të menduar se midis shteteve të ekuilibruara, zbrapsen epshet shoviniste dhe synohet drejt lidhjeve e marredhënieve konstruktive. Kjo është një nga tendencat kryesore e zhvillimeve botërore, ndërsa gadishulli ynë ballkanik i ka ende në aktivitet vullkanet keqbërëse, sepse makro dhe mikro gjeopolitikat janë përdorur e ndërthurur në mënyrë krejt të padrejtë, kanë viktimizuar, në radhë të parë e kryesisht, kombin shqiptar, prandaj, në vazhdimësi, ai nuk po gjen karar. Prej kohësh e në vazhdimësi po theksohet se pa zgjidhjen e drejtë të nyjes gordiane, që përbën çështja shqiptare, Ballkani nuk do të

ketë stabilitet e normalitet. Kjo ide s'i ndahet historisë ballkanike për rreth një shekull e gjysëm, nga **Abdyl Frashëri** tek akademiku ynë **Rexhep Qosja,** më argumentuesi i kauzës sonë kombëtare, si në veprën e kahershme "Çështja shqiptare-historia dhe politika", në të mëvonshmen "Shqipëria dhe Kosova-si janë dhe si do të duhej të jenë", në shumë artikuj, intervista etj. Ai është edhe më këmbngulësi, me të drejtë thekson se "ende nuk janë arritur vlerat e ëndërruara politike, shoqërore dhe kombëtare të rilindësve të mëdhenj … Rëndësia më e madhe e bashkimit (Shqipëri-Kosovë), është shtimi, rritja. pasurimi; sigurimi i mundësive ekonomike, arsimore, shëndetësore, shkencore, kulturore dhe qytetëruese të popullit shqiptar për jetë më të mire, për mirëqenie të përgjithshme, bashkëkohore, qytetëruese të të gjithë shqiptarëve. Krahas pranisë së idesë kombëtare, për ç'shpaloset nëpër faqet e revistës **Dija** në këtë pikë, është çnjerëzore, rrënqethëse, indinjuese. Në kohë të vështira, shqiptarëve u është forcuar trimëria, më e thellë ka shpërthyer edhe mënçuria. Këtu duhen fokusuar edhe përpjekjet politiko-diplomatike të dy shteteve shqiptare, të subjekteve politike dhe bashkësive shqiptare nëpër trojet etnike. Kësaj problematike i duhet lënë gjithnjë hapësirë. "Ç'hap të ri hodhëm në drejtim të bashkimit kombëtar?"- kjo pyetje i qëndron si sfinks çdo organizmi politik e shoqëror të trevave shqiptare. Pohimet e pushtetarëve tanë të sotëm, sikur kauza e "çështjes shqiptare", do të gjejë zgjidhje me integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian, janë ëndrra me sy hapur.

7. Krahas studimeve e reflektimeve të historisë kombëtare, të lëvizjeve patriotike, Revista ndjek, në mënyrë kritike edhe zhvillimet e sotme ballkanike e botërore. Me mjetet e fuqishme dhe shkallën e komunikimit, bota është afruar e zvogëluar së tepërmi; i ngjan një fshati të madh; Qartë dhe me shpejtësi të rrufeshme merret vesh edhe ngjarja më e rëndomtë në cilindo e nga çdo skaj i saj. Nëse mungesa e komunikimeve, ka çuar në largimin e të afërmëve, komunikim intensiv, çon në afrimin edhe të të largëve. Qasja e tillë kompozicionale e **Dijes**, është tipar i vyer dhe shumë domethënës. Shkenca, kultura, arti (mund të shtonim dhe sportin), vërtetë kanë shpirt dhe karakter të thellë kombëtar, por janë produkte mbarënjerëzore. Duke patur atdhe, zbulimet shkencore, veprat kulturore-atistike, aktivitetet sportive, po lidhen, pleksen e ndërvaren edhe si elemente të një mozaiku botëror, që e pasurojnë atë, e zbukurojnë shumëngjyrshëm; gjithnjë e më shumë po bëhen hallka, nyje, ura lidhjeje e komunikimi midis popujve e kombeve.

Në stadin e sotëm, "asnjë kulturë nuk mund të mjaftohet vetëm me traditën e vet". Përmes ballafaqimit me tjetrin, njeh më mirë edhe veten; ndaj dhe përkthimet, mjaft të nevoshme për qytetërimin, janë bërë nevojë organike e gjithëkundshme. Çdo lloj takimesh midis qytetërimeve, evidentohet dukshëm në zones e Mesdheut, po ndërthurja dhe gërshetimi i tyre, ka vepruar, në një proces gjithnjë e më intensiv, kudo, mids vendeve, rajon pas rajoni, deri në lidhjet ndërkontinentalee të mbarë planetit. Kuptohet, edhe me veprat e mendimit e kulturën botërore, është krijuar një piramidë, në majën e së cilës janë krijimet me përmasa të përbotshme e të gjithkohëshme, e atyre, që edhe pas ndarjes nga jeta, mbeten gjithnjë midis nesh e për gjeneratat. Kjo Revistë e kryen më së miri këtë mision mbarënjerëzor. Del. përshembull, mbi raportet e mbrapshta historike dhe gjithçka që s'pushon së kudisuri guzhina politike e Beogradit, në raportet shqiptaro-serbe dhe poetin e këtij kombi ballkanas, e përfshin në faqet e saj për vlerat dhe mesazhet mbarënjerëzore. Edhe ky është një akt i vyer e zbukurues i imazhit shqiptar, tërë fisnikëri e racionalitet, në funksion të proceseve integruese. Thënë më gjerë, revista, me misionin vizionar, gjithëpërfshirës, funksional, konfirmon kohezionin mbarëkombëtar e i shërbën konsolidimit të tij; shuan etjen e shqiptarëve për dije, kulture e art; sendërton dhe lidhjen shumëplanëshe të kombit me botën mbarë. Nëse mungesa e komunikimeve, ka bërë të largohen të afërmit, ky komunikim intensiv, çon në afrimin edhe të të largëve. Me mjetet e fuqishme dhe intensifikimin e komunikimit të lidhjeve e marredënieve, bota është afruar e zvogëluar së tepërmi; i ngjan një fshati të madh, ku qartë dhe me shpejtësi të rrufeshme merret vesh edhe ngjarja më e rëndomtë, nga një cep në cilindo skaj të saj.

8. Historinë e vet çdo popull e ka të shtrenjtë e si memorje të jetës, si pasqyrë të ekzistencës. të bëmave dhe përcaktues identitar. Po si mund të shkruhet ajo me realizëm e objektivitet, kjo nuk e ka gjetur kriteret e zgjidhjen metodologjike të plotë e të sigurtë. Edhe në këtë drejtim revista **Dija** i ka bërë përçapjet e veta. Janë bazë dokumentet, apo edhe ato duhen parë me rezerva? "Edhe të dhënat e informacionet dokumentare, janë version zyrtar i kohës, i mbrujtur, thellësisht me anshmëri të theksuara interesash, bindjesh, kënd-vështrimesh". Rrjedha e jetës i ka çuar, shpesh shqiptarët në dilemën "të jenë, apo të mos jenë!" Jemi aktorë dhe autorë të historisë sonë, apo atë e kanë vërtitur forca e faktorë madhorë të jashtëm? Faktorët e jashtëm gjeopolitikë, mbeten vendimtarë, apo janë episoditë, koniukturale e kalimtarë? Nga anarkia

në rend, nga rendi në anarki! Pse është shfaqur disa here edhe kërcënimi serioz për fshirjen e emrit Shqipëri nga harta e Ballkanit? Për fatin e keq kombëtar, në shumë raste, historia jonë ka qenë e kushtëzuar ngushtë prej vendimeve të Fuqive të mëdha. Kush ishin endësit e fateve të Shqipërisë? Po të mbijetonte si shtet, kujt të huaj do t'i vihet kurora e monarkut, se për Ahmet Zogun nuk kishte as hamendësime, megjithëse kish arritur deri në postin e ministrit të brendshëm! Vendi, i ndarë dhe në klane, i kryqëzimit të prapaskenave, intrigave dhe kundërintrigave tronditëse, vendore e ndërkombëtare, kishte dhe "plot vajza dhe djem të etur për përparësitë e edukimit dhe mundësitë që ofronte jeta moderne". Historia na tregon kush jemi, na dallon nga popuj e kombe të tjerë. Realizmi dhe objektiviteti i ndriçimit të skutave dhe labirintheve të jetës shoqërore, ka gjasa të jenë efikas në qasjet e studiuesve të huaj. Përfshirja e tyre në studimet e historisë e të jetës sonë, bën që të vërtetat të ndriçohen më drejt dhe më mirë. Ky është një zë tjetër që flet fuqishëm edhe në këtë numër të revistës, përsa i përket historisë, imazhit dhe karakterit shqiptar. Në të gjejmë autorë të huaj, të cilët, pa egoizëm apo ndonjë konflikt interesi, as me ndërgjegjen e vet, pa përfillur as opinionet zyrtare, japin gjykime objektive, përcaktime e konsiderata për të vërtetat tona historiko-etno-shoqërore.

9. Edhe në këtë aspekt të rubrikës e temës me interes, revista **Dija** është e pasur. Për debatet e polemikat e shumta, që janë bërë e bëhen për aspekte të historisë sonë, ajo sjell një studiues Italian, që na konfirmon si pasardhës të pellazgëve. Ai pohon se "ajo populsi, nga trysnia e dyndësve, që përpiqeshin të pushtonin gadishullin (keltët, shiitët, vizigotët, hunët, ostrogotët dhe sllavët), gjetën strehë në malet e Shqipërisë, duke e ruajtur të pastër etninë e tyre. … Në Itali janë të pranishëm mbi njëqindmijë arbëreshë. Arbëreshët mbijetuan deri tani, sepse kishin një ndjenjë të thellë komuniteti, …Pasurinë gjuhësore, e ruajnë prej pesëqind vjetësh; ajo nuk është vetëm një kod alfabetik, për përmban shtigje identiteti, të shprehjes së përkatësisë së një populli"…. Ata formojnë një urë thelbësore me kulturat e përmbytura të botës ballkanike: …Edhe pse jetonin ekzistencën e tyre kulturore historike, dhe shoqërore të dyfishtë, në fortunate e Rilindjes, arbëreshët nuk ishin thjesht dëshmitarë, por edhe protagonist të ngjarjeve historike, që përgatitën dhe ndërtuan Bashkimin e Italisë". Përmendet edhe një krijues malazez, që vëren, se "Prezenca e "tjetrit", me kombësi, fe e gjendje materiale ndryshe, ndërsa diku tjetër shfaqet e frikshme, e papranueshme, këtu është shembullore". Gjuhën shqipe e prezanton si

“shumë të pasur, me një bagazh historik e leksikor mjaft të fuqishëm, dhe e pranueshme në rregullat e drejtshkrimit të saj”.Të ngjall respekt autori i huaj, që me dorë në zemër, pohon: “Ekzistojnë paragjykime për shqiptarët. …Në bindjet e mia nuk ka vend për sulme ndaj etnosit, prejardhjes, fesë apo racës …Në shkrimet e mia, nëse jo me shumë, besoj të jenë një kontribut i vogël në heqjen e tyre. Na cilëson “grupi etnik më i vjetër, parahelen, në këtë gjeohapësirë, më së shpeshti i viktimizuar; …popull fatkeq, sakrificash të mëdha, i ndershëm në veprim, i qënrueshëm në mëri, i sfiduar deri në çmënduri.…Ata nuk janë fetarë fanatikë.…Myslimanë e të krishterë, jetojnë pranë njeri-tjetrit, janë të bashkuar me shoqi-shoqin në jetën e rendë e të rrezikshme… Edhe pse të ndarë fetarisht në muslimanë, ortodoksë e katolikë, shqiptarëve rrallëherë ka mundur ndokush t’ua shkëpusë nyjen etnike” Ky autor hedh poshtë edhe apologjinë teologjike sikur shqiptarët e pranuan me dëshirë islamizmin, paçka se u servirej prej pushtuesve.. Përkundrazi, zhvendosjet e shqiptarëve, veçanërisht dy shpërnguljet më të mëdha e drastike, drejt Greqisë dhe Italisë (të quajturit arvanitas e arbëreshë), i përkasin intensifikimit të dhunshëm të islamizimit. Konvertimi në musliman u përdor si mënyre e mjet mbijetese e pragmatizmi, si, për të mbajtur pasurinë e të kontrollonin tregëtinë, ashtu dhe për akses në pushtetin administrativo-ligjor, për t’u bërë pjesë e qeverisjes etj. Ku ka presion e dhunë më të fuqishme sesa të të detyrojnë të gjesh mënyrën e jetesës e të mbijetosh?

Vlerësime e konsiderata të tilla, godasin në lule të ballit agresivitetin dhe fanatizmin sllavo-serbo-grek, që përdor mashën fetare si pretendiim e pretekst “për qëllime strategjike e politike” (**Kisinger**, Diplomacia, f. 93), kthehen edhe në goditje të shpifësve e gatuesve të insinuatave anti-shqiptare si “njerëz me bisht”, “pa aftësi shtet-formuese” etj; Që shovinizmi rrethues e përvetëson dhe instrumenalizon fenë, në atë fare feje, sa s’ka ku të shkojë më, këtë e dëshmon edhe shqetësimi i shprehur nga autori, se kishat e manastiret, të ndërtuara qysh nga kohët e hershme nga shqiptarët, si ato në ujdhesat e liqenit, kisha e Krajës, bashkë me strukturën metalike në formën e kishëzës në majën e malit të Rumisë legjendar, janë uzurpuar e sllavizuar, kohët e fundit, nga Kisha ortodokse serbe, që përbëjnë një akt fyerjeje për shqiptarët në përgjithësi e në veçanti për krajanët” (f. 238)

10. Një interes të veçantë ngjall proza “Të gjithë të mitë” (f. 60). Ajo tërheq vëmendjen edhe për t’u gëricur, me atë përmbajtje teologjiko--mitologjiko-historike, manierë fantastiko-realiste, kompozim sufisto-

eklektik. Por të bën për vete me një ide tjetër: ndërsa prezantohet si vepër bashkëkohore malazeze, - në të buçet fuqishëm thirrja: "nuk jemi turqë, ne jemi shqiptarë!" (Ta marrin vesh disa qytetarë të Strugës, Ohrit, apo ku tjetër, të cilët, të përgjigjen shqip: "jemi turqë, turçelinj!?) Dhe, mandej, ndodhi, që këtë autor të etnosit shqiptar, e përkthen në shqip një krijues malazez, poezitë shqip të të cilit i ka përkthyer në gjuhën malazeze një shqiptar tjetër. Një kryqëzim rolesh, që ngacmon për të rrëmuar si është krijuar kjo gjendje! Kësisoj, ky tregim, me simptomat e paraqitura, vjen si një dëshmi historike e sllavizimit të hershëm të shqiptarëve në këtë zone. Edhe spikatja mirë e qartë e tolerancës ndërfetare, tek proza në fjalë, është dukuri që e gjen një lehtësim favorizues në terrenin bektashian, por, më rrënjësisht, toleranca është virtut e kulturë, që i takon po shpirit shqiptar. Këto të dhëna, i bashkojmë edhe me idenë e fomuluar nga **Muhamet Nika**, në studimin "Gjurmë lashtësie në dasmën e Anës së Malit". Ai vëren se shqiptarët dhe malazezët, që sot rezultojnë si dy etni të ndryshme, "kanë etnogjenezë shumë të përafërt, ose të përafërt". me "shumë zakone popullore të ngjashme "në mentaltet e në leksikun gjuhësor", siç janë "besimi në gjarpër", "këngët kreshnike me lahutë", "këngët e vajtimit të burrave" – Lelekanje -, nga malësorët e të dy popujve; fjalën "vatra" (zjarri), të cilat nuk gjënden tek serbët apo sllavët e tjerë. Të dytët, malazezët, konkludon autori, mbase më parë ishin iliro-shqiptarë, po u asimiluan pas dyndjes sllave". Në mbështetje të kësaj hipoteze apo supozimi, hulumtuesi shton argumentet bindëse, si, bie fjala, konstatimi se gjuha e një popullate të pushtuar e nën presion, siç ndodhi me dyndjen sllave në Ballkan, asimilohet e para, kurse ritet, zakonet dhe mënyra e jetesës, jetojnë më gjatë, "ose nuk asimilohen fare".

Simptomat e përmendura, të bëjnë të mendosh se ka qenë e gjallë dhe prirja për të zbutur këtë asimilim e identitet të imponuar e për t'u riafirmuar në identitetin e natyrshëm, por nëpërmjet mjetit fetar, atij bektashian. Mohim i mohimit, metamorfozë e të tjetërsuarëve! Këto konstatime gërvishin koren e ngurtësuar të një dukurie, që nuk mund të ngelen me kaq. Kemi të bëjmë, jo thjesht dhe vetëm me diçka kërshërore, por me simptoma të një interesi të thellë historiko-sociologjik, që meritojnë hulumtim më të thellë. Pyetja shtrohet: malazezët sotëm janë tërësisht apo pjesërisht, pasardhës të sllavizuar të ardianëve e fiseve të tjera ilire për rreth; apo vendasit ilirë kanë lënë gjurmë zakonore-kulturore tek ardhësit slavë? Nuk mund të pohojmë të dëshiruarën, me"mbase" e duke i ardhur rrotull, por të zbërthejmë dritë-

hijet e historisë, me të gjitha mënyrat, rrugët e mjetet, që të përqafojmë të argumetuarën. "Ku janë baladat, eposi, kujtesa e kombit?: - ka bërë pyetjen me sens metodologjik **Kadareja** ynë, në vjershën Vendet e shkombëtarizuara. Brrënjët, origjina, ideniteti i një etnie shuhen me bjerrjen e gjuhës amtare, me ndryshimin e emrit, veshjeve, zakoneve (adeteve), me vendosjen e mbrapashtesave në emër, veçanërisht, në mbiemër etj. Brezat e mëvonshëm malazeze, me një gen, apo ADN të tillë, pse arritën të gjakosen kaq ashpër me shqiptarët? Mos ka bërë të vetën e ndikuar në këtë mesele, afria paraosmane e krishtere shqiptaro-sllave, shoqëruar dhe me përpjekje të tjera për t'i konvertuar vëndasit në identitetin e dyndësve? Përcaktimi i variantit dhe vendosja e çështjes në pistën e vet, ku, secila është madhore, të tilla janë dhe deduksionet, që dalin. Problemi shtrohet, disponohen vetëm simptomat e përmendura, apo ka dhe të tjera? Ato mbeten diçka tangenciale e kalimtare, apo çështja është e hapur për hulumtim dhe pret dhe konfirmime të tjera, pa ekuivoke?

11. Në jetë, vërtetë ka mjaft ndërthurje dukurish, kundërvepruese e ndërpërjashtuese, siç janë, përshembull, shpjegimet shkencore dhe dogmat fetare. Po ato janë ndarë veç, nuk mund të dalin bashkë në të njëjtën arenë apo tribunë. Kurse në faqet e revistës **Dija,** edhe pse tribunë e shkencës, kulturës e artit, rezulton të ceken edhe aspekte dogmash të bashkësive fetare. Që të jemi më të saktë, ato pak aspekte, paraqiten, edhe si element i mirëqenë në jetë, edhe si dukuri të qortueshme, të kthyera në table qitjeje. Njëri thotë, me të drejtë: "me qiejt mos u mbani, se nuk mbahen gjëkundi" (me lapsusin, që i përket Çajupit, jo Naimit); tjetri e përmend serbes të plotëfuqishmin e botave, e cilëson "Të Gjithëmjaftueshëm e Mëshirëplotë", sikur fjala prej tre gërmave z o t, paraqet dikë a diçka, të cilit vetë pohuesi i ka prerë kërthizën! Shprehja "fati është i shkruar për secilin", përdoret pa teklif, e shoqëruar edhe me vargjet teologjike "Për këtë botë mos kij dhimbje fare, shijeve të saj shkundu sa më pare" (f. 61). Po këto abrogohen prej personazhit të një romani, kozmonaut, i cili, duke folur që nga Hëna për objektet që duken prej atje, rrëfen objektivisht, pa i mbajtur anën askujt, qoftë të besimit islam, apo të krishterë. Është real e i kuptueshëm autori kur shprehet se koha ka diktuar ndërtime profane, utilitare, por edhe sakrale; se"objektet fetare, kishat dhe xhamitë, disa prej manasireve në ishujt e Liqenit të Shkodrës, të ndërtuara nëpër fshatra, në kohë të ndryshme, u shërbyen vendasve për qëllime të caktuara" (f. 218). Po s'ka fare argumente të evokohet dogma primitive, siç dël në shprehjet:

“Po qe me prejadhje familjare të devotshme, je dhe i destinuar të ecësh në rrugën e fesë, … Të gjykosh sipas sheriatit, të jesh i drejtë, në paqe me Zotin dhe njerëzit, ishte, ndoshta, puna më e vështirë botë” (f. 247, 248), Këto përbëjnë apologji, shërbejnë dhe si furçë, furkë apo “patericë intelektualiste” e teologjisë. Përndryshe, si e bëhet hallit **Mustafa Qemal – Ataturkut,** që struku dogmat dhe suprimoi sheriatin!? Në një tregim, autori e ka të vetën dogmën e fatalitetit, prandaj dhimbjen e vdekjes së babajt e zvogëlon dhe justifikon me shprehej “”fatit nuk i ka ik askush, që t’i ikja unë”. Qasje krejt tjetër përfaqëson ideja: “Vendosja e Homo Sapiens në pirgun e zinxhirit të të ushqyerit, e bën atë Zot të planetit”. Çiftëzimi dhe kreativiteti, përcaktohen si dy elemente të qëllimit të jetës, dhe nuk ndihet nevoja, as nuk i lihet fare vend ndonjë revelacioni apo përkushtimi hyjnor, siç turfullon pa prajtur teologjia. Një autor, e mbyll shkrimin e vet, me pohimin: “Në thellësinë e tokës jetojnë demonët dhe zotat e nëntokës, si dhe shpirtrat e të ndjerëve” (f.203); e thotë këtë me po atë siguri të një arkeologu, i cili ka rrëmuar dhe ka zbuluar një objekt real të lashtësisë. Pohohet se është ngritur faltorja “me fuqinë e besimit dhe të shpirtit”, kurse gjejmë dhe poezinë “Meditim për zotin”, nga **Ali Podrimja,** që përfundon me vargjet: “Po tim zot, atëhere, mes mumjeve, si ta dalloj, apo edhe më në shpinë rrasën e varrit të bart unë!” Nga një anë përdoret termi “qytetërimi islam” (f. 210); bëhen portrete klerikësh, me përcaktimet “bari i shpirtrave”, “dijetar i madh islam”, “ndërtues faltoresh”, “gjykues i drejtë, sipas sheriatit” etj; nga ana tjetër, kur vjen fjala për faktin historik të islamizimit të shqiptarëve, përmenden drejtë e saktë shkaqet e konvertimit në fenë islame, të cilën e sillnin me vete pushtuesit osmanë, si shtet teologjik me trajtim politikisht të islamit.

Po përse i fokusuam tërë këto grimca nëpër revistë,? Aspak për qëllime censurore. A e kanë ato vendin edhe në këtë tribune të shkencës, kulturës e artit?. Debati e polemika janë promotor i përsosjes së dijes. Siç kanë dalë autorët në të dy qasje të kundërta ndaj teologjisë, - injoruese dhe pohuese, ashtu është ndarë sot edhe bota. Para kësaj tabloje, nga një anë kujtojmë aforizmin rus “duron letra” (tjerpit bumaga), nga ana tjetër, demokracia moderne ka sanksionuar lirine e mendimit dhe fjalës, po, pike së pari, kjo normë nuk duhet çuar deri në absolutizim, duke shprehur dhe absurditete. Njerëzit mud të shprehen mbarë e mbrapsh, po normës së të botuarit ide e tema panshoqërisht të dobishme, a i mbetet vend? Të paktën, revista duheta t’a shmang dualizmin dhe të mbaj fort rolin e misionin e saj illuminist-shkencor.

Teologjia e klerikalizmi kanë siguruar kq shumë hapësira, sa s'ka arsye t'u bëhet vend në botimet, që obligohen për të kundërtat e kundërshtaret e tyre.

12. Grimcat e mësipërme i trajtuam edhe polemikisht, sepse jemi dëshmitarë të polemicës shekullore të së natyrshmes, racionales, transparentës, kundër të mbinatyrshmes, irracionale e mistereve të mbivëna. Mirëpo, me keqardhje, duhet të komstatojmë se një nga devijimet më të rënda juridiko- orientuese, që ka bërë bota zyrtare, të cilin nuk ka fare gjasa se po e korregjon as kjo demokracia moderne, është shpallja dhe trajtimi i fesë si vlerë, liri, e drejtë njerëzore; përligjja dhe e nocioneve "kulturë e krishtere", "qytetërim islam" dhe sa e sa glorifikime, bonuse, furçe, furka, paterica, të gjitha doza morfine për zgjatjen e jetës së një produkti primitive dhe të një organizimi e veprimtarie kundërjetësore. Nga këto klerikalizmi edhe më shumë krekoset, kapardiset, duke i shkaktuar ende njerëzimit viktima, gjakderdhje, urrejtje, përçarje, intolerance, plagë e dhimbje. Janë lënë në arkiva, si apeli i lashtë epikurian: E ndershme është, jo të pajtohesh me paragjykimet e masës mbi perënditë, po të hedhësh dritë mbi to, ashtu dhe sa ide e orientime të tjera të mendimit dhe kulturës botërore, (përfshi dhe ato kombëtare, mjaft shpotitëse e të argumentura), me të cilat mund të mbushet krejt një revistë. Njerëzimi po vuan edhe për ato mend të kokës, të cilat ia ka dhuruar po koka e vet. I ka mbytur ato, me huqin magjik që ka krijuar politika.

Po që nga Rilindja europiane e këtej, njerëzimi hyri në epokën e dijes dhe iluminizmit, e vendosjes së pushtetit të bindjes, në vend të besimit të verbër, adhurimit dhe nënshtrimit ndaj fantazive të sëmura të fëmijërisë së me ndimit njerëzor. Po nuk e drejtojë nteligjenca këtë revolucion të madh të njerëzimit, ngërçet, zigzaket dhe humbjet, nuk do të na ndahen! Përballë fakteve kokërforta dhe zhvillimeve të vrullshme, klerikalizmi, nga ana e vet, po përshtatet, i adoptohet kushteve të reja, një kameleonizëm të mirëfilltë. Teologëve dhe klerikëve, në kohët tona modernë, u intereson të pohojnë apo të trajtojnë artistikisht "marrëdhënie të shkëlqyera e shembullore mes kombësive, feve e brezave". Po kjo manierë është vetëm një orvatje e dëshpëruar e përshtatjes ndaj kushteve të reja shoqërore. Asnjë lloj ngjyrosjeje nuk i bën më Biblën e Kuranin të dobishme, as të justifikueshme. Perënduan, të ezauruara, në mundësitë e vlerst e tyre, ato kohëra kur feja kërkonte gjuhën amtare, kur pasurimi dhe mbrojtja e gjuhës shqipe motivihej si "e dobishme për përhapjen e fesë". Kryesorja në këto raporte është se

gjuha, letërsia dhe arti, historikisht pësuan diversionin uzurpues të organizmave klerikale, u përdorën ato si mjete, që dogmat irracionale, të bëheshin më joshëse e të pranueshme për ndjenjat dhe arsyen njerëzore. Trashëgimia krijuese e **Frang Bardhit**, është një shtyllë kilometrike në historinë e kulturës kombëtare, por të vajtosh që "ajo nuk rezulton të ketë patur ndonjë ndikim të madh kulturor në vend", është një lluks e pretendim i sajuar. Sundimin turk mund ta akuzosh për njëmijë drejtime, po s'mund të pretendosh prej tij as "zhvillimin e kulturës, (sidomos të gjuhës shqipe), as fabrikim pengesash, më tepër dhe më të ndrysheme nga ç'ofronte koha. Të veçosh, më tej, dhe se ky ndikim, qënka penguar, "aq më tepër se autorët e këtyre veprave ishin prelate katolikë të Veriut", kjo është si të qash pa u rrahur, sepse në shekullin e Frang Bardhit, po niste islamizimi dhe s'kishte shans për t'u ndalur në veprat e këtyre apo atyre klerikëve. Po në këtë shkrim, autori e quan "fatkeqësi periudhën e gjatë 50 vjeçare të diktaturës komuniste" (në Shqipëri). Përse? Sepse atë trashëgimi e la "vetëm pronë të institucioneve shkencore", kurse "për publikun e gjerë të sudiuesve", ato libra"hupën si krripa në ujë". Zotërinj, praktika e ndërtimit socialist në Shqipëri, i ka boll gabimet, kufizimt, të metat, devijimet, që e mbytën, po mos folni "si e ëma e Zeqos maj thanës", dokumente e vjetra, me vlerat e tyre gjuhësore, letrare etj, e kanë vendin në biblioteka dhe institucione shkencore, bëhen të njohura për publikun e gjerë për si dhe sa ato pasqyrohen në tekstet shkollore, veç në këtë drejtim mund të vëzhgohet nëse ka ndonjë defekt! Shprehja e ekzaltuar për një "jetë, kushtuar besimit dhe mësimit" (f. 247), vë shenjën e barazimit midis përhapjes së dijes dhe predikimeve të dogmave, sikur ato të jenë dy shina levizjeje e progresi, në një kohë kur njerëzimi ka kalëruar forte në Pegasin e Dijës, duke u shkëputur çdo ditë e më shumë nga çoroditjet e çorientimet teologjike anti-jetë e anti-shkencë. Tjetër; feja islame e ka bërë lanet pikturimin e subjekteve të botës së gjallë, prandaj, më kot një autor pohon: "Nuk dihet me saktësi arsyeja e mosshfrytëzimit të simboleve frymore në gurrëvarret e Anës së Malit, Ulqin" (204) Tjetër; të shprehesh që "është e pamohueshme se, simboli i shpatës, i gdhendur në gurrëvarret e trevës së Anamalit, para së gjithash, ka kuptimin e drejtësisë, fuqisë, pushtetit, mirëqenies, ushtrisë etj,…është sundim i drejtësisë dhe pushtetit, i të mires ndaj të keqes" (f.210), kjo përfaqëson shpërdorim të fjalës e frazës, deri në atë fare feje, sa të zezën ta quash të bardhë.

13. Me një fjalë, njerëzimi, tashmë, i ka, plotësisht të qarta e të ndara dy qëndrime ndaj dogmave fetare e klerikalizmit, dy qasje, dy prezantime të

kundërta, përjashtuese. Nga indoktrinimi e fanatizmi fetar, deri tek botëkuptimi shkencor materialist, shtrihet gama e disa kënd-vështrimeve të botës e jetës, ku, jo për censurë po me autocensurë, apo vetë-kontroll, revista e shkencës, kulturës dhe artit, të mbetet tribunë e këtyre kryefjalëve të saj, me përmbajtje mbarënjerëzore, duke e lënë botën, gjuhën dhe tematikën fetare në "shenjtërinë" e tyre. Gjuha shkencore-artistike është e të gjithëve e për të gjithë, gjuha teologjike është veëm e disave. Gjurmë lashtësie, si ato në dasmën e Anamalit, gjejmë në krejt mënyrën e jetesës së njerëzve, po në folklor kemi edhe një trashëgimi të vyer të stigmatizimit të dogmave fetare, bestytnive e klerikalizmit, Jo rastësisht, edhe atyre anëve thuhet për klerikët "e kanë bërë dinin-dinar" e sa gjykime të tjera. Kur nuk vepron vetëcensura, e merr fjalën redaktimi përmbajtësor. Kush nuk dallon se dogmat divergojnë thellësisht e rrënjësisht me botën reale, laike, ka përqafuar dhe i shërben një kompromisi démodé e absurd. Nuk mungojnë nëpër botë edhe akademikë që të fornulojnë "argumentet" e ekzistencës së zotit etj, po edhe më e durueshme se letra është kjo toka jonë, ç'nuk mban e ç'nuk gjen në të! **Dija** duhet të pozicionohet prerë, drejtë dhe qartë në qëndrimin, qasjen dhe prezantimin që i takon. Në kohëra të errëta, mund të përcaktoheshe edhe si "imam i dalluar, me autoritet të veçantë". Për shqiptarët ne territoret e kolonizuara, islamizmi mund të ketë shërbyer edhe si mjet rrethanor kundër ortodoksizimit asimilues sllavo-grek. Në këtë komtekst, është pak e josaktë të themi, sikur: "Ke sllavët dhe grekët feja ishte shpesh motiv i përçarjes"; sepse ajo mbetet mjet permanent i dasive, përçarjes dhe asimilimit, madje, edhe mozaikun fetar të vetë kombit tonë, atdhetari **Fan Noli** e cilësonte si anarkinë e parë të jetës shoqërore-politike. Për nga numri i viktimave, plagët më të mëdha dhe dhimbjet më të thella, të shkaktuara me anën e feve e në emër të tyre, jemi kombi unikal, rast paprecedent. Kujt tjetër, si ne, i është mohuar, identiteti i natyrshëm, gjuha amtare, shkolla dhe libri shqip, deri dhe lloji i alfabetit të përshtatshëm, për t'u asimiluar e tjetërsuar? Për sllavët, ka qenë program shtetëror dhe qëndrim politik ndaj shqiptarve: "o konvertim në ortodoksizëm, o vdekje!"

14. Kush tjetër gatoi të tillë tolerancë ndërfetare , vetëm si atribut kombëtar imunitar ndaj diversionit përçarës, urrejtjendjellës, intolerant dhe asimilues të feve? Ndaj dhe intelektualët e botës shqiptare, duhet të jenë në nivelin iluminist-shkencor të kohës. Madje, të dallohen për qartësi, konseguencë, distancues të prerë me fanatizmin shekullor, ithtar të papërmbajtur të progresit. Në forume dhe tribuna intelektuale, duhet

të dominojë fryma iluministe, parimi i laicizmit, duke e lënë "besimin" një çështje vetiake, pa dale publikisht, sepse ai nuk është më i të gjithëve dhe tendenca dominuese e jetës, është ngushtimi i besimit të verbër. Mund të spikasë, drejtpërdrejt edhe ateizmi, sepse ai është një deduksion i natyrshëm i kultures dhe njohurive shkencore botërore. Shpehjes "paqja qoftë mbi të" etj, i gjenden mëse mjaftueshëm, hapësira në faltore dhe në librat teologjike, jo të shfaqen dhe në botime shkencore-kulturore.. Në një kohë kur bashkësitë fetare mbahen me disa furka, paterica e furçe politike, në krejt planetin, përfshi dhe hapësirat tona etnike, në **Dija** gjejmë pjesë ku prezantimi i frymës teologjike, pasaçërrisht asaj islame, nuk mbetet mjet rastësor e tangencial, po kthehet në qëllim predikimi. Asaj i vihen, kështu, edhe "paterica intelektualiste". Gjurmët pagane-politeiste dhe të gjitha besimet monoteiste, që sot paraqiten si një lloj politeizmi horizintal, kanë të kaluar, po jo dhe të ardhme. Kalimi gjithnjë e më shumë në bindje të argumemtuara, ky është sot procesi i fuqishëm, i pandalshëm. Janë të gjitha argumentet shkencore, juridike dhe jetësore për të bërë sygjerimin, që **Dija** të jetë më pak teologjike, të spikatë e të dominojë në të fryma iluministe-laike, deri edhe ajo ateiste, ashtu siç është edhe forca e prirja kryesore e progresit të njerëzimit, ku jeta po laicizohet, edhe terminologjia teologjike po profanizohet. Kur Rilindja europiane doli me sloganin **"Dija është forcë"**, (i cili mund të zëvendësojë ose shoqërojë citatin e Xheladin Rumit, në f. 3), ajo dha kushtrimin dhe bëri apel për kthesën e madhe të njerëzimit nga besimi i verbër drejt eksperimentit e hulumtimit të dijes të argumentuar; heqjen dorë nga pasiviteti, fataliteti, përulja, kërkimi i ndihmës e mëshirës prej një zoti fiktiv, virtual; marrjes së kthesës drejt shpalljes së njeriut zot të natyrës, të jetës e të fateve të veta; shkëputjen nga stanacioni, dogmat primitive e të ngrira të besimeve, për të kalëruar në Pegazin e shkencës, i cili na ka sjellë në nivelin e sotëm dhe s'po e ndal trokun galopant. Këtë frymë përcolli edhe plejada e shquar e rilindësve tanë, siç mund të përmendim për shemull, vargjet e **Koto Hoxhit**: "Jo për kishë e për xhami, po për mësim, qytetëri, vritemi për Shqipëri". Proceset me këtë prirje krejt të re, të kundërt me atmosferën mendësore-shpirtërore të rendit skllavopronar e atij feudal, janë evidente, të fuqishme, të pandalshme, të pakthyeshme. Intensiteti dhe shtrirja e tyre është obligim i detashmenteve intelektuale, i krijuesve, të cilat, të .ndërgjegjësuara për këtë mision illuminist, realizojnë shkëputjen me të kaluarën, mposhtin inercinë e traditës, sfidojnë opinionin, ende dominues të njerëzimit

profetar, bashkë me atë politik-zyrtar, Siç pohon sociologjia shkencore, besimet e kanë një të kaluar të vetën, po jo dhe të ardhme. Atyre, nga ish dominuese, deri absolute, po u shkëputen fijet e lidhjeve me jetën njerëzore, po i kufizohet sfera e ndikimit. rrëshqasin si në një pjerësirë. Nuk i përket **Dijes** të merret me injektimin e morfinës, psherëtimave dhe rënkimeve, të mbetura nga shekujt! Thënë më gjerë, në ka kulture e inteligjencë në këtë rruzull, që ta ndajë qartë shapin nga sheqeri. të vëjë mire pikat mbi i, të mos i thotë derrit dajë, as sapunin të mos e servirë për djathë, këto janë mendimi, kultura jonë kombëtare, me detashmentet intelektuale si protagonistë dhe krijues të tyre.

15. Po shprehem, posaçërisht, edhe për faktin se shfaqja në revistë e firmës **Bahri Brisku**, si anëtar i Redaksisë, edhe me fragmentin e dorëshkrimit "Odisejada autobiografike", ishte një surprizë e shumëdëshiruar, më riktheu shpresën të jetë bash ajo figurë publike, që po i avitet 85 vjetorit të lindjes dhe jo ndojë adash me të njëjtin emër e mbiemër. E vlerësoj këtë takim virtual me bacën, sepse kanë kaluar vite pa u parë, po me tragjikja është se ndaj pyetjes në stendën e Malit të Zi të një panairi të librit, para disa viteve, në Pallatin e Kongreseve (Tiranë), mora përgjigje të dhimbshme, krejt të padëshirueshme. Më injektuan në mendje një vdekje, e cila duhet revizionuar me kënaqësi. Përgënjeshtrimin e atij informacioni do t'a përjetoj e përshëndet si një "ringjallje" të një ulqinaku simpatik e krijues, bacës të urtë e të mire, intelektualit të kauzës kombëtare, me nostalgjinë për lidhjen tone pranë Partisë sp Unitetit Kombëtar (Tiranë). Për të qenë tërësisht i sinqertë, verifikimi i statusit ekzistencial të Bahri Brikut, a është bajrak mbi tokë, dhe jo i ndjerë nën dhe, kjo përbën dhe një nga shtysat e ndërmarrjes së këtij meditimi.

Së fundi, pasurimi i bibliotekave shqiptare me një botim të tillë, shkencor-artistik-kultror, solid e konstruktiv; përbën një kontribut të vyer të intelektualëve ulqinakë; faleminderit **Dijes**, që u bë shkak e shtysë për t'u përqendruar në këto refleksione Prezantimi i revistës në Muzeun Historik Kombëtar më 17 nëntor 2017, (ditës e 73 vjetorit të çlirimit të Tiranës nga pushtimi nazist), së bashku me veprën Krijime popullore shestanase, të autorit **Simë Gjon Dobreci,** i dha asaj dite kolorit dhe dimensione të reja. Pjesëmarrjen në këtë aktivitet e quaj fatlume; dhurimi i këtij numri të revistës më bëri më të forte dhe më krenar. Meditimi është një sprovë, që, po rezultoi shoqërisht i dobishëm, bëhet letër e hapur e prezantimit të atij numri dhe urë e ndërlidhëse me numrin e ri të **Dija**-s, 2018.

LIBRI/GJUHA

Dr. Eljon DOÇE, pedagog i letërsisë, UT

MIGJENI, RECEPTIMI I MUNGUAR/DEFORMUAR

Me siguri që nëse Krijuesi do të mjaftohej duke i treguar Evës dhe Adamit vetëm mrekullitë e kopshtit të Edenit, duke e lënë mënjanë historinë e Pemës së Njohjes, ndoshta Historia do të qe ndryshe!
Një prej mësimeve që mund të nxjerrim prej këtij episodi biblik është që kur diçka cilësohet si "e ndaluar", edhe në mos pastë në të ndonjë gjë realisht të dëmshme, vetëm fakti që e etiketon si të tillë e bën atë një objekt kurioz dhe pse jo të lakmuar. Kjo edhe mund të justifikojë si "primordial" prirjen që njeriu ka për të shkuar më shpejt kah së ndaluarës sesa të lejuarës.
***

Po të hedhim një vështrim të shpejtë në historinë e letërsisë botërore, një pjesë e mirë e atyre që sot i konsiderojmë si "kryevepra" janë mbrujtur në rrethana të pafavorshme historike apo biografike: Dantja, Floberi, Bodleri, Wilde-i, Xhojsi, Pastërnaku etj. nuk janë "mirëpritur" në kontaktin e parë me receptuesin/kritikën e kohës, paçka se më vonë janë kthyer në klasikë dhe, madje, kanonikë si autorë.
Kështu mund të dalim në përfundimin se vërtet që p.sh.censura, duke e reduktuar apo edhe shkëputur plotësisht kontaktin e lexuesit me veprën, nga njëra anë duket se e mpak vlerën e kësaj të fundit, por nga ana tjetër e rrit edhe interesin për "frutin e ndalur".
Mirëpo Migjeni pati (në njëfarë mënyre) fatkeqësinë të mos ishte "frut i ndalur" siç qenë Konica, Fishta, Koliqi etj. autorë të cilët u nxorrën jashtë skemën së komunikimit fillimisht duke u anatemuar dhe pastaj thjesht duke u lënë në harresë. Me sa duket propaganda totalitare e kuptoi që duke e "mallkuar" një autor, nga njëra anë dukej se e nxirrte atë jashtë skemës së komunikimit letrar, por nëndheshëm, nga ana tjetër, rriste njëkohësisht interesin për këtë "demonin", i cili po të zbulohej mund të rrëzonte krejt demagogjinë e kritikës socrealiste. Ndaj edhe u zbatua metoda e heshtjes: të asgjësohet shkrimtari duke mos folur fare për të.
Historia e Migjenit duket fatlume në karahasim me historinë e

përbashkët të tre autorëve të sipërpërmendur: jo vetëm nuk u anatemua, por përkundrazi u kthye në epiqendër të vëmendjes së kritikës së kohës.
Mirëpo për çfarë? Sigurisht jo për atë që ne, nga pozitat e sotme, mendojmë që përbën vlerën artistike të veprës së tij: shijen e re të shprehjes artistike e cila jo vetëm që theu traditën paraardhëse romantike, por që edhe në raport me shkrimtarët bashkëkohës ishte e pangjashme ose, më mirë me thënë, "kangë në vete".
Thamë më sipër se "historia e Migjenit duket fatlume".
Po, sepse vijoi të jetë pjesë (hiper) aktive e komunikimit letrar dhe njëkohësisht fatkeqe pasi u bë pjesë e një deformimi sistematik nga kritika e cila e futi në kallëpe ideolgjikë që e përçudnuan dhe ngushtuan në mënyrë të skajshme frymën e saj universale.
Nëse pas viteve '90 me Koliqin, Konicën apo Fishtën, puna do të niste mbi një terren ku duhej të hiqej "balta" që mbuloi për 50 vjet veprën e tyre, me Migjenin puna ishte edhe më e vështirë: këtu balta nuk gjendej vetëm në sipërfaqe, por në çdo ind të veprës dhe, ç'është më e keqja, "balta", e "blatuar" për gjysmë shekulli mbi Migjenin, nuk perceptohej si e tillë, pra si baltë.
Pra pyetja që do të vijonte tani është: cili do të ketë qenë receptimi i Migjenit në kohën kur shkroi?
Jemi në mesin e viteve'30, kohë kur Migjeni boton "Vargjet e lira". Jemi po sërish në mesin e viteve '30, kohë ku E. Koliqi boton përmbledhjen me novela "Hija e maleve".
Përse e bëmë këtë analogji?
Në fakt, nuk do të donim që kurrsesi të nisnim një punim i cili mëton të aplikojë metoda të natyrës formal-gjuhësore dhe veçanërisht semiotike duke bërë digresione historike të cilat realisht, për natyrën që kemi dashur t'i japim punimit, jo vetëm që nuk ngrenë peshë, por madje janë edhe të dëmshme në qoftë se *aplikohen* (ndoshta termi më i drejtë në këtë rast do të qe "*implikohen"*) si instrumenta studimorë për të ndriçuar një objekt të caktuar me karakter letrar (e që në rastin e metodave formale do të duhej të ishte, madje, vetëm literal).

Kjo ishte një vërejtje të cilën ne e morëm parasysh në çastin kur vendosëm që të nisnim këtë shkrim dhe është një vrejtje e qëndrueshme, por siç edhe mund të konstatohet fare lehtë, fati i krijimtarisë së Migjenit, nuk ka qenë më i *paqtë* se ai i Fishtës, Koliqit, Konicës e shumë të anatemuarve të tjerë të cilët jo vetëm që u keqkuptuan (me dashje) por u arrit deri aty sa të fshiheshin fare nga tekste didaktike. Mospreferenca, për shkaqe të njohura për t'i publikuar këta autorë dhe

fshirja nga antologjitë shkollore, në njëfarë mënyre e ka pasur edhe ajo një rrjedhojë sadopak "pozitive" në gjithë atë farë inkuizicioni, pasi gjithsesi, duke kaluar në periferi të vëmendjes së kritikës utilitare të kohës, "të nëmurit", përveç etiketimeve-klishé si "reaksionar", "borgjez" e ndonjë tjetër, dalëngadalë u lanë paksa në harresë në pikëpamje të studimeve të veprave të tyre- duke i ruajtur kësisoj të përbaltur si figura, por të paprekur si vlera artistike.

Vëmendja e tepruar që u përqendrua tek Migjeni, si pararendës i "diellit alegorik" të socrealizmit dhe e gjithë historia që pasoi, ndoshta e ngritën shumë lart atë në hierarkinë e letrave shqipe, çka edhe mund (*dhe*) i takonte, porse shqetësimi qëndron në *arsyet* dhe *qasjen* metodologjike ndaj veprës tij, çka bëri që ai vërtet të ngihej lart në hierarki, por në një piedestal të paqëndrueshëm për aq sa arsyet ishin politike dhe qasjet jashtëletrare.

Siç edhe e kemi përmëndur më herët, fati i "Vargjeve të lira" që ato, në një regjim të caktuar, u censuruan dhe, pavarësisht se gjatë regjimit që pasoi u publikuan së bashku me "Novelat e qytetit të veriut", në të dyja rastet u bënë për të njëjtat shkaqe: ***jashtëletrare.*** Ndaj është e vetëkuptueshme që, edhe për rrjedhojë të këtyre shkaqeve, njohja me këtë autor rezultoi më shumë një *mosnjohje e asaj që duhej të njihej*.

Qasja jashtëletrare është një gjë, *arsyet* e kësaj qasjeje janë diçka tjetër.

Qasje jashtëletrare janë edhe biografizmi, historicizmi, psikanaliza etj. të cilat pavarësisht se janë të pjesshme si njohje (sipas tezave formaliste, ato nuk janë njohje asfare), por që (për të mos kaluar në skajshmëri), gjithsesi mbeten një përmasë e caktuar e njohjes, por kur këto qasje jashtëletrare bëhen për arsye thjesht propagandistike atëherë dëmi që i bëhet artit është edhe më shkatërrues.

Me rastin e Migjenit, ka ndodhur pikërisht kjo dukuri.

Është kjo arsyeja që nuk arritëm dot që të paktën këtë përmasë historike, ta shmangnim nga ky punim, siç edhe jemi munduar që të përjashtojmë sa të mundim p.sh. referencat biografike të *autorit* 9, këndvështrimet psikoanalitike apo edhe filozofike.

Ka një çështje të cilën do të donim që ta sqaronim për të mos i dhënë dorë kahjes që *a-priori* të vlerësojmë (në kuptimin "pohojmë") çdo

9 Me termin "autor" do të kemi mjaft diskutim në vijim të punimit dhe, përgjithësisht, do t'i referohemi atij thuajse ekskluzivisht si "autor model" sipas teramve te Eco-s, e në disa raste autori do të kuptohet thjesht si *"grupim ligjërimi"(me termat e Focault-së),* por për momentin, me "autor" po kuptojmë përmasën empirike të Migjenit për aq sa jemi në një diskurs me karakter historik.

shkrimtar i cili është keqvlerësuar më parë në rrethana të caktuara historike, pasi kështu, në pikëpamje *proceduriale*, nuk të bënim asgjë më shumë se ajo pjesë e kritikës që ka bërë të kundërt e asaj që ne po pretendojmë me këtë punim.
Ndaj edhe gjejmë rastin që të bashkohemi edhe qëndrimin e studiuesit S.Fetiu i cili shprehet se:

> "*... vepra e Migjenit nuk kërkon as vlerësime mitizuese as shqyrtim demitizues: për të janë të preferueshme analizat përkatëse shkencore [...] pra, mënyra e ndërtimit, e shtjellimit dhe e strukturimit të materies, pavarësisht nga ideja dhe tema, por duke e vështruar problemin në tërësinë e mjeteve ideoartistike dhe stilistiko-gjuhësore*." 10

Ndoshta jemi ende në kushtet kur do të na duhet të riartikulojmë shqetësimin që Arshi Pipa ngrinte qysh <u>në vitin 1941</u> (kujtojmë që ende nuk kishte filluar "revolucioni kulturor" në Shqipëri) se :
" [...] *nevoja ma e madhe qi i paraqitet problemit letrar shqiptar asht* ***rishikimi i vlerave***. " 11

Le të ripohojmë që ky është një shqetësim i përhershëm në fushë të mendimit letrar, pasi hierarkitë asnjëherë nuk janë përfundimtare dhe ato i nënshtrohen në mënyrë të pandërprerë dialektikës së ripërmasimit, edhe në kushte "normale". Por kur ky "normalitet" deformohet për periudha të gjata kohore, siç edhe ka ndodhur me rastin e letërsisë shqipe, thirrja e Pipës bëhet edhe më e ngutshme, duke marrë, madje, karakter imperativ më shumë se sa thjesht udhëzues.

BIBLIOGRAFI

- Fetiu, Sefedin, Vepra e Migjenit dhe kritika e saj, Prishtinë, 1984
- Pipa, Arshi, Për një kritikë letrare, Princi, Tiranë, 2006

10 FETIU, Sefedin, Vepra e Migjenit dhe kritika e saj, Prishtinë, 1984, f. 11.
11 PIPA, Arshi, *Për nji kritikë letrare* , Kritika- Esse 1940-1944, Princi, Tiranë, 2006, f. 12 (marrë nga revista e përmuajshme "Shkëndija"Viti II i botimit, gusht-shtator, Nr. 2-3, 1941)

Daniela-Carmen STOICA, Ph.D.

TË DREJTAT GJUHËSORE NË SHQIPËRI , MAL TË ZI DHE NË ISH-REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË (FYROM)

Hyrje

Gjendja e tanishme demografike, si dhe statusi i pabarabartë i bashkësive etnike dhe gjuhësore në Shqipëri, Mal të Zi dhe ish-Rebublikën Jugosllave të Maqedonisë janë kryesisht pasojat e proceseve historike dhe politike të cilat u zhvilluan në këtë zonë të veçantë gjeografike të Evropës. Ballkani Qendror dhe Perëndimor ishte pjesa e fundit e Evropës Juglindore që u nda nga kufijtë shtetërorë. Kjo ndarje, që shpesh konsiderohet e diskutueshme dhe artificiale, ndodhi në fillim të shekullit 20, pas rënies përfundimtare të Perandorisë Osmane. Një prej pasojave të drejtpërdrejta të saj ngjarje ishte që anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike dhe gjuhësore të rajonit u bënë shtetas të shteteve kombëtare të sapo formuara. Më tepër, shtetet kombëtare, shumica e tyre bazuar në ideologjinë e një shteti-një gjuhë, i perceptuan pakicat si një kërcënim për integritetin e tyre. Përveç kësaj, një tjetër ngjarje politike që ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në situatën e këtyre komuniteteve që jetojnë në këtë zonë ishte shpërbërja e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë. Konteksti i ri gjeo-politik, veçanërisht integrimi në Komunitetin Evropian, ku Shqipëria, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi aspirojnë të anëtarësohen nënkupton, midis të tjerave, më shumë të drejta për gjuhët rajonale dhe të pakicave të folura në këto vende. Siç do të shohim në prezantimin tonë më poshtë, edhe në këtë pikë ka mospërputhje dhe pabarazi në mënyrën se si këto vende po merren me këtë çështje delikate.

1. Shqipëria

Trashëgimia historike dhe politike e Shqipërisë, e cila gjithashtu përfshin të kaluarën e saj komuniste, është edhe sot e dallueshme. Pas rënies së komunizmit në vitin 1991, deri kohët e fundit, statusi zyrtar i pakicave gjuhësore dhe etnike në Shqipëri i ka pasur rrënjët në politikat e ish-Republikës Socialiste të Shqipërisë. Regjimi shqiptar komunist, i karakterizuar nga paranoja dhe izolimi ndaj vendeve fqinje, njihte ekzistencën e dy llojeve të pakicave brenda vendit: pakicat kombëtare,

ku përfshijeshin grekët dhe sllavët maqedonas dhe pakicat etno-gjuhësore, ku bënin pjesë romët dhe arumunët, të cilët nuk e gëzonin të njëjtin status, atë të pakicave kombëtare, sepse, sipas shtetit shqiptar të asaj kohe, ata nuk kishin 'atdhe' ose, për të përdorur një term tjetër: "një shtet". Zyrtarisht, kjo ndarje konfuze dhe të pabarabartë ka ardhur në fund të vitit 2017, me hyrjen në fuqi të Ligjit 96/2017, ku sot njihen zyrtarisht nëntë pakica kombëtare në Shqipëri: greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazezë, boshnjake, serbe dhe bullgare . Duke marrë parasysh legjislacionin dhe politikat të miratuara nga shteti shqiptar deri në nëntor 2017 vetëm gjuhët e pakicave kombëtare kishin disa të drejta. Ndonjëherë këto të drejta ishin kontestuar nga vetë anëtarët e pakicave pasi ato ekzistonin më shumë në letër sesa në realitet.

Sllavët maqedonas të Shqipërisë jetojnë në vendbanime rreth liqenit të Prespës dhe qytetit të Korçës, por edhe në zona të tjera që kufizohen me ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Gjatë periudhës komuniste, të drejtat gjuhësore iu njohën vetëm komuniteteve agrare që banonin brenda në dhe rreth fshatit Pustec, në bregun e liqenit të Prespës, ku popullsia lokale zhvillonte arsimin fillor edhe në gjuhën sllave maqedonase.

Në Shqipërinë e Jugut, në kufirin me Greqinë, ekziston një popullsi greke, e cila përfaqëson edhe sot pakicën më të madhe kombëtare në Shqipëri. Pjesa më e madhe e kësaj pakice jeton në rrethet Sarandë, Delvinë dhe Gjirokastër. Sipas Raportit të Parë të Shqipërisë, sipas nenit 25, paragrafi 1 të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (2001), pakica kombëtare greke ishte e para e njohur zyrtarisht nga shteti shqiptar. Pas Luftës së Parë Botërore, shteti i ri shqiptar zbatoi standardet e vendosura nga Lidhja e Kombeve për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Me këtë angazhim, pakicës kombëtare greke në Shqipërinë e Jugut i është dhënë e drejta për të hapur shkollë në gjuhën greke, e cila funksiononte si shkollë private, e financuar nga qeveria greke. Pas rënies së sistemit komunist, shumë anëtarë të pakicës greke kanë emigruar në Greqi (vlerësohet rreth 50% deri në 70%).

Pakicat sllave maqedonase dhe greke demografikisht shfaqen si komunitete relativisht kompakte, gjë që nuk ndodh me arumunët e Shqipërisë, të cilët, kryesisht për shkak të stilit të tyre të jetesës tradicionalisht nomade, jetojnë në komunitete të përhapura si ishuj të vegjël në hartën e Shqipërisë . Sidoqoftë, ato janë kryesisht të përqendruara në zonat rurale të Myzeqesë, Fierit dhe Vlorës, në Frashër

të Përmetit, në Moker të Pogradecit, në Kolonjë, si dhe në disa qytete si për shembull Korçë, Berat, Tiranë, Elbasan dhe Durrës. Sipas raportit të lartpërmendur, " Kjo populsi ruajti deri ne vitet 1950, karakterin e saj nomad blegtoral dhe stabilizimi i saj eshte i lidhur me te ashtuquajturin ' perfundim i kooperimit socialist te bujqesise' gjate diktaturës komuniste ne Shqiperi." Me fjalë të tjera, ata u detyruan të heqin dorë nga stili i jetesës së tyre nomad, nga kafshët e tyre dhe të vendoseshin brenda kufijve të shtetit kombëtar shqiptar. Në raport ata janë përshkruar si një populsi e integruar plotësisht në shoqërinë shqiptare. Arumunët e Shqipërisë i përkasin grupit Fersherot (Nevaci 2011: 17), duke folur një dialekt të gjuhës rumune, të njohur si dialekti arumun, i cili, së bashku me meglenorumanishten dhe istrorumanishten, formojnë dialektet historike të gjuhës rumune në jug të Danubit. Edhe pse gjatë sistemit komunist nuk kishte shkolla ose mësime në dialektin arumun, arumunët, veçanërisht ata që jetonin në zonat rurale, arritën të ruanin traditat, kulturën dhe gjuhën amtare, shumica e tyre duke u bërë dygjuhësh. Pas rënies së komunizmit, duke ndjekur një traditë që ekzistonte përpara vendosjes së këtij regjimi në Shqipëri, Rumania ka ofruar mbështetje financiare për hapjen e dy shkollave fillore private, një në Korçë dhe një në Divjakë. Tani vetëm shkolla e Divjakës vazhdon të funksionojë. Përveç kësaj, çdo vit, shteti rumun ofron bursa për të rinjtë shqiptarë me origjinë arumune për të studiuar në gjimnazet dhe në universitetet rumune.

Pakica rome në Shqipëri, e përqendruar kryesisht në Shqipërinë Qendrore dhe Jugore, si dhe në kryeqytetin e Tiranës, është më e diskriminuar dhe më e ekspozuar ndaj fenomeneve të trafikimit të fëmijëve dhe braktisjes së shkollës. Me të njëjtin lloj trajtimi diskriminues përballet edhe pakica egjiptiane. Në *Raportin e Opinionit të Tretë për Shqipërinë* (23 nëntor 2011) të lëshuar nga Komiteti Këshillimor, vlerësohet se "Përpjekje të posaçme për të hapur dhe për të mbështetur institucione të arsimit parashkollor në lagjet e banuara nga një numur i konsiderueshëm romësh. Megjithatë, numri i romëve analfabetë, fëmijë dhe të rritur, mbetet në nivel të papranueshëm." Instruksioni i fëmijëve romë në shkolla bëhet vetëm në gjuhën shqipe, kurrë në gjuhën rome dhe ky është edhe rasti i arumunëve, malazezëve, serbëve, bullgarëve dhe boshnjakëve. *Raporti i Opinionit të Tretë mbi Shqipërinë* vjen në të njëjtin përfundim, kur vlerëson nivelin e arsimimit në gjuhët e pakicave:

"Mundësitë për të mësuar gjuhët e minoriteteve dhe për shkollim në këto

gjuhë mbeten të pamjaftueshme. Megjithëse vazhdojnë të funksionojnë disa shkolla tetëvjeçare dhe të mesme ku mësimi bëhet në gjuhët greke dhe maqedonase në "zonat minoritare", ku banojnë një numër i konsiderueshëm personash që u përkasin këtyre minoriteteve, shumë kërkesa për organizimin e mësimdhënies në këto gjuhë, por edhe në gjuhë të tjera të minoriteteve, nuk kanë marrë përgjigje pozitive nga autoritetet. Nuk ka klasa ku mësimdhënia të organizohet në gjuhët serbe, malazeze, arumune/vllahe dhe rome."

Si përgjigje ndaj këtij vlerësimi, *Raporti i Katërt*, i paraqitur nga Shqipëria në Këshillin e Evropës në vitin 2016 për mbrojtjen e pakicave kombëtare në kuadër të Konventës Kuadër, shpjegon këto fakte nëpërmjet mungesës të mësuesve të kualifikuar dhe të kurrikulave të përditësuara, ku mësimi i gjuhëve të pakicave duhet të integrohet së bashku me atë të gjuhës shqipe.

Pas miratimit të *Ligjit për pakicat kombëtare*, i cili hyri në fuqi në nëntor 2017, Shqipëria përballet tani me një moment vendimtar për ruajtjen e gjuhëve të pakicave si pjesë e trashëgimisë kulturore të saj - firmosjen, ratifikimin dhe zbatimin e Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe të Pakicave.

2. Mali i Zi

Në krahasim me Shqipërinë, Mali i Zi duket shumë më përpara në njohjen e të drejtave të gjuhëve të pakicave, pasi ky shtet nënshkroi Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe të Pakicave në vitin 2005, e cila hyri në fuqi një vit më vonë. *Raporti i katërt i vlerësimit të ekspertëve mbi aplikimin e Kartës Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave në Malin e Zi* (27 shtator 2017) i kushton rëndësi të veçantë masave të ndërmarra për të mbrojtur dhe promovuar katër gjuhët e minoriteteve: shqiptarë, boshnjakë, kroatë dhe romë. Raporti vëren se, deri tani, zbatimi i duhur i Kartës në Mal të Zi është penguar nga përkufizimi i paqartë i territoreve në të cilat Karta zbatohet. Nga katër gjuhët e pakicave, shqipja është në një pozitë të favorshme në arsim, me autoritete gjyqësore dhe administrative, në media dhe veçanërisht në jetën kulturore, ku gjendja në përdorimin e gjuhës është e lavdërueshme. Është bërë e mundur të merren karta identiteti në gjuhën shqipe dhe partitë rregullisht e përdorin këtë të drejtë.

Duke pasur parasysh sfondin e përbashkët gjuhësor të gjuhëve malazeze, serbe, boshnjake dhe kroate, pothuajse nuk ka probleme praktike në lidhje me zbatimin e Kartës për gjuhën boshnjake dhe kroatishtishten.

Megjithatë, ekziston nevoja për një promovim më të mirë të identiteteve kulturore boshnjake dhe kroate.
Nga ana tjetër, gjuhës rome nuk i është dhënë një status zyrtar dhe ende është në një situatë të pafavorshme. Nuk ka pasur përparim as në standardizimin e gjuhës. Mungesa e mësuesve të kualifikuar dhe materialeve mësimore pengon përfshirjen e romëve në arsim. Raporti thotë se përparimi në jetën kulturore dhe në mediat është bërë, por përmbushja e kësaj sipërmarrje gjithashtu kërkon që autoritetet të mbështesin aktivitete të ndryshme në fushën e përkthimit, dublikimit, post-sinkronizimit dhe titrimit, me një skemë të financimit të qëndrueshëm.

3. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM)
Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë shumica etnike përfaqesohet nga sllavët maqedonas që flasin një gjuhë sllave. Ndryshe nga Shqipëria, e cila kurrë nuk ka nënshkruar Kartën Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë e nënshkroi më 25.07.1996, por kurrë nuk e ratifikoi atë. Megjithatë, disa nga pakicat njihen nga kushtetuta (shqiptarët, arumunët / vllehët, bullgarët, kroatët, grekët, serbët dhe turqit), duke u dhënë atyre disa të drejta gjuhësore, por në nivele të ndryshme. Regjistrimi i fundit, i kryer në vitin 2002, tregoi se një e katërta e popullsisë ishte shqiptarë. Statusi kushtetues i pakicave në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë u arrit vetëm pasi tensionet midis shumicës sllave dhe pakicës shqiptare u kulmuan në një konflikt të armatosur në pjesën veri-perëndimore të vendit në vitin 2001. Konflikti përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit , zbatimi i të cilës përfshinte ndryshime të rëndësishme në legjislacionin lidhur me statusin e pakicave dhe me të drejtat e tyre gjuhësore. Megjithatë, pakicat më të vogla etnike (romët, turqit dhe vllehët / arumunët) shpesh neglizhohen.
Përdorimi i gjuhëve të pakicave në kontekstin lokal u implementua në mënyrë efektive pas vitit 2001. Qëllimi i përdorimit të gjuhëve të pakicave mund të zbatohet vetëm në lidhje me Amendamentin V të Kushtetutës. Kjo do të thotë se në të gjithë territorin e shtetit maqedonas, gjuha zyrtare është gjuha sllave maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, dhe në zonat ku 20% e popullatës flet një gjuhë minoritare, kjo gjuhë është zyrtare, së bashku me gjuhën sllave maqedonase. Me fjalë të tjera, në njësitë e qeverisjes vendore, ku shumica e banorëve i përkasin një pakice, përveç gjuhës sllave maqedonase dhe alfabetit cirilik, gjuha dhe

alfabeti i tyre janë gjithashtu në përdorim zyrtar. Mbishkrimet dhe titujt mund të jenë në gjuhën e pakicës, si dhe emrat e shkollave, institucioneve kulturore dhe të tjerave që lidhen me trashëgiminë kulturore të kësaj kombësie. Toponimet në zonat e banuara nga një numër i konsiderueshëm i personave që u përkasin grupeve të pakicës janë në gjuhën sllave maqedonase dhe në gjuhën e pakicës. E drejta e tyre për arsimim në gjuhën e tyre në shkollat fillore dhe të mesme është gjithashtu e garantuar. Në përputhje me këtë ligj, arsimimi në gjuhën e pakicës është plotësisht i mundësuar në nivelet fillore dhe të mesme të arsimit dhe në disa pjesë në një nivel më të lartë. Kur numri i fëmijëve është i mjaftueshëm, fëmijët romë dhe serbë, për shembull, marrin mësim edhe në gjuhët e tyre. Përveç kësaj, shqiptarët si pakica më e madhe kanë të drejtën e arsimimit në gjuhën e tyre edhe në nivel universitar.

Ashtu si në Shqipëri, pakica rome është pakica kombëtare më e diskriminuar dhe e ekspozuar. Në vitin 2014 qeveria hartoi një strategji të re kombëtare për romët nën angazhimin e saj për Iniciativën e Dekadës së Përfshirjes së Romëve (tani pjesërisht e shëndërruar në nismën e Integrimit të Romëve 2020) që do t'i ndihmonte Romët me arsimimin, strehimin, punësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës. Me përjashtim të arsimimit, fondet nuk ishin të mjaftueshme për të nxjerrë rezultate të rëndësishme, veçanërisht përsa i përket kujdesisë shëndetësore. Qeveria vazhdoi të financojë qendrat e informacionit për t'i orientuar romët në drejtim të shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe të mirëqenies sociale. Rritja e fondeve të OJQ-ve dhe qeverisë për të eliminuar barrierat në arsim, duke përfshirë transferimin e kushtëzuar të parave për studentët romë, rezultoi në frekuentimin e vazhdueshëm nga ana e tyre të shkollës, veçanërisht në shkollat e mesme.

Prezantimi i personave që u përkasin pakicave kombëtare është i mundur edhe në mediat private elektronike dhe të shtypura. Sipas Art. 16, garantohen liria e fjalës, adresimi publik, informimi publik dhe krijimi i institucioneve për informim publik. Janë të garantuar gjithashtu aksesi i lirë në informacion dhe liria e marrjes dhe transmetimit të informacionit. Garantohet edhe e drejta për t'u përgjigjur përmes mediave, si dhe e drejta për korrigjim dhe e drejta për të mbrojtur një burim informacioni në masmedia. Kështu, arrijmë në përfundimin se ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë sot ka arritur standarde të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve të pakicave. Kushtetuta maqedonase e vitit 2001 përmban standarde qytetare, si për

shembull - konceptin liberal, i cili thekson të drejtat vetjake të gjuhëve dhe vendosjen e individit në thelbin e ekzistencës të kushtetutës. Kjo mbrojtje e cila përfshin përafrimin me dispozitat e instrumentit ligjërisht detyrues - Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, por edhe dispozitat e parashikuara në ligjet dhe Kushtetutën vendore janë në frymën e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave, madje edhe pse ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë ende nuk e ka ratifikuar këtë instrument.

4. Përfundime

Si përfundim, mund të themi se të drejtat gjuhësore, veçanërisht të drejtat e gjuhëve të pakicave, mbrohen nga korniza ligjore gjithëpërfshirëse të parashikuara nga legjislacionet e brendshme apo nga kushtetuta në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe nga Karta Evropiane në Mal të Zi. Sidoqoftë, në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë këto korniza janë miratuar në radhë të parë si pjesë e një procesi më të madh të negociatave për zgjidhjen e konfliktit dhe jo kryesisht si mjete për ruajtjen e të drejtave gjuhësore. Një nga mangësitë kryesore që lidhen me vënien në praktikë të këtyre kornizave ligjore është që kjo bëhet në mënyrë të pabarabartë, sepse pakicat në përqindje më të madhe gëzojnë më shumë të drejta përsa i përket arsimimit në gjuhën e tyre amtare. Pakicat më të vogla duket se janë më të lënë pas dore. Megjithëse Shqipëria nuk ka akoma një kornizë të tillë ligjore gjithëpërfshirëse përsa i përket të drejtave gjuhësore të pakicave të saj, kjo tendencë është vërejtur edhe këtu, veçanërisht në rastin e pakicave greke dhe sllave maqedonase. Arumunët dhe romët nuk kanë qënë trajtuar në mënyrë të barabartë në bazë të kriterit se këtyre pakicave u mungon një shtet/ atdhe. Tani, pasi hyri në fuqi ligji 96/2017 dhe njihen nëntë pakica kombëtare, ekzistojnë shpresa të mëdha që Shqipëria do të përmirësojë kornizën e saj ligjore e cila, në mënyrë ideale, do të kulmojë me ratifikimin e Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe të Pakicave, si një mjet të efektshëm për të ruajtur të gjitha gjuhët e pakicave dhe për të mbrojtur ekzistencën e tyre afat gjatë. Padyshim që zgjedhja e nëneve dhe paragrafëve (minimalisht 35) duhet të bëhet duke u bazuar jo vetëm në ekspertizën ligjore që qeveria shqiptare merr gjatë gjithë kohës, por edhe në ekspertizën dhe këshillat e gjuhëtarëve dhe sidomos të sociolinguistëve. Për zbatimin e Kartës, Shqipëria ka tashme një shembull, Malin e Zi, shtet me tëcilin mund të bashkëpunojë nga afër për të mësuar nga përvoja e tij në lidhje me këtë çështje.

Referenca

Council of Europe (2009). *European Charter for Regional or Minority Languages, and explanatory report*, ETS No. 148 opened for Signature in Strasbourg on 5 November 1992 and explanatory report, Council of Europe Publishing.

Council of Europe (2016). *Fourth Report submitted by Albania to the Council of Europe in 2016 on the protection of national minorities within the Framework Convention.* Published in:< https://rm.coe.int/16806befc5>.[retrieved on 13.03.2018].

Council of Europe (2012). *Third Opinion Report on Albania adopted on 23 November, 2011*. Published in:< https://rm.coe.int/16806befc4>.[retrieved on 12.03.2018].

Council of Europe (2001). *Albania's First Report Pursuant to Article 25, Paragraph 1 of the Framework Convention for the Protection of National Minorities*. Published in:< https://rm.coe.int/16806befc2>.[retrieved on 10.03.2018].

Friedman, Victor A. (2008), "The Konikovo Gospel and the Macedonian Identity in the Late Eighteenth and Early Nineteenth Centuries", in Jouko Lindstedt, Ljudmil Spasov & Juhani Nuorluoto (eds.). The Konikovo Gospel - Konikovsko evangelie: Bibl. Patr. Alex.268, *Commentationes humanarum litterarum* 125, Helsinki: Societas Scientiarum Fennica, 385–391.

Karakasidou, A. N. (1997). *Fields of Wheat, Hills of Blood*. Chicago: University of Chicago Press.

Korhonen J., Makartsev, M., Petruševska, M. & Spasov, L. (2016). "Ethnic and linguistic minorities in the border region of Albania, Greece, and Macedonia: An overview of legal and societal status", in Maxim Makartsev & Max Wahlström (eds.). *In search of the center and periphery: Linguistic attitudes, minorities, and landscapes in the Central Balkans*. Slavica Helsingiensia 49, (Helsinki: University of Helsinki, Department of Modern Languages), 13–49.

Nevaci, M. (2011). *Graiul aromânilor fărşeroţi din Dobrogea.* Bucureşti: Editura Universitară.

STUDIMORE

HISTORIKE

Anton LULGJURAJ, arkeolog

FORTIFIKIMI NË GJYTEDZEN E LLOPARIT

Fundnat janë zonë kodrinore malore që shtrihet në shpatet veriperëndimore të masivit të malit të Sukës. Ka lartësi të përafërt nga 400 deri 700 metra mbi nivelin e detit. Përbëhet nga kodrina të shumëta të cilat nuk shprehen me lartësi mes të cilave shtrihet një numër i madh i lugjeve dhe vorbullave karstike përreth të cilave shtrihen fshatrat më të vogla të Fundnave siç janë: Rabraj - Gjekivanaj, Loparë, Gubovdol, Pas Shkallë, Ledinë dhe Vulani lagjë e braktisur[12].

Gjytedza e Lloparve ndodhët në majen e një kodrës në formë konike në mes të rrugës nga fshati Rabraj dhe Llopar. Të dhënat GPS të rregjistruara nga një pikë në mesin e siperfaqes se këtij fortifikimi janë këto: *N= 41^o 57.602' E= 019^o 16.530' h=590 m.*

Nga maja e kodrës përbën një terracë rrafshët shkëmbore, zotëron një shikim të gjërë në të gjithë ultësirën e Zetës. Poashtu është e rrethuar me kullosa të përshtatshme si dhe me disa gropa të vogla karstike të pasura me disa burime të ujit.

Përpos kushtëve të volitshme natyrore që i ofron kjo zonë, fortifikata poashtu ka rrol strategjik pasi ai mbron shtegun natyror që vjen nga ultësira e Zetes dhe kalon përmes qafes së malit në drejtim të zonave të thella malore të krahinës së Trieshit dhe Kuçit. Këto shtigje në migrimet e blegtorëve në kullotat sezonale kanë luajtur një rol shumë të rëndësishem në zhvillimin e blegtorisë dhe shoqërisë në prehistori[13].

Nga të tri anët e vendit të fortifikuar ka një pjerrësi të madhe e sidomos nga ana jugore është e pranishme një vertikale të ashpër shkëmbore. Ngjitja në maje është më e lehtë nga ana veriore. Fortifikimi është i rrethuar me mure në tre anet e saja, përpos në anën jugorë ku është e mbrojtur nga humnera e thellë shkëmbore. Muret kanë formën e gjysëm elipses dhe rrethojnë një hapësirë të vogël, që në pjesën gjatësore shkon 25 m. ndërsa në pjesën tjetër 15 m. Nuk ka gjurmë kthesash apo elementesh tjera fortifikuese. Hyrja nuk është e mundur të konstatohet pasi pozicioni i saj është mbuluar nga gurët e rënë të murit.

Trashësia shkon nga 2 – 2.20 m. Në vendet ku gurët janë rrëzuar nga

12 Për përshkrimin gjeografik falenderoi z. Luigj Camaj.

13 GOVEDARICA, 1989, 231-241.

fasadat e murit shohim se janë shpërndare në një distancë që shkon deri në 10 m. në anët e jashtme të fortifikatës ndërsa në drejtim të hapësirës së brendshme derdhja e gureve shkon deri në 3 m. gjatësi. Faqet e murit janë të dukshme vetëm në anën veriore. Pikërisht në këtë fragment muri ne mund të konstatojmë se teknika e ndërtimit është ajo në të thatë me gurë të mëdhenj dhe të mesëm të papunuar, të vendosur pa ndonjë kujdes. Ruhet në lartësinë max. prej 0.50-0.60 m. Brendësia e murit është e plotësuar me gurë të vegjël dhe të mesem.

Po të vështrosh vendosjen e këtij fortifikimi në lidhje me lokalitetet tjera të aferta bashkëkohëse mund të vërehet se ai komunikon vizualisht me tumate periudhës së Bronzit në Pllanicë. Në territorin e Malësisë ngjason me fortifikim Gjytedze në fshatin Ploçë ndërsa në krahinën e Krajës me fortifikimin ne fshatin Ljarre. Në rrethinën e Shkodrës ka ngjajshmëri me fazën e parë të ndërtimit në fortifikimin e Ganjollës (Ganjollë I) [14]. Në territorin e Malit të Zi shohim ngjajshmëri me fortifikimin në Medjedja Glava[15] dhe Trijebaç[16] pranë Podgoricës. Duke shkuar më në veri në territorin e Hercogovinës me Gradinen Varvari[17]. Në aspektin inkuadrimit kulturor të gjitha këto vendbanime të sipërpërmendura lidhen me kulturën e Adriatikut Lindor të krijuar gjatë epokës së të bronzit[18].

Terreni brenda fortifikimit është i ashpër dhe shkëmbor sidomos në pjesën qendrore dhe jugore. Vetëm një brez i ngushtë pranë murit është tokë e butë. Nuk ka gjurmë të banesave dhe as nuk është gjetur material arkeologjik në sipërfaqe.

[14] LAHI, 1993, F. 201-218
[15] MARKOVIĆ, 2006, F. 172
[16] MLAKAR, 1960, F. 216
[17] ČOVIĆ, 1978 , F. 135.
[18] GOVEDARICA, 1989, F. 173.

1. Pamje e ultësirës të Zetes nga fortifikimi

2. muri në anën veriore

3. fasada e jashtme murit

Dr. Erenestina Gjergji HALILI, pedagoge e letërsisë, UT

UDHËTIM I SHKURTËR NËPËR HISTORIKUN E PROVINCËS FRANÇESKANE

Provinca Françeskane Shqyptare asht e vjetër sa vetë Urdhni, të cillit i përket.[19]

Shkrimet e studimet e deritanishme, për historinë e Provincës Françeskane si mision apostolik në tërësi, si dhe për shkollën letrare të saj, nuk janë shterruese. Historiku i kësaj Province, që u plazmua me qëllimin e lartë *Për Fé e Atme*, ende kërkon punë kërkimore në arkiva, botime e analiza shkencore, në të gjitha fushat e shpërfaqjes së krijimtarisë së të tyre.

Ishte Shën Françesku i Asizit, ai që themeloi tri Urdhra, ndër të cilët edhe O.F.M *(Ordine dei Frati Minori), Urdhëri i Murgjve të Vegjël*. Vetë Át Donart Kurti, shpjegon për këtë Urdhër, misionar i të cilit ishte:*Dihet se Fretent u shperndanë gjithkund nepër Shqypni të Mesme e deri ndër skajet ma të largetat e Shqypnisë së Verit, si edhe në Kosovë e në Mal të Zi e gjatë bregut t'Adriatikut, si: në Tivar, në Ulqin, në Raguzë e deri nalt në Dalmaci.*[20]

Qëllimi i lartë apostolik- baritor, i Provincës Françeskane të Shqypnisë "e të Lajmuemit të Zojës", ose "Nunciatës", përmes shërbimit , përvujtërisë e përshpirtërisë, ishte të përhapte Ungjillin në popullatë, duke qenë shembull të stilit jetësor, duke jetuar për të tjerë, sipas frymës e betimit të vetë Urdhrit… Mbështetur mbi këtë qëllim, Provinca Françeskane, shënjoi një veprimtari të gjerë, që rroku të gjitha fushat e jetës shqiptare. Mision i saj, u shndërrua mbi të gjitha, shkrimi i historisë së kombit tonë, për të ndërgjegjësuar shqiptarët për origjinën, kulturën dhe fenë e tyre të vërtetë. Ky qëllim i epërm, do të mund të realizohej së pari përmes arsimimit të grigjës. Shkolla françeskane, ishte hapi cilësor drejt realizimit të misionit.*Tue u shumue Fretent Shqyptarë, nisi m'u ndie nevoja me mendue ma larg e me punue me nji program ma të gjanë. E iu vu syni Shkollës, per me e ba votër kulturet per vendin tonë e*

19 Kurti, Át Donat, *Provinça Françeskane Shqiptare*, Shkodër, Botime Françeskane, 2003, f.10

20 Kurti, Át Donat , *Provinça Françeskane Shqiptare*, Shkodër, Botime Françeskane , 2003, f.15

pishtar të dashunisë per atdhe.[21]

Drejtori Át Gjergj Fishta, si dëshmon vetë Át Donart Kurti, i dha një synim të madh programit të saj, mësimin e gjuhës shqipe, duke e pasuruar atë edhe me përvojat më të mira arsimore, si ajo e Austrisë, të cilin ia përshtati më së miri shkollës sipas veçorive të kohës e vendit edhe në situata të jashtëzakonshme lufte e paslufte. *Gjatë Rrethimit të Shkoders, në luftën ballkanike, si edhe në kohën e serbjanëve, Shkollës i ra me i pezullue mësimet përkohësisht, por i kapi prapë, fill mbrapa deri në vjetin 1917.*[22] Forca e madhe e besimit në Zot, si shëlbim i shpirtit të misionarit të fesë, energjia, entuziazmi vullnetmirë, bashkërendimi në unitet, si një trup i vetëm, sepse *bashkimi ban forcën - thotë një fjalë e urte*[23], koordinimi i aktiviteteve me fokus të gjerë e kthyen Provincën, një epiqendër të kulturës dhe identitetit kombëtar. *Françeskanët para perspektivave të mëdha plot arsye kerkojnë rrugë të reja per me shkue përpara e per me punue ma shumë.*[24]

"Gjimnazi Françeskan Illyricum"1921, drejtuar nga Át Gjergj Fishta, ishte modeli i funksionimit të një shkolle me program jo vetëm arsimor korrekt e modern, por edhe liturgjik, filozofik e shkencor, sipas metodave të fundme evropiane. Fillimisht, aty u mësuan bazat e latinishtes e më pas u përgatit për shtyp e u botua gramatika e sintaksa e A.Scheindlerit nga Át Donart Kurti, i cili kishte vëmendje të posaçme ndaj *problemeve të drejtshkrimit dhe të kulturës së gjuhës. Ai kërkon që për çështjet drejtshkrimore të merret për bazë gjuha e popullit dhe shqiptimi më i përhapur, por duke pasur parasysh të folmen e Shkodrës.*[25]

Shkolla letrare e dalë prej Urdhërit françeskan, u formësua si e tillë sepse u ngrit si model arsimtar dhe kulturor bazuar në pedagogjinë e urdhërit, duke përhapur shkollimin në gjuhën shqipe dhe për më tepër ajo është e lidhur ngushtë me disiplinat e tjera albanologjike si shkencat historike:etnografinë, arkeologjinë, antropologjinë kulturore, historinë, historinë e arteve dhe arkivistikën, shkencat filologjike:gjuhësinë;sepse botoi fjalorë, gramatika dhe studime mbi gjuhën shqipe;sepse studioi folkloristikën, duke hulumtuar në trashëgiminë kulturore etnike

21 Kurti, Át Donat,*Provinça Françeskane Shqiptare*, Shkodër, Botime Françeskane, 2003, f.28

22 Po aty, f.227

23 Po aty, f.229

24 Po aty, f.228

25 Omari, Anila. "Kontributi i 'Hyllit të Dritës' në studimet filologjike shqiptare", Hylli i Dritës, Numër jubilar më rastin e 100-vjetorit të themelimit, Shkodër.2013.

shqiptare, duke mbledhur, studiuar dhe botuar trashëgiminë gojore; sepse kultivoi sidomos letërsinë, teatrin dhe dramaturgjinë; sepse dha ndihmesë për përkthimin duke përkthyer në shqip kryevepra të letërsisë botërore; sepse i dha elementet bazikë publicistikës, jo vetëm duke nxjerrë periodikë të rëndësishëm si: Hylli i Dritës dhe Zani i Shna Ndout, por duke dhënë një kontribut real, themelor në modelin shkrimor publicistik në shtypin shqiptar; sepse u dallua në kritikën dhe studimet letrare të kohës etj.[26]

Në pohim të sa u evidentua prej mendimit e hulumtimit shkencor të cituar më lart, mjafton të vëmë në spikamë, Át Donat Kurtin dhe Át Bernardin Palajn me "Visaret e Kombit", Át Leonardo De Martinon me tekstin e parë dramatik shqip "Natë Kërshëndellash", Át Shtjefën Gjeçovin me "Kanunin e Lekë Dukagjinit", Francesco Maria da Lecce me "Dizionario italiano-albanese në vitin 1702 dhe "Ossevazioni grammaticali nella lingua albanese" në vitin 1716, kolosin Át Gjergj Fishta me kontributet e tij në letërsi, në përkthim, në publiçistikë etj, Át Marin Sirdanin si historian, gjuhëtarin Át Justin Rrota, filozofin Át Gjon Shllaku, Át Zef Pllumin si përkujtues i veprave të misionarëve françeskanë etj.

Françeskanët, si vijuesit e veprës së autorëve të vjetër, ishin më të interesuarit për botimin e njohjen e teksteve të tyre nga lexuesi bashkëkohas, edhe në funksion të studimit të gjuhës së tyre për të nxjerrë përfundime shkencërisht të sakta për gjuhën e përbashkët letare.[27]

I gjithë ky arsenal kulture, ky piedestal i identitetit kombëtar e fetar, ky kontribut i papërsëritshëmshëm në të gjitha kontekstet e tjera historike , shoqërore e kulturore shqiptare, i ra ndesh interesave të klasës politike, që mori pushtetin dhe instaloi sistemin e saj.

Komunizmi iu vërsul si përbindësh elitës së besimit kristian.[28]

Kështu, Át Donat Kurti, si vëllezërit e tjerë të të njëjtit fat, u shpërblye me burg dhe torturë. Fjalët e tij, para trupit gjykues, tingëllojnë edhe sot një akuzë e fortë, por njëherazi dëshmojnë kumtin e fratit të doktoruar, që ishte betuar për varfëri, dashuri e përkushtim ndaj vendit e grigjës:

Prej jush unë nuk pres kurrnji të mirë, edhe pse deri më sot nuk i kam bâ

---

26 Marku, Kastriot. "Shkolla letrare françeskane e Shkodrës" , Shkodër, Hylli i Dritës nr.4, 2011, f.41-42

27 Omari, Anila,"Kontributi i 'Hyllit të Dritës' në studimet filolologjike shqiptare", Shkodër, Hylli i Dritës, Numër jubilar me rastin e 100-vjetorit të themelimit, 2013, f.67

28 Pllumi, Át Zef. "Si e martirizoi komunizmi elitën e besimit Kristian", Panorama, 25 korrik 2006, f.16

kurrkuj keq. Mue nuk më bân përshtypje as vdekja as burgu, por më vjen keq se më mbeti puna pergjysë. Të gjithë jetën teme, të gjithë talentin tem e kam shkrî vetëm për me i sherbye popullit shqiptar, pa marrë parasyshë sakrificat e privacjonet.[29]

Mjaf kontribute apostolike- baritore, shkencore e kulturore personale, punime, dorëshkrime të çmuara u asgjësuan, veç disa fatlumëve, që përmes sakrificave, arritën të ruhen nga vetë fretërit dhe individë të caktuar, si edhe veproi Mark Hiluku nga Hajmeli, me 37 veprat e Át Donart Kurtit. Ndërkohë, presin ende në Arkivin Qendror Shtetëror punën e studiuesve dhe filologëve, vepra e kontribute të tjera të freterve françeskanë. Pas "harresës" të gjatë të kontributit të Provincës Françeskane dhe shkollës letare të saj, disa vite pas rënies së komunizmit u rigjallërua dhe rikujtua aktiviteti, misioni dhe pasioni i fretërve. Edhe Biblioteka Françeskane u rithemelua, falë kontributit të Provincës Françeskane sot e dashamirësve e përkujtuesve e dëshmitarëve të ferrit që përjetuan martirët e kleri katolik në përgjithësi. Si rezultat, ekzemplarë e dokumente të rralla e të çmueshme të fretërve, janë artefakte e dëshmi, pos ndihmesës së madhe edhe sot në studimin e fushave të gjuhësisë diakronike dhe albanologjisë historike në përgjithësi.

Këto të dhëna, tashmë të njohura, i risollëm në vëmendje, pasi kanë shërbyer për ne si shtysë për hulumtime drejt veprave të panjohura e të pabotuara.

Qershor, 2018

BIBLIOGRAFI

1. Kurti, Át Donat, *Provinça Françeskane Shqiptare*, Shkodër, Botime Françeskane, 2003
2. Omari, Anila. "Kontributi i 'Hyllit të Dritës' në studimet filologjike shqiptare", Hylli i Dritës, Numër jubilar më rastin e 100-vjetorit të themelimit, Shkodër.2013
3. Marku, Kastriot. "Shkolla letrare françeskane e Shkodrës" , Shkodër, Hylli i Dritës nr.4, 2011
4. Pllumi, Át Zef. "Si e martirizoi komunizmi elitën e besimit Kristian", Panorama, 25 korrik 2006
5. Pllumi, Át Zef në: Klosi, Ardian. *Quo vadis Shqipëri*. Antologji autorësh, Tiranë München Botime Albania,1993

29 Pllumi, Át Zef në: Klosi, Ardian. *Quo vadis Shqipëri*. Antologji autorësh, Tiranë München Botime Albania,1993, f.247

Sadik PELINKU

TYRBJA E FANIT NË ULQIN - DËSHMITË HISTORIKE

Shenjtorët (në Islam evlijat) janë të elaboruar në tërë historinë konfeksionale që nga Vedat, Torah, Bibla deri te Kur'ani.

Në të gjithë besimet monotoiste qysh nga Abrahami (Ibrahimi a.s.) kjo dukuri gëzon respekt dhe është element i domosdoshëm i arritjes së harmonisë trupore dhe shpirtërore me krijuesin, krijesat e tija dhe me natyrën.

Çuditërisht në islam zoton një dozë animoziteti konstant ndaj njerëzve që duke flijuar EGON arrijnë grada të larta spirituale të cilat i njofton dhe i shijon koha, hapësira dhe njerëzit, sipas meritave.

Kur përmenden trashigimtarët e Budës – lamat etj., te Hebrenjët, rabinët të cilët afirmojnë spiritualitetin hebreik përmes Kaballës – mistika hebreje (do t'i ceki disa; Abraham Kohen Herera dhe Sabatai Zwi etj.) kujtimet e pasusëve dhe besimtarëve në përgjithësi për të cilët janë plotë respekt dhe dashuri.

Duke kujtuar entuziazmin shpirtëror të krishterëve ndaj Shën Kollit (San Nikolla), të cilët falë qëndrimit disa ditor të trupit të këtij shenjtorit gjatë udhës për në Bari u ndërtua kisha në Shën Koll. Kjo kishë sot gëzon respektin e të gjithë konfeksioneve.

Shna Ndou (San Antun) në Laç dhe Braticë janë vende të pelegrinazhit masovik si dhe Sveti Vasilije Ostroshki në mes të Nikshiqit dhe Danillovgradit në Mal të Zi.

Të gjithë këto personazhe shenjtërimin e treguan edhe e tregojnë vazhdimisht me ndodhje metafizike për të cilat gjenden përgjigjet në të gjitha librat e shenjta.

Pasi që tema e këtij eseji janë dy njerëz të veçantë të qytetit tonë që pushojnë në Tyrben FANI në Ranë – Plazhi i vogël – Ulqin, do të përqendrohem pjesërisht në fenomelogjinë e sufizmit – mistikës islame në hapësirat e Ballkanit dhe natyrisht në Ulqin.



Sufizmi – mistika islame është komponenta e brendshme e sistemuar me temele të islamit.

Dijetari i famshëm Sheih Muhamed Ozak mistikën si fenomen e lidh me Adamin (Hazreti Adem) dhe si e tillë praktikohet gjat tërë historisë së besimeve monotoiste.

Sufit luajnë rolin kyç me shtrirjen e islamit si në Europë ashtu dhe në Ballkan.

Si shembull do të cek misionarin Muhamed Çishti cili ndikoi në shtrirjen në Gadishullin Indian dhe më gjërë në Azi.

Sipas hadithologut të famshëm Muhamed Taip Okiq islami u infiltru në Ballkan në mënyrë të qetë në shekullin XI përmes misionarëve sufi (pra mbi 200 vite para ardhjes së osmanëve) të cilët me sjellje modeste dhe tolerancë ishin atraktiv për njohjen e popullit autokton me islamin. Ata ndërtonin ZAWI – faltore modeste të cilat siguronin strehim dhe ushqim nevojtarëve dhe udhëtarëve.

Ulqini me veçoritë natyrore do të ketë qenë tërheqës dhe për këta misionarë.

Butësia, mikpritja dhe toleranca për dallime, klima dhe kushte të volitshme natyrore dhe ekonomike ishin tërheqës për jetë në këtë hapësirë dhe veprimtari ekonomike, sociale dhe shpirtërore.

Burimet flasin për faltoren e parë (ZAWI) në vendin e objektit turistik të tanishëm Hollegro.

Xhamia e Detarëve mund të ketë ekzistuar për të siguruar kërkesat fetare të tregtarëve.

"IN MEDIAS RES"

Kush ishin këto dy vëllezër:

Kam zhvilluar disa herë biseda me të moshuaren e fisit të tyrbedarëve (kujdestarët e tyrbes) PEKU, me Haxhi Hafize Peku r.a.

Tregimet e saja janë përputhur me burimet e disponuara dhe trashëgiminë gojore që bëhet fjalë për SHEIH HYSEIN dhe SHEIH LUTFIUN.

Si përcjellin trashigimitë gojore e këtyre sufive shenjtëria – evlialleku është dëshmuar vazhdimisht.

Detarët ulqinakë duke transportuar vaj ullirit i kapi stuhia në det.

Pas lutjeve krijuesit dhe për shpirtë të këtyre vëllezërve të cilëve ia banë "kurban" një fuçi vaji, deti u paqësua dhe ato mbërritën shëndosh në shtëpia.

Siç transmetohet në mëngjes u gjet fuçia e vajit para tyrbes.

Një ish Kryetari i Komunës së Ulqinit, edhe pse komunist i përbetuar më ka biseduar se një aksident fatal i një funksionari ulqinak i parapriu ***vërejtja*** në gjumë e përjetuar nga i ndjeri që t'i shmanget qëllimeve destruktive ndaj tyrbes.

Poashtu Haxhi Hafize Peku më ka treguar se në përcjelljen e xhenazes së tyrbadares ----- Peku, është vërejtuar nga disa persona një dukuri (keramet) i veçantë.

Shembja e objektit të ndërtuar në afërsi të tyrbes, përpjekja për ta

djegur dhe pasojat që pësuan tentuesit, tregojnë se ulqinakët e të gjitha konfesioneve kanë respekt të veçantë për këtë objekt kulti.

Shpesh shkruhej nga disa autor si dr Ruzhdi Ushaku, Ismet Karamanaga etj.: "Legjenda thotë se këto dy njerëz u flijuan duke mbrojtur Ulqinin nga Venedikasit 1714-1718 (Mletaçka Republika) dhe kur iu prenë kokat ata me koka nën sjetull i banë disa hapa deri në vend ku u ndërtua tyrbja.

Duke hulumtuar mbi këtë ngjarje, falë kontributit të intelektualit shumë dimensional z. Gazmend Çitaku arrita t'i siguroj disa prova të cilat Legjendën e vërtetojnë me dëshmi historike (Ditari i luftës i komandantit të flotës venedikase, flotë kjo e cila sulmoi Ulqinin, Marshall Shulenburg).

Për t'iu shmangur ngjyrosjes subjektive, vendosa që pjesë e këtij eseji të jetë ditari në fjalë nga viti 1718.





Miloš I. MILOSEVIĆ

Pokušaj mletačkog osvajanja Ulcinja 1718. godine

Mletačka flota koja je 21. jula krenula za Ulcinj imala je, prema Šulemburgovom izvještaju, preko 200 većih i manjih plovnih jedinica, sa ukupno 11000 ljudi, svakako podrazumijevajući i posadu brodova. To je, dakle, bio pothvat daleko veći i organizovaniji od onog izvedenog na Bar, od prije skoro jedne godine (16-22. oktobra 1717), koji nije uspio zbog malih snaga mletačke vojske i dolaska skadarskog paše u pomoć gradu.[14])

II

Kako ćemo vidjeti, u tih dvadeset dana iskrcavanja trupa, opsade, okršaja i borbi oko ulcinjske tvrđave i povlačenja mletačke vojske (23. jula — 11. avgusta 1718), bilo je nekoliko faza i neobičnih, dramatičnih obrta situacije.

Prva pripremna faza iskrcavanja mletačkih trupa i artiljerije i zauzimanja pozicija, relativno neometana od turske vojske, trajala je od dolaska brodovlja 23. do 28. jula.

Od 29. VII do 1. VIII otpočeli su, u drugoj fazi, jači turski napadi iz dalje okoline, kao i intenzivnija odbrana iz samog grada, što kulminira 1. avgusta. Taj ponedjeljak (1. VIII) bio je svakako najneobičniji dan vojnog pothvata, pun najraznovrsnijih iznenađenja. S jedne strane jača turski pritisak i vode se sve oštrije borbe oko grada. S druge strane baterije su uspjele da otvore brešu na gradskim zidinama, tako da je osvajanje grada bilo na dohvatu ruke. Ali opet tog istoga dana oko 19 sati stiže iz Venecije hitni nalog da se obustave sve akcije.

U trećoj fazi početka povlačenja (od 2. do 7. avgusta), poslije nekoliko kontakata sa predstavnicima turskog štaba i načelnog dogovora o nenapadanju, dolazi do teške oluje i oštećivanja manjeg brodovlja i stalnog pritiska i napada Turaka.

Najzad četvrtu fazu (9-11. VIII) karakterišu oštri napadi turske vojske i oštre borbe, uz naporno povlačenje trupa do obale i ozbiljne žrtve. Uz to je došlo i kurtoazno izvinjenje turskih komandanata da su turski odredi napadali samovoljno, na inicijativu po-

---

[13]) U okviru svojih dinamičkih ofanzivnih planova, Schulemburg je pisao još 1716. »...sarebbe assai opportuno l'occupare di nuovo Santa Maura, sacheggiare le Rive del Golfo d'Arte e queste dell'Epiro e scorgendo apertura si potrebbe tentare di sorprendere o Durazzo o Dulcigno nell'Albania. Questa riguardevole parte di Stato, io la credo di somma importanza per quello di Vostrà Serenità. S'unisce alle Bocche di Cattaro et a Corfù. Si espurgarebbe il Golfo dai rapaci corsari che l'infestano. Dominerebbe nazioni bellicose, ne poco s'accrescerebbe il commercio di Vostra Serenità. A. S. V. Archivii proprii. B 48—51.

[14]) Dr Gligor Stanojević, Crna Gora u doba vladike Danila, Cetinje 1955, str. 133—139; Miloš Milošević, Oko pokušaja osvajanja Bara i Ulcinja 1717. i 1718. godine, Istorijski zapisi, 1960/4, str. 789.

jedinih novosakupljenih turskih trupa, a bez znanja i odobrenja komande.

Slijedeći tok operacija izlažemo na osnovu sačuvanih dnevnika, uz neke važnije dopune iz drugih navedenih arhivskih izvora.

Subota, 23. jula 1718.

Prije pokreta trupa održane su u Budvi zajedničke molitve cjelokupne mletačke vojske za uspjeh vojnog pohoda i procesija. Brodovi sa opsadnim trupama koristili su osrednje jaki i povoljni sjeveroistočnjak i usidrili se kod pješčane obale, iza rta Djeran, na tri milje jugoistočno od Ulcinja.

Nedjelja, 24. jula.

Pošto nigdje nije bilo otpora od strane Turaka, maršal Šulemburg je u 12 sati naredio najprije iskrcavanje novosakupljenih domaćih trupa,[11]) zajedno sa redovitim domaćim trupama. Tokom osam sati iskrcano je dvije trećine trupa i ove su već otvorile vatru na neprijateljske položaje. Nove domaće trupe su zauzele položaj iznad rta Đeran, a za njima su pristigle i redovite domaće trupe. Kako se između mjesta iskrcavanja i utvrđenog grada nalazilo otvoreno naselje, vojska ga je uspješno i bez većih napora zauzela. Sada je i armija sa brodova mogla da nastupa. Redovne trupe su marširale preko ravnice, sve do istočnog dijela naseljenog predgrađa, dok su se nove domaće trupe uputile prema zapadnom dijelu predgrađa, suzbijajući izvjesne otpore. Tako su već drugog dana branioci grada bili zatvoreni u zidinama. Vjerovalo se da će otpori iz predgrađa biti daleko jači, međutim ova su brzo napuštena, pa se čak u kućama nalazila i hrana.

Ponedjeljak, 25. jula.

Maršal Šulemburg je ispitivao položaj utvrđenog Ulcinja i uputio redovite trupe na brežuljke oko grada, naredivši inženjerima da odrede položaje rovova.

Utorak, 26. jula.

Pošto je maršal uočio karakter ovih vojnički teških položaja, zbog šumovitog terena sa dosta brežuljaka i dolina, na opasnim tačkama prema rovovima pojačana je dvostruka linija vojnika, a za najudaljenije straže upućene su nove domaće trupe. I prebacivanje

[11]) U originalu »Coletizie«, što inače u mletačkoj vojnoj terminologiji znači trupe sakupljene na brzinu i sa malo reda. (Giuseppe Boerio, Dizionario del dialetto Veneziano, Venezia 1867). Da se radi o domaćim vojnim snagama znamo i po tome što je generalni providur dobio nalog da sakuplja čete i po čestoj vezi »Truppe Coletizie con Nazionali regolati«. Te čete ćemo nazivati: Nove domaće trupe.

hrane u dugim borbenim linijama bilo je teško i zamorno, pa su zato i sa desne i sa lijeve strane grada podignuti depoziti za zalihe živežnih namirnica i municije.

Pod istim ovim datumom izradio je maršal Šulemburg jedan »Opis utvrđenog grada Ulcinja sa neophodnim zapažanjima«.[16]) On je zanimljiv i treba se zadržati na njemu, iako se mora odmah istaći da je sam maršal kasnije odustao od nekih tu navedenih odluka, koje je bio donio poslije prvih ispitivanja terena. Tako je on bio stekao utisak da se grad može efikasno tući jedino sa zapadne strane, sa nadom da se otvore breše. Međutim, kako ćemo kasnije vidjeti iz dnevnika bitke i geografske karte, glavne artiljerijske baterije su postavljene sa istočne strane i tu su otvorene breše na zidinama. Na tu stranu je, uostalom, bilo daleko bliže i lakše dovući artiljeriju sa rta Đeran.

U spomenutom Opisu maršal je naročito istaknuo slijedeće važnije detalje: Ulcinj je podignut na živoj stijeni u moru i samo je malim sjevernim dijelom okrenut kopnu, dok je skoro sve ostalo okruženo morem. Ali i taj sjeverni dio ima visoke zidine i nasipe, a možda je isto zidan na stijeni, pa bi ga bilo teško rušiti topovima. I južna strana, prema moru, sa kulama i debelim zidinama, ne može se sa uspjehom napadati. Istočna strana zidina podignuta je na živoj stijeni, visine od 100-150 stopa, isto se ne može uspješno napadati i minirati. Na zapadnoj strani su slične stijene sa naizmjeničnim zidinama i zgradama. Iako je i tu dobra odbrana, ipak bi se sa te strane gdje su gradska vrata pa prema kuli, mogao naći dio zidina koji bi se mogao tući sa nadom da se otvori breša. Istina je da su na tom predjelu, poslije ranijih napada na grad, vršena neka pojačanja sa svodovima, nasipom i parapetom. Ali jedino sa te strane postoji bočni prostor, na kom se može postaviti top za napad. Inače taj utvrđeni grad nema opkopa nego samo sa zapadne strane. Od izlaza grad ima dvoja vrata. Sa morske strane su bili otpočeli neki radovi oko utvrđivanja, ali još nisu dovršeni. Grad je malo podignut na uzvišici, pa je neophodno iskopati rovove. Okolni teren je kamenit, a ne mekana zemlja, pa su posljedice topovskih hitaca teže po vojsku koja drži opsadu. Zgodne drvene građe za »fašine« nema pri ruci. Voda je u okolici grada veoma oskudna i ima svega tri česme, pa ove nisu dovoljne ni za vojsku ni za konje. I turska vojska je u istoj nestašici, pa dobavlja vodu iz daljine. Kako se mletačke trupe nalaze po uzvišicama brežuljkastog terena, a dva krila su odvojena jednom velikom udolinom, veoma je otežano prenošenje vode, hrane i ostalog po malenim puteljcima usječenim u stijenu. Posebno je teško prebacivanje topova.

U cjelini mletačka vojska je, po mišljenju maršala, bila u povoljnijem položaju, ali bi bio opasan svaki pokušaj napada na okolnu vojsku, kao i spajanje dva krila, ili povlačenje. Opasnost je naročito

[16]) Description de la Place..., vidjeti bilj. 6.

za zaštitnicu. Potreba podizanja magazina hrane pravda se opasnošću da dođe do oskudice u hrani i vinu za vojsku. Posebno je opasno da flota ne ostane bez vode.

Vojnici moraju biti stalno na oružju, pa su prisiljeni na velike napore i oskudicu sa ishranom. Zato je prisutna i opasnost masovnijeg dezertiranja. Međutim najveća opasnost za flotu je od oluje. Ipak je maršal u tom trenutku bio uvjeren da se grad može zauzeti za 6-8 dana.

Srijeda, 27. jula.

Otpočelo se sa iskrcavanjem poljskih topova i pripremanjem terena, od strane jedne specijalizovane jedinice (»guastadori«), za formiranje baterije kod gradskog brodogradilišta sa 4 topa kalibra od 50,[16a]) dva od 20 i 4 mužara od 500. Cilj je bio da se otvore breše na istočnim zidinama što graniče morem i spomenutim brodogradilištem. Istog dana uveče još je iskrcano nekoliko topova i mužara. Sve mletačke galije su se pojavile sa istočne strane grada da osiguraju iskrcavanje, ali su bile jako ometane neprijateljskom artiljerijom. U noći između 27. i 28. jula postavljene su dvije važne baterije. Maršal je namjeravao da sa 4000 ljudi redovnih trupa i 2000 Dalmatinaca iznenadno napadne tursku vojsku, ali kako su neki dezerteri o tome obavijestili Turke, od toga se odustalo.

Četvrtak, 28. jula

Kada su se trupe rasporedile i sredile prilike, iskrcao se generalni providur sa dva vanredna providura i drugim i smjestio se između trupa iz Splita i Perasta,[17]) na 4 milje sjeveroistočno od grada.

Petak, 29. jula.

Od ovog dana otpočinju česti turski napadi u cilju razbijanja opsadne linije. Predveče, na istom već navedenom položaju za bateriju, iskrcana su još 4 topa sa municijom. Tada su svi mletački topovi počeli tući Ulcinj, ali sa oskudnim efektom, jer je grad efikasno branio jedan mužar od 200.

Subota, 30. jula.

Nastavilo se sa postavljanjem baterije jer je pucanje mužara i dva topa iz grada za nekoliko sati bilo smanjeno. Tokom noći su topovski meci od 30 i 20 doprli sve do glavnog vojnog stana.

[16a]) U dokumentu su kalibri topova i mužara označeni samo brojevima bez ikakve druge oznake. Vjerovatno je da se ovdje radi o težini zrna u mletačkim librama (476 gr).

[17]) »...et accampativisi all'intorno li Spalatini e Perastini...«.

Nedjelja, 31. jula.

Sve su se više pojačavali šančevi sa zapadne strane grada, gdje su se nalazili pukovnici Spingarol, Soppe i Sisgoreo, zajedno sa redovnim domaćim trupama. Oni su predstavljali zaštitnicu pukovnika Combato, Macedonia, Margnani i Fanfogna. Sa iste ove zapadne strane nalazili su se i dva regimenta (Ottingh i Buratic), koji su se utvrđivali za protivtežu brda Kruti, gdje se isto nalazio neprijatelj. Pukovnik Medin je imao zadatak da spriječi eventualne pokušaje juriša iz grada. Uveče je otpočelo djelovanje 4 topa od 50, ali su iz grada snažno uzvraćali vatrom iz svog mužara.

Ponedjeljak, 1. avgusta.

Toga dana dolazi zaista do neočekivanih promjena. Već ujutro turska vojska napada sa pošumljenih brežuljaka, gdje je bila zaštićena. Sudar vojski bio je snažan, naročito sa istočne strane, gdje su sa jedne uzvišice turski vojnici bili podržavani bjesomučnom pucnjavom karabina. Tu su se našle i sve glavne ličnosti komandnog mletačkog kadra. Našavši se u teškoćama, preko pukovnika Albertija pozvani su odredi Splićana i Peraštana, sa njihovim kapetanima. Tada su Turci odustali od dalje borbe. U rovovima je ostalo oko 60 mrtvih. Za razliku od ovih podataka iz dnevnika, maršal Šulemburg daje i neke cifre, tvrdeći da je mletačke položaje napalo 7-8000 turskih vojnika i da je bitka trajala pet sati. Dok nikako ne spominje Splićane i Peraštane, maršal tvrdi da je poslao 100 grenadira iz svog bataljona, poslije čega su se Turci povukli.

Uporedo sa tim borbama pojačalo se djelovanje mletačkih topova koji su ciljali na gusto naseljeni dio grada. Poslije tri dana jake vatre, došlo se konačno do cilja. U gradu je vladalo teško, upravo panično stanje, a na zidinama je otvorena breša »od dva koračaja zida«. Kroz otvor su ozdo prolazili meci, oštećujući fasade zgrada, ubijajući i ranjavajući, tako da je bilo nemoguće tu podizati neke barikade. U planu je bilo da se istovremeno napadne i krajnji istočni dio zidina prema morskoj strani, i to prekrivenim čamcima. Ta diverzija, ako i ne bi uspjela, podijelila bi snage branilaca. Ali do nje nije došlo. U datoj situaciji se smatralo da grad treba da padne za 5-6 dana. Šulemburg u zvaničnom izvještaju opisuje da su, poslije početka rušenja zidina, deprimirani branioci prekinuli vatru sa svojih oštećenih artiljerijskih položaja i, u oskudici vode, prepustili se sudbini, sa jedinom nadom u pomoć okolnih turskih snaga.[18]) Jer, kako se smatralo, turski vrhovni komandant trupa (serasker) ne bi mogao pustiti da pred njegovim očima padne grad, a da ništa ne preduzme.

[18]) »Li difensori non facevano più fuoco e disanimati stavano attendendo il loro destino tra la speranza dei soccorsi e la disperazione. Le poche difese della Piazza eran' tutte levate, smontate le artiglierie e smantellati li parapetti. Provavano i difensori estrema penuria d'acqua«. Isto, B 5—8.

U toj kulminacionoj tački cijele vojne akcije, kada je Ulcinj svakako bio pred padom, uveče oko 17h (ili po Sulemburgu oko 22h) iz Venecije stiže sa felukom naređenje Senata, upućeno glavnoj komandi, da se obustave neprijateljstva. I to je odmah izvršeno, izazivajući, navodno, zaprepaštenje kod branioca grada, koji još nisu znali za motive takve nagle promjene. Poslije će Ulcinjani i okolna turska vojska iskoristiti taj obrt situacije da sami uzmu inicijativu, pa će ih Sulemburg nazvati »perfidnim«. Preko Peraštana Turci su i u gradu i oko njega obaviješteni o primljenom naređenju. Noć je protekla mirno.

Utorak, 2. avgusta.

Nešto kasnije ujutro, stigao je do mletačkih rovova jedan aga, kao predstavnik seraskera. On je došao da u ime turskih komandanata u mletačkom glavnom stanu javi da su primili obavještenje o zaključenom miru. Razgovor je bio tajni, preko prevodioca. Prema Sulemburgovom izvještaju na francuskom, seresker još nije bio zvanično obaviješten o Požarevačkom miru, ali je bio spreman da primi mletačkog predstavnika, pa da se zajedno odluči o daljim koracima. Utvrđeno je da se poslije obustave vatre postave straže i time spriječe eventualni dalji sukobi.

Srijeda, 3. avgusta.

Za mletačkog predstavnika u turskom logoru određen je Rizzo (Rico) sa oficirima i oni su otišli u turski logor.. Inače se otpočelo sa uništavanjem baterija i skidanjem topova da ih se vrati na brodove.

Međutim mletački se predstavnici nisu vraćali, a pripremala se oluja, tako da je vojska bila u nedoumici i u izvanredno teškom i opasnom položaju, bez dovoljno hrane i municije. U početku nevremena još i nije bila sva vojska koncentrirana na obali, pa nije mogla ostaviti vodu, hranu, artiljeriju i prtljag sa bojnog polja turskoj vojsci, koja je bila svuda naokolo. Ocijenivši tešku situaciju, turska komanda je zadržala mletačke oficire i počela postavljati zahtijeve, kao da su oni pobjednici, a mletački vojnici da su pogazili mir. Zato su jurnuli na obalu, uništavali neke čamce, koji su se lomili pod udarcima vjetra i mora, odvodeći u ropstvo one koji su nadživjeli brodolom. Borbena gotovost mletačkih vojnika bila je smanjena naređenjem da se ne smije pucati, osim u izuzetnim slučajevima. Sve je to izazivalo sumnju i nemir.

Četvrtak, 4. avgusta.

Oluja je tokom noći izazvala žalosne poslijedice po brodovlje, bilo državnih galija, bilo drugih manjih jedrenjaka. Snažan vjetar je pojačan i tokom četvrtka nastavio da pričinjava štete. Hrana i municija je teško stradala. Prema Sulemburgovom izvještaju na fran-

cuskom, na kopno se bilo nasukalo 6 galija i oko 50 manjih brodova. Turska vojska je bila u neposrednoj blizini, pa je situacija bila još kritičnija. Po Šulemburgu, potopljeno je nekoliko naoružanih i natovarenih brodova. Postavljao se problem ukrcavanja artiljerije, pošto je znatan broj brodovlja bio uništen. Poslije zapada sunca ipak je došlo do smirivanja vjetra. Prema maršalovom izvještaju na francuskom, serasker je vidno promijenio svoj stav prema mletačkim vojnim snagama, kada je vidio oštećenja mletačkog brodovlja od oluje, smatrajući da je cijela flota uništena.

Petak, 5. avgusta.

Iako se more još nije bilo potpuno smirilo, ipak se moglo predveče prići ukrcavanju teškog tereta i pripremanju topova. Ponegdje su Turci izazivali smetnje.

Subota, 6. avgusta.

More se još nije sasvim smirilo, ali je posada sa krajnjim naporima otpočela sa ukrcavanjem teške artiljerije i mužara. Među turskim i mletačkim komandantima izmijenilo se niz pisama, a odnosi su postali prilično nepovjerljivi i napeti. Mlečani su, strahujući od napada, isticali da će o postupcima turske vojske biti obaviještene sve sile potpisnice ugovora o miru. Sa obje trane su bili vraćeni taoci.

Nedjelja, 7. avgusta.

Uz pomoć Malteža na ukrcani su još neki topovi. Toga dana nije bilo smetnji od strane Ulcinjana. Komanda mletačke vojske je prijetila da će, ako se nastavi sa provokacijama, zapaliti okolna sela i galije na skveru. Po drugom izvoru, ipak je bilo neke pucnjave iz grada. Sa svoje strane turska komanda je uputila ultimativnu prijetnju da će ponovno napasti mletačke snage ako tokom slijedećeg dana ne napuste položaje oko Ulcinja.

Ponedjeljak, 8. avgusta.

Tek poslije sedam dana od prvog obavještenja, stigla je vijest iz Venecije o sklapanju mira sa Portom. O tome je obaviještena turska komanda i toga dana se u potpunosti poštovalo primirje.

Utorak, 9. avgusta.

Dok se 8. VIII i dalje mirno prenosilo i ukrcavalo oružje, Ulcinjani su, pozivajući se na svoju ultimativnu prijetnju od 7. VIII otpočeli novi oštar napad, pucajući puškama i topovima na vojsku i brodove, još učestalije nego tokom opsade. To je trajalo sve do noći i bilo je dosta mrtvih i ranjenih. Mletačka komanda se pozivala na ranije dogovore, ali na to Turci nisu htjeli obraćati pažnju. Naro-

Msc. Arjan KALLÇO

TIPARET E NJERIUT TË FUNDIT NË KËNDVËSHTRIMIN E FUKOSË

I. Njeriu – universi i çdo filozofie

1 – Njohja si një proces i mundshëm.

Të gjithë njerëzit priren ndaj diturisë – thotë **Aristoteli**. Dituri do të thotë t'i studiosh të gjitha njohuritë që njerëzimi gjatë jetës së vet ka mundur të krijojë, mbledhë dhe përçojë në shekuj. Nëse një shoqëri pararendëse ka punuar dhe arritur suksese në zhvillimin e tyre, atëherë ka krijuar bazën e duhur të përvojës e cila meriton të jetë në morinë e njohurive fillesë apo vazhdim i dijeve. Kjo do të thotë që një shoqëri solli risi në jetën e vet, duke prekur kufijtë e mundësisë së progresit. Më pas shoqëritë e tjera që erdhën dhe do të vijnë do të ecin më përpara dhe kështu pasurisë së njohurive do u shtohen dije të reja, më të gjera, duke marrë parasysh dialektikën e zhvillimeve të njerëzimit.

Ta studiosh Fukonë do të thotë ta njohësh jetën, veprat dhe gjithë mendimin e tij të shprehur dhe pasqyruar në to, këndvështrimin mbi botën, me të gjitha natyrat që merr trajtimi i çështjeve dhe në veçanti atë që është forma dhe thelbi i jetës – njeriu i kohës dhe epokës në të cilën jetoi dhe njohu filozofi.

Natyra dhe cilësitë e njeriut (njeriu dhe evolucioni i tij janë koncepte pa të cilat filozofia nuk do të kishte asnjë kuptim) në procesin e zhvillimit të tij ndryshojnë që nga njeriu i parë grek i lashtësisë, deri tek njeriu i sotëm modern i një periudhe që shumë dituri po priren ta quajnë njeriu i postmodernizmit.

Njeriu është qendra e universit dhe rreth tij rrotullohet, në kahe dhe forma të transformueshme, e gjithë bota që na rrethon. Njeriu është subjekti dhe objekti, pa të vetë bota nuk do të kishte kuptim, ashtu si vetë koncepti filozofik i kohës që jashtë tij nuk do të kishte gjasa që të përcaktohej dhe interpretohej. **Sofokliu** shprehet se ka shumë gjëra të admirueshme, por asnjë më i admirueshëm se njeriu. Pra, nëse do ta

shohim botën përqark nesh, do të dallonim natyrën dhe njeriun në bashkëveprimin e dialogut mes tyre se njeriu vepron mbi natyrën, si dhe natyra mbi njeriun. Natyra nga ana e vet ka ciklet e veta dhe mbetet e tillë në një transformim të pakushtëzuar nga njeriu, ndërsa transformuesi në kohëzgjatjen e jetës së vet, d.m.th të kohës, tepër e shkurtër në ballafaqim me natyrën, vrojtohet dhe studiohet vetëm brenda shoqërisë.
Dëshira është thelb i njeriut – thotë **Spinoza** dhe kjo dëshirë duhet parë si mundësi, jo vetëm për të hedhur hipoteza mbi të vërtetën, por edhe për t'i zbuluar ato, të vrojtuara këto gjithmonë në optikën relativiste të termit. Dëshira është mundësi dhe të dëshirosh do të thotë të përpiqesh që t'u japësh udhë ideve e më pas t'i shohësh të gjitha mundësitë që krijohen për t'u dhënë përgjigje, t'i studiosh dhe të nxjerrësh konkluzionet e duhura. Pengesat në këtë rrugë duhen parë jo si një dështim, por si hapa të padiskutura drejt njohjes. Nëse dëshirojmë të hyjmë në konceptin e njohjes, mundësi ka nëse duam dhe një rrugë gjendet gjithmonë. Siç thekson **Lesona** gjithçka varet nga forca e vullnetit që është në gjendje të mposhtë çdo pengesë.

2 – Dialektika e pohim - mohimit

Dialektika në përcaktimin e vet filozofik duhet të qaset si një përshkrim i zhvillimit real, pasi siç dihet ajo është një ndërveprim midis dy tezave apo parimeve të kundërta. Të pohosh diçka të re detyrimisht duhet të mohosh, të lësh pas (mohosh) histori dhe arritje, me synimin për t'i dhënë impuls të ri zhvillimit. Në këtë konceptim të zhvillimit, jemi të detyruar ta mohojmë të vjetrën, natyrisht kjo nuk nënkupton gjithçka dhe në mënyrë radikale. Marrëdhënia që krijohet mes tyre mes tyre është një luftë, por njëkohësisht dhe unitet i të kundërtave. Një vështrim i tillë na shtyn drejt idesë se duhet ta mohojmë modernizmin, si diçka e vjetëruar dhe që e kreu misionin e vet dhe të pohojmë të renë, që ka lindur dhe po zhvillohet, pra postmodernizmin. Në realitet kjo nuk do të thotë braktisje e së shkuarës modernes, përkundrazi presupozon mbështetje të fortë tek ajo. Ndryshimi sjell ndryshime, duke e konfirmuar pohimin se gjithçka ndryshon, por jo ligji i ndryshimit. Postulati, se asgjë nuk fillon nga hiçi, por është e lidhur pazgjidhmësisht me vazhdimësinë, është shprehja më e vërtetë e procesit të zhvillimit që detyrimisht çon në evolucion. Engelsi pohon se në dialektikë të mohosh nuk do të thotë të thuash jo, apo të deklarosh që një gjë nuk qëndron, apo dhe ta shkatërrosh, "omnis determinatio est negation" – mohimi duhet të jetë i vendosur e më pas shton se çdo gjë e ka një mënyrë të

veçantë mohimi kur rezulton një zhvillim dhe kjo është e vlefshme edhe për idetë dhe konceptet.

II. Epoka postmoderniste

1- A jemi të sigurtë që sot po jetojmë në një epokë postmodernizmi?

Të dyshosh është njerëzore, por të këmbëngulësh gjithmonë tek dyshimi do të thotë që të mos i lejosh hapësira mendimit që të bësh hapa para dh eta shikosh realitetin në sy. Por realiteti është në sytë e atij që shikon, kështu që këndvështrimi i tij bëhet objekt gjykimi dhe interpretimi filozofik. Të dyshosh gjithmonë e për gjithçka ndoshta nuk krijon ndjesi të mira, por e kundërta e saj, nëse triumfon pa kundërshti dhe diskutime, shndërrohet në qesharake. Filozofia si shkencë detyrimisht mbështetet tek dyshimi, pasi e konsideron parimin e gjithçkaje, por edhe metodën më përsosur për të filozofuar. Sipas **Platonit dhe Aristotelit** dyshimi është në themel të diturisë, pra dhe të vetë filozofisë.

Nëse dyshojmë për të, për ekzistencën e postmodernizmit, atëherë duhet thënë se dhe vetë Filozofia postmoderne nuk është veçse një dyshim, pra dhe vetë njeriu. Duhet të mos harrojmë se janë debatet ato që e bëjnë shkencën, në këtë rast edhe vetë filozofinë, interesante, medituese, reflektuese dhe deduktuese. Nëse i referohemi mohimit, ndoshta më të madh të historisë së njerëzimit, për ta pohuar të renë, duhet patjetër të ndalemi tek ndarja më e qartë dhe dalluese në dy kampe, pro ose kundër Iluminizmit. Kjo ndarje epokale mes të kundërtave duket se konsiderohet prej shumë mendimtarëve si guri i provës, por në të njëjtën kohë edhe fusha ku përplasen mendime të ndryshme që i shtyn edhe filozofët të debatojnë pafundësisht mes tyre, gati një luftë të ashpër, herë duke i pranuar dhe herë jo pozicionet reciproke. Dy nuk është numëri i përsosur në një dominim egoizmi njerëzor që në hierarkinë e rendit, është gjithmonë bazuar tek uniku, shpesh edhe me fuqinë e pushtetit, ose rrugëve të tjera.

2. Si lindi ideja e postmodernizmit?

Në luftën dhe në përballjen e ideve mes dy kampeve, i pari që hodhi idenë për postmodernizmin, shumë mendimtarë arrijnë në një emërues të përbashkët se ideja nuk lindi nga shkencat, por çuditërisht nga arti. Një ndër artistët e famshëm të modernizmit, piktori dhe skulptori francez **Jean Dubuffet** (1901 – 1985) mund të konsidrohet postmodern ante litteram. Ai shkruan se kultura jonë është një veshje që nuk i përshtatet

momentit aktual…[…]…dhe një ndryshim intelektual më rëndësi të madhe dhe orientues po ndodh në art, si në të gjitha fushat e mundshme. Ky mendim i tij mbështetet në katër pika themelore të cilat janë:
1) Largimi nga antropomorfizmi perëndimor.
2) Largimi nga kryesimi i arsyes dhe logjikës.
3) Qëllimi i artit nuk është të krijojë vepra të dukshme, por të dyshimta: kjo polisemi duhet futur me vetëdije.
4) Arti nuk duhet të prodhojë vetëm sende të bukura, me forma dhe ngjyra të vendosura artistikisht që t'i kënaqin sytë, por të krijojnë objekte me magji të pasur dhe të thellë, që të çojnë tek shpirti.
Ndër mendimet e piktorit do të citonim : "Filozofia akademike nuk është shumë interesante, sepse nuk përmban impulse jetësore. A mundet që filozofia të jetë e tillë dhe të mbetet e pandryshuar? A mund të lindte një filozofi tjetër, plotësisht e aftë të sillte drejtësi në përmbajtjet e nënkuptuara të artit modern dhe në gjendje t'i formulonte qartësisht?" Këtë meditim të Dubuffetit do ta plotësoja me mendimin e filozofit gjerman Marks i cili thotë se Filozofët vetëm sa e kanë interpretuar botën në mënyra të ndryshme; por çështja është që tani ta ndryshojnë atë.

III. Filozofia në të cilën lundron Fukoja

1 . Trashëgimia filozofike e Fukosë

Në filozofi si në çdo fushë tjetër të jetës pararendësit në gjithë ecurinë e punës së tyre kanë lënë veprat të cilët konsiderohen si trashëgim për pasardhësit. Në to autori mban qëndrime të caktuara lidhur me mendimin e pararendësve, duke debatuar me ta, duke i kritikuar, por gjithashtu ai hedh e shpjegon mendimin e tij për çështjet e ndryshme. Vepra e tij "Fjalët dhe sendet, një arkeologji e shkencave humane, botuar në vitin 1966 është një studim, ku filozofi nxjerr në pah se edhe njeriu**,** si objekt i dijeve të veçanta, është shpikja më e fundit dhe që zanafillën e vet e ka në shekullin e 19-të. Mendimi i tij ndalet në tre pika të cilat analizojnë :
anën ekonomike të shoqërisë
historinë e natyrës në biologji
gramatikën e përgjithshme në filologji
Në këtë analizë ai thekson se epokat në historinë e tyre karkterizohen nga epistema (ose shkenca) e cila konceptohet si një sistem i paqartë, i pandërgjegjshëm dhe anonim rregullash në të cilën krijohen dhe veprojnë dijet e një epoke. Duke u karakterizuar nga dukuri të tilla,

atëherë na lind e drejta të shprehemi se kalimi nga një epistemë tek tjetra nuk është një proces i vazhdueshëm që qeveriset nga logjika e brendshme e zhvillimit dhe e përsosjes progresive, por që realizohet me hope dhe që ka një natyrë të pashpjegueshme. Kështu Fukoja arrin në konkluzionin se detyrën më të rëndësishme e ka arkeologjisa që duhet të hedhë dritë mbi epistemin e çdo epoke, duke e përcaktuar drejt natyrën e saj. Njeriu sipas tij zë vendin në to si një subjekt i veçantë, i karakterizuar nga koncepte të reja të tre fushave të mësipërme të cilat përkthehen në punë – jetë – gjuhë.

Duke iu referuar Kantit, Fukoja mendon se antropologjia është baza themelore që e ka përcaktuar edhe vetë mendimin filozofik. Kanti – shprehet ai - gjeti tek njeriu burimin e vlerave pozitive dhe përcaktoi tek emancipimi i njeriut mundësinë e kthimit të një mbretërie njerëzore. Kështu filozofia u përgjum në një gjumë të ri, të ndryshëm nga ai dogmatik ku ishte zhytur Kanti dhe që konsiston në faktin se e konsideron njeriun si bazë të njohjes dhe të së vërtetës. Por, duke iu referuar idesë së tij për arkeologjinë, ai vazhdon dhe thotë se ajo na tregon se dhe vetë njeriu është një objekt i përkohshëm, ditor, i lindur në kuadrin e një episteme të saktë që sot po thyhet dhe copëtohet.

Një filozof tjetër të cilit ai i referohet në kënvështrimet e veta është **Niçja** i cili, duke shpallur me zë të lartë vdekjen e Zotit, në fakt nuk bëri gjë tjetër veçse lajmëroi në të njëjtën kohë vdekjen e njeriut, pasi sipas Fukosë njeriu dhe Zoti i përkasin njëri-tjetrit. Nga ky konceptim i këtij raporti mund të nënvizojmë se, duke u bazuar dukshëm edhe tek Fukoja, Niçja na ofroi pikënisjen nga e cila filozofia bashkëkohore mund të fillojë të mendojë.

Fukoja në këtë arsyetim i referohet edhe filozofit gjerman **Haidegerit** dhe në faqet e fundit të veprës së vet pranon faktin se sot është e mundur të mendohet "vetëm brenda zbrazëtisë së njeriut të zhdukur", ku për zbrazëti duhet kuptuar, jo më shumë një mungesë që duhet mbushur, sesa hapja e një hapësire të re brenda së cilës të mendosh. Në Letrën mbi humanizmin që Haidegeri i drejton Sartit në vitin 1947 thotë se në qendër të veprimit të realitetit nuk është njeriu i cili është një përçues i qënies. Sipas Fukosë kjo nënkupton fundin e çdo humanizmi tradicional, të filozofive impenjuese dhe të historicizmit. Më tej ai e shtjellon mendimin e vet, duke e konsideruar historinë si një proces të vazhdueshëm rritjeje dhe njeriun si agjent i ndërgjegjshëm i këtij procesi. Këto për të janë dy anë të së njëjtës medalje dhe që të shtyjnë ta kuptosh revolucionin si ndërgjegjësim, pra si një veprim që ka në

qendrën e vet subjektin.

2 . Tiparet e njeriut "postmodern"

Njeriu modern hyri në krizën e vet që padyshim e quajmë krizë identiteti, pra ky njeri nuk e gjen më veten e vet tek moderni, pasi duket se e ka kapërcyer këtë fazë. Por kjo epokë u shoqërua sigurisht nga rënia e të gjitha ideologjive totalitare në mbarë botën. Njeriu i katërt, njeriu modern, nuk beson më në asgjë dhe ka një ndryshim të madh me njeriun grek, mesjetar dhe illuminist. Kjo do të thotë se ushqehet me një pasiguri të qëndrueshme që fillon nga vitet '900, prandaj e bën të priret drejt një forme të re që të jetë i hapur ndaj çdo besimi dhe përvoje. Njeriu përballë jetës është agnostik, pra nuk ka përgjigje për njohjet dhe të vërtetat dhe e pezullon gjykimin e tij ndaj një problemi të përcaktuar. Por në të njëjtën kohë është dhe skeptik dhe kështu përpiqet të gjejë forma të reja eksperimentimi të vazhdueshme të dëshirave më të reja dhe rafinuara. A ka një kufi ndarës midis njeriut të katërt dhe njeriut të pestë, postmodern? Mendoj se është ende herët që të përcaktohet një kufi dallues midis tyre, pasi njeriu i pestë duket se bashkëjeton përjetësisht me skepticizmin që është vërtet zoti i këtij kufiri. Ndoshta në gjurmët e të katërtit po formohet silueta e të pestit, por që është ende i pastrukturuar, pra i pashkëputur tërësisht prej pararendësit.

Tek njeriu dalëngadalë po fiken ose janë fikur plotësisht kurioziteti i tij i pafajshëm intelektual, tensioni metafizik që e mbante të lidhur me qëndrimin ndaj njohjes, besimi në progresin shkencor të pakufizuar që imagjinatës së tij po i jep përgjigje të vazhdueshme dhe që po e rrudhin atë. Kjo situatë e re solli detyrimisht varfërimin e tij ekzistencial që mund të përmblidhet në varfërim të shumëfishtë. Njeriu pa kuriozitetin, do të ngjajë me një robot që e konsideron veten të huaj ndaj botës, pasi është programuar vetëm për t'iu bindur urdhërave të programimit.

Te njeriu vihet re prirja që të krijojë pika referimi shpirtërore, që të ndihet kështu i mbrojtur ndaj së panjohurës që lidhet me vdekjen. Besimi i tij afrohet tek ato besimet më të përgjithshme, duke u lënë hapësira sekteve më integraliste që siç po e shohim të çojnë në terrorizëm me natyra fetare dhe jofetare. Rreziku më i madh është radikalizmi i një shoqërie e ndikuar shumë edhe nga krizat e gjata ekonomike.

Para së vërtetës ai ndihet i tmerruar, pasi përtej tunelit nuk shikon asnjë dritë rrugëdaljesh. E shkuara, edhe ajo më e afërta, për të është e largët, që nuk lidhet me të, i përket vetëm së shkuarës. Nuk beson tek siguritë e së shkuarës, pasi mendon se kanë prodhuar eksese, prandaj kjo prodhon

tek ai një llojë alergjie për siguritë. Historia duket se nuk është më mësuesja e pagabueshme.
Nuk kujdeset më për shpirtin e vet si në aspektin fetar dhe atë ateist. Liria shpirtërore duket se i jep më shumë qetësi, sesa klishetë e feve dhe besimeve që duken të perënduara. Besimi i fortë fetar për të është një mbeturinë e së shkurës dhe këto i konsideron përralla të cilat nuk duhet t'ua tregojnë më as fëmijëve.
Njeriu postmodern nuk është më person, pra qënie në një shoqëri dhe e zëvendësoi atë me individin, të shkëputur dhe të izoluar nga bota dhe shoqëria. Në konceptimin e vet duket "si monadë" e mbyllur në vetvete që gjithçka ia dedikon idesë që të kënaqë kërkesat e UNI-t. Uni mbretëron brenda arsyes, shpirtit dhe qënies.
Filozofi gjerman Karl Marksi në përcaktimin e primares në jetën e një shoqërie thekson se nuk është ndërgjegjia e njerëzve që e përcakton jetën, por kushtet e jetës së tyre që e përcaktojnë ndërgjegjen e tyre. Njeriu postmodern që është më i sofistikuar, përsëri është skllav i aspektit ekonomik, sepse beson tek mashtrimi se konsumi është qëllimi final dhe që bazohet tek fuqia ekonomike. Mesa duket realizimi në jetë po merr synime të tjera që lidhet me dëshirat të cilat pretendohen si shenjë absolute e lirisë.

Konkluzione

Filozofia në mendimet e Fukosë, jo vetëm që nuk ka vdekur, ashtu si njeriu që nuk e konsideron në qendër të veprimit të realitetit, por na jep premisa që të ecim më tej në debatin e përjetshëm të saj dhe që është qëndrimi ndaj NJERIUT dhe mundësia e tij në njohjen e të vërtetave. Njeriu postmodern ndryshon nga paraardhësit e vet në të gjitha drejtimet dhe duket se ka humbur disa tipare dhe ka fitur disa të tjera, por përsëri është thelbi i shoqërisë, pa të cilin vetë bota në të cilën jetojmë nuk do të kishte kuptim. Kështu që për filozfinë dhe filozofët nuk marrin fund betejat dhe debatet, por ato bëhen më të komplikuara. Fukoja dhe Postmodernizmi na e përcaktojnë njeriun "e ri" si njeriu që gjithmonë e më shumë po varfërohet intelektualisht, shpirtërisht dhe shoqërisht, pra individi "pa fe, pa filozofi, pa histori, viktima të dëshirave dhe jo të nevojës". A do të jetë vallë njeriu i fundit? Po pas tij çfarë do të vijë? I takon filozofisë që të mendësojë dhe prezantojë teori dhe doktrina që kësaj prirjeje t'ia ndryshojë drejtimin.

Bibliografi

Foucault. M., *Le parole e le cose: un'archeologia delle scienze umane* (1966), trad. Emilio Panaitescu, Rizzoli, Milano 1967.
Foucault. M., *L'archeologia del sapere* (1969), trad. Giovanni Bogliolo, Rizzoli, Milano 1971.
Foucault. M., *La volontà di sapere* (1976), trad. Pasquale Pasquino e Giovanna Procacci, Feltrinelli, Milano 1978.
Gagliano. G., *L'intellettuale in rivolta. L'antagonismo politico nelle riflessioni di Michel Foucault…*Rubbettino, Soveria Mannelli 2012.
Veyne. P.,, *Michel Foucault: la storia, il nichilismo e la morale*, trad. Massimiliano Guareschi, Ombre corte, Verona 1998.
Iacomini. M, *Le parole e le immagini: saggio su Michel Foucault*, Quodlibet, Macerata 2008.
Antologia: *l'impazienza della libertà*, a cura di Vincenzo Sorrentino, Feltrinelli, Milano 2005.
Ruini. A., *Michel Foucault. Un ritratto critico*, Clinamen, Firenze 2007.
Cremonesi. L., *Michel Foucault e il mondo antico*, Edizioni ETS, Pisa 2008.
Cotesta. V., *Linguaggio potere individuo: saggio su Michel Foucault*, Dedalo, Bari 1979.
Raccolte, *Il discorso, la storia, la verità*, a cura di Mauro Bertani, Einaudi, Torino 2001.
http://www.ilgiardinodeipensieri.eu/storiafil/erika-1.html
http://www.gianfrancobertagni.it/materiali/filosofiacritica/foucault_alonzo.htm
http://www.materialifoucaultiani.org/it/component/content/article/235-raffaele-ariano--morte-delluomo-e-fine-del-soggetto.html?jjj=1478987400988

Majlinda KURT

SHËNDETI MENDOR – STABILITETI EMOCIONAL

Shëndeti mendor është më shumë se sa mungesë e çrregullimeve mendore. Një shëndet i mirë mendor do të thotë ekuilibrim i mirë mes individit dhe ambientit ku jeton.

Nga mendja nisin shumë çregullime që ndikojnë në mosfunksionimin adekuat të individit. Anomalitë e shëndetit mendor mund të çojnë drejtë problemeve me manifestime të shumta. Çdo llojë çrregullimi ka simptomat dhe mënyrat e veta të manifestimit, dhe vetë diagnostikimi si dhe trajtimi varen nga natyra e problemit.

Sa ndikon mendja në perkeqesimin e shëndetit apo në ruajtjen e tij?

"Në një mëndje të shëndetshme, trup i shëndetshëm".

Shpesh ndodhë që nga një sëmundje, nëse i përkushtojmë brengë, duket sikur sëmundja bëhet edhe më e madhe. Nga sëmundjet më të njohura e më të përhapura që lidhen me shëndetin mendor, në majat e klasifikimit mbahet skizofrenia, nga edhe është marrë iniciativa për shënimin e datës 10 tetorë si dita Botërore e shëndetit mendor. Jo më pak preokupuese si sëmundje të lidhura ngusht me të mos qenurit në gjëndje të mirë mendore, janë edhe: stresi, depresioni, fobitë, ankthi, obsesionet, mania, çrregullimi i humorit, çregullimet e gjumit, çrregullimet e të ngrënit. Tek fëmijët, më shpesh vehen re problemet apo çrregullimet e të nxënit – rënie e përqëndrimit gjithmonë si pasojë e shqetësimeve në mëndje; hiperaktiviteti por ndodh të hasim edhe në vetdëmtim. Nuk duhet lënë pa numëruar në këtë grupim, e që çdo vit e më shumë po merr hov të madh- autizmi. Të gjitha këto janë çrregullime të cilat pengojnë në funksionimin normal të individit e që jo rallëherë çojnë deri në somatizim që do të thotë manifestim të ndjesisë apo edhe manifestim serioz të sëmundjeve të organeve. Gjithashtu nuk duhet të lënë pa u përmendur fakti që pikërisht sëmundjet mendore janë ndër shkaqet kryesore të invaliditetit në botë e që të gjitha sëmundjet mendore, së bashku përfshijnë rreth 15% të barrës totale të sëmundjes. Sipas vlerësimit e raportimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH), 400 deri në 500 milion njerëz vuajnë nga sëmundjet mendore.

Por, shëndeti mendor nuk ka të bëjë vetëm me çrregullime psikologjike. Vetë preventiva nënkupton forcim të kapaciteteve të personalitetit. Nga Organizata Botërore e shëndetësisë (OBSH) këshillojnë që duhet ta pranojmë veten ashtu siç jemi, bashkë me të mirat dhe të metat. Kyçja në mësimin e diçkaje të re, ndihmon në rritjen e vetbesimit si dhe të kënaqësive. Komunikimi lidhur me problemin a shqetësimin, të kërkuarit e ndihmës, janë pa diskutim lehtësim e zgjidhje e qëlluar.

Problemet mendore janë të mundshme të ndodhin gjatë tërë jetës, çdo ditë.

Nuk ekziston individ i cili në rrethana të caktuara nuk mund t'i nënshtrohet përjetimit të ndonjë problemi shpirtërorë apo mendor.
Ndonëse sot ende ka paragjykime dhe bariera kur bëhet fjalë për të drejtuarit për ndihmë profesionale, në rastet e përjetimit të problemeve të cilat disbalancojnë shëndetin mendor apo në rastet e preventivës, duhet punuar që të luftohet stigma, diskriminimi apo shkelja e të drejtavë për shërim, pa çka se është evidente mungesa e kulturës për ruajtjen e shëndetit mendor dhe për vizitat e rregullta psikologut. Sot, po t'i drejtohesh për ndihmë profesionistëve në fushën e shkencës së psikologjisë, nga jashtë, për fat të keq, shihet si diçka e turpshme apo e papranueshme në shoqëri.

"Shëndet i mirë do të thotë mirëqënie e plotë fizike, mendore dhe shoqërore, jo vetëm mungesën e sëmundjes apo pafuqi "

- Organizata Botërore e Shëndetësisë(OBSH)

Shëndeti mendor apo thënë ndryshe stabiliteti emocional, nënkupton mosprezencë të çrregullimeve mendore, marrëdhënie dhe ndërveprim të shëndetshëm emocional. Ka simptome që nuk duhet të injorohen. Njohja e tyre përkon me nevojën për të konsultuar mjekun me qëllim që të përcaktohet nëse kemi të bëjmë me një problem fizik apo psikologjik.

"Çrregullimet mendore mbahen fshehur, lihen pas dore dhe paragjykohen." - (OBSH).

Nuk ka individ të cilin jeta nuk e ballafaqon me probleme. Mjaft individë me sëmundje mendore ngurojnë të kërkojnë trajtim mjekësor për shkak të stigmës si të sëmurë mendorë dhe për këtë arsye, një numër i madh i tyre mbetet pa u trajtuar.
Duhet vetëdijesuar që përmes kujdesit të duhur shëndetësor, individi mund të gjejë shërim e të vazhdojë një jetë më kuptimplotë. Trajtimet përgjithësisht përfshijnë biseda me specialistë të shëndetit mendor të cilët e ndihmojnë individin që ta pranojë e të kuptojë sëmundjen, të zgjidhë problemet e jetës së përditshme dhe mbi të gjitha, të arrihet bindja se sa e domosdoshme është të mos heqë dorë nga mjekimi.
Shëndeti mendor si dhe problemet me të, nuk janë çeshtje e zgjedhjes por realitet me të cilin po që se nuk ballafaqohemi dhe në këtë mënyrë refuzojmë të kërkojmë ndihmë dhe bëjmë sikur problemi nuk ekziston, ai s'do të zhduket vetvetiu, përkundrazi, mund edhe të avancojë më shumë.
Shëndeti mendor dhe çrregullimet e shëndetit mendor përcaktohen nga faktorë të shumëfishtë dhe interaktivë, siç janë: faktorët social, psikologjik, biologjik dhe jo vetëm. Nga parametrat të cilat definojnë çrregullime në sferën e shëndetit mendor, gjendje të paqëndrueshme mentale e që shumë

shpesh shfaqen si shkak apo pasojë e akumulimit të ankthit, depresionit, stresit apo traumave si dhe akumulimit të problemeve serioze e mbingarkesave sidomos emocionale, numërohen: ndryshimet e humorit dhe sjelljet e paparashikueshme, vetkontrolli i dobët dhe sulmi i zemërimit, sjelljet obsesive - kompulsive si dhe praktikimi i një sërë ritualesh, problemet e kujteses, izolimi, çrregullimet e gjumit, çrregullimet e të ngrënit, problemet fizike si lodhja kronike dhe mungesa e energjisë. Shumë nga çrregullimet janë rezultat i akumulimit të përvojave që vazhdimisht kanë rrezikuar mirëqenien psikologjike të individit.

Janë me dhjetëra shkaqe sociale të cilat ndikojnë në një sërë çrregullimesh. Ndër shkaqet kryesore pa dyshim që janë mjedisi, përkatësisht faktori ambiental,duke pasuar me ata kultural, kushtet e jetës / gjendja socio-ekonomike, raportet apo marëdhëniet si në familje ashtu edhe në shkollë, punë, përjetimet traumatike dhe abuzimet fizike apo psikologjike, distancimet nga persona të dashur si divorcet e prindërve apo humbjet e rënda siç janë rastet e vdekjes së personave të afërm e të dashur. Nuk duhen anashkaluar as faktorët e brendshëm – biologjik e gjenetik si dhe të ashtuquajturat tiparet negative të personalitetit.

Shëndeti mendor nuk është vetëm mungesa e çrregullimeve mendore. Ajo përkufizohet si gjendje e mirëqenies, në të cilën çdo person e kupton potencialin e tij, lufton me stresin e përditshëm të jetës, mund të punojë produktivisht dhe është në gjendje të kontribuojë në komunitet. Ka të bëjë edhe me sjelljen. Problemet mendore, sociale dhe shëndetësore, ndikojnë në sjellje dhe mirëqënie.

Në fokus duhet të jetë përmirësimi i shëndetit mendor përmes parandalimit të disa çrregullimeve mendore që në fëmijëri, me qëllim të ruajtjes së shëndetit mendor në moshën e rritur.

OBSH dhe shqatat e psikologëve këshillojnë:

> Aktivitetet fizike dhe rekreacionet, stërvitjet, masazhi, ndihmojnë në reduktimin e stresit dhe nervozizmit. Hobit e ndryshëm, shetitjet në natyrë, meditimi, çlodhja, ushqimi i shëndetshëm; leximi, arti, muzika, gatimi e deri tek punët artizanale janë ilaç natyral e me efekt të mirë. Refuzoni konsumimin e alkoolit apo të drogave me preteksin që ndihmojnë që të kalohen disi më lehtë problemet sepse substancat nuk ndihmojnë gjë tjetër veçse në dyfishimin e problemeve. Angazhohuni çdo ditë me diçka që ju nihmon shumë për ruajtjen e shëndetit dhe mirëqënien mendore e psikologjike.

Arlinda SUKALIQI

SI TË MENAXHOJMË NJË KLASË TË SUKSESSHME DHE SI TË JEMI MENAXHUES TË MIRË

Padyshim që shkolla është ambjenti ku fëmijët kalojnë pothuajse pjësën më të madhe të kohës. Në shkollë janë mësuesit që i mësojnë dhe edukojnë nxënësit ndërsa në shtëpi menaxhuesit ose udhëheqësit e tyre janë prindërit.

Si dihet profesioni i mësuesit është një profesion i shenjtë dhe si i tillë kërkon përkushtim, ka shumë përgjegjësi pasi çdo veprim i tij ndikon në formimin e nxënësit në çdo aspekt qoftë ai psikologjik, shoqëror, moral etj.

Çdo sjellje e tij monitorohet me kujdes dhe çdo moment i veprimtarisë së tij në shkollë, që nga mënyra e komunikimit, sjellja, lëvizjet, gjestet është i skanuar nga sytë e përqendruar te nxënësit e tij.

Po le të lëmë mënjëanë të gjitha këto që u thanë më lartë për të kaluar në një punë ose detyrë të cilën mësuesi duhet ta ushtroj në mënyrën më të mirë të mundëshme. Cila është ajo? Menaxhimi i klasës është pikërisht një ndër detyrat e tija më të vështira, pra të dish të jesh një menaxhues i mirë. Si të arrihet kjo?

Do e nis të elaboroj këtë temë më poshtë po përpara dua të theksoj një thënie të vjetër të një mësuesi ku thuhet. ”Une kam arritur në përfundim plotësisht të qartë se unë jam faktori vendimtar në klasë, është mënyra ime personale e të sjellurit që krijon gjithë klimen në klasë, është humori im gjatë ditës që përcakton gjithçka...

Duke u nisur nga kjo thënie ne në vazhdimësi do të kemi disa këshilla si të menaxhojmë klasën dhe si të jemi menaxhues të mirë.

Menaxhimi i klasës është një nga shqetësimet kryesore të mësuesve, në mënyre të veçantë të mësuesve fillestarë. Menaxhimi i klasëse fillon me zhvillimin e ndërtimit të besimit dhe mardhënieve midis nxënësve. Mësuesit duhet të zotërojnë situaten, për të shmangur çdo thyerje disipline dhe mbi të gjitha të realizojë me suksese procesin mësimor, i cili çon në prodhimin e vlerave edukative.

Le të shpjegojmë dhe çfarë do të thotë fjala menaxhim. Menaxhim rrjedh nga fjala latine manus-dorë dhe agere-dmth të veprohet, që do të thotë udhëheqje, drejtim, organizim, në këtë kontekst në kuadër të procesit mësimor.

Menaxhimi i mësimit ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënit duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësve në mësim.
Formulimi dhe kuptimi i plotë i konceptit menaxhimi i klasës, evidenton faktin e nevojës që duhet të ketë mësimdhënësi për të bashkëvepruar dhe për të realizuar integrimin e të gjitha strategjive të mundëshme analitiko-metodiko-didaktike të administrimit, me qëllim që të arrijë të zgjedhe nga tërë kjo mori strategjish, atë që është më e afërt dhe më aplikative për momentin-
Më poshtë do të numerojmë disa nga faktorët kryesorë të menaxhimit të klasës:

1. Ambienti (hapsira) fizik-përfshin organizimin e klasës, mënyren si janë bankat e renditura etj.
2. Rregullat dhe rutinat
3. Mardhëniet mësues-prind-nxënës
4. Motivimi i nxënësve
5. Disiplina

Një mësues i mirë, i organizuar dhe që ka objektiva të qarta lë një përshtypje të mirë tek nxënësit e tij, pra me fjalë të tjera ky lloj mësuesi është menaxhues i suksesshëm.
Shumë ekspertë pohojnë se arritjet e suksesit në mësimdhënie, në ditët e sotme varet në mënyrë të ndjeshme nga aftësitë komunikuese me njerëzit, brenda dhe jashtë klasës/shkollës. Mësuesit për të qenë efektiv dhe menaxhues të mirë duhet të jenë praktikë, të faktuar, konciz, të adresuar dhe bindës.
Praktika e menaxhimit të klasës në shkollë paraqet një mori trategjishe të afta për të trajtuar problemet, që mund të shfaqen gjatë mësimdhënies dhe zhvillimit të procesit edukativo-arsimor në klasë. Është e domosdoshme që kësaj çështje t'i kushtohet vëmendje e merituar.
Për ta përmbyllur në thelb mësuesit përdorin menaxhimin jo për të kontrolluar sjelljet e nxënësve, por për të ndikuar dhe drejtuar atë në mënyrë konstruktive për të vendosur bazat për mësim.

TRADITË

Ali GJEÇBRITAJ

ETNOGRAFI – VESHJA POPULLORE E KRAJËS

Një nga aspektet e rëndësishme të mënyrës së jetesës janë veshjet popullore të cilat me larminë dhe variantet e tyre pasurojnë trashëgiminë kulturore shqiptare. Kjo është simbolikë e veçantë që dallohet me tiparet e veçanta. Në Krajë bie fjala janë dalluese veshja e Anës së Sipërme dhe e Anës së Poshtme. Emblemë e të pares s'ka dyshim se është veshja e Shestanit, veshja e grave. Karakteristikë, në të dy anët është, edhe pse Kraja është zone e thatë, pa ujë të gjallë, veshja e gruas kranjane është e bardhë, karakteristike për gjithë zonën me përjashtim që veshjet e nuseve janë të dekoruara me ngjyra të theksuara të ndritura. Qëllimi i këtij shkrimi nuk ka të bëj aspak me studim, por thjesht një përshkrim i veshjes së gruas kranjane në Anën e Poshtme të saj.
Ashtu si veglat e punës, shtëpitë e banimit, ushqimi etj. edhe veshjet konsiderohen ndër mjetet kryesore të jetës së njeriut, thotë Afërdita Onuzi. Edhe kranjanet sipas moshës dhe kategorisë shoqërore krijuan veshjen e tyre me karakteristikat dhe tiparet e saja. Kur kemi të bëjmë me shtresën shoqërore, fjala është këtu vetëm për stolitë e gjoksit me ar e serm e jo me tipare tjera. Të gjitha veshjet e femrës krajane kanë krijuar një pasuri veshjesh. Ashtu si të gjithë shqiptarët, edhe veshja e grave Krajës zë një vend të posaçëm në trashëgiminë tonë të begatë. Këtë begati në Krajë, në Anën e Poshtme të kësaj krahine shqiptare e populluar kryesisht me shqiptarë të besimit islam, gratë e kanë ruajtur me fanatizëm. Me kohë u krijua këtu veshja popullore, e cila në këto anë është ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga gratë. Gjë që për veshjen e burrave nuk mund të thuhet. Shijet estetike të përdorura për zbukurim, por edhe mënyra e stilizimit, janë ato që pasqyrojnë veçantinë etnike. I gjithë zhvillimi i veshjeve, edhe këtu është i lidhur ngushtë me historinë e zhvillimit e përgjithshëm ekonomik, arsimor e kulturor tek kjo populsi, për pasojë edhe me historinë e veshjes karakteristike të Krajës(fjala është këtu me disa zbukurime të cilat kanë pësuar disa ndryshime të vogla e që nuk janë përdorur më parë)
Në Krajë veshja e gruas ka tri tipare të saj. Veshja e vajzave, veshja e nuseve dhe veshja e grave të moshuar, plakave.

Veshja e vajzave përbëhet nga këmisha e qepur nga faqelli i bardhë, tpanat (brekët, në Krajë përdoret fjala tlindat) e bardha pa dekorime në kamëza, mangët e bardha të dekoruara me lule të pakta, të veçanta për moshën, xhamadani nga kadifeja e zezë i dekoruar me shirit të hollë të bardh, boçja (përparësja) e lidhur në brez me tojë përreth trupit. Boçja është e bardhë, e punuar nga leshi në tezjeh (vekë). Në brez vajzat vendosin edhe mendil në anën e djathtë me dekorim të ndonjë luleje. Edhe çorapët e vajzave janë çorapë leshi të bardhë. Në gjoks si dekorim vajzat vejnë po ashtu mendilin e bardhë me ndonjë lule në krahun e djathtë. Në kokë mbajnë shami të bardhë që në gjuhën popullore i thonë degermi e bardhë, e butë. Siç shihet, veshja e vajzave të Anës së Poshtme të Krajës është tërësisht e bardhë me përjashtim të xhamadanit.
Veshja e nuses dallon nga ajo e vajzave për nga ngjyrat. Me gjithë atë, edhe këtu mbizotëron e bardha. Nusja, kuptohet ka më shumë zbukurime në veshje kudo ndër shqiptarët. Kraja s'ka si të bëjë përjashtim nga kjo traditë gjithë shqiptare. Nuset në Krajë veshin këmisha me nuanca të ngjyrës së bardhë. Veshja e poshtme, tpanat (brekët) po ashtu të bardha, por kamëzat, pjesa më e poshtme e tyre, janë të qëndisura me gjilpërë, në popull njihen me termin ura, pra tpanat me ura. Në pjesën e më sipërme të kamëzave, mbi ura, tpanat e nuseve dekorohen edhe me qëndisje në gjergjef. Kështu si rrjedhojë del se dekorimi i kamëzave të tpanave janë të stolisura me dy zbukurime qëndisjeje, me grep dhe në gjergjef. Setra e nuseve paraqet karakteristikë të veçantë për këtë kategori të veshjeve së nuses kranjane. Setra është nga kadifeja e zezë e shëndritshme me jaka jeshile ose të kaltërta. Jakat sikur edhe mangët e setrës janë të dekoruara me shirit të bardhë. Edhe pjesët e poshtme të dorëzave të setrës janë me ngjyrë të jakave. Hasen këtu edhe shirita ngjyrës së verdhë të hapur. E gjithë setra e nuses është e qepur dhe e therur me tegela të shpeshtë. Nën setër, nusja vesh xhamadanin e nuses i cili është nga kadifeja e zezë. Xhamadani qëndiset me tertil, stolisur me shirit me ngjyrë të theksuar që i shkon për shtati nuses. Stolisja e kokës së nuses nisë me kavërxhikun i cili është nga mëndafshi i kuq, me dekorime të llojë-llojëshme dhe me thakë e që lëshohet poshtë shpinës si stoli. Kavërxhiku ka edhe kapuçin i cili vendoset në kokë dhe është me ngjyrë rozë. Urat e tij janë të qëndisura me fije të arit. Krahas kavërxhikut, stoli e shpinës së nuseve janë edhe kurdelet, të cilat kanë ngjyra të larmishme të hapura, ku mbizotërojnë roza, e kuqja, jeshilja dhe e kaltërta e hapur etj. Mbi kavërxhik nusja vendosë degerminë e bardhë nga mëndafshi. Nusja poashtu veshë mangët me ngjyrë të bardhë të dekoruara me ngjyra të larmishme të hapura. Mbizotëron kryesisht dekorimi me ngjyrë rozë dhe qëndisja me tegela jeshil. Pjesë e veshjes

së nuses, sikur edhe te vajzat, është edhe boçja, e cila vihet në brez dhe lidhet në ije, me tojë me ngjyrë të hapur. Boçja e nuses është me ngjyra të hapura ku mbizotërojnë e kuqja, roza, ngjyra vjollcë dhe ngjyra tjera të hapura. Boçja e nuses stoliset me fije ari. Ngjyrat e boçes qëndrojnë në pozitën vertikale dhe janë paralele. Stolit e brezit të nuseve janë edhe çevret, (llojë shamie këto të qëndisura) në kënde (qoshe). Ngjyrat e çevres kryesisht janë rozë, ndërsa mendili dekorues i brezit ka ngjyrën jeshile i qëndisur në skaj. Dekorim i posaçëm në veshjen e nuses është hajmalia. Ajo është e dekoruar me pesë ose shtatë grashatarë (në formë monedhe argjendi të vogla) dhe e lidhur me qestekë nga sermi (argjendi). Nuset i varin hajmalitë me qestekë në anën e majtë në qosh të xhamadanit. Hajmalitë hasën edhe në veshjen e nuses çame. Zbukurim tjetër tek veshja e nuses është edhe bazibeni, luan rolin e hajmalisë por nuk e ka formën e saj. Nuset zakonisht veshin çorape leshi me ngjyra të hapura të qëndisura me lule në maje të gishtërinjve. Çorapët janë punuar nga leshi i butë me kërrabëza. Zatën, edhe një këngë e vjetër popullore ndër të tjera thotë: Ban çarap pak me vrap, nji syze, nji sahat, mu sjellë njer gjashtë sahat, mi marue nji mat-mat(një mot-mot). Pjesë e veshjes dekorative e fytit të nuseve kanë qenë edhe gjerdanët me rruaza. Edhe veshja e grave të moshuara, e njohur si veshje e plakave përbëhet nga ngjyra e bardhë. Tlindat janë të bardha. Gratë plaka që nuk janë vejusha kamëzat e brekëve i kanë të dekoruara me ura, ndërsa vejushat jo. Këmisha nga pelhura dhe degermia (shamia e kokës) janë të bardha. Setra e zezë e thethur me tegela por pa zbukurime. Jakat dhe dorezat me shirit të bardhë të hollë, më të hollë se tek setra e nuses. Plaka vesh nën setër xhamadan të zi me shirit të verdhë. Boçja e plakes është e bardhë nga pambuku, ndërsa si dekorim plakat në brez vendosin tojën e brezit një mëndil të thjeshtë të bardhë. Mangët e anterisë së plakës janë ngjyrë misri me dekorime të pakta jo të theksuara. Plaka përdor çorape të zinj leshi.

I gjithë ky bagazh etnografik veshjes së grave në Anën e poshtme të Krajës është punuar në tezjeh (vekë). Karakteristikë e kësaj veshje në të tri moshat është se mbizotëron veshja e bardhë e trashëguar nga Iliria e lashtë, nga fisi ilir Labeat që ka populluar basenin e liqenit të Shkodrës. Duket qartë se pasardhësit e këtij fisi të lashtë ilir janë edhe kranjanët. Këtë e dëshmojnë në Krajë, jo vetëm veshja e bardhë edhe në morte, por edhe simboli i gjarprit i skalitur në gurët e shtëpive në disa vendbanime të Krajës, si në Anën e Sipërme ashtu edhe në Anën e Poshtme. Ora e shtëpisë (gjarpri), ngjyra e bardhë e veshjes, mënyra e mbulimit të kokës me shami, si dhe shumë karakteristika tjera janë dëshmi e pamohueshme së kjo trevë ka q enë dhe është është iliro–shqiptare.

Muhamet NIKA

CEREMONIALI I DASMËS ANAMALASE

Martesa si akt i rëndësishëm jetësor, ka një zanafillë të lashtë të zhvillimit ndër shqiptarët, kurse kodifikimi i saj në gjendjen ekzistuese përfundimisht u kristalizua me Kanunin e Lekë Dukagjinit, para katër shekujsh. Si e drejtë civile Kanuni ndër shqiptarë u paraqit para së drejtës civile, te popujt tjerë të Evropës. Edhe pse aplikimi i tij ndër shqiptarët duket se ishte me një kosto të lartë, prapëseprapë ai në të shumtën e rasteve ka bërë që dasma të mos shndërrohet në aventurë, duke evituar shumë pazare moderne të kohës.

Me Kanunin e Lekë Dukagjinit, martesa përcaktohet kësisoj: (mu martu me Kanun dmth, mu ba shtëpi, me ia shtue shtëpisë nji rob ma tepër sa për krah pune, sa për të shtuem të fëmijve), Kanuni, pika 28.

Kjo për shqiptarët nuk është e tëra. Sepse nusja jo vetëm që duhet të jetë e shëndoshë, por duhet të jetë prej dere të mirë, e ndershme në fis të vet dhe e ndershme ajo vetë, madje të jetë edhe e bukur.

Çështja bosht sipas Kanunit të Lekës është puna e shkuesit, e cila është e përcaktuar mirë dhe sipas pikave të Kanunit. Ai ka këtë funksion: "1. Shkuesi është ndërmjetës te dhëndri e te nusja (te djali e te vajza), të mos luajnë fjalët as njana as tjetra lagje; 2. Shkuesi ka tager mbi 50 grosh të shkuesisë për këpucë, të preme prej kanuje; 3. Këpucët e shkuesit kanë vaden me ditë që të merret nusja; 4. Shkuesin e gjen shtëpia e vajzës ose shtëpia e djalit... KLD,pika38).

Realiteti i sotëm i ceremonialit

Duke pasur parasysh realitetin e sotëm të ceremonialit të dasmës në Anë të Malit, i cili lidhet me trashëgiminë kulturore shqiptare në përgjithësi pohojmë se realiteti i ceremonisë paraqet një filozofi jetësore të trashëguar, por që nuk dallon gjithaq nga dasma shqiptare në përgjithësi. Informacioni I hollësishëm që fitohet nga "adetet" e dasmës së kësaj zone të nxitë të mendosh se ritet e ceremonialit i takojnë traditës së lashtë shqiptare, që vijnë nga koha antike ilire.

Në qoftë se kemi parasysh faktorin gjeografik të shtrirjes së kësaj treve që gjendet në rrugën e cila lidhë Shkodrën me Ulqinin, konstatojmë se zhvillimi historik i shqiptarëve në këtë zonë daton që nga zhvillimi i Shkodrës si qytet i Ilirisë. Zona ishte urë e dy qyteteve të lashta

Shkodër dhe Ulqin, ndërsa si njësi e veçantë kulturore ishte edhe qyteti rrënojë i Shasit.

Aktualisht treva paraqet një njësi të veçantë të rrumbullakuar mirë nga kufijtë gjuhësorë, etnologjikë, etnografikë etj. Duke u munduar që të zgjidhim enigmën e shtratit dhe nenshtratit ritual te ky ceremonial karakteristik, regjistrimit të materialit të trashëguar kulturor, i cili arriti t'i përballojë kohës duke mbijetuar, aty këtu do të përpiqemi që në fushën e regjistrimit të materies të japim edhe disa komentime të saj. Vështrimi i formës rituale si segment komunikativ me domethënie të caktuar krijon horizonte konkrete që zbërthen enigmën e ceremonialit duke mundësuar marrjen me mend të informatës. Sot ky ceremonial ka "thyerje" të normave të vjetra, të cilat gradualisht zëvendë- sohen me trajta të thjeshtësuara të cilat janë funksionale për formën moderne te të jetuarit. "Thyerja" ose rinovimi i formave tradicionale të ceremonialit është në zhvillim e sipër, ku hetojmë varfërimin në përmbajtjen e formave të vjetra dhe njëkohësisht "begatimin" me elemente të formave të reja. Natyra e kundërt e këtyre dy proceseve na shtyn që në fillim të rrekemi me format e vjetra të këtij ceremoniali.

Ashtu siç janë uniforme të gjitha zakonet tjera kulturore, që kanë të bëjnë me traditën kulturore popullore shqiptare edhe ritet që e shoqërojnë ceremonialin e dasmës në Anë të Malit janë uniformë me ritet e dasmës që e shoqërojnë martesën, në të gjithë truallin e banuar me shqiptarë. Mirëpo, besimet dhe praktikat magjike që ndeshen me ceremonialin e dasmës, me origjinalitetin e vet, këtë zonë e bëjnë të hetueshme si zonë të veçantë etnologjike.

Nisur nga fakti se ky variant i ceremonialit të dasmës në tërë shtrirjen zonale të vet nuk është prekur nga studiuesit e këtij lëmi, është nevojë e kohës që të bëhet kjo gjë. Përmes trajtesës do të parashtrojmë materialin e formave që ndeshen në materialin ceremonial e që në mënyrë komplete zbulon rrënjën e zakoneve të ndryshme të së kaluarës. Në ceremonial, përveç tjerash, hetojmë sjelljen etike të kolektivit anamalas ndaj aktit të martesës si moment me rëndësi të veçantë për jetën e njeriut. Duke folur për vlerën e veçantë të pasurisë dhe trashëgimisë kulturore si pikë kyçe për studime serioze, po trajtojmë fazat më origjinale të kësaj ceremonie, duke e zbërthyer atë në disa segmente.

Caktimi i ditës së dasmës

Caktimi i ditës së dasmës është një moment me rëndësi të veçantë, sepse me te shënohet fillimi i dasmës. Për këtë ngjarje janë të interesuar

të dyja palët, familja e vajzës dhe familja e djalit. Zakonisht caktimin e datës (vades) e bën familja e vajzës, me pëlqimin e familjes së djalit. Duke ditur që rëndësi të veçantë në lidhjen e dy të rinjve ka edhe shkuesi, shtojmë se roli i tij vjen në shprehje edhe gjatë caktimit të ditës së dasmës. Në të shumtën e herëve është vetë shkuesi ai që vendosë në caktimin e ditës së dasmës ose ndodhë që të ndërmjetësojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme, që mund të lindin

gjatë caktimit të ditës së dasmës ose të atyre mosmarrë-

veshjeve që lindin pas caktimit të ditës së dasmës për arsye të ndryshme. Kjo ditë në popull njihet si datë e "damjes së vades" ose si dita e nisjes së krushqve.

Sipas traditës popullore, në Anë të Malit ishte praktikë që dasmat të bëheshin në vjeshtë, atëherë kur përfundonin të gjitha punët bujqësore të popullsisë, e cila kryesisht merrej me bujqësi. Ndërsa nga ditët e javës kur praktikohej që të bëheshin dasmat, zakonisht ishin dita e hënë, e mërkura dhe e enjtja. Tjetër, për të shkuar martesa mbarë duhej të binte në "hanë ndeje!". Përjashtim nga këto norma bën martesa e grave të veja "vejushave", për të cilat nuk ishte e rëndësishme se kur martohej; në cilën stinë të vitit dhe në cilën ditë. Për martesën e tyre nuk sigurohej ndonjë ceremoni e veçantë dhe nuk mblidheshin shumë veta për ta çuar atë te dhëndri. Shtyrja e ditës së martesës duhet thënë se nuk ishin një moment i pëlqyeshëm për asnjërën anë, as për familjen e vajzës as për familjen e djalit sepse shtyrja e saj ndjell tersllëk. Shtyrja nganjëherë nuk është lejuar as me rastin e sëmundjes së nuses?!

Ishte zakon që kur caktohej dita e dasmës, vajza detyrimisht duhej të fshihej në shtëpi, të mos komunikonte me të tjerët, ndërsa gjatë kësaj kohe ndihmohej nga gratë e fisit, pra nga kushërirat e veta më të afërme

Kur është caktuar dita e dasmës, e cila fillonte p.sh. të enjten, atëherë dhuntia, sëndukët e nuses nga shtëpia e dhëndrit nisen të hënën. Po këtë ditë, nga të dy palët ndahen "thirsat" (thirrësit) e dasmës, që kanë për obligim të ftojnë mysafirët në dasmë. Ndërsa të mërkurën ishte zakon që të caktohej "kryehysmetçia" dhe "hysmetçitë", të cilët sillnin edhe nga një barrë dru.

Thirrësit shkojnë nëpër shtëpi te të ftuarve, i ftojnë në dasmë dhe në shenjë të respektit praktikohet që atyre si dhuratë në shenjë gëzimi dhe shendi t'u jepen peshqeshe të ndryshme si: llokume, të holla, ose peshqirë. Pasi bëjnë thirrjen, ata shkojnë përsëri te kryefamiljari dhe e njoftojnë që i kanë kryer obligimet e veta.

Dita e dhuntisë

Në këtë ditë pala e djalit, në prani të shkuesit, i çojnë nuses sëndukë me petka. Ishte zakon qe të çonin gjashtë palë petka e në mesin e tyre duhet veçuar teshat e mira ku hyjnë: barneveket, shalli, degërmi, një zhezhe (lloj shamie për kokë), çarçafët e zezë me byrde dhe vathët. Gjithashtu nuses i çohen për të ngrënë edhe fiq të tharë, llokume etj. Një adet të ngjashëm e gjejmë deri te dasma çame.

Nga ana tjetër fillon rituali i bërjes së vajzës nuse në shtëpinë e saj që nënkupton vënien e makijazhit. "Nuse" vajzën e bëjnë motrat ose hallat, por duhet që ajo femër që e bën nuse të ketë fëmijë.

Në shtëpinë e familjes së dhëndrit, dy ditë para se të merrej nusja, vinin të afërmit e tij, si: dajat, hallat etj., të cilët sillnin dhuratat e veta dhe kur hynin në oborr të dhëndrit qitnin pushkë.

Në momentin kur nisen sëndukët për në shtëpi të vajzës, në shtëpinë e dhëndrit fillojnë të këndojnë këngë dhuntie, e njëra nga këto këngë është edhe kjo: "Shkon pulë bardha nëpër Dri, N.N. aga çon dhunti, çon dhuntinë e djalit tij"

Dita e dasmës

Pika më kulminante e ritualit të dasmës është kur krushqit nisen për të marrë nusen. Për këtë kulminacion të ritualit dhe ceremonisë Sokollovi thotë: ritmi i dasmës dhe tërë ceremoniali i saj përbën në vete elemente dramatike.

Është në të vërtetë një lojë e kombinuar dhe e lidhur me aktorë, me tekst, ku çdo aktor duhet të luajë thjeshtësisht rolin e tij me karakter skenik që e mban tradita. Ndërsa Gëte shprehet se martesa është themel dhe kulm i gjithëqytetërimit.

Këtë ditë e karakterizojnë: përgatitja e kalit ose qerres për nuse; nisja e kalit për nuse; nisja e dasmorëve; arritja dhe qëndrimi në shtëpi të vajzës; kthimi i dasmorëve me nuse; zbritja e nuses nga kali; çelja e derës së nuses dhe momenti kur asaj i këndojnë këngë të ndryshme që lidhen me bukurinë e saj. Si fillim definitiv i dasmës merret kur krushqit nisen për të marrë nusen. Krushqit, sipas adetit, në shtëpinë e dhëndrit sjellin ndonjë kilogram sheqer, ndërsa sot nga një shishe raki.

Zakonisht nusja merrej pas dreke. Atë shkojnë për ta marrë krushqit me qerre, me kalë dhe me këmbësorë. Dikur nuk ishte adet që për nuse të shkonin gratë. Ndoshta një veprim i tillë lidhet me kohën kur martesat ishin të pasanksionuara, madje kishte edhe grabitje. Gjithashtu

me krushq nuk shkon as dhëndri, bile atë ditë praktikohet që dhëndri të mos jetë në shtëpi, por të shkojë çoban në mal.

Krushqve u printe krushku i parë, që ishte daja i dhëndrit, i cili shoqërohej nga "Zotin madhi" (babai i dhëndrit). Bile, në qoftë se daja nuk ishte njeri shumë i zgjuar atëherë ai zen edhe vendin e tij. Në ballë të krushqve qëndron bajraku, të cilin e mban një i afërt i dhëndrit, nga radhët e kushërinjve. Gjatë rrugës krushqit ecin në radhë një nga një dhe zakonisht këndojnë këngë duke futur gishtat në vesh. Afrimi i krushqve në shtëpi të nuses shoqërohet me ceremoni të ndryshme. Një përfaqësues i palës së vajzës u dilte përpara për t'i pritur krushqit dhe, në qoftë se pala e vajzës mbante zi, u jepte "izën", leje krushqve për të kënduar ose jo. Ai gjithashtu u tërhiqte vërejtjen krushqve që të mos këndojnë nëse familja e vajzës qëndronte keq, në hasmëri, me ndonjë familje të fshatit.

Sipas zakonit krushqit silleshin rreth pajës së nuses pasi përshëndetën me dasmorët e vajzës. Ne këtë moment ata këndojnë këngë të ndryshme dhe në shenjë shendi qesin pushkë, por nuk përziheshin me dasmorët e shtëpisë së nuses. Kur nusja del nga shtëpia e vet, vëllai dhe daja e përcjellin me të qara, derisa e vendosin në kalë ose në qerre. Hipja e nuses në kalë bëhej nga vëllai ose daja. Kali i nuses stolisej me lule dhe pasqyrë. Është interesant që kali i nuses duhet të jetë i bardhë ose i kuq, ndërsa nuk guxon të jetë i zi. Gjatë rrugës krushqit e ndërronin rrugën. Në këtë ceremoni besohet se nusja nuk do të kthehej më në shtëpi, sepse do t'u dredhonin fuqive të liga, të mbinatyrshme, të cilët nuk u dëshirojnë jetë të lumtur të rinjve të martuar.

Arritja e nuses në shtëpi të burrit pritet me këngë dhe me pasqyrë. Ndërsa në oborr qitet sheqer, për të kaluar jetë të ëmbël, kurse në prag të shtëpisë ajo thyen pasqyrën që i vihet në babune dhe përshëndet tri herë. Ndërsa me gishtin të cilin ia lyejnë me mjaltë prek derën e dhomës së vet. Në fjetore e sjellin tri herë rreth fronit (karriges). Zakonin e vënies në fron e kanë pasur edhe popujt e vjetër si: gjermanët, kaukazasit, indasit, por edhe popujt indoevropianë. Gjithashtu, me këtë rast, nuses i vënë një djalë në prehër, me dëshirë që nusja të lind djem.

Përshëndetja, 3 herë e nuses kur hyn në oborr, pastaj sjellja 3 herë rreth fronit, si dhe respektimi i gjithëhershëm i simbolikës së numrit tek, që ngjet të të gjithë popujt e vjetër, shikuar nga këndi i religjionit, simbolika si tabu, duhet të lidhet, me mësimet fetare të lashtësisë-

arkaikës, të cilat mësojnë se Zoti është tek dhe se atij i i pëlqen teku. Madje edhe faljet ditore te myslimanet janë tek (kohët e namazit), nga kjo pozitë, besimtarët myslimanë, thojnë se u bë synet (namaz i pëlqyeshëm), nga profeti, edhe falja e namazit të Vitrit, që është namaz nate; profeti Muhamet as, thoshte: falni namazin e vitrit, me reqate tek sepse Zoti është tek dhe atij i pëlqen teku....?!! Si duket, me këtë respekt të simbolikës së numrit tek, sot popujt, në mënyrë të pa vetëdijshme ruajnë kuptimin simbolik të atributeve të Zotit krijues.

Pas disa orëve nuses i hiqej duvaku, e ky moment njihet si "çilja e derës së nuses". Nga dritarja qitej njëherë pushkë, e kjo ishte shenjë se u çel dera e nuses. Para se të çelej dera e nuses, duhet thënë se dhëndri, me qëllim të shtimit të begatisë, e gjuan nusen me të holla. Pasi hynte dhëndri në dhomë të nuses i fliste asaj duke e përshëndetur në emër, i fuste një gjësend të ëmbël në gojë dhe duhej t'ia shkelte këmbën. Gjatë kësaj kohe ai duhej të deklaronte nëse i pëlqen gruaja ose të deklaronte lëshimin e saj. Nga momentet tjera të kësaj kohe duhet veçuar lodrimi i kalit të nuses "për me dalë nusja e shkathtë", gjuajtja e shenjës me revole...Për dallim nga krahinat e tjera, natën e parë dhëndrit s'i lejohej të flinte me nuse. Ajo natën e parë flinte me të motrën e dhëndrit ose me ndonjë fëmijë. Sipas Abaz Dojakës, ky zakon të kujton të drejtën e të tretit natën e parë. Të nesërmen në mëngjes, nusja gjithashtu duhej të çohej herët dhe asaj i qet të lajë faqet një fëmijë, i cili i kishte prindërit gjallë. Për dallim nga disa treva tjera, natën e parë, pra, të rinjtë nuk flenë bashkë. Me këtë edhe përfundon dasma.

Natën e dytë nusja duhet të hyjë e para në dhomë (në fjetore), duhet të rrijë te dera në këmbë dhe nuk guxon të flasë. Pastaj dhëndri duhet ta marrë e ta hedhë në shtrat, të cilin e ka shtruar dikush i shtëpisë. Atë natë nuk është zakon që nusja të flasë me burrin, derisa të lindë dielli, sepse po të flasë shumë, asaj do t'i thyhen gjërat (enët) në shtëpinë e re. Të nesërmen para mëngjesit, asaj dikush nga të shtëpisë i len një enë me ujë para dere dhe largohet, kurse nusja del dhe e merr. Pasi lahet e pastrohet çohet para të gjithëve, ndez zjarrin, i pjek kafen vjehrrit, vjehrrës dhe kështu me radhë. Po këtë ditë ajo u tregon teshat e veta dhe i dhuron"teshat", që i ka sjellë si dhuratë. Po këtë ditë nga fshati vijnë gra dhe vajza për të parë nusen, pajën që ka sjell, stolitë e tjera. Me këtë edhe dasma merr fund.

Pasdasma - Të shkuarit e nuses në gjini – pasitë

Pasdasma karakterizohet nga të shkuarit e nuses në gjini ose siç thuhet "pasish". Kthimi i nuses në gjini, pra të shkuarit "pasish" bëhet pas dhjetë ditëve. Ky zakon haset në të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët. Kështu, pas dhjetë ditëve, sipas marrëveshjes, familja e djalit bashkë me dhëndrin shkojnë në gjini të nuses, si "miq të ri". Kësaj here dhëndri shkon dhe takohet me vjehrrin, me vjehrrën si dhe me familjarët tjetër të shtëpisë. Pasi hanë darkë, dhëndri dhe shoqëruesit tjerë kthehen në shtëpi, ndërsa nusja rrinë te prindërit e vet. Pas disa ditëve bëhet kthimi i vizitës nga familja e vajzës.

Ishte zakon që kur kthehej nusja nga pasit në shtëpi, të përgatiste kuleç prej miellit, qumështit dhe vajit, me të cilët qarroste fëmijët e lagjes dhe kalimtarët, të cilët i takonte në hyrje të fshatit. Mirëpo, për t'iu shmangur kësaj ceremonie disi të pazakonshme, ajo kthehej disi pas "akshamit", atëherë kur kalimtarët ishin edhe më të rrallë. Me këtë ceremonial përfundon edhe dasma në Anë të Malit.

Duke analizuar dasmën e Anës së Malit, kuptojmë se shumë gjëra sot kanë ndryshuar, por dasma si moment e sanksionuar dhe si e tillë respektohet si vlerë e traditës shumëshekullore. Ky sanksionim dhe kultivimi i traditës po ruhet edhe te komunitetit anamalas në Amerikë.

Tradita e mrekullueshme e dasmës anamalase -shqiptare ka kushtëzuar dhe po kushtëzon martesa të lumtura, që krijojnë parakushte për një jetë të harmonishme dhe të moralshme e të cilën shumë popuj të botës nuk e kanë dhe do ta paguanin shtrenjtë. Falës kësaj rregullsie -nderim të traditës, sot në Anë të Malit hasim në shumë pak shkurorëzime, ndërsa numri i fëmijëve jashtë martese është barazi me zero. Këto dy të dhëna janë vlera të cilat duhet kultivuar dhe në të ardhmen, sepse ruajnë freskinë e racës. Ndërsa si "të metë" mund të quajmë numrin e vogël të martesave që lidhen ndërmjet krahinës së Anës së Malit dhe krahinave tjera shqiptare, siç është treva e Krajës, rrethina e Ulqinit dhe vetë Ulqini.Por edhe numri i kufizuar i martesave te të rinjtë, të cilët fare pak vendosin të martohen në moshen e re, dhe fare pak vendosin të lindin fëmijë ndoshta për arsye të kushteve jo fort të pëlqyeshme ekonomike. Si rezultat i kësaj kemi një rënie tepër të madhe të natalitetit që kushtëzon plakjen e popullsisë së trevës dhe zvogëlimit të numrit të banorëve në krahasim me vitet e mëhershme.

ARKITEKTURË

Shkëlzen SULEJMANI, arch. i dipl.

BANESA TRADICIONALE NE RRETHINEN E ANES SE MALIT

1. Ç'KEMI TRASHËGUAR?

'Raporti i njeriut me trashëgiminë, është i njëjtë me raportin e fëmijës me nënën e vet' [30]

Në vazhdën e gjërë të vlerave të trashëguara në vite nga populli ynë, për shekuj me rradhë, hyjnë padyshim edhe vlerat arkitektonike dhe ndërtimore. Trashëgimia arkitektonike, ka vlera të veçanta në krijimin e lidhjes logjike në mes abstraktes dhe reales në historinë e një populli. Ajo nuk vjen kurrë e vetme, por si një grumbull vlerash në secilin element përbërës, duke pasuruar kështu secilën fushë të trashëgimisë kulturore. Populli shqiptar ka një trashëgimi të pasur arkitektonike. Kur themi të pasur nuk kemi në mendje vetëm sasinë por edhe shumëllojshmërinë e ndërtimeve si dhe shpërndarjen e saj në kohë. Kjo lejon krijimin e lidhjes kronologjike si dhe vijës evolutive.

Trashëgimia arkitektonike përfshin në vete të gjitha llojet e ndërtimit. Pjesa më e madhe e kësaj trashëgimie është krijuar nga mjeshtri popullor, në kohë, ndërsa lloji i ndërtimit ka qenë kryesisht arkitektura profane (e banimit). Meqë si qëllim studimi është arkitektura e mjeshtrit popullor në Anë të Malit, gjegjësisht banesa tradicionale e Anës së Malit, shkëpusim nga ansambli i trashëguar arkitektonik një pjesë të saj e cila e dokumentuar, nuk shkon më larg se shek. XIX. *Mungesa e datimeve në banesat fshatare e vështirëson përcaktimin e një caku të saktë për fillimet e formimit të tipeve që janë arritur deri në ditët tona. Banesat që kanë mundur të ruhen nga e kaluara, me përjashtime mjaft të pakta, nuk shtyhen më tej se shek. XIX, por kjo nuk do të thotë që të vendosim si kufi të mundshëm kohor këtë kohë.* [31] Megjithetë gjurmët e banesave më të thjeshta, në vendbanimet rrënoja, janë pothuajse të të gjitha periudhave kohore. Lidhja e qartë funksionale dhe kompozicionale e shtëpive të shek. XIX dhe XX, arrin të krijohet deri

30 JOHN HENRIK CLARKE - thënie

31 A. BAÇE, A. MEKSI, E. RIZA GJ. KARAISKAJ, P. THOMO "Historia e arkitekturës shqiptare"

me shtëpitë parahistorike ato më të lashta pellazgo-ilire. Këtu shihet rruga e gjatë e transformimit të traditës së ndërtimit dhe banimit, prej formës së parë elementare, deri te ajo me tipare të perfeksionuara, të krijuara nga mjeshtri popullor. *Mjeshtri popullor shqiptar, në lëmin e arkitekturës popullore krijoi vlera kulmore arkitektonike, me tipare të mëvetësishme apo autoktone, origjinale, unike dhe struktura konstruktive nga më të guximshmet në tërë arkitekturën popullore ballkanike*[32]. Kjo është arritur përmes bartjes së njohurive konstruktive dhe funksionale. evoluimit të tyre në kohë si dhe respektimit të trashëgimisë shpirtërore si shtyllë e rëndësishme në ruajtjen e lidhjes së pashkëputur që nga parahistoria. Këtë rrjedhë të pashkëputur e kanë dokumentuar me rradhë studiues të fushës, e cila e thjeshtëzuar do ndahej në dy shtylla:

1. Rrjedha funksionale dhe kompozicionale

2. Rrjedha shpirtërore

Trashëgimia arkitektonike ka fituar elemente të reja në kohë ndërsa ato egzistues i janë nënshtruar ndikimeve të jashtme, por kanë ruajtur qartazi lidhjen me zanafillën. Meqë si qëllim studimi është arkitektura e banimit në Anën e Malit, e që gjurmët janë kryesisht të shekulit XIX atëherë spjegimin e rrjedhës do e bëjmë përmes lidhjes direkte të arkitekturës së kësaj kohe me atë pellazgo-ilire ose me atë të lashtë shqiptare.

1.2 RRJEDHA FUNKSIONALE DHE KOMPOZICIONALE

Nëse përqendrohemi në arkitekurën profane, atëherë nuk mund të flasim për shtëpinë e banimit si të veçantë, por duhet të shtrihemi minimalisht në ansamblin ndërtimor brenda oborrit por edhe më gjërë në truallin në shërbim të tij.

Në këtë kontekst, ndërlidhja e parë krijohet në vendosjen e shtëpisë në truall. Në arkitekturen popullore Ilire, por edhe më heret atë pellazge, pozicionimi i shtëpisë bëhej pingul ndaj izohipsave të terenit. *Vendosja pingule e shtëpisë ndaj izohipsave, si tipar ndërtimi, spikatet në ndërtimet brenda qytetit të fortifikuar e të lashtë ilirë, Kalasë së Ulqinit dhe Tivarit*[33]. Këtë element fare pak të modifikuar e vërejmë në arkitekturën e shek. XIX. Shtëpia fshatare në Anën e Malit, sidomos në zonat malore, ruan pozicionimin pingul ndaj izohipsave. Këtë mund ta

32 FLAMUR DOLI "Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar"
33 FLAMUR DOLI "Arkitektura vernakulare e Kosovës"

vërejmë tek shtëpitë në fshatin Bojk, Millë dhe Rashtish ku vërehet qartë pozicionimi i shtëpive ndaj izohipsave në atë mënyrë që tereni depërton përdhesën në gjysëm lartësie e herë-herë në lartësi të plotë kati (fig).

Rrjedhë direkte sa i përket teknikës së ndërtimit paraqet muri karaktristik pellazgo-ilir, i njohur si *muri ciklopik* apo cyklopean. Kjo teknik e punimit të mureve është një fije e pastër dhe e pashkëputur lidhje në trashëgimin arkitektonike të mjeshtrit popullor. Muret ciklopike prej momentit që janë aplikuar në arkitekturën profane, nuk kanë njohur shkëputje prej saj deri në fillimin e aplikimit të materialeve industriale. Muret ciklopike si metodë e punimit të mureve i hasim jo vetëm në arkitekturën e shtëpisë por edhe atë të ansamblit ndërtimor. Këtu përmendim, muret e ansambleve ndërtimore brenda oborrit në fshatrat fushore të Anës së Malit. Në këto mure (fig), vërehet teknika e punimit të mureve ciklopike por jo edhe madhësia e gurëve e cila nuk arrin atë tipike.

Lidhja e tretë funksionale është ajo e strukturës planimetrike. Në kohërat pellazgjike ndërtoheshin shtëpitë (kasollet) me planimetri ovale. Më tutje në arkitekturën popullore ilire shfaqen shtëpitë tumë, shtëpitë përmendore (cippus) poashtu me planimetri rrethore. *Tek shqiptarët, njihet kashtorja (koshi i misrit) i cili riprodhon tërësisht tiparet hapsinore formësuese të cipusit liburn, i njohur në hapsirën e Shestanit.*[34] Kashtorja (koshi i misrit) është pjesë e pandarë e ansamblit ndërtimorë brenda oborrit tek shtëpitë e shek XIX dhe XX në Anën e Malit (fig)

Megjithatë, përveç elementeve të tipizuara populli shqiptar shquhet për diversitet në krijimin e njësisë së vet të banimit. Kjo jo vetëm për arsye intimiteti por si rezultat i vlerësimit të lartë që ai i bën shtëpisë së banimit dhe dëshirës që ajo të jetë e veçantë. *Shqiptarët janë një prej popujve ballkanikë më të ngulitur, pra të lidhur ngushtas me një hapësirë tokësore si truall ndërtimi*[35]. Megjithatë ngelet e qartë rrjedha e traditës së trashëguar nga mjeshtrit popullor.

1.3 RRJEDHA SHPIRTËRORE

Populli shqiptarë ka krijuar, ashtu si të gjithë popujt, Perëndi dhe Zot-a, në tentativën për t'u mbrojtur prej fenomeneve të paspjegueshme. Pjesë të shkëputura të besimit pagan, i cili tek ilirët ka qenë shumë i pasur, kanë mbijetuar deri në kohën e besimeve monoteiste. Ato janë trashëguar në formë të riteve ceremoniale

34 FLAMUR DOLI "Arkitektura vernakulare e Kosovës"
35 EMIN RIZA "Banesa popullore shqiptare"

tradicionale, miteve, legjendave, e disa kanë arritur të kthehen në zakone e rregulla që duheshin zbatuar në përditshmëri. Vlen të përmendet legjenda mitike sipas të cilës Kadmi (biri i një mbreti fenikas) dhe Harmona gruaja e tij, nuk kishin fëmij pas një martese të gjatë. Ata i luten Zotërave që t'iu fal një fëmij, po sikur edhe të jetë gjarpër do ishin falenderues. Kjo edhe ngjan, atyre ju lind fëmij, gjarpër, të cilin e quajnë Ilirios. Sipas legjendës Iliriosi disa vite më pas martohet dhe lind fëmij, emrat e të cilëve janë edhe emrat e fiseve ilire.

Kulti ktonik i gjarpërit, ndeshet kudo në arkitekturën e banimit tek Ilirët, në kulturën e Arbrit në Mesjetë, por edhe në atë shqiptare më vonë. Gjarpri njihet si *hyjni mbrojtëse e jetës, e mirëqenies dhe mbarësisë në familje*[36] dhe sipas traditës së gojëdhënave, secila shtëpi ka gjarprin e vet mbrojtës. *Ornamentet nga kulti i gjarprit, për shkak të karakterit dhe simbolikës së tyre, u aplikuan përherë në vendet apo në elementet kompozicionale më të ekspozuara të shtëpisë, meqë përdorimi i tyre kishte funksion magjik, mbrojtës dhe fatsjellës. Për më tepër, aplikimi i këtyre ornamenteve, kryesisht në formë artistike të relievit të ulët, shquhet për një strukturim kompozicional të harmonizuar organikisht me konceptin estetik formësues dhe arkitektonik të ndërtimit popullor, apo elementeve strukturale të tij.*[37]

Në etnosin e Anës së Malit, kulti ktonik i gjarpërit ka gjetur një aplikim të madh. Duke filluar me byzylykët dhe varëset ku paraqitet si tredimenzional, veshjet tradicionale ku paraqitet në forma më të rregullta gjeometrike, për të vazhduar tek enët e ushqimit dhe mjetet e punës, deri tek përdorimi i tij në formë relievi të ulët në portat hyrëse të shtëpisë, apo i gdhendur tek shuli i portës (foto). Si element ornamentik, i aplikuar në arkitekturën e shtëpisë së banimit në Anën e Malit, kryesisht është në forma reale, e rrallëherë në forma gjeometrike. Përvec portave hyrëse, shpeshherë përdorej edhe brenda shtëpisë, në odën e zjarrit (burrave). Për këtë arsye aplikimi i kultit ktonik ashtu si edhe në të gjithë hapsirën shqiptare edhe në Anën e Malit *u zhvillua në vertikalen diakronike, në një vijimësi të pandërprerë në harkun kohorë që nga ilirët deri tek shqiptarët e kohës sonë*[38.]

Përveç kultit të gjarpërit, në etnosin anamalas, gjendet edhe ornamenti i një kulti të rëndësishëm (për të mos thënë më i rëndësishmi),

36 MARK TIRTA "Mitologjia ndër shqiptarët"
37 FLAMUR DOLI "Ornamentika nga kompleksi I kutit të gjarpërit të shtëpise ", Ligjëratë
38 FLAMUR DOLI "Ornamentika nga kompleksi I kutit të gjarpërit të shtëpise "

ai i diellit dhe i hënës (më rrallë edhe i yjeve). Sa i përket kultit të diellit në ornamentikën popullore ai paraqitet në forma të ndryshme, shpeshherë edhe përmes figurave metaforike. *Si elementë shumë të qartë të mbeturinave të kultit të diellit janë svastika, rrathët koncetrikë dhe motive të tjera të diellit në objektet e kulturës lëndore, në zbukurimet e veshjeve popullore, në punime të ndryshme tekstili; në gdhendje në gurë (në dyert e shtëpive, në oxhaqet e vatrës, në kryqe e gurë të varreve), në punime druri nga më të ndryshmet (djepa, hambarë, furka, tryeza, arka, enë ushqimi e vegla muzikore, karrige e tavane shtëpish, në vezë të ngjyera rituale, në tatuazh e kështu me radhë*)[39]

Sipas studiuesit Mark Tirta, njihet kulti i disa vendeve të larta ose maja malesh që adhuroheshin, të cilave njerëzit iu faleshin në lindje të diellit. Poashtu zhvilloheshin ceremoni të ndryshme në majat e këtyre maleve në data të caktuara. *Kështu vendësit ngjiteshin në majën e malit Rumia (Rumia: mal në 1 perëndim të liqenit të Shkodrës, në trevën e Malit të Zi), me nga një gur në dorë që e hidhnin në vendin e shejtë në majë, ditën e Rushajave pa rënë dielli dhe me të lindur i faleshin atij. Të tilla rite bëheshin edhe në maja të tjera malesh në Shqipëri.40* Ky manifestim vazhdon të zhvillohet edhe sot, nga populli vendas i Anës së Malit dhe zonave shqiptare përreth (Kraja, Ulqini, Tivari, Malësia e Shkodra).

Kulti i diellit, duket të ketë qenë shumë i aplikuar në rajonin e Anës së Malit. Ai gjendet i aplikuar në shtëpitë e vendbanimit të vjetër në Kllezen, në formë të rrathëve koncentrik, në vendbanimin e Likajve në Brajshë, pastaj në formë të Treshit DIellor41 në mullirin e Isenit në Millën e Poshtme. Ornamente të kultit të diellit, në etnosin e rajonit të Anës së Malit, gjejmë edhe në veshjet tradicionale të Anës së Malit, mjetet shtëpiake të punës (hekuri, furka, djepa, arka) por edhe në gurët e varreve. *Në përgjithësi, mendojmë se në paraqitjen artistike të këtyre motiveve kemi të bëjmë me veçori vendëse për faktin se diellin e rrezatuar, rrathët koncentrikë, vijat e valëzuara, paralele e të thyera, hënën, të gjitha këto të kombinuara, i gjejmë si elementë shumë të dukshëm si tek ilirët, në Kulturën e Arbërit në Mesjetën e Hershme dhe tek Shqiptarët e, aq më tepër në forma të thjeshta e arkaike.*[42]

39 MARK TIRTA "Mitologjia ndër shqiptarët"
40 MARK TIRTA "Mitologjia ndër shqiptarët"
41 Treshi diellor - Rendi prej tri ornamentesh me kontur rrethor përkatësisht dielli ne lindje, zenit dhe perëndim
42 MARK TIRTA "Mitologjia ndër shqiptarët"

2. BANIMI TRADICIONAL NË ANËN E MALIT NË FUNDIN E SHEK. XIX DHE FILLIMIN E SHEK. XX TIPARET FUNKSIONALE TË NJËSISË DHE TËRËSISË

Si një popull me histori mijëvjeçare dhe me manifestim të spikatur të ekzistencës së vet, përmes të gjitha lëmive jetësore, kemi padyshim edhe manifestim te larmishëm të veprës ndërtimore. Kjo vepër ndërtimore, ka ndjekur pa ndalur historinë e këtij populli duke manifestuar nivelin e zhvillimit ekonomik, besimeve shpirtërore dhe organizimin shoqërorë të epokave të ndryshme. Trashëgimia ndërtimore përmban thesarin e dokumentimit të fakteve historike në shkallën më të lartë të vërtetësisë.

Trashëgimia ndërtimore në Anën e Malit, ka themele shumë të hershme. Ndonëse jo të gjitha të dokumentuara, nuk mund të mbetet as në nivel hipoteze, teza se këtu ka shenja jete nga parahistoria e hershme. Këtë e dokumentojnë padyshim fillimisht elementet e thjeshta siç janë artifaktet e gjetura në fshatrat Krythë, Kaliman e Shas (fig), mëpastaj edhe tumat ilire (jozyrtarisht të njohura) në fshatin Rashtish (fig) deri tek rrënojat në qytetin e vjetër të Shasit. Kjo tregon për një shtrirje të jetës përgjatë tërë perimetrit malor të rajonit të Anës së Malit. Jeta zhvillohej në shpat mali, ndërsa sipërfaqa fushore shfrytëzohej për bujqësi. Vendbanimet rrëzë mali ishin më strategjike, favorizonin blegtorinë, nuk zaptonin tokën e punës dhe kishin karakter të fortë mbrojtës (fortifikim natyral). Kjo është tipike për të gjitha vendbanimet ilire, e më vonë edhe ato shqiptare. Për rrënjë të thella të trashëgimisë ndërtimore, deri në parahistori, dëshmojnë edhe kultet pagane, pjesë e pandarë e ornamentikës ndërtimore. Kulti i diellit dhe kulti i gjarpërit,të bartur që nga ajo kohë, hasen edhe në ornamentikën e arkitekturës profane në trevën e Anës së Malit të shek. XVIII deri në shek. XX.

Arkitektura e mjeshtrit popullor në Anën e Malit, nuk njeh shkëputje. Si e tillë ajo është rezultat i traditës ndërtimore të përcjell në vite. Arkitektura e banimit, në fund shek. XIX dhe fillim shek. XX, në këto treva, tregon qartazi nivelin e zhvillimit ekonomik, shoqërorë dhe shpirtëror të kësaj treve. Vërehet nje nivel më i zhvilluar i ndërtimit dhe mbushja e një boshlleku të madh nga një periudhë paraardhëse më e errët. Adaptohen shpejt tiparet ndërtimore dhe avancohen elementet konstruktiv dhe funksional. Pasurohet ansambli brenda oborrit me objekte të reja, në funksion të zhvillimit të bujqësisë dhe bllegtorisë. Fillon shkëputja aty-këtu nga dedikimi i plotë i përdhesës për bagëti

duke adaptuar një pjesë të saj për qëllime tjera (banim, zejtari)

Shtëpia e banimit në Anë të Malit është tipike shtëpi banimi fshatare. Maksimalisht e përshtatur në pejsazhin natyror, e shkrirë në të funksionalisht dhe vizualisht. *Arkitektura jonë e traditës ka krijuar mrekulli që jo vetëm nuk ndërhyjnë ashpër në mjedis, por duket se burojnë prej tij.*[43] Ato kanë plotësuar kërkesën e njeriut për atë çka nuk mund të gjente në natyrë, sigurinë dhe strehimin. Vërehet qartë tipi i shtëpisë fshatare, me karakter të mbyllur, me pak hapësira që komunikojnë me jashtë si çardaqet e hapura[44], tremet[45] apo edhe hajatet[46]. Kjo është tipike për shtëpitë fshatare të ndërtuara në tërë rajonin. Për ndryshim nga shtëpitë qytetare me hapësira më të mëdha të komunikimit me natyrën, fshatarët pothuajse tërë ditën e kalonin jashtë në natyrë, ndërsa shtëpia iu ofronte atë çka ju kishte munguar gjatë ditës, qetësinë dhe rehatinë, prandaj nuk krijonin shumë ambiente të hapura. Kjo ka ndodhur edhe me shtëpinë e banimit në Anën e Malit si shtëpi tipike fshatare.

Ashtu si në tërë Shqipërinë veriperëndimore, ku *në pjesën më të madhe të krahinave terreni është malor i theksuar, që rrethon nga veriu e lindja fushat e Mbishkodrës dhe Zadrimën*, edhe në Anën e Malit, *ekonomia kryesore e banorëve ka qenë blegtoria, ndërsa në zonat e ulta, kryesisht bujqësia*[47]. Në fillim të shek. XIX, forma më e thjeshtë e banesave është ajo njëkatëshe me vetëm një ambient, shtëpinë e zjarrit. Banesa kryesisht kishte përmasa të zgjatura , në mënyre që më vonë të mund të ndahet në dy pjesë, ku në pjesën e dytë strehoheshin bagëtitë. Zhvillimi i banesës bëhej në drejtimin horizontal (gjatësorë), me shtimin e hapësirave të reja. Hyrja ishte dirkete nga jashtë për të gjitha hapësirat, përveç në raste shumë të rralla kur kishin lidhje të brendshme ndërmjet tyre. Megjithatë , shtëpia tipike, me përdorim të gjërë në këtë zonë ishte ajo dykatëshe, me skemë kompozicionale të thjeshtë. Zakonisht kishin nga një ambient në kat, kati përdhesë përdorej për strehimin e bagëtisë, ndërsa në katin e dytë zhvillohej jeta e familjes. Lidhja në mes kateve realizohej përmes shkallëve të jashtme, e më rrallë atyre të brendshme.[48]

---

43 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"
44 Çardaku i hapur
45 Treme
46 Hajat
47 A. BAÇE, A. MEKSI, E. RIZA GJ. KARAISKAJ, P. THOMO "Historia e arkitekturës shqiptare"
48 Po aty.

Skema më e zhvilluar kompozicionale përfshinte dy kthina në kat.

2.1 KRIJIMI I VENDBANIMEVE DHE KONFIGURIMI URBANISTIK

Territori i Anës së Malit, ka brenda vetes një larmi të vërtet të resurseve natyrore. Malet në tërë perimetrin territorial, Liqenin e Shasit në qendër dhe Lumin Buna në juglindje, janë vetëm disa nga shumë resurset natyrore e kësaj zone. Kjo ka favorizuar krijimin e vendbanimeve përgjatë tërë territorit, pothuajse në mënyrë të njëtrajtshme.

Vendbanimet në zonat malore janë ngritur në luginat e përrenjve ose mbi pllaja të larta. Kështu është krijuar vendbanimi i Krythës, Brajshës, Millës dhe Bojkut dhe Kravarit, ndërsa ai i Shasit në afërsi të Liqenit të Shasit. Nëse shikojmë shtrirjen e vendbanimeve malore, shohim se ato paraqesin *vijën e trashur* të përrojeve që burojnë nga malet qarkore të territorit të Anës së Malit. Shpati i malit ku gjendej vendabanimi përpunohej në mënyre teracore (vendësit i quajnë 'megja'), të cilat kishin gjërësi 3-15m varësisht nga vendndodhja dhe mbaheshin me mure guri të thatë. Përpunimi i terenit me teraca tregon se megjithatë edhe në këto zona zhvillohej bujqësia, ndonëse në nivel të ulët.

Vendbanimet në zonat e ulta kanë një zhvillim më të luhatshëm sepse *me vendosjen e pushtimit Osman ato u braktisën dhe u kthyen në moçalishte. Banorët e krahinave malore përreth i përdorën këto si kullota dimrore. Gradualisht këta banorë filluan të vendoseshin në këto zona, duke ushtruar edhe bujqësinë.Ata sollën me vete dhe mënyrën e të ndërtuarit.* [49] Vendbanimet në zonat e ulta megjithatë u ngritën mbi kodrina. Ky është rasti i fshatrave Selitë dhe Sukubinë, vendbanime të ngritura në kodrinat e zonës fushore. Përjashtim bëjnë fshatrat në bregun e lumit Buna të cilat u zhvilluan në zona të ulta, për arsye të afërsisë me tokën bujqësore. Sa i përket organizimit brenda vendbanimeve, ai është i thjeshtë dhe përcjell vijën e resursit rreth të cilit është krijuar vendbanimi.

2.2 KOMPLEKSI I OBJEKTEVE BRENDA OBORRIT

'Hija e shtëpisë përfshin tokat përreth, shtëpinë, mëdhecka, kasolle, shterpore, vathnajë gjaje, bletësh, pulash, stel qeni, koshtarë,

49 A. BAÇE, A. MEKSI, E. RIZA GJ. KARAISKAJ, P. THOMO "Historia e arkitekturës shqiptare"

mullarë.'[50]

Në mënyrën e jetesës në fshat, oborri i shtëpisë, përbënte mjedis të mirëfilltë banimi. Objektet ekonomike, parësore dhe dytësore, që gjendeshin brenda oborrit, luanin rrol të rëndësishëm në jetën fshatare. Ndonëse shtëpia si njësi, kishte frekuencën më të lartë të lëvizjes, elementet tjera brenda oborrit ishin aq të rëndësishme në përditshmëri saqë nuk mund të përjashtohen nga struktura e banimit.

Ansambli i oborrit të shtëpisë në Anën e Malit është mjaft i pasur në tërë zonën, megjithatë diçka më i pasur në zonat më të ulta. Oborri rrethohej me gardh degësh ose me mure guri të thatë. Lartësia e tyre ishte përherë nën nivelin e syrit. Porta hyrëse ishte e drunjtë pothuajse gjithherë, e profilit të thjeshtë dhe pjesërisht transparente. Rrallëherë në këtë zonë paraqitet *avllija*. Nga porta (trad. Trina) hyhej direkt në oborrin nga ku kishe akses në të gjitha objektet ndihmëse ashtu si edhe në shtëpinë e banimit. Përpunimi i oborrit ishte kalldrëm në pjesën më të madhe të tij, përgjatë shtigjeve lidhëse ndërmjet objekteve. Shtigjet lidhëse ishin të formës së çrregullt dhe lidhnin në vijën më të shkurtër dy pikat kontaktuese. Afër hyrjes në shtëpi, gjendej druri (mund të ishte pemë, por jo me doemos), i cili ishte më i vjetër se shtëpia. Vendësit kanë respektuar gojëdhënën *shtëpia ndërtohet aty ku mrizojnë delet*, gjatë përzgjedhjes së taprakut të shtëpisë, e aty në afërsi kishte çdoherë një dru, e cila nuk pritej edhe pas ndërtimit të shtëpisë. Varësisht prej nevojave të familjes por edhe mundësive të saj, përveç shtëpisë familja kishte në dispozicion të vetin edhe ndërtime ndihmëse si: *kasolle për banim të përkohshëm, kasolle për strehimin e bagëtive, vathë* për mbajtjen e bagëtisë së imët, *hajate ose strehë* të ndryshme (për mbajtjen e veglave bujqësore, pulave, qenit apo druve të zjarrit), *koshin apo kotecin* për mbajtjen e misrit, *mullarë* bari, kashte e gjethesh si ushqim për blegtorinë, *puse apo kroje* për ujë të pijshëm, *saranxha* për depozitimin e ujit, *mulli* për nxjerrjen e miellit të grurit dhe misrit etj.[51] Në shumicën e rasteve këto ndërtime janë ngritur brenda oborrit, por ka patur raste kur janë ndërtuar edhe jashtë tij. Ndërsa të ndërtuara kryesisht jashtë kompleksit të oborrit, në shërbim të familjes, ishin: *stanet* e bagëtive të ngritura kryesisht në mal, *lëmenjtë për shirje* , janë realizuar pranë arës së mbjellë me të lashta, këndet për larjen e rrobave kur nuk kishte burim uji në oborr etj. Pranë burimeve të ujit kishte të ndërtuara edhe lugje druri në të cilat pinin ujë bagëtia.

50 'Kanuni i Skenderbegut' - mbledhur nga DOM F. ILIA

51 ALI MUKA "Banesa fshatare dhe familja e madhe"

KOSHI - është krijuar si hapësirë ndihmëse, për ruajtjen e drithit. Paraqitet kryesisht në fshatrat e zonës së ultë. Forma planimetrike është rrethore ndërsa sistemi i punimit të mureve është në fomë të trinës (thurur me thupra). Muret janë të pavarura nga sistemi konstruktiv i mbajtjes së çatisë. Zakonisht sistemi konstruktiv vendosej jashtë, ndërsa muratimi nga brenda. Në kompozicionin e koshit paraqitet detali i derickave që shërbenin për zbrazjen e koshit. [52]

PUSET apo SARANXHAT - Në kompleksin e ngrehinave brenda oborrit, gjenden edhe puset, gjegjësisht saranxhat. Kjo në varësi të pozitës, në vendet malore ishte më shumë prezente saranxha, e cila bënte grumbullimin e ujërave të shiut si zgjidhje e problemit të furnizimit me ujë, ndërsa puset shfaqen kryesisht në zonat e ulta. Sipas studiuesit Flamur Doli prerja vertikale e puseve është e njëjtë në tipare strukturale formësuese me ato Ilire të gjetura në qytetin ilir NIKAE. [53]

MULLINJTË - janë objekte ekonomike të cilat zakonisht gjendeshin brenda oborrit, ose kishin qasje direkte prej tij.Paraqiten në fshatrat malore të Anës së Malit, në numër më të madh në fshatin Millë. Megjithatë mullinjtë si pjesë e trashëgimisë ndërtimore kërkojnë analizë të veçantë. Kjo për arsye jo vetëm të mullirit si objekt arkitektonik, por edhe elementeve tjera përcjellëse, që secili në vetvete përbën një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë.

.

2.3 STRUKTURA KOMPOZICIONALE E SHTËPISË SË ANËS SË MALIT

Shtëpia e banimit, ka qenë përherë për anamalasit, vendi ku kanë shijuar pushimin dhe rehatinë, pas ditës së ngarkuar me punët e fshatit. Kjo ka bërë që shtëpia tradicionale anamalase të marrë vetitë e shtëpisë fshatare, më konzervative ndaj natyrës në pamje të parë. Megjithatë vërehen ndikimet e klimës mesdhetare, tek dimenzionet e dritareve të cilat megjithatë nuk i kanë rezistuar rritjes, si edhe tek pjerrtësia e vogël e kulmit. Kjo ndërthurje e karakteristikave e bën shtëpinë anamalase të veçantë në llojin e vet.

Familja anamalase ishte e lidhur ngushtë me pronën e saj dhe tokat e punës, mbajtjen e bagëtive dhe kullosave Nga të gjitha këto duhej siguruar dhe përgaditur ushqimi, veshmbathja e anëtarëve të familjes, mirëmbajtja e banesës dhe elemente tjera të përgjithshme në përputhje me standardin e kohës. Për këtë arsye, shtëpia përveç njësive

52 FLAMUR DOLI "Arkitektura vernakulare e Kosovës"
53 FLAMUR DOLI "Arkitektura vernakulare e Kosovës"

me funksione banimi duhej të përmbante edhe hapësirat për strehimin e bagëtive, depozitat e rezervave ushqimore dhe ushtrimin e zejeve shtëpiake (punimi i veshjeve, endja e shtrojeve etj). *Në banesën fshatare të çdo tipi është vështirë të flitet për prani kthinash monofunksionale në kuptimin e plotë të kësaj fjale*[54]. Pra banesa nuk kishte funksion ekskluziv banimi por ishte një ngrehinë multifunksionale. Raporti i vendosjes së këtyre kthinave, paraqet vet zgjidhjen funksionale të banesës.

Moduli elementar i shtëpisë është katërkëndëshi i zgjatur. Brenda këtij moduli përfshiheshin elementet kryesore të shtëpisë, ndërsa jashtë tij elementet ndihmëse.

Shtëpia tipike anamalese ishte dykatëshe. Përdhesa ishte e dedikuar për mbajtjen e bagëtive. Hyrja në përdhesë bëhej në mes të fasadës ballore, përmes derës së drunjtë me gjërësi 1m deri në 1,8m. Elementi i derës ishte edhe elementi më i përpunuar i përdhesës dhe zakonisht e përpunuar në formë qemeri. Ndarja e hapësirës në përdhesë bëhej në dy pjesë, përkatësisht bagëtia e trashë në njërën pjesë dhe ajo e imët në pjesën tjetër. Ndarja bëhej përmes murit të thurur me thupra. Ndonjëherë në përdhesë gjendeshin edhe shkallët e brendshme të cilat të ngjisnin në hapësirën lart. Këto shkallë ishin të drunjta dhe zakonisht të lëvizshme. Kjo realizohej për arsye sigurie nga kushtet natyrore, por kishte edhe karakter mbrojtës.

Ngjitja për në katin e banimit, bëhej përmes shkallëve të gurit ose të drurit. varësisht nga përzgjedhja e mjeshtrit popullor. Megjithatë në këtë përzgjedhje ndikonte edhe pozita gjeografike, në zonat e ulta të Anës së Malit kryesisht paraqiten shkallët e drunjta. E kundërta ndodh në zonat malore. Kjo për arsye të afërsisë së materialit punues. Shkallët e gurit ishin të plota, me basamakë të përpunuar me rrasa guri. Zakonisht lartësia e vogël e përdhesës nuk kërkonte më shumë se 11 shkallë për t'u ngjitur në kat. Dimenzioni i rrasës së gurit përbënte edhe lartësinë e shkallës. Ndërsa shkallët e drurit ishin më të thjeshta. Konstruktoheshin nga dy traje të pjerrta, në të cilët inkastroheshin basamakët e drunjtë.

Nga shkallët mbërrihej në *çardakun*[55] e drunjtë i cili me hapësirën e *hajatit*[56] nën të, krijonte të ashtuquajturin bllok *hajat-çardak*, e që paraqet rastet më të spikatura dhe më të arrira nga ana

54 ALI MUKA "Banesa fshatare dhe familja e madhe"

55 Çardaku është është pjesë e hapur e rrethuar me parmakë në katin e sipërm të banesave popullore

56 Hajati është një hapësirë e jashtme në katin përdhesëtë ndërtesës

arkitektonike[57]. Funksioni i çardakut ishte për ndenje në kohë të mirë dhe për pritjen e miqve. Por shërbente edhe si hapësirë ndërlidhëse për hapësirat e banimit (zakonisht shërbente për hyrje në katin e banimit). *Çardaku është kurdoherë i mbuluar nga çatia me strehë të gjërë dhe trarë në dukje, ndërtohet me strukturë druri, parmakë dhe dysheme druri*[58]. Në rastin kur kjo hapësirë ishte e pambuluar, mund të flitet për paraqitjen e tipareve të *kameries*[59] si element ndërtimi.

Dera e hyrjes në kat, së bashku me dritaret e jashtme janë edhe elementet më të përpunuara të shtëpisë së banimit në Anën e Malit. Korniza e derës përbehej prej dy gurëve-shtyllë dhe arkitraut i cili në të shumtë e rasteve ishte harkor në anën e jashtme, ndërsa me arkitra druri nga brenda. Spikaten ornamente të shumta në arkitraun e derës ku më i arrirë është ai i *treshit diellor*. Dera hyrëse ishte e drunjtë me konstruksion bartës hekuri dhe mbyllej me *dang* ose *çengel*. Nga dera hyhej direkt në katin e banimit të familjes. Skema më e thjeshtë përmban dy ambiente në kat: *odën e zjarrit* dhe një *qilar* (dhomë gjumi), ndërsa ajo më e zhvilluar përmban dy *qilarë* (maksimalisht tre). Pjesë e katit të familjes ishte zakonisht edhe *nevojtorja* e cila në të shumtën e rasteve dilte jashtë strukturës së katit në formë erkeri. Qilarët ishin dhoma gjumi të vogla, për vendosjen e çifteve bashkëshortore, me një krevat të gjërë dhe një *arkë* karakteristike për ruajtjen e rrobave. Koridori i cili i lidhte ambientet branda katit përmbante edhe *kapanin*. Kapani ishte platform lëvizëse e dyshemesë prej druri, e cila ngrihej dhe mundësonte akses në shkallët e drunjta që të çonin në *ahër.*Hapësirat brenda katit të banimit ndaheshin me gardhe të thurura me thupra dhe të përpunuara me llaç gëlqeror.

2.4 SHTËPIA E ZJARRIT DHE ODA E MIQVE

'Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut'[60]

Karakteristikë e trevës së Anës së Malit është ndërthurja e këtyre dy kthinave. Shtëpia e zjarrit [61] dhe Oda e miqve, paraqiten të bashkangjitura, si në aspektin funksional edhe atë hapsinorë në një

57 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"

58 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"

59 Kameria është një volum ndërtimi që krijon një shesh qëndrimi, soditje dhe vëzhgimi. Kameria është e pambuluar dhe e rrethuar plotësisht me parapet prej guri.

60 Thënie popullore Shqiptare

61 Oda ku bëhet përgaditja e ushqimit si dhe kryhen punët e shtëpisë

ambient. Ky strukturim është i veçantë dhe shumë i rrallë ndër shtëpitë e traditës. Në vazhdim do të përdorim termin oda e ndënjes si një emërtim i zonës, më i përafërt. për këtë ambient.

Në tipare formësuese strukturtale, oda e ndënjes në banesën e Anës së Malit, përputhet më së miri me atë të shtëpisë së zjarrit, ndërsa ndryshimin e vetëm e ka tek tiparet funksionale ku ka ngërthyer në vete atë të qëndrimit të miqve.Për këtë arsye ajo është njësia , që më së miri ka ruajtur tiparet e veta. *Ajo, me të gjitha tiparet paraqitet si një konstantë në fomësimin struktural hapsinor dhe kompozicional të njësisë së banimit*[62] Ajo është pjesa më reprezentative e shtëpisë, zë pozicionin më të përshtatshëm orientues, përfshin pjesën më të madhe të katit të banimit dhe kryen funksion të shumfishtë.

Anamalasi i kushton rëndësi të veçantë odës së ndënjes.Ajo i ka marr vëmendjen më të madhe mjeshtrit popullor, si në përpunimin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm. Gërshetimi i funksioneve brenda kësaj dhome spjegon shumë edhe për mënyrën e jetesës së anamalasit.

Oda e ndënjes, me dispozicion arkitektoniko funksional të tipizuar, në kontekst të evoluimit të kullës, paraqitet si mbijetojë e pandryshuar që nga periudha e neolitit të vonë[63].

Në *odën e ndënjes*, te shtëpia e Anës së Malit, hyhej përmes derës së drunjtë. Zakonisht dyert e brendshme i përmbaheshin dimenzionit 0,60m deri në 1,0m në gjërësi dhe 1,90 deri në 2,0m në lartësi(arsyeja ishte përkulja para hyrjes në odë). Kapakët e dyerve realizoheshin me dërrasa, trashësia e të cilave shkon nga 4 deri në 6cm, të vendosura vërtikalisht dhe të lidhura me binarë horizontal. Tërë sipërfaqa e ambientit organizohej në kënde të ndryshme, me funksione të ndara. Të gjitha këndet funksionale kishin rol të rëndësishëm në jetën e familjes dhe në përputhje me këtë funksion bëhej edhe mobilimi i tij. Nyjet kryesore funksionale të kësaj kthine janë:

- *Vatra e zjarrit dhe oxhaku* - me sipërfaqe të përgjithshme deri në $5m^2$. shërbente për gatim, pjekje, qëndrim e ngrohje. Gropëza e vatrës ishte më e thellë se niveli I dyshemesë për 10-15cm, e shtruar me gurë, ndërsa rrethohej me gurë të latuar (deri në 12cm) që dilnin mbi nivelin e dyshemesë e që quheshin *buza e vatrës.* Në skajet e buzës së vatrës, afër oxhakut. ishin dy gurë më të mëdhenj, *carojtë,* të ciët ngriheshin gjys

62 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"

63 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"

pëllëmbe mbi nivelin e gurëve të buzës së vatrës. Carojtë shërbenin për të ndaluar shpërndarjen e druve të zjarrit. Nga trarët e çatisë lëshohej në drejtim të vatrës *vargoni*, në të cilin varej *gjygymi,* ose ndonjë enë tjetër. Gjatë uljes pranë vatrës vendi më i nderuar ishte ai pranë *carojve*, ndërsa përreth vatrës shtroheshin *postet* (*postiqe,* lëkura bagëtish), *rrogoza, shilte* ose trungje a stola të vegjël prej druri. Në afërsi të gropës së zjarrit vendosej *pishtari* mbi të cilin qëndronte *kandili*.[64]

- *Këndi i gatimit dhe këndi i pjekjes së bukës* - Gjendej në pjesën e odës ku kishte më pak lëvizje. Këndi i gatimit përbëhej nga hambari ku mbahet misri dhe magjja ku përpunohej brumi. Magjja dhe hambari realizoheshin vetë, zakonisht nga druri. Ndërsa pjekja e bukës, bëhej varësisht në vatër ose në furrë (disa shtëpi kishin furrën e brendshme për pjekjen e bukës). Varësisht nga mënyra e pjekjes kishte edhe bukë të ndryshme si *bukë gjethje, bukë votre,* bukë çerepi, *bukë tepsie, bukë saçi , bukë kakije,* etj.[65] Buka në furrë, ose në votër, lëshohej me *qethe*.

- *Këndi i enëve të gatimit dhe të ngrënies* - Në këtë këndi, vend kryesorë zenin *sergjenet,* në të cilat vendoseshin enët. Ato kishin gjërësi rreth dy pëllëmbë. Në to vendoseshin enët, pingul ndaj murit. Dërrasa për vendosjen e lugëve ishte me vrima, ku futeshin lugët me kokë lart dhe bishtin poshtë. Poashtu kishte edhe *grremça* druri të vendosura në mur ku vareshin enët e ndryshme të gatimit. Afër këndit të enëve mbështetur për mur qëndronte *sofra*. Ndër enët tjera që janë përdorur njihen: *sinia, tasi, çinia, vekshi, kusia, kazani, sepeti, tinari, oksha, shekja (shegla), tija (mtija), magripa, kupa, vorba, legen* Enët e gatimit (vekshi, kazani, funtereja) ishin prej bakri dhe njihet procesi I *kallajtisjes* (rigjenerimit të enëve).

- Këndi I larjes së enëve. - vendosej afër këndit të enëve dhe përbëhej prej një çeltine në trashësinë e murit ku vendosej *sqolli.* Afër sqollit ndodheshin *mashtrapat, katrova* dhe *ibrikët.*

- Këndi I mbajtjes së bylmetit - QURI

Gjatë shfrytëzimit të kësaj ode si odë e miqve, ajo fiton disa cilësi të reja. Zjarri I votrës bëhet qendra, rreth të cilit ulen të gjithë, miqtë dhe anëtarët e familjes. Mënyra e të ndenjurit ishte ulur ose këmbëkryq. Sipas zakoneve ulja ishte e përcaktuar qartë, në krye të vendit, më afër oxhakut, ulej miku. Ndërsa më pas sipas një hierarkie moshe dhe afërsie të gjakut uleshin të tjerët. I zoti I shtëpisë ulej pëballë mikut, në pozitë që t'I mundësonte pjekjen e kafes. Në të dy anët e

64 ALI MUKA "Banesa fshatare dhe familja e madhe"
65 ALI MUKA "Banesa fshatare dhe familja e madhe"

oxhakut ndodh të ketë dritare, ndërsa pothuajse çdoherë gjenden dy çeltina në trashësinë e murit (dollap). Në këto çeltina mbahej kafeja dhe filxhanët e kafesë, për këtë arsye quhen edhe *dollapet e kafesë*. Kjo hapësirë shfrytëzohej për ndenje, ngrënie por edhe fjetje.

Elementet konstruktive të kësaj hapësire janë poashtu interesantë. *Dyshemeja* Ishte prej dërrasave të çara me sopatë (sakic), të vendosura mbi trarët mbajtës. Kishte raste kur mbi to vednosej një shtresë balte. Afër votrës, në vendin ku shtrohej sofra, gjendej zakonisht vrima në dysheme, nga ku, pas ngritjes së sofrës, hudheshin në katin më poshtë copëzat e ushqimit (dramcat), me të cilat ushqeheshin bagëtia e imët (zakonisht pulat). *Tavani* shfaqet vonë dhe paraqitet shumë rrallë si element I hapësirave të familjes.

Ndriçimi bëhej permes dritareve të cilat gjendeshin në anën e murit ku gjendej oxhaku, ose në murin përbri. Lartësia e dritareve nga dyshemeja është dy pëllëmbë, në mënyrë që të lejonte pamjen jashtë nga pozicioni I ulur këmbëkryq. Pamja e dritareve është shpeshherë jugore, e gjithherë nga oborri i shtëpisë. Dimenzionet e dritareve janë 40-50cm gjërësi dhe 60-70cm lartësi. Nga jashtë dritaret mbylleshin me kapakë druri.

Në banesën e Anës së Malit, më rrallë, paraqitet edhe një ballkon i brendshëm me tipare të *divanhanes.*Zakonisht dilte nga sipërfaqa e murit me traje druri të vazhduara nga konstruksioni I brendshëm. Nga jashtë, pjesa ballore e këtij ballkoni të brendshëm, ishte e rrethuar me dritare që Anamalasit e quajnë *taraba.* Gjërësia shkon deri në 2m jashtë volumit të mureve.

Ashtu si për çdo gjë tjetër, të gjthë elementet e shfaqur brenda shtëpisë së zjarrit (odës së miqve), varet nga kërkesa e familjes, aftësia e mjeshtrit popullor dhe mundësia ekonomike e familjes për realizim. Për këtë arsye, shtëpia e zjarrit, paraqet edhe fotografinë më të qartë të pozitës ekonomike të familjes. Ndërsa, mbivendosja e shtëpisë së zjarrit me odën e miqve, nuk duket të ketë qenë si pasojë e pamundësisë ekonomike aq sa rezultat I mosnevojës për një hapësirë të tillë.

3. FORMËSIMI ARKITEKTONIK

Shtëpitë e fshatrave të Anës së Malit, kanë strukturë të pastër hapsinore. Struktura gjeometrike (moduli bazë ndërtimorë) është në formë paralelopipedi, drejtkëndëshi të zgjatur, e rrallëherë në formë katrori. Raporti i brinjëve të drejtkëndëshit shkon nga 1:1,5 deri në 1:2. Gjeometria drejtkëndore e shtëpisë, në vija të trasha, përbëhet nga tre

mure anësore me strukturë guri, dhe fasadës ballore, e cila kishte kombinim struktural të materialeve gurë dhe dru. Kjo fasadë zakonisht ishte me orientim jugorë (juglindor ose jugperëndimorë) , ndërsa gjithmonë e orientuar nga oborri i shtëpisë.

Për ndryshim prej formës së tërësishme gjeometrike, hapësirat e brendshme tentonin drejt formës gjeometrike katrore, që i përmbahej frekuencës së raportit 1:1 deri në 1:1,5, megjithatë duke ruajtur formën e drejtkëndëshit. Zakonisht forma e njëjtë e modulit fillon nga poërdhesa dhe vazhdon në kat, por ndodh edhe që paraqitet përdhesa si më e madhe dhe e kundërta kur kati është më I madh. Kjo ndodh zakonisht në zona me teren të përthyer.

Jashtë volumit kryesorë, dalin elementet sekondare të shtëpisë. Ato jo vetëm strukturalisht por edhe vizualisht dalin jashtë modulit kryesorë. Si elemente dytësore llogariten: pullazi, shkallët e jashtme, hajati, çardaku, divanhaneja, telizi, streha, daljet e nyjeve sanitare etj.

Fasada e shtëpisë së Anës së Malit shquhet me një vendosje të mprehtë të elementeve. Pasqyrimi i elementeve deri në *simetri* ndodh më rrallë, por ka simetri të pjesshme të elementeve. Ndërsa më së shumti, paraqitet *ekuilibri* si efekt i fasadës. Ekuilibri i fasadës arrihet me vendosjen e pasqyrimit të njërit grup të elementeve dhe balancimin e elementeve të tjera të fasadës. Kjo ndodh psh. *shkallët e jashtme në fasadë, bartin simetrinë në njërën anë, ndërsa divanhaneja në anën tjetër, ekuilibron pamjen.*

Ritmi dhe përsëritja si elemente arkitektonike të fasadës, shfaqen të respektuara, por në shkallë të thjeshtë dy dimenzionale. Ndërsa raporti ndërmjet pjesëve, apo raporti *pjesa-tërësia,* synon të ruaj proporcion të përafërt, duke grupuar elemente për të krijuar pjesë më të mëdha. Kështu psh. *Dritaret dyshe shfaqen si grup në raport me fasadën, për të ruajtur proporcionin me tërësinë (që mos të duken të vogla).*

Transparenca si veti vizuale, paraqitet e thjeshtë me plane të ndara. Me transparencë nënkuptojmë vetinë e fasadës për të shfaqur dukjen e planeve të njëpasnjëshme në thellësinë e pamjes[66]. Kështu psh *në shtëpinë e rajonit të Anës së Malit, plani i parë i fasadës krijohet me fasadën e bllokut hajat-çardak ndërsa e plani i dytë me atë të murit nga moduli kryesor i shtëpisë.*

66 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"

3.2 ELEMENTET KONSTRUKTIVE DHE ARKITEKTURA

Për të filluar konstruktimi i shtëpisë, në Anën e Malit, së pari bëhej zgjedhja e trollit ndërtimor. Ky truall, zgjidhej me kujdes nga më të moshuarit, ku siç thamë më heret, kishte një sërë testimesh paraprake. Siç thamë më heret prova me vathim delesh, me kalin e shalës, apo edhe mbjellja paraprakisht e truallit me drithë, tregojnë për praktika të ndjekura për përzgjedhjen e truallit. Pas përzgjedhjes së truallit, fillonte konstruktimi i shtëpisë. Në zonën e Anës së Malit, kanë punuar në të shumtën e rasteve mjeshtrit ndërtues nga Shqipëria Verilindore të njohur me emrin *dibranë*.

Gurthemeli - hedhja e gurthemelit, ishte akti fillestar i konstruktimit të shtëpisë. Në fillim bëhej *matja* apo piketimi i themeleve.Si elemente për piketim përdornin kunja druri, spango, metër, plumçe etj. ndërsa si njësi matëse ishte *pashi* (rreth 1,5m) dhe *pëllëmba* (rreth 20cm). Gjërësia e themeleve ishte zakonisht 5 pëllëmbë, ndërsa thellësia varësisht nga lloji i tokës. Sa i përket përmbushjes së kritereve (lagështia e tokës, koha e fillimit të punës, fortësia e tokës), vendoste mjeshtri më me përvojë. Mënyra e muratimit ishte e njëjtë me atë të mureve mbi tokë. Dallimi është tek shtresa e parë e gurëve të themelit, ku bëhej hedhja e tyre në tokë të thatë (pa llaç balte). Pa llaç balte vendosej shpeshherë edhe shtresa e dytë e gurëve, ndërsa mëpastaj vazhdohej muratimi me llaç. Kjo bëhej për arsye të largimit të ujërave sipërfaqësorë (kullimi). Respekti ndaj gurthemelit në Anën e Malit ka qenë i një niveli të lartë. Është besuar se aty qëndron mbarëvajtja e ndërtimit, jetëgjatësia e tij deri edhe mbarëvajtja e familjes. Për këtë arsye hapjen e themeleve e shoqëronin një sërë zakonesh e ritesh të karaktereve të ndryshme (më i njohuri është ai i derdhjes së gjakut).

Muret - kishin rëndësi shumëfishe në konstruktimin e banesës. Përveç rrolit konstruktiv-mbajtës ato kishin edhe rrol estetik, funksional dhe fortifikues. Në shtëpinë tradicionale të Anës së Malit gjejmë përdorim pothuajse të përhershëm të mureve mbajtëse nga guri. Të pakta janë gjurmët e përdorimit të mureve nga druri, si mure mbajtëse. Sa i përket mureve konstruktive mbajtëse nga druri, shumë rrallë gjenden si mure të thata (pa llaç), ndërsa më shpesh me llaç gëlqereje e ndonjëherë edhe me llaç balte. Shkalla e përpunimit të murit, te Shtëpia e Anës së Malit, është tipike e shtëpisë fshatare shqiptare. Përpunoheshin elementë të fasadës si gurët e qoshnikut, gurët e brezit të kurorës, por jo edhe sipërfaqa e plotë e murit e cila mbetej e papërpunuar. Për fillimin e murit mbi themel, fillimisht bëhej përzgjedhja e gurëve, grumbullimi i

tyre, përpunimi i elementeve të qoshnikut, kornizave të dyerve, dritareve e oxhaqeve dhe pastaj muratimi[67]. Përveç përpunimit, në gurët e qoshnikut por edhe ne kornizat e dritareve gjejmë edhe relieve me motive të ndryshme. Pajisjet për punimin e murit janë ato që përmendëm më heret, ndërsa mënyra e zbatimit të punimeve është forca e krahut. Për dallim prej mureve mbajtëse, muret e brendshme të shtëpisë (muret ndarëse), realizoheshin edhe me materiale të tjera si druri apo qerpiqi.

Çatija - është elementi përmbyllës i konstruksionit të shtëpisë së banimit. Çatia përbëhet nga konstruksioni mbajtës dhe mbulesa. Për ndërtimin e të parës, kushtohej mund dhe kujdes i madh nga ana e fshatarëve. Lënda që përdorej në strukturën e çatisë pritej në mes të pranverës, ndërsa qëndronte e prerë për kalitje, së paku një vit kalendarik. Përndryshe lënda e prerë do *brehej* nga krimbi. do kalbej e nuk do jetonte gjatë. [68] Mëpastaj lënda e prerë latohej deri në pjesën e *skuqit*[69] për arsye të fortësisë dhe jetëgjatësisë. Shtresa e mbulesës së çatisë ishte rrasa e gurit ose tjegulla. Rrasat e gurit përpunoheshin nga mjeshtri popullor, ndërsa tjegullat përgaditeshin nga vetë fshatarët. Sa i përket kullimit, Tipike për shtëpinë e kësaj zone është çatia me katër kullime, por varësisht nga kushtet, përdorej edhe ajo me dy apo me tre kullime. Pjerrtësia e kullimeve nuk ishte e madhe në përputhje me kushtet klimatike të vendit.

3.2 TEKSTURA DHE NGJYRA

Përpunimi i materialit punues, ka qenë çdoherë pjesa më mjeshtërore e porcesit të ndërtimit. Arritja e përpunimit të materialit bëhej në atë nivel që ai të shfaq më së miri karakteristikat që bart. Varësisht prej kërkesës së porositësit, materiali përpunohej i lëmuar, i ashpër apo i dekoruar. Ndërsa sa i përket ndjesisë dhe ngjyrës, përdorej kontrasti i lehtë ngjyrave natyrore të materieleve të ndryshme(kryesisht gurit dhe drurit) e cila njëkohësisht barazpeshonte ndjenjën ngrohtësisë apo ftohtësisë. Arkitektura e banimit në rajonin e Anës së Malit, ashtu si edhe në tërë hapsirën Shqiptare, nuk fsheh vetitë e materialit, përkundrazi i shfaq me krenari ato. *Në këtë mënyrë materiali dhe ngjyra e tij natyrore janë moraliteti dhe logjika estetike e arkitekturës sonë të traditës.*[70]

67 ALI MUKA "Banesa fshatare dhe familja e madhe"
68 ALI MUKA "Banesa fshatare dhe familja e madhe"
69 shtresa e brendshme e drurit, zemra e drurit
70 MAKSIM MITROJORGJI dhe JOLI MITROJORGJI "Forma përmbajtja dhe arkitektura"

JUBILE – VITI 2018 VIT I SKËNDERBEUT

Qani Osmani

GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU

(Me rastin e 550 vjetorit të vdekjes)

Për popullin shqiptar datat e shënuara të historisë nuk kanë qenë kurrë dhe nuk duhet të jenë vetëm ngjarje të thjeshta, të cilave u detyrohet vetëm një lloj respekti konvencional, në një ditë të caktuar të kalendarit, për t'i lënë pastaj në gjumin e haresës. Por përkundrazi duhen të trajtohen si ruajtës, vazhdues dhe kurorëzues i thesarit të traditave historike, patrotike, duke i vlerësuar lartë këto tradita, duke i mbajtur të gjalla në shërbim të çështjes së madhe të lirisë e pavarësisë kombëtare, të mbrojtjes së tërësisë dhe sovranitetit të tokës së shejtë të atdheut, të luftës për ndërtimin e jetës së re më të lumtur. Në mënyrë të veçantë kjo vlenë për figurën lavdiplote të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, që qëndron lartë si përmendore vigane e njërës nga periudhat më vendimtare të historisë sonë kombëtare dhe zë një vend të shquar nderi edhe në faqet e historisë botërore. Ne sot në këtë 550 vjetor Jubilar të vdekjes të heroit tonë kombëtar, përkujtojmë me mirënjohje një epokë të tërë që mbanë me të drejtë emrin e tij, si një nga epokat më vendimtare të historisë kombëtare, në të cilën masat popullore shqiptare, si heronjë pa emër, nën udhëheqjen e Skënderbeut për shumë vite me radhë luftuan për mbrojtjen e tokës së lirisë e të pavarësis së vet, duke i vënë themelet e qëndrueshme asaj ndërtese që brezat e ardhshëm e çuan në fund, bashkimit të popullit shqiptar në shtetin e tij kombëtar.

Viti 2018 për shqiptarët kudo që janë në botë (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Luginë të Preshevës, Mal të ZI dhe diasporë) shënon një ngjarje madhështore e kuptimplote. Ky vit është shpallur përvjetor Jubilar kushtuar Gjergj Kastrioti Skenderbeut me rastin e 550 vjetorit të vdekjes. Me botën mbarë, sot në këtë përvjetor, ne përkujtojmë epokën e Skenderbeut si një pjesë të asaj lufte të madhe, në të cilën popujt e Evropës Juglindore, e midis tyre në radhët e para populli shqiptar, duke luftuar për tokën dhe lirinë e vet, u bënë një ledh mbrojtës për të ndaluar vërshimin shkatërrues të agresionit të sulltanëve Osman në shekullin

XV, agresion që vinte në rrezik fatet e qytetërimit evropian në përgjithësi.

Kastriotët e kanë origjinën nga Hasi i Kuksit. Gjyshi i Skenderbeut, Palë Kastrioti, mund të jetë larguar nga Hasi dhe të jetë vendosur si pronar i dy fshatrave në Luginën Drinit të Zi (Sinjës dhe Gardhit të Poshtëm). Zotërimet e Kastriotëve filluan të zgjeroheshin që në fund të shek.XIV, nga i biri Gjon Kastrioti, që ishte i ati i Skënderbeut. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu lindi në vitin 1405. Gjergji ishte djali më i vogël dhe fëmija i parafundit i familjes me shumë fëmijë të Gjonit dhe Vojsavës, familja e së cilës banonte në krahinën e Pollogut. Ata kishin katër djem (Stanishin, Reposhin, Konstatinin dhe Gjergjin) dhe pesë vajza (Marën, Jellën, Angjelinën, Vllajkën e Mamicën).

Gjergj Kastrioti lindi në një kohë kur Principata e Kastriotëve ishte fuqizuar. Në moshën nëntëvjeçare ai u dorëzua peng tek osmanët, së bashku me dy vëllezërit e tjerë. Zgjuarsia dhe shkathtësia e dalluan nga vëllezërit e tij. Prandaj, për rreth 10 vjet Gjergji vazhdoi shkollën e içogllanëve për t'u përgaditur si qeveritar i Perandoris Osmane. Natyra e kishte paisur me dhunti të veçanta mendore dhe fizike. Gjatë shkollimit ai u dallua nga të tjerët, u përgatit ushtarakisht dhe mësoi disa gjuhë të huaja. Atij iu vu emri Skënder. Skënderbeu ishte më i vogli i katër djemve të Gjon Kastriotit. Fëmijëria e tij bie në vitet kur vërshimet osmane ishin që nga Jugu drejt Veriut, duke i imponuar vendit një regjim që sillte një vështërësi dhe rëndim të përgjithshëm ekonomik-shoqëror të masave të vendit. Nën këto goditje u gjendën qysh herët edhe Zotërimet e Kastriotëve, që shtriheshin në Shqipërinë e Mesme-Lindore. Lufta kundër këtij pushtimi me pasoja shkatërimtare që vinin në rrezik gjithë zhvillimin e arritur nga vendi si dhe të ardhmen e kombit shqiptar, përbënte thelbin kryesor dhe detyrën themelore të jetës dhe veprimtarisë së Skenderbeut

Përvoja e 30 viteve të para të shekullit XV i kishte treguar Skënderbeut gadishmërinë e masave popullore për të luftuar. I kishte treguar se lufta e veçantë e zotëruesve të ndryshëm feudal si dhe kryengritjet popullore në krahinat e ndryshme veçmas, sado të fuqishme që kishin qenë, nuk ishin në gjendje të ndalin pushtimin Osman. Po ashtu ishte bërë e qartë për Skënderbeun se sulltani nuk lejonte në asnjë mënyrë që Zotërimet e Kastriotëve të mbeteshin të bashkuar qoftë në formën e një ziameti me vete në kuadrin e Sanxhakut shqiptar, që ishte formuar më 1431.

Pra, këto ishin rrethanat, në të cilat u zhvillua ajo kthesë vendimtare dhe fillon ajo periudhë e re më e lartë në luftën kundër pushtimit Osman dhe gjithë historin e kombit shqiptar që lidhet me emrin dhe veprën e Skënderbeut. Kjo kthesë që zhvillohet në vitet 1443-44, i ka rrënjët në kushtet objektive e subjektive të brendshme, që u favorizua edhe nga disa rrethana të jashtme.

Pushtimi i tokave serbe në vitin 1439, goditjet e njëpasnjëshme kundër Mbretërisë Hungareze, si dhe përparimi i ushtrisë Osmane në viset qendrore të Ballkanit drejt Danubit e detyruan Mbretërin Hungareze të kalonte që nga viti 1442, në një politikë kundërsulmuese të fuqishme kundër osmanëve. Përfaqësuesi i kësaj politike u bë J. Huniadi, i cili pas Skënderbeut u bë një nga figurat më aktive të luftës antiosmane. Nën udheheqjen e tij, një ushtri hungareze kaloi në vjeshtë të vitit 1443 Danubin. Për t'i siguruar Mbretëris Hungareze mbështetje, u zhvillua një veprimtari e gjallë diplomatike, në mesin e të cilëve u përfshi edhe Arbëria.

Në betejën e Nishit që u zhvillua në ditët e para të nëntorit në vitin 1443, ku forcat Osmane pësuan disfatë, qëndrimi i Skënderbeut nuk ishte një veprim i lindur spontanisht, por rezultat i planit të paramenduar. Në këtë betejë siç tregojnë burimet morën pjesë me repartet e veta të gjithë sanxhakbejlerët. Skënderbeu u tërhoq me forcat shqiptare që kishte me vehte, dhe ato që mundi të mblidhte. I pajisur me nji ferman që ia mori me forcë, siç na tregojnë shumë burime, sekretarit të vulës së Bejlerbeut, me shpejtësi të rrufeshëm Skënderbeu mori rrugën e kthimit në atdhe, rrugën e kryengritjes së hapur kundër sulltanit. Skënderbeu i vetëdijshëm se gjithçka varej nga shpejtësia e veprimit dhe i vendosmërisë, për të ngritur në këmbë masat, për të zënë në befasi garnizonet armike në vend, për tu marrë atyre kalatë, i nevoitej një pikmbështetje e fuqishme e masës popullore nga të gjitha anët e vendit. Në këtë drejtim faktori vendimtar që e lehtësoi planin e Skenderbeut ishte përgjigjia që e gjeti që në hapat e para ky veprim në tokat shqiptare. Mobilizimi masiv i forcave që filloi së pari në Dibër dhe vazhdoi në të gjithë vendin, ishte prova dhe sinjali se këtu ishte fjala për një veprim që u kthye brenda pak kohe në një kryengritje të përgjithshme. Në këtë veprim gjenin shprehje dhe aspirata të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare; fillimisht të masave fshatare mbi të cilat rëndonte prej kohësh pesha kryesore e sundimit të huaj, por edhe të asaj pjese të klasës feudale që ishte shpronësuar tani më apo ishte në rrezik të shpronësohej me zgjerimin e mëtejshëm të pushtetit Osman.

Në fillim të kthimit, Skënderbeu zhvilloi një veprimtari të gjërë, të palodhshme dhe vendimtare deri në skajet më të largëta të vendit. Brenda tre muajsh u çliruan dhe u morën kalatë e mëdhaja dhe u çlirua principata e Kastriotëve si dhe pjesa më e madhe e trevave shqiptare. Sa lartë e çmonte Skënderbeu gadishmërinë luftarake të kombit, tregojnë fjalët që ai tha, sipas Barletit, në çastet solemne kur në kështjellën e Krujës së çliruar më 28 Nëntor të vitit 1443, u ngrit përsëri Flamuri i Kastriotëve me shqiponjën e zezë dy krenore me fushë të kuqe, që u bë tani e tutje flamuri historik i luftërave për liri të popullit shqiptar: ***"Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta këtu në mesin tuaj...armët nuk ua ngjesha unë, por ju gjeta të armatosur, lirinë e kishit kudo në krahënor, në ballë, në shpatë, në ushtat!"***-u tha ai ushtarëve në takimin e parë me ta.

Populli shqiptar i asaj kohe duke nxjerrë mësime nga përvoja e dhjetëra viteve luftime e dështime në planin shqiptar, Skënderbeu u bë guri themeltar i gjithë veprimtarisë së tij si burrë shteti dhe udhëheqës ushtarak në vitet që do të pasojnë më vonë. I vetëdishëm se pa mos i kapërcyer pozitat e vjetëruara politike të përçarjes së vendit në një varg zotrimesh të veçanta, pa krijuar një bazë politiko-ushtarake të organizuara e të qëndrueshme, pa mos i bashkërenditur veprimet e brendshme me lëvizjet antiosmane që organizoheshin në plan të jashtëm, lufta nuk do të kishte perspektivën e fitores. Pra, ishte meritë e madhe e Skënderbeut që u ba udhërëfyesi dhe zbatuesi më i qartë, më i ndërgjegjshëm dhe më i vendosur i kësaj domosdoshmërie që impononte situata objektive e asaj kohe.

Pas fitoreve të para të viteve 1443-44, filluan gjithnjë e më të të forta kundërgoditjet e ushtrive Osmane, të cilat niseshin nga bazat e tyre të mëdha në portet e trojeve shqiptare, në Manastir, Ohër, Kostur e Shkup me forcat gjithnjë e më të mëdha, me ekspeditat të organizuara vit për vit me një rregullsi të paramenduar, kohën e mbjelljeve e të korrave, për t'i shterur forcat njerëzore dhe mundësit ekonomike të trojeve shqiptare. Si detyrë më urgjente, ishte organizimi sa më efektiv të mbrojtjes së vendit, i shërbeu thirrja e Kuvendit të Lezhës (2 mars të vitit 1444), dhe themelimi i Beslidhjes të sundimtarëve shqiptar si organ politik.

Skënderbeu me autoritetin e vet që gëzonte si udhëheqës i kryengritjes së përgjithshme dhe nismëtar i mbledhjes, si përfaqësues i njërës nga principatat më të mëdha e të randësishme të vendit nga pikpamja politike dhe ushtarako-ekonomike, mundi t'u inponohej sundimtarëve feudal dhe përfaqësuesve të krahinave të vetëqeverisura

për të kapërcyer divergjencat që kishin midis tyre. Lidhja e Lezhës u bë kështu i pari bashkim politik në shkallën mbarëshqiptare që njihet në historinë tonë. Skënderbeu u zgjodh kryetar i Lidhjes dhe komandant i përgjithshëm i saj. Nën udhëheqjen e Skënderbeut, ushtria që ai e organizoi, kaliti e komandoi, u bë një armatë e fuqishme tejet e shkathët për mbrojtjen e vendit. Tokat shqiptare për më se 25 vite mundën t'u bënin ballë vërshimeve të njëpasnjëshme, betejave masive, bllokadave dhe rrethimeve që organizuan Murati II dhe i biri Mehmeti II, i mbiquajtur "Pushtues i botës", për të zhdukur këtë vatër qëndrese në brigjet lindore të Adriatikut, në një kohë kur vëmendja e osmanëve ishte drejtuar parasëgjithash drejt Evropës së Mesme.

Nën drejtimin e tij, Kuvendi i Lezhës u bë bërthama e parë efektive për njësimin politik e ushtarak të forcave të popullit shqiptar kundër pushtimit Osman. Kjo nuk ishte një dukuri e rastit. Më shpejt e më qartë se të gjithë bashkohësit, Skënderbeu e kuptoi dhe realizoi si një fakt të madh-pushtimin e huaj, kërcënimin e ardhur nga jashtë ai e shndërroi në një faktor përshpejtuas për njësimin e bashkimin e principatave e resurseve të tyre në funksion të mbrojtjes së lirisë e pavarësisë së fituar. Një fenomen i ngjajshëm u zhvillua në kushte të përafërta edhe në vendet fqinjë si në Bosnje, Serbi ndonëse në këto vende, nuk mundi të sillte ato rrjedhime efektive që u shfaqën në trojet shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Skënderbeu duke shfrytëzuar veçoritë e terenit shqiptar, luftën tradicionale e popullore dhe duke kombinuar si mjeshtër i artit luftarak me operacione të mëdha strategjiko –taktike dhe ndeshje frontale, kundërshtarin e lodhi me pusi e kurthe, alarme e shqetësime të vazhdueshme, e godiste me sulme të fuqishme e të befasishme dhe e shkatëronte përfundimisht. Me këtë strategji të mbrojtjes aktive, me parimin ***" mbrohu duke sulmuar",*** ai arriti rezultate të shkëlqyera me një ushtri relativisht të vogël, duke venduar në jetë parimin e tij, se kush nuk është në gjendje t'a mund arrmikun me një ushtri prej 10-12 mijë ushtarë, nuk do të mund ta bëjë këtë as edhe me një ushtri shumfish më të madhe. Kjo ushtri bashkonte vrullin e një ushtrie popullore me përvojën e reparteve të zgjedhura, të specializuara për detyra të veçanta të një ushtrie të qëndrueshme, të rroguar, me komandantët e dalë nga radhët e kombit që u rritën e u kalitën bashkë me ushtrinë të udhëhequr nga Skënderbeu. Ishin rrethanat që përmendëm mësipërmi të cilët bënë që shqiptarët të humbin të fundit pavarësinë e vet, ndonëse shtetet e tjera ishin më të mëdha në numër e më të pasura në mundësi e mjete. E

vetmja rrugë zgjidhje si ajo, që gjeti e zbatoi Skënderbeu, e vuri atë në kushte të favorshme që t'i bënte ballë rrezikut të vërshimit Osman i cili kishte marrë përmasa evropiane. Lufta e pabarabartë që bënte populli shqiptar, nuk ishte vetëm një luftë për mbrojtjen nga pushtuesi turk të krahinave të veçanta por edhe për ruajtjen e bashkimit të forcave politike, ekonomike dhe ushtarake të kombit tonë. Ishte kjo luftë që farkëtoi atë ndjenjë të bashkimit politik, etnik e kulturor, që u ruajt edhe pas pushtimit të vendit si fitore e rëndësishme e saj.

Forcat shqiptare nën komandën e Skënderbeut arritën të fitonin dhjetra beteja kundër ushtrive kufitare osmane. Fusha e Pollogut, e Dibrës , e Ohrit dhe Domosdovës, grykat dhe luginat e Drinit e të Shkumbinit, sidomos në vitet 1444-48, 1450-56, 1462-65, fushat e Ujit të Bardhë (1457) të Livadhisë 1462, të Vajkalit (1465) e të tjera u bënë sheshe e arena disfatash të ushtrive të rëndësishme osmane.

Besëlidhja e sundimtarëve shqiptar me një evulucion të brendshëm filloi të kthehej në një aparat shtetëror, në një shtet të përqendruar, që kishte si bërthamë qëndrore Zotrimet e Kastriotëve. Në gjirin e klasës sunduese, në këto kushte, pozita kryesore në aparatin politik-shtetëror e ushtarak kaluan kryesisht në duart e feudëve të vegjël, të cilët qëndronin bashkërisht prapa përfaqësuesit të pushtetit qëndror.

Skënderbeu me personalitetin e tij si burrë shteti, strateg e mjeshtër i artit ushtarak, dallonte me tiparet e veta karakteristike nga princërit e tjerë feudalë bashkëkohës të Perendimit. Ai ishte luftëtar i thjeshtë midis luftëtarëve, ai luftonte me ***"mëngje të shpërvjelura",*** në krye të një kalorësie që vepronte me shpejtësi të jashtëzakonshme në krahasim me ushtritë e rënda feudale të asaj kohe. Si burrë shteti ai nuk njihte intriga. Ishte mishërues i traditave më të larta të kombit të tij, ai ishte shprehës i asaj force vitale të jashtëzakonshme që ka manifestuar kurdoherë populli shqiptar. Kujtimi i Heroit shqiptar jetoi jo vetëm në zemrën e kombit që e lindi, por ai pati shtrirje që i kalonte kufijtë e Gadishullit Ballkanik, pra pati një peshë e rëndësi evropiane.

Gjatë kohës që vërshimi Osman qëndronte si një shpatë e mprehtë mbi Evropën e Mesme dhe Perendimore, aq kohë edhe figura e Skënderbeut, si luftëtar e ngadhnjimtar qëndronte kundrejt një armiku që mbahej i pathyeshëm, vazhdonte të tërhiqte vëmendjen jo vetëm të historianëve, po edhe të ushtarakëve, të burrave të shtetit e të opinionit publik evropian.

Interesimi për luftën e kombit shqiptar që gjithmon qe i gjallë, e kishte burimin në literaturën e shumëllojt dhe shumëgjuheshe, kushtuar

figurës së Skënderbeut në të katër anët e botës. Nga përvoja luftarake e shqiptarëve dhe udhëheqësit të tyre, kërkohej të nxireshin mësime për luftën kundër një armiku, që vetëm një Skenderbe ishte në gjendje ta thyente, ndërsa historianët e poetët e përdornin emrin dhe figurën e Skënderbeut si flamur frymëzues për mobilizimin e masave të gjëra fshatare. Duke ngritur figurën e Skënderbeut, ideologët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare synonin të vinin në dukje meritat e mëdha që kishte populli shqiptar përpara Evropës, kulturën e së cilës ai e kishte shpëtuar nga shkatërrimi në kohën e rëndë të vërshimeve osmane. Skënderbeu i rritur në mes feve-për rilindasit u bë simbol i karakterit mbifetar e afetar që duhej të kishte kultura shqiptare.

Personalitetit dhe figurës së Skënderbeut, si simbol i kombit shqiptar dhe si mishërim i historisë së tij lavdiplote, të traditave të tij të lashta patriotike e luftarake, Rilindasit i kushtuan veprat e tyre artistike e shkencore. Ashtu siç kishte qëndruar në fillet e humanizmit shqiptar, vepra e parë e letërsisë shqiptare, e dalë nga pena e shkrimtarit e patriotit Marin Barleci, ashtu edhe në fillimet e letërsisë së Rilindjes dhe historiografisë së re shqiptare, qëndrojnë jetëshkrimet e heroit të shkruara nga rilindasit e parë, qëndron epopeja monumentale e Naim Frashërit. Para se të përfundojmë është me randësi të thuhet se Flamuri i Kastriotëve, që Skënderbeu e kishte çuar nga fitorja në fitore u bë Flamur Kombëtar dhe i udhëhoqi shqiptarët nëpër periudha historike më të vështira dhe nëpër beteja të përgjakshme deri në ditën e shënuar të 28 Nëntorit të vitit 1912. Fryma e luftës së pamposhtur të shekullit XV, si dhe tradita e luftës së madhe popullore, nuk u shua kurrë dhe nuk mund të shuhet, në popullin që e lindi këtë heroj. Skënderbeu pati shumë shokë e trima të frymëzuar nga Ai, të cilët luftuan e qëndruan të patundur si burra të vërtetë.

Këtë punim për të shënuar 550 Vjetorin të vdekjes të heroit tonë kombëtar, dëshiroj ta përbyll me një mesazhë që ka të bëjë me realitetin tonë të sotëm: duke u nisur nga përvoja e aspekteve që dalin nga Epoka e Heroit tonë Kombëtar, asnjëherë më tepër se sot shfaqet nevoja për pajtim të botës shqiptare të ndarë e të përçarë nga armiku dhe nga vetë klasa politike shqiptare e cila është e kriminalizuar. Pra, është imperativ i kohës që të arrihet një pajtim i udhëheqësve tanë, para ngjarjeve vendimtare ashtu si e ka bërë Skënderbeu në Kuvendin e Lezhës (2 Mars të vitit 1444) dhe më pas. Kjo është arsyeja kryesore, përse Emri i Skënderbeut dhe i popullit të tij do të qëndroj për jetë në panteonin e pavdeksisë.

25. 07. 2018 Ulqin

Gazmend ÇITAKU

PELEGRINAZH NË VARRIN E MARA KASTRIOTIT ME RASTIN E 550 VJETORIT TË VDEKJES SË SKËNDERBEUT

Foto: Gëzim Mavriqi, Sami Flamuri

Viti 2018 është shpallur Viti i Skënderbeut. Të gjitha trojet shqiptare me ceremoni të ndryshme shënojnë këtë vit në kujtim të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Po si të shënohet e të mos bëjmë diç të ngjashme me ate që kanë bërë të tjerët? Çka të bëjmë që të sjellim diçka të re që e kemi para syve e nuk e shohim? Po, pra, një vizitë varrit të motrës së Skënderbeut. Është kaq afër po shumë larg nga të gjithë. Studiuesit shqiptarë çdo ditë shkruajnë e përshkruajnë ato çka dikush tjetër veç i ka thënë, të paktë janë ata që marrin iniciativë e të bëjnë hulumtime nëpër arkiva e edhe më pak të atillë që ndërmarrin iniciativa vizitash vendeve ku kanë lënë gjurmë njerëzit tanë. Kurreshtja ime për motrën e Skënderbeut, konkretisht Marën ishte i kahershëm. Lindi që atëherë kur si informatë e mora nga filimi për Skënderbeun. Për një kohë të gjatë u harrua, risillet sërisht nga informata e marrë se varri i saj gjindet në një manastir që gjendet diku në ishujt e Liqenit të Shkodrës. Po ku ishte ky vend? Natyrshëm lindte pyetja. Heshtje.

Në verën e vitit 2008 në Ulqin erdhën Moikom Zeqo dhe vëllai i tij Fredi. Ndenjëm së bashku ne të tre dhe Naim Flamuri me çrast diskutuam për gjëra të ndryshme e një nga to ishte edhe mundësia e shkuarjes në ishullin Kom, në vendin ku prehej Mara motra e Skënderbeut dhe gruaja e Stefan Crnojeviqi mbretit të Zetës. Prapë u zgjua kjo kurreshtje, u dakorduam që të nesërmen në mëngjes të nisemi për në vendin e caktuar. Fredi ishte i gatëshëm që me benzin e tij të na çonte në vendin e duhur. U ndamë. Unë nuk u zgjova heret. Ata shkuan pa mua. Me siguri ishte sinjal se nuk isha i gatëshëm të shkoja në një vend të tillë. Pak ua kisha zili kur u takuam në mbrëmje dhe më tregonin për vendin, flisnin për pllakën që kishin parë, tregonin se si Naimi ishte shtrirë përmbi pllakë që të përcjellë ngrohtësinë njerzore në ftohësinë e pllakës së gurit që kishte mbyll Zonjën Marë në botën e përtejshme... Ah, sa ua kisha zili por nuk u tregoja...

Ja 10 vite më vonë nga kjo ngjarje, sot në vitin 2018, mu në 550vjetorin

kur shënojmë Vitin Jubilar të përkujtimit të vdekjes së Heroit tonë kombëtar Skënderbeut unë (Gazmend Çitaku) së bashku me vëllaun binjak të Naim Flamurit – **Samiun** dhe **Gëzim Mavriqin** (një ulqinak denbabaden) vendosëm që një të diele të shkojmë në ishullin Kom dhe të vizitojmë varrin e Mara Kastriotit – Crnojeviqit. Kjo vjeshtë dhe dimër ishte me shumë lagështi kështu që edhe niveli i Liqenit të Shkodrës ishte mjaftë i lartë. U dakorduam që diku në fund të prillit apo në fillim të majit të marrim rrugën dhe kjo ditë erdhi.
Të shtunën më 28 prill 2018 i bëra një telefonatë Samiut dhe e pyeta se nëse nuk kishte planifikuar ndonjë gjë do ishte mirë që të marrim rrugën e Zhabjakut të Crnojeviqëve dhe ishullin Kom. Konfirmimi i parë erdhi. Samiu ishte i lirë dhe atë ditë nuk kishte diç me rëndësi. Menjëherë kontaktuam edhe Gëzim Mavriqin, i cili ishte i gatëshëm që të marrë aparaturën e tij fotografike dhe të na përcillte, për fat të mirë edhe ai ishte i lirë. Kësisoji duke u caktuar orën e nisjes (13:00) një prej shenjave nga mozaiku u plotësua.

Pranë bedenit të kalasë së Zhabjakut të Crnojeviqëve. Nga e majta Gëzim Mavriqi, Sami Flamuri dhe Gazmend Çitaku. 28.04.2018

Saktësisht në orën 13 morëm rrugën e Podgoricës. Samiu nxori telefonin ku përmes navigatorit dëshironte ta përcillte rrugën, mirëpo për një gjë të tillë unë i thash se nuk kemi nevojë pasiqë rrugën deri ke Kalaja e Crnojeviqëve (Gjurazive) edhe pse nuk kisha qenë asnjëherë e dija, por, prej aty e deri ke Manastiri ku prehej motër Mara (Kastrioti) duhej të pyesim popullsinë lokale dhe nëse kemi fat e të mos ketë ujë do mund të shkonim këmbë. Rruga na u duk shumë e shkurtër pasi që gjatë tërë

rrugës diskutonim tema të ndryshme nga jeta e përditëshme dhe herë herë jepnim ndonjë detaj për vendin ku ishim nisur. Më në fund dolëm nga rruga kryesore dhe u futëm në rrugën e ngushtë por të asfaltuar. Ja edhe tabela e parë që tregonte drejtimin e Kalasë së Crnojeviqëve. Nuk vonoi shumë dhe para nesh u shfaq vendbanimi. Një konglomerat banesash sa të reja e moderne aq edhe të vjetra e të lëna pasdore. Aty koha ishte ndalur. Majtas shihej një urë nga koha romake dhe unë që të bëhem pak i mençur i shpjegoj Gëzimit se në bazë të harqeve mundet lehtë të bëhet dallimi i urave nga periudha osmane ndaj atyre më të vjetra dmth nga periudha romake ose bizantine. Dhe ura jonë në këtë rast ishte urë e ndërtuar diku në shek.VII të e.re. Pasuan fotografitë dhe që të tre të vendosur për eksplorime të mëtejshme u nisëm në drejtim të Kalasë.

- Ku është rruga për me u ngjit në kala, pyeti Samiu një zonjë të vjetër.

Ajo filloi të na tregojë por unë menjëherë ndërhyra duke pyetur se po që se nisemi këtyre shkallave mes këtyre shtëpive të vjetra a do të mund të mbërrijmë lart. Po tha ajo dhe ne vazhduam të gjarpërojmë nëpër labirinthin e shtëpive të vjeta. Shpejt para nesh u shfaq një kishëz dhe e dinim se jemi afër hyrjes kryesore. Samiu fascinohej me rrugën e ruajtur mirë blloqet kufizues të rrugës dhe kalldramin edhe pse e vjetër mbi gjashtë shekuj. Gëzimi bënte fotografi deri sa unë sikur në trans ngjitesha kalldramit të vjetër i cili gjarpëronte nëpër lartësi deri sa para nesh u shfaqën shkallët e ruajtura në mënyrë fenomenale. Po a ka fjalë të përshkruhej muri i kalasë? Shkallët që çonin drejt portës kryesore e që

ishte një portë hyrëse e vogël e që me lehtësi kontrollohej nga kulla vrojtuese aty pranë. Çdo gjë ishte e përkryer. Disa foto para portës e pastaj u futëm në brendi. Një hapsirë jo e madhe por ende lehtë mund të identifikoje të gjithë planimetrinë e saj. Nga të tri anët kalaja kishte mbrojtje perfekte natyrore që do të thotë se assesi nuk ka mundësi ta pushtosh nga ato anë vetëm nga hyrja kryesore e që edhe ajo ishte lehtë e kontrolluar nga kullat anësore. Lartë u shpërndam të tre dhe secili në mënyrën e vet bënte eksplorimin. Koha kalonte dhe vetvetiu rruga hapej andaj filluam të zbresim rrugës nga kishim ardhë.

Tani kishte ardhë koha që të nisemi në pelegrinazh drejt Manastirit në ishullin Kom, drejt vendit ku gjendej edhe varri i motrës së Skënderbeut, zonjës Marë. Pyetëm të parin, të dytin, të tretin askush nuk bëzante nuk na jepnin kurajo të shkonim atje. U ndalëm të pimë nga një kafe dhe të pushojmë pak. As në kafe nuk na jepte shpresë kamarierja. Kishte ujë aqë sa për të mos shkuar me makinë ose këmbë e gjithashtu vende vende kishte cekëtira ku nuk mundje as me sul apo siç e quanin vendasit ÇUN.

Na treguan se zakonisht në fund të gushtit por edhe në fillim të shtatorit mund të shkosh me veturë. Sepse atëherë uji ishte tërhequr fare dhe toka ishte e shndërruarr në kullosa. Me zemër të thyer u nisëm në drjetim të veturës duke bërë planet që të rikthehemi përsëri në shtator.

Por, jo. Ne ishim nisur në pelegrinazh në varrin e zonjës Marë, motrës së Skënderbeut. Viti 2018 është shpallur viti i Skënderbeut, me aktivitete të ndryshme shënohej 550 vjetori i vdekjes së heroit tonë kombëtar. Ne dëshrionim ta shënojmë këtë datë më ndryshe nga të tjerët. Konstadini e Doruntina kalëronin qiellit dhe ne si nipa të Skënderbeut duke marrë si shembull Konstadinin ishim nisur drejt hallës sonë Marë të çojmë në vend një amanet, ta kujtojmë motër Marën. Një lojë mistike filloi të luhet. Ora kishte kaluar 17, dielli filloi të tërhiqej nga perëndimi. Zonja Marë nipave të vet ua dërgon një njeri të kalojë atypari. Samiu nuk heziton ta pyes a di ndokend që do ishte i gatëshëm të na dërgonte deri në ishullin Kom. Ishte ky siç mësuam më vonë Mishko Tatari, vendas por që për çudi nuk kishte varkë por që rrugën nëpër liqe e njihte më mirë se xhepin e vet. Na tha të presim pesë minuta sapo të pyes një njeri aty afër.



Konaku në ishullin Kom, pak mlë në të djathtë gjendet manastiri ku prehet Zonja Marë

Çudia e dytë ishte gati të ndodhte. Pronari i sulit ishte një vendas i cili nuk jetonte aty por që kishte mbërrit atë mëngjes dhe siç duket enkas për ne. Ishte ky Dragan Vukçeviqi i cili iu hodh punës për pastrimin dhe vendosjen e motorit në sul apo çun siç e quanin ata. Pas një gjysmë ore motori ndezi ne ishim gati për pelegrinazh. U futëm në sul dhe u sistemuam asisoji që pesha të shpërndahej njërajtësisht. Mishkoja jepte sinjalet nga të shkonim u futëm në xhunglën e shkurreve dhe pyllit të Liqenit të Shkodrës. Rruga ishte një labirinth që vetëm vendasit e njihni. Mishkoja pandërpre jepte shenjë majtas, djathtas dhe kur rruga ishte pak më e pastër fillonte bisedën të na tregonte sa më shumë histori për këtë vend. Njihte mirë disa gjëra, kishte shumë shokë e miq edhe shqiptarë. Na tregonte për mbiemrat malazez që jetonin në Ulqin e që rrënjët i kishin nga fshati i tyre por që me rastin e dorëzimit të Ulqinit, Kral Nikolla i kishte dërguar në Ulqin si kolonistë. Sa kalonte koha ne i afroheshim cakut. Para nesh filloj të dukej një kompleks banesash. Ata na shpjeguan se ajo që shihej ishte konaku ndërsa pak më djathtas ishte Manastiri dhe vendi ku ishte e varrosur Stefan Crnojeviqi dhe Zonja Marë. Biseda u ndërpre. Dëgjohej vetëm cicërrima e zogjëve. Mishkoja u hodh nga suli në tokë dhe na dha instruksionet si të dalim një nga një. Aty pranë ishte një djalë që pastronte anijen e Manastirit dhe si për çudi iu hodh në qafë Samiut athua se së bashku kishin ruajtur delet,

konstatuam e kishte ngatërruar Samiun me dike por tek e fundit skishte gjë të keqe. U nisëm të ngjitemi ngadalë kodrës, Mishkoja e Dragani na prinin, Samiu pas tyre e unë e Gëzimi të fundit. Mbërritëm ke porta hyrëse e oborrit. Në të dy anët ishin ikonat e dy shenjtorëve kurse pak më në të majtë tabela urdhëruese që ndalonte futjen e aparatëve fotografik, armëve dhe tabela për kodin i veshmbathjes.
U futëm në oborr në të majtë ishte vendi për ku ishim nisur dhe ishte caku ynë. Të gjithë ishim në trans. Veçanërisht dy udhërrëfyesit tanë ishin të frikësuar. Murgun ose e kishte zërë gjumi ose ishte diçka shumë i zënë. Ai nuk bëhej i gjallë. I pari u futa unë. Nuk e di pse por prisja ndonjë altar dhe shikoja majtas djathtas ku ndodheshin varret. Nuk i gjeja vazhdova drejt, padashje lëkunda qiriun e ndezur, që për fat mbeti në këmbë. Mishkoja na tregoj ku janë varret. Ja ku janë, tha ai janë në dysheme. Unë e Samiu i cili ishte duke bërë xhirime ONLINE njëkohësisht ulëm kokën dhe çtë shihmin pllakat e gdhendura. Filloi paniku te udhërrëfyesit ata kishin frikë murgun kurse ne nuk ua vënim



veshin dhe shikonim që të bëjmë sa më shumë fotografi dhe xhirime. Ata insistonin të dilnim jashtë, por ne nuk dëgjonim, në një moment Samiu u ul në gjunjë pranë pllakës së zonjës Marë. Unë e xhiroja dhe transmetoja në rrejte sociale për së gjalli gjithë çka ndodhte. Mishkoja na lutej të dilnim se kishte frikë murgun mos po na hedh ndonjë mallkim. Samiu doli unë vazhdova të eksploroj. Freskat brenda ishin mahnitëse.
Kërkoja ndonjë pllakë por brenda ishte terr nuk mundja të identifikoja. Ndoshta do të kishte qenë më mirë sikur të shfaqej murgu, ndoshta ai do na tregonte diç më shumë. Udhërrëfyesi përgjërohej të dilnim, e dëgjuam dolëm vetëm atëher kur aparati im fotografik bllokoi dhe nuk donte të bënte fotografi. Kjo është shenjë tha Mishkoja që të mos bëjmë më foto. Ok, i thashë po dalim. Dolëm jashtë

dhe mendoj se pelegrinazhi në varrin e motrës së Skënderbeut në vitin e tij jubilar ishte mëse i qëlluar dhe ia kishim arrit qëllimt. Murgu nuk bëhej i gjallë askund, ne hymë e dolëm nga Manastiri dhe atë nuk e takuam. Hipëm në varkën tonë dhe filluam të kthehemi mbrapa. Japëm fjalën se do të kthehemi prapë.

Miqt e ri na ftuan në një festë të zonës që festohej më 28 gusht dhe hapën barkun e zemrën. Mishko Tatari na doli se rrënjët i kishte nga Kastrati kurse Dragani ishte koshient për rrënjë shqipe. Çdo gjë frymonte shqip tashmë. Rruga ishte hapur, tani dukej se varka ecte vetë dhe nuk kishte nevojë për sinjalistiken majtas-djathtas. Ata dy garonin kush do tregon diçka më të veçantë, në një moment motori ndaloi. Hasëm në cekëtirë. Po kush lodhte mendjen për varkën tani, misioni ynë ishte përmbyll në mënyrën më të mirë. Një herë, dy herë dhe motori ndezi. Vazhduam rrugën dhe përshtypje na la tregimi se dikur motit kur në Manastir vihej këmbë ishin gurët e nëpër të cilët duhej kaluar dhe ai që nuk dinte se ku të vente këmbën mbaronte në ujin e liqenit. Duke folur e qeshur mbërritëm ke vetura. Dielli ishte gati në perëndim dhe ne na priste rruga e kthimit për në Ulqin.



Duke u përshëndetur me udhërrëfyesit u nisëm e meqë nuk kishim ngrënë gjithë ditën vendosëm të ndalemi në restorantin përballë Kalasë së Oso Kukës në Lesendro. Gëzimi ngriti dronin dhe bëri xhirime fantastike. Unë e Samiu ishim nën përshtypjet e pelegrinazhit dhe nuk mundim të besonim se çka na kishte ndodhë atë ditë. Se si ishin hapur rrugët që ishin të mbyllura me shekuj, se si ishin hapur dyert që kishin qenë deri atëherë të kyçura, si ishte shfqaur njeriu që na tregoi rrugën, si kishte mbërrit varkëtari atë mëngjes që me sulin e tij të na dërgoj deri në ishull. Ne dokumentuam dhe bëmë që të të verbrit të shohin, të shurdhërit të dëgjojnë. Bëmë një pelegrinazh në varrin e Zonjës Marë Kastrioti mu në vitin jubilar – 550 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut. Shënuam këtë vit dhe pelegrinazhin na e mundësoi shpirti fisnik i hallës Marë e ne tre nipat e Skënderbeut i çuam të gjithë ngrohtësinë njerzore dhe ia ngrohëm për një moment pllakën e mermertë në gjysmëerrësirën e Manastirit Kom që është shumë afër por shumë larg atyre që nuk dinë, nuk shohin, nuk dëgjojnë. Por, jam mëse i bindur se aty mund të shkoj vetëm ai i cili e meriton dhe që shpirti fisnik i motrës Marë e lejon. Ajo e di si ti hapë rrugët, di si të ftojë meritorët dhe unë e di se në vitin jubilar të Skënderbeut me rastin e 600 vjetorit të vdekjes rruga do jetë e hapur për fëmijët tanë të cilët do shkojnë rrugës së baballarëve dhe do vizitojnë sërisht varrin e Motres Marë.

Ne nipërit tuaj ju kujtojmë o Skënderbe e motra Marë.

I përjetshëm qoftë kujtimi ndaj jush.

Ulqin, 29.04.2018

PORTRET

Prof. dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI*

JETA DHE VEPRA E HAFËZ ALI RIZA ULQINAKUT (1855 – 1913)

Hyrje

Në Ulqin si krijues kultural dhe shkollor përmendet Hafiz Ali Riza Ulqinaku, i cili ka shkruar "MEVLUDIN". Në gjuhën shqipe kanë shkruar "MEVLUDIN", posë shkrimtarëve shqiptarë Hasan Zukos, Ismail Floqit, Haxhi Çiçkajt dhe Avdullah Konispolit, edhe Hafiz Ali Riza Ulqinakut. "MEVLUDI" i tij është botuar me titull "Tergume – i Mevlud Ala Lisan Arnavud" (Përkthimi i mevludit në Stamboll) dhe paraqet përkthimin e Mevludit të Sulejman Qelebiut.

Sipas kumtesës me shkrim të Hasan Mavriqit, në Ulqin, nga entet shkollore të Ulqinit, kanë qenë të njohur në këtë pikëpamje Salih - Hylja – efendiu, mësues Haxhi Ymeri efendiu nga Prizreni dhe të tjerë. Nga entet shkollore të Ulqinit, në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX punojnë vazhdimisht shkolla fillore në gjuhën serbokroate dhe mejtepi në gjuhën turke. Deri sa ishte student i Medresës së Ulqinit, Hafiz Aliu e përktheu në gjuhën shqipe "MEVLUDIN". Para se të shpërngulej në Shkodër e të merrte mbiemrin sipas vendlindjes Ulqinaku e përmend edhe në hyrje të Fjalorit të cilit në kujtim të vendlindjes ia jep emrin Ulqin. Me punimet e veta Hafiz Ali Riza Ulqinaku u paraqit si njohës i KURANIT dhe i disiplinave tjera fetare, i gjuhës arabe, turke dhe shqipe

Shënime biografike

Hafëz Ali Riza Ulqinaku lindi në Ulqin në vitin 1855, në familjen e një barkatar, që banonte në lagjen Rana pranë bregut të detit. Babai i tij quhej Jakub Behluli, prej fisit Usta Ali. Në Ulqin e thërrisnin Hafëz Ali Gjoku, sipas familjes që njihej edhe me këtë emër. Mësimet i filloi në Ulqin te myderrizi Sali ef. Hylja. Në Medresenë e Ulqinit mësimet i ka ndjekur deri në librin Fenari. Me rënien e Ulqinit nën Mal të Zi, më

* Dr Maksut Xh. Haxhibrahimi, Fakulteti i biznesit dhe turizmit, Budvë.

1880 familja e tij emigroi në Shkodër bashkë me 413 familje të tjera që u shpërngulën nga Ulqini. Në kohën kur iu lehtësua pikëllimi dhe mjerimi i madh, që e dërrmoi moralisht e materialisht familjen e tij, Hafëz Aliu vendosi të vazhdonte mësimet në Medresenë e Shkodrës dhe aty e mori ixhazetin (diplomën e medresesë). Pas kryerjes së Medresesë në Shkodër, Hafëz Aliu në vitin 1882 emërohet mësues i shkollës fillore në lagjen Dudas të Shkodrës.

Hafëz Ali Ulqinaku në fillim ka punuar si imam dhe myfti në Ulqin. Në kohën e agresionit të Malit të Zi kundër Ulqinit (1876 – 1878), Hafëz Ali Ulqinaku mori pjesë në luftën për mbrojtjen e qytetit.

Pasi e kreu medresenë në Shkodër, Hafëz Ali Ulqinaku punoi si mësues në këtë qytet. Pastaj nga Shkodra shkoi në Lezhë, punoi si myfti dhe myderris. Hafëz Aliu vdiq në Shkodër më 23 prill 1913. Është varrosur në xhaminë e Shaban – efendisë në Mahallë të Re. Varri i tij sot nuk gjendet.

Hafëz Ali Ulqinaku ishte atdhetar i shquar, poet i talentuar, përkthyes i shkëlqyeshëm, leksikograf i dalluar dhe alim i nderuar në rrethin ku jetoi e veproi dhe më gjërë. Njerëzit që e njohën thonë se ka qenë bejtexhi i talentuar, kurse njeri prej tyre Hafëz Hasan Mavriqi thotë:

"Ka qenë i zoti, sidomos si shair. Letrën ka pas mujt me e ba në bejte".

Veprimtaria letrare

Hafëz Ali Ulqinaku në veprat e tija nënshkruhej me pseudonimin: Ali Riza. Ai ka lënë disa vepra, të botuara dhe dorëshkrime. Ka botuar një përmbledhje me tri vepra të veçanta: 1) Përkthimin shqip të veprës turke "Huda Rabbim", 2) Mevludin me titull: "Terxheme – i mevlud ala lisani arnaud" dhe 3) Një fe – rrëfenjës me titull: "Mexhmuat – ul – avah". Ndërsa në dorëshkrim ka lënë një "Abetare" shqipe dhe tre fjalor që i quajti "Ulqin". Viti i botimit i përmbledhjes së përmendur nuk është shënuar as në faqen titullare e as gjetiu, pos siç thotë vetë Hafëz Ali Ulqinaku në parathënien e fjalorit me titull:" Bedi – ul – Mukattar ", përmbledhja e tij u botua me lejen e Ministrisë së Arsimit në vitin 1302 (1884 – 85). Është një fjalor në vargje turqisht – shqip.

Fjalori Bedi -ul – Mukattar ka një parathënie me rëndësi. Parathënia që Hafëz Ali Riza Ulqinaku e shkroi në fillim të fjalorit të pare: Bedi – ul – Mukattar është shkruar në gjuhën arabe më 22 dhjetor 1905. Kjo parathënie është edhe autobiografi e Hafëz Ali Riza Ulqinakut..

Vepra Huda Rabbim për here të pare e botua më 1306 (1889) dhe prej

këtij viti deri në vitin 1898 është ribotuar dhjetë here. Është shumë interesant të theksohet se përkthimi shqip i veprës Huda Rabbim, që e bëri Hafëz Ali Riza Ulqinaku është botuar katër vite para se të botohej në gjuhën turke.

Përveç kësaj përmbledhjeje të botuar Hafëz Ali Riza Ulqinaku hartoi një abetare dhe tre fjalorë, që kanë mbetur në dorëshkrim. Fjalori i pare që mban titullin Bedi – ul – Mukattar, është hartuar në vargje sipas metodës së aplikuar për të parën here në letërsinë e vjetër turke nga poeti mistik Shadini – Ibrahim Dede.

Fjalori i dytë Axhib – ul – menzar është fjalor alfabetik turqisht – shqip, ndërsa fjalori i tretë Garib-ulme Osar është fjalor shqip – turqisht. Ky fjalor paraqet më tepër interes dhe përbëhet prej 4000 fjalëve dhe është më i gjati që ka 915 faqe, ku janë dy shtylla, e një shtyllë ka dy kolona – njëra turqisht e tjetra shqip.

Si kryevepër e Hafëz Ali Riza Ulqinakut merret Mevludi Sherif. Fjala është për Mevludin e poetit të shquar turk Sylejman Çelebiut, të cilin Hafëz Aliu e ka përkthyer në gjuhën shqipe. Përkthimin e Mevludit Hafëz Aliu e bëri në Ulqin në moshë të djalërisë, në vitin 1873 – 74.

Lëndën për hartimin e fjarovëve të tij hafëz Ali Riza Ulqinaku e ka marrë nga vendlindja e tij, pra nga e folmja e Ulqinit. Në kohën kur hafëz Ali Riza Ulqinaku i harton fjalorët ishte tendenca e shkrimtarëve tanë të Rilindjes që të përdornin vetëm fjalë shqipe duke kuptuar në këtë purizëm përjashtimin nga gjuha të fjalëve të huaja, sidomos të atyre orientale.

Këta fjalorë të pabotuar, me kopjen e vetme të dorëshkrimit, të shkruar me alfabetin arab mbeten si një vlerë e çmueshme filologjike e lënë mënjanë që u hynte në punë për studime vetëm atyre që, veç shqipes dinin edhe turqishten, por gjithsesi turqishten e vjetër, e që edhe ata për fat të keq nuk i kishin shfrytëzuar sa duhet.

Punën më të madhe rreth fjalorëve të hafëz Ali Riza Ulqinakut gjithsesi e ka bërë gjuhëtari e orientalisti i shquar O. Myderrizi, i cili më 1961 në BUSHT boton një punim me titull: "Fjalori shqip – turqisht i Hafëz Ali Riza Ulqinakut", ku shkruan për jetën dhe veprat e hafëz Ali Riza Ulqinakut, jep disa vështrime gjuhësore të gjuhës së Mevludit dhe të fjalorëve të Hafëz Ali Riza Ulqinakut duke i krahasuar me të folmen e Ulqinit.

O. Myderrizi duke e pare vlerën e rëndësinë e madhe që kanë fjalorët e hafëz Aliut për studimin e shqipes, sidomos për dialektologjinë shqiptare e transkriptoi fjalorin shqip – turqisht dhe e botoi në dy vazhdime në

“Studime filologjike” duke bërë shpjegimin e disa fjalëve të panjohura, dhe kështu mundësoi që ky fjalor të përdorej nga një qark më i gjerë njerëzish për njohjen e studimit e atij fjalori.

Në vitin 1970, në Podgoricë (Titograd) u botua “MEVLUDI SHERIF”, në gjuhën shqipe, hartuar prej hafëz Ali Riza Ulqinakut, ribotuar me vendimin e Kryesisë së fesë Islame në Republikën e Malit të Zi. Në parathënie të “MEVLUDI SHERIF”, theksohet se përveç “MEVLUDIT”, hafëz Ali Riza Ulqinaku e shkroi jetën e profetit Muhamedit aleinis selam, ka shkrua edhe jetën e Ahiretit dhe “Bazat fetare të islamizmit”.

Në parathënie të “MEVLUDIT-SHERIF”, shtesë “MEVLUDI – SHERIF”, me gjatë theksohet se hafëz Ali Riza Ulqinaku, si nxënës i medresës filloi të shkruaj nga fusha e fesë islamike në gjuhën e vetë amëtare (shqipe). Vepra kryesore e hafëz Ali Riza Ulqinakut është përkthimi i “MEVLUDIT” nga turqishtja në gjuhën shqipe, të cilën e ka shkrua shkrimtari i njohur turk – udhëpërshkruesi Evlija Çelebija. Ai përpos të përkthimit të “MEVLUDIT”, shkruan edhe “SHTESË MEVLUDI” në gjuhën shqipe. Botimi i pare në gjuhën shqipe shfaqet në Stamboll në vitin 1879.

Veprimtaria shkencore

Parathënia që hafëz Ali Riza Ulqinaku e shkroi në fillim të fjalorit të pare: Bedi – ul – mukattar e hartuar në gjuhën arabe më 22 dhjetor 1905 njëherit është edhe autobiografi e hafëz Ali Ulqinakut.. Kjo oarathënie përveç që hedh dritë në jetëshkrimin e autorit, ajo i korrigjon edhe disa gabime dhe lajthitje që janë bërë nga studiuesit e veprës së hafëz Ali Ulqinakut, e sidomos gabimet e bëra në konstatimin e vitit të botimit të Mevludit të tij. Punëtorë të ndryshëm shkencorë si Hasan Kaleshi, Jashar Rexhepagiqi etj. Për vit të botimit e kanë marrë vitin 1295/1878, përkatësisht tarihin (kronogramin) e përkthimit të përmbledhjes të veprave të botuara të hafëz Ali Ulqinakut. Ndërkaq vetë hafëz Ali Ulqinaku në parathënien respektivisht autobiografinë e tij thotë se ky mevlud është botuar në vitin 1302/1884 - 85. Nga autobiografia e hafëz Ali Ulqinakut mësojmë se ai i hyri hartimit dhe shqipërimit të veprave që na ka lënë, i motivuar nga ndërgjegja e lartë që kishte për gjuhën amtare dhe lëvrimin e saj si dhe nga qëllimi fisnik i arsimimit të masës së gjerë të popullit. Gjuha shqipe, thotë autori, ka mbetur e pashkruar dhe e papërdorur dhe kështu duket si e ngrirë dhe e vdekur midis

gjuhëve tjera. Nuk i gjen njeriu ndonjë të metë kësaj gjuhe, vazhdon ai, "veçse kishte nevojë për ca shkronja dhe shënja".

Mevludi i hafëz Ali Ulqinakut konsiderohet se është mevludi i pare i botuar në gjuhën shqipe. Ky mevlud u perhaps buhishëm në Shqipërinë Veriore sidomos në Shkodër dhe në Malësinë e mbishkodrës, por depërtoi edhe në Kosovë e Maqedoninë Perëndimore, në Opojë, fjala vjen, këndohet edhe ky mevlud anipse shumë më rrallë se mevludi i Tahir Gjakovës.

Më 1933 mevludi i hafëz Ali Ulqinakut u ribotua me alfabetin e gjuhës shqipe me një parathënie, që e shkroi djali i tij, hafëz Said Ulqinaku, imam në Lezhë. Mevludi i hafëz Ali Ulqinakut u ribotua edhe here të tjera, por është me interes të vihet në spikamë një rast i ribotimit të këtij mevludi siç vërejmë nga disa të dhëna që i jep z. Nexhip P. Alpani. Ai duke bërë fjalë për mevludet e veçon një për të cilin thotë: "S'është bërë fjalë deri më sot në studimet përkatëse, që është botuar më 1922 nga shqiptari Nazmi Hilmi. Shqpja, që është përdorur në të, është një e folme lokale, me shumë terma e shprehje fetare arabisht dhe fjalë osmano – turke". Të dhëna tjera për këtë mevlud Alpani nuk jep, por na e thotë mendja se këtu është fjala për një ribotim të mevludit të hafëz Ali Ulqinakut, që do ta ketë bërë ndonjë shqiptar, i cili për autor gabimisht do ta ketë marrë kronogramin në fund të parathënies osmanisht të Mevludit fq. 3. Ky kronogram përbëhet nga fjalët "Arnaut Nazmi Xheli" (tek. arab) që ka kuptimin: vjersha e shkëlqyer shqipe. Kur të llogaritet ky kronogram sipas ebxhed – llogarisë del viti 1295/1878 që edhe figuron nën këtë kronogram, i cili nuk e tregon vitin e botimit të përmbledhjes së hafëz Ali Ulqinakut, por tregon vitin e përkthimit apo shqipërimit të veprave: Mexhmuat – ul – ahval, Huda Rabbim dhe të Mevludit, gjë që edhe vetë autori e pohon në bejtin e fundit të parathënies në fq. 3.

Ylemaja e Shkodrës, që kishin pare mevludin e hafëz Ali Ulqinakut i kishin propozuar të përkthente veprën Huda Rabbim gjë që ai e pranoi. Pasiqë ai e hartoi fjalorin e tij të pare për qëllime didaktike, ata i propozuan të bënte një fjalor tjetër të mirëfilltë. Në autobiografinë e tij hafëz Ali Ulqinaku lidhur më këtë thotë: "Sadoqë s'e pashë vetëhenë të zoti për këtë gjë, e pranova urdhërin e tyre, se, përulja përpara dëshirës së të mëdhenjet është një prej nevojavet të eduaktëse, dhe ata që përulenë jan'në syt të mëshirës së Zotit. Porse gabuanë duke mejtuarë që unë jam i zoti, kurse kapitali im është fort i pakët, edhe nga pandehme e tyre unë jamë fare lark; desha vetëm që t'i bindem urdhërit, edhe me

gjithë që thashë se i urdhërnumi nuk ashtë ma i ditun se urdhnusi, fillova….".

Hafëz Ali Ulqinaku ndonëse ishte modest në vlerësimin e aftësive të veta, ylemaja e Shkodrës do t'ia kenë njohur realisht aftësitë, sepse më shumë se fjalët që i tha për vete, flasin veprat e tija.

Hasan Kaleshi mendon se mevludi i hafëz Ali Riza Ulqinakut është mevludi i pare në gjuhën shqipe.

Mevludi i Ali Riza Ulqinakut mban titullin në gjuhën osmane "Terceme – I mevlud – I ala lisan – 1 arnavud" (Përkthimi i mevludit në gjuhën shqipe). Siç shihet në vetë titullin edhe ky mevlud është përkthyer nga ai i Sylejman Çelebisë me disa vargje të veta. Mevludi është botuar më 1295/H. (1879), ndërsa sipas H. Kaleshit viti është gabuar dhe është datuar 1878, edhe te Osman Myderrizi datën e këtij mevludi e gjejmë të vitit 1879.

Është me rëndësi të theksohet një varg i mevludit të hafëz Ali Riza Ulqinakut për të vërtetuar vetëdijen kombëtare të hafëz Ali Ulqinakut, të cilin e shpreh në parathënien e mevludit:

-Arnaudçe me qerem të Zotit u lenis (hartuar)
-ishit një gjuh që kalam s'ish kollanis. (përdor)
-Kushda qi ta ven hesab donji hata (gabim)
-mej gadit aj qi ta shof i banj rixha (i lutem).

Sipas studiuesit Lumo Skendo, hafëz Ali Riza Ulqinaku i përkiste shkollës letrare dhe shkencore shqiptare të traditës islame (të cilët për shkrim përdorën grafinë arabo – osmane), të njohur në letërsinë shqipe me sintagmën bejtexhinj dhe pas vetës ka lënë një opus të gjerë veprash letrare, përkthime shqipe dhe origjinale, mandej fjalorë shqip – turqisht dhe turqisht – shqip dhe vepra me karakter filozofik islam, midis të të cilave: Një Mevlud; Një Abetare shqip; Një Libër të imituar prej Tuhfe – I Vehbije në vjershë, me frazë dhe fjalë turqisht – shqip; Një Fjalor shqip – turqisht me 133 faqe me rreth 5500 fjalë; Një Fjalor turqisht – shqip me 435 faqe me afro 18 mijë fjalë.

Lumo Skendo përfundonte: "Po i japim këta përshkrime nga frika se mos çdukenë një ditë dorëshkrimet dhe humbet edhe kujtimi i tyre.

Frika e L. Skendos me gjasë kishte bazë. Një e dhënë nga viti 1936, nga i biri i hafëz Ali Riza Ulqinakut, hafëz Said Ulqinaku, përpos "MEVLUDIT SHQIP" e zuri ngoje vetëm "nji fjaluer Shqip _Turkisht e nja dy vepra të vogla", pa ua përmendur emrin. Hafëz Saidi për të atin

do të konstatojë: “I ndjeri Hafëz Ali kishte me vedi një shpirt të madh të pajisun me nji kulturë të naltë theologjike, me natyrë të mprehtë poetike e me ndërgjegje të kullueme dhe të edukueme si mbas parimeve t’Islamizmës”.

Problemin e hulumtimeve të dorëshkrimeve të hafëz Ali Riza Ulqinakut Lumo Skendo më fuqimisht e shtroi më 1928. Duke i botuar disa fragmente nga parathënia arabisht e veprës “Bedi –yl – Muakattar”, u ndal më gjatë në tekstin bazë të veprës – fraza turqisht të përkthyera shqip. Kjo vepër dhe disa të tjera leksikografike e pedagogjike janë shkruar pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe janë fryt i rebelimit të tij shpirtëror si njeri i mbështjellur me xhyben e imamit. I biri I tij, Saidi, do të konstatojë: “Ky njeri i lindun jo në kohë të përshtatun me idealet e tija sillesh vërdall nëpër Shkodër për të gjetur ngushllimin e atdheut qi kishte humbë. Mjerisht kronika e ngjarjeve dhe rrethanat nuk i nepshin asnjë shpresë. Edukata morale nuk e lejonte me derdhë vnerin e dishprimit ashtu si e bajnë shumë poetë. Prandaj ky u tërhoq në nji anë dhe kapi rrugën mistike për të ngushllue shpirtin e vet. Edhe me të vërtetë këtu e gjeti dermanin”.

LITERATURA:

1.Nehat Krasniqi, Mevludet në letërsinë shqiptare me alfabet arab, Dituria Islame, viti VI/Nr. 30 -31, tetor- nëntor, Prishtinë, 1991.

2.Iljaz Rexha, Roli i Mevludit në ruajtjen e gjuhës shqipe, Dituria Islame, viti VI/Nr. 30 – 31, tetor – nëntor, Prishtinë, 1991.

3.Muhamet Pirraku, Qëmtime për jetën dhe veptën e Hafiz Ali Ulqinakut (1853 – 1913), Dituria Islame, viti VI/Nr. 30 – 31, tetor – nëntor, Prishtinë, 1991.

4.Muhamet Pirraku, Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1979.

5.Historia e Letërsisë Shqiptare, Tiranë, 1983.

6. Sabri Hamiti, Vetëdija letrare, Prishtinë, 1989.

7.Osman Myderrizi, Letërsia Shqipe me alfabetin arab, Buletin për Shkencat Shoqërore, 2, Tiranë, 1955.

8.Osman Myderrizi, Hasan Zyko Kamberi, Buletin për Shkencat Shoqërore,1, Tiranë, 1955.

9.Osman Myderrizi,, Fjalori shqip – tyrqisht i H. Ali Ulqinakut, BUSHT, Ser. Shk. Shoq.,, nr. 3, Tiranë, 1961.

10.Osman Myderrizi, Fjalori shqip – tyeqisht i H. Ali Ulqinakut,

Studime Filologjike, nr. 3 dhe 4, Tiranë, 1965.
11.Lumo Skendo, Disa dorëshkrime shqip me germa tyrqishte, Dituria, nr.8, Tiranë, 1928.
12. Lumo Skendo, Për shkrime të harruarë dhe të pa – diturë, Dituria, nr. 1, vol. i dytë, Tiranë, 1926.
13.Jashar Rexhepagiq,, Razvoj prosvete i školstva Albanske Narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918. godine, Priština, 1968.
14.Nexhip P. Alpan, Ndikimet e gjuhës dhe letërsisë turke në gjuhën dhe letërsinë shqipe, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Tiranë, 1970.
15.Shemsi Mehmeti, Kush asht autor i vërtetë i "Mevludit", Jeta r Re, nr. 4, Prishtinë, 1951.
16.Said Ulqinaku, Parathanje, Mevludi Sherif, Lindja e Hazreti Muhamedit Alejhiselam, Tiranë, 1936.
17.Hajro Ulqinaku, Ali Riza – Ulqinaku, Jehona, nr. 1 – 2, Shkup, 1993.
18.Revista "Zani naltë", nr. 11, portreti: Ali Riza – Ulqinaku, Tiranë, 1937.
19.Mevludi Sherif, KBI në RS të Malit të Zi, Titograd, 1975.
20.Maksut Haxhibrahimi, Qëmtime për jetën dhe veprën e veprimtarëve pedagogjiko – arsimor të fesë islame në Ulqin, Simpoziumi shkencor kushtuar 150 vjetori i lindjes së Hafiz Ali Riza Ulqinaku, Ulqin, 2005.
21.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Zhvillimi i arësimit dhe kulturës islame shqiptare në Ulqin prej mesit të shekullit XIX deri në fillim te shekullit XX, Elif, shtator – tetor, Titograd, 1991.
22.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Kultivimi i ndjenjës fetare dhe përhapja e kulturës orientale islame në Ulqin gjatë pushtimit otoman në periudhën e shekujve XVI – XVII,Elif, nëntor – dhjetor, Titograd, 1991,
23.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Medresa e Ulqinit, Liberali, nr. 12, maj 1998, Podgoricë, 1998.
24.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Jeta dhe vepra e Hafiz Ali Ulqinakut, Plima, nr. 7,8,9, viti II, Podgoricë, 1996.
25.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Objektet fetare dhe historike islame në Ulqin, Dituria Islame, viti XVI, nr. 136, tetor 2001, Prishtinë, 2001.
26.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Mektebet dhe medreseja e Ulqinit, Dituria Islame, viti XIV, nr. 123 – 124, shtator – tetor 2000, Prishtinë, 2000.

Dorian KOÇI

FILOZOFI I PAQËTIMIT

Në historinë sociale e politike të kombit shqiptar janë shumë të ralla figurat dhe personalitetet që gëzojnë një reputacion dhe respekt të veçantë këndej e andej kufirit. Kjo dukuri ndodh , jo sepse kemi një zbrazëtirë me figura të tilla historike dhe sociale apo niveli i tyre kulturor e social nuk është në gjendje që t'i apelojë nevojave dhe dëshirave të kombit shqiptar sot, por sepse ndër shqiptarë është shumë vështirë të zërë rrënjë mendimi pozitiv kur vjen puna për hierarkitë letrare, shoqërore të figurave të veta. Raste tipike të një mendësie të tillë janë debatet mbi figurën e Gjergj Kastriotit, Nënë Terezës, Ismail Kadaresë, debate të cilat përpara se të shtojnë ndonjë vlerë në panteonin e vlerave shqiptare më tepër tregojnë katandinë se në cilën gjendet mendimi kritik shqiptar.

Mirëpo, në gjithë këtë vorbull mendimi e përroi të fshehtë të ndërgjegjes që shpesh herë mundohet të marrë çka gjen përpara gjendet një figurë që ka arritur të ndërpresë dhe përbashkojë në një pikë mendimin shqiptar. Kjo figurë është misionari i paqëtimit ndër shqiptarë, Prof. Anton Çetta që brezit tim të porsa dalë nga rrëzimi i murit të Berlinit politik por dhe shpirtëror ndër shqiptarë si ishin vitet 90' na apelonte për një filozofi paqëtimi dhe bashkimi ndër shqiptarë, në një kohë kur lufta politike dhe pa princip i përçante më shumë se çduhej shqiptarët. Profesor Anton Çetta përfaqëson, pa dyshim në kapërcyellin e viteve 90' një apostull të paqes dhe shqiptarizmit dhe për këtë gjë, figura e tij është shumë e veçantë ndaj ndërmarrja e shkrimit të një libri të shpjegimit të filozofisë por dhe kontributit të tij në shoqërinë shqiptare është një sfidë e veçantë në radhë të parë kulturore dhe pastaj autoriale. Filozofia e Prof Çettës është një kaledeskop që zbulotet nuanca pas nuancash, jo si një dukuri lokale e Kosovës dhe e Shqipërisë por si një mesazh universal, çka e kthen mendimin filozofik të Profesor Çettës në një rrafsh krahasimtar me figura të tjera të mendimit paqësor botëror. Analiza krahasuese e ndërtuar në një rrafsh të tillë i jep filozofisë së pajtimit të Profesor Çettës një dimension jo vetëm për shqiptarët por në të njëjtën kohë është dhe një dritare e mirë për të huajt për të kuptuar më mirë shpirtin shqiptar me të gjitha mekanizmat e tij, si bujarinë, faljen, hakmarrjen apo dhe paqëtimin.

Shqiptarët nuk janë të parët që kanë mes tyre, fenomenin e gjakmarrjes. Ky fenomen ka pasur një shpërndarje gjeografike të gjerë në Evropë duke filluar nga Skocia në Britaninë e Madhe, Korsika në Francë, Kreta e Mani në Greqi etj. Gjithsesi shqiptarët mbeten të vetmit që vazhdojnë ta praktikojnë dhe kjo mbetet "thembra e Akilit" në profilin psikologjik tonin. Nëse zhvillimet e ndryshme kulturo-politike kanë bërë të mundur që fenomeni në vendet e tjera të zhduket, në Shqipëri ,"kulshedra e gjakut ka mbijetuar". Ndonëse për një kohë të gjatë ka mbizotëruar një ndërgjegjësim i mjaftueshëm i shprehur nëpërmjet medies dhe shoqërisë civile për ta frenuar këtë fenomen, gjithsesi ai s'është ndalur dhe ka marrë përmasa të frikshme. Para tre vjetësh Kisha Katolike e Shqipërisë dhe Mitropolia e Shkodrës dhe e Lezhës ndërmorën hapin e nxjerrjes së një dekreti që shkishëron çdo njëri që ushtron dhe vret për gjakmarrje. Kjo ndërthurje e mbështetjes së Kishës, shoqërisë civile dhe shtetit mund të rezultojë të jetë trinomi i artë për të filluar numërimi mbrapsht i fenomenit të gjakmarrjes. Jo shumë kohë më parë në vitin 1991 në Kosovë, një personalitet si Anton Çetta ia doli mbanë që nëpërmjet kuvendeve të pajtimit ta neutralizonte këtë plagë shekullore të shqiptarëve, ndaj perspektiva e efektit të këtij trinomi në shoqërinë shqiptare është pozitive.

Sigurisht që efektet e këtij bashkëpunimi trepalësh nuk mund të jenë të menjëhershme pasi nëse do të ishte kështu të gjithë do të ishim të lumtur, por që ky bashkëpunim mund të jetë shumë efektiv, besoj se është jashtë çdo diskutimi. Kisha Katolike me dekretin e saj shërben si katalizator për të lidhur sëbashku të gjitha fijet e shëndosha të reagimit qytetar, ndaj është një rast që duhet ndjekur dhe nga institucionet e larta të besimeve të tjera fetare në Shqipëri për të bërë të mundur që vakuumin që lë shteti me vështirësinë për zbatueshmërinë e ligjit ta plotësojnë institucione të tjera dinjitoze si janë institucionet e besimit fetar. Në rrethana dhe momente të caktuara çdo komb nxjerr figura të tij historike dhe sociale që ndërmarrin rrugëtimin e drejt të kombit të tyre drejt paqes sociale dhe përparimit. Në këtë rrugëtim është e rëndësishme që ata të kuptojnë psikologjinë dhe sociologjinë e kombit të vet, dhe Profesor Anton Çetta sipas biografit të tij, Gjon Kekës "kishte zbuluar dy damarë të rëndësishëm të komunikimit me popullin shqiptar, atë të mendjes, arsyes, kulturës dhe traditës, si dhe atë të zemrës, ndjenjave, përjetimeve. Mu për këtë mendoj se ishte një ndër njohësit më të mirë të "gjakut tonë të shprishur", si thonë Arbëreshët, të mendjes dhe zemrës arbërore.E tërë kjo punë, lëvizje, gjurmim ndër popull dhe me popull, si

duket ishte parapërgatitja ose "uvertura" për kryeveprën e tij jetësore, pajtimin e gjaqeve gjatë vitit 1990, aq sa më të drejtë mund ta quajmë, ishte e mbetet "Babai i Pajtimit". Prandaj, para çdo veprimi, pika e parë është kuptimi i gjendjes, si nga aspekti historik, ashtu edhe nga vështrimi aktual."

Filozofia e pajtimit të Profesor Çettës u krijua si një filozofi "sui generis" e mbështetur mbi tradita lokale të besës, ndaj Zotit, ndaj njëri-tjetrit dhe pastaj ndaj komunitetit duke e kthyer këtë traditë të vjetër të shqiptar në një instrument modern të filozofisë mbijetuese dhe vetvendosëse të shqiptarëve në Kosovë, që nëpërmjet filozofisë pajtuese të prof. Çettës bëhet më tepër e njohur dhe më e pranishme mes shqiptarëve. A e kemi kuptuar dhe përjetsuar mendimin filozofik të profesor Anton Çettës? Për ne, kjo është tashmë një doktrinë që na e shtjellon mjeshtërisht përmes frymës së saj shpirtin shqiptar e në të njëjtën kohë mund të themi se tashmë me këtë filozofi të pajtimit kemi fillin e Arianës prej nga mund të drejtohemi për të çarë përmes labirinthit të gjakmarrjes drejt paqëtimit social mes nesh.

Kristaq BALLI

TRE HIERARKË KORÇARË TË FOTOGRAFISË

Hyrje:

S'ka dyshim që, në historinë 150 vjeçare të fotografisë shqiptare, krijimtaria e artistëve korçarë zë një vend të hijshëm, duke e plotësuar atë në një diapazon të gjerë kohor, historik, ekonomik, shoqëror, kulturor, artistik me larushaninë e gjinive, stileve, identiteteve, origjinaliteteve. Jo rrallë, këto vlera e kanë befasuar shpesh opinionin qytetar.

Më se 20 është numuri i fotografëve korçarë, që, kush më pak e kush më shumë, kanë lënë gjurmët e tyre në vellon e argjendtë të fotografive. Papa Jani e Vangjel Zengo, si dhe pinjollë të tjerë të këtij trungu, Perikli Kaçauni, Thimi Raci, Petro Dhimitri(Korçari), Kristo Sulidhi e i biri i tij Vangjeli, Kristaq Sotiri, Mandi Koçi(Maku), Vani Burda, George Boria, Gjon Mili, Misto Treska, Studio Venetiku, Vangjush Mio, Bellovoda, Kotti, Teodor e Niko Stefani, Tasho, Çika, etj.i kanë gdhendur emrat e tyre në librin e fotografëve të nderuar shqiptarë që i kanë lënë paurisë së fotografisë dëshmi interesante nga historia e jeta e përditshme shqiptare. Por, midis tyre, veçohen tre emra, tre personalitete, tre hierarkë të fotografisë, krijimtaria e të cilëve është ekstrakt, është sintezë e përvojave të gjata e të suksesshme jetësore e artistike botërore që, pavarësisht se rruga e formimit të tyre shkon nëpërmjet Amerikës, rruga e përkatësisë e shpirtit, zemrës, afeksionit dhe ëndrrave të tyre humane shkon nga Korça, nga Shqipëria.

1. ***Kristaq Sotiri*** (1883-1970). Opusi i krijimtarisë së tij, nga njera anë, dhe gjumi letargjik nën sulmin e pashpirt të Kronosit kohor mbi arkivën të thjeshtë familiare, si dhe pamundësia për ta soditur këtë balerin të fotografisë artistike të paktën me një katalog, apo album serioz, të dëshpëron, madje pa ngushëllim edhe më tepër kur oguri i keq të trazon shpirtin sapo ke marrë vesh se është shuar nga jeta edhe Gjergji, djali i këtij fotografi, pra përfaqësuesi i një brezi tjetër që e largon artistin edhe një brez më tepër nga komuniteti shoqëror që, edhe pse me shumë pasion për trashëgiminë e vyer të të atit, s'mundi të bëjë më shumë se aq, nuk mundi të bëjë plotësisht të njohur, të përgjithësojë e ta përjetësojë në historinë e fotografisë shqiptare të paktën me një

vepër dinjitoze të botuar në favor të gjithë shqiptarëve e opinionit artistik edhe pse ai meriton shumë më shumë. Një brengë që s'do t'ia tretë varri.

Rreth vitit 1900 "epidemia" e emigracionit si po edhe për shumë korçarë të atëhershëm, veçanërisht djem të rinj e plot ëndërra e pasione,(kjo epidemi u riciklua me intensitet më të madh edhe pas një shekulli) nuk e kurseu as Kristaqin, por e nxiti si me magji të rrahë kurbetin në ShBA, fillimisht në Nju Jork, ku punoi për disa vjet në një fabrikë tekstili. Por atë jehonë të kunatit të tij më të madh Kristo Sulidhit, asokohe një fotograf me nam në Korçë, pas të cilit kishte fituar edhe disa koncpte të fotografimit, nuk mund t'ia zhbënte e harronte dot koha, ca më tepër që ai kishte edhe një lloj prirje imagjinative ndaj artizanatit të fotografimit, që atëhere ishte bërë një mjeshtëri, cilësia e së cilës varej kryesisht nga fermenti profesional që fotografi përdorte për mbrujtjen e prodhimit të tij vizual. Kjo mbase e nxiti të guxojë të proovonte ambicjet e tij në fushën e fotografisë të fillimit të shekullit XX, kur në ShBA ishin bërë përparime e kapërxime teknologjike e artistike. Punoi disa vite si asistent në disa studio fotografësh komercialë, derisa ëndrra për të provuar zotësinë e vet e shtyu të shkojë e të provohet tek një prej fotografëve amerikanë në zenith të arritjeve të tij – George Steckel në Los Anxheles të Kalifornisë. Por dështimi nuk e kurseu përpara nivelit të lartë artistik të fotografit Steckel, i cili e refuzoi bashkëpunimin me të për arsye thjesht profesionale, kryesisht të retushimit, që ishte një nga proceset kryesore e delikate të fotografive në atë kohë. I mërzitur, por jo i zhgënjyer, falë karakterit të tij të forte, durimit, etjes së moshës së vet për të asimiluar e, posaçërisht, të kompletimit të tij si mjeshtër i vërtetë fotografish, u end për ca vite të tjerë në të tjerë artizanë ku, sigurisht, përfitoi dhe e
perfeksionoi profesionin e tij. Duke e ndier veten tashmë më të aftë e më të sigurt, ai guxoi e shkoi përsëri tek fotografi Steckel, i cili duke vlerësuar perfeksionimin e tij e pranoi ta ketë bashkëpunëtor, bashkëpunim i cili zgjatë për afro 10 vjet e që për Kristaq Sotirin ishte rafinimi i talentit, asimilimi dhe eksperimentimi i koncepteve artistike e estetike të përparuara për atë kohë në ShBA.

Siguria, profesionalizmi dhe niveli i lartë i fotove e nxitën këtë herë të ndahet me mirënjohje nga Steckel dhe të çelë studion e tij në Nju Jork më 1921. Por ajo studio dhe puna e pavarur e tij në të nuk e paten jetën e gjatë, pasi për një arsye familiar ai duhej të kthehej në vendlindje. Edhe pse nuk e kish parashikuar se këtej e tutje do të

banonte përgjithmonë në Korçë, ngjarjet rrodhën të tilla që, ai, më 1923, të hapë në qytetin e tij studion fotografike me emrin "Sotir Studio" dhe të zhvillojë aty aktivitetin fotografik shumë të gjatë e po aq të suksesshëm deri në vitin 1963, pra kur ai ishte 80 vjeç.

Veprimtaria fotografike e Kristaq Sotirit dallohet për sasinë e madhe numerike të saj, ashtu si edhe për shkallën e lartë të realizimit. Në më se 15.000 pllaka xhami e negativa me dimensione të ndryshme është pasqyruar një pjesë e rëndësishme e jetës historike, ekonomike, sociale, arkitekturore, urbanistike, natyrore, kulturore e artistike e qytetit të Korçës, me çrast janë fotografuar kryesisht portrete, foto të përbashkëta familiare, peizazhe karakteristike të Korçës, Pogradecit, Dardhës, Voskopojës, mjedise etnologjike, ceremoni të larmishme qytetare, personalitete të jetës ekonomike e shoqërore, intelektuale, përfaqësues nga shtresat më të larta aristokratike e deri tek njerëzit më ordinerë, si fshesarë, ciganë, varfanjakë të vetmuar, pra tematika e krijimtarisë së Sotir Studios është shumë e gjerë dhe e larmishme e, me siguri, përbën një tablo të kompletuar të situateës qytetare gjatë viteve të aktivitetit të tij. Aspekti i dytë e komplementar është mjeshtëria e profesionalizmi, si dhe niveli i lartë mjeshtëror e artistik i fotove të tij, që vjen si rezultat, së pari i talentit të tij visual e shpirtëror, pastaj i punës dhe eksperiences së tij të gjatë e mjaft serioze për t'u kultivuar e për t'iu përgjigjur kërkesave të tij mjeshtërore e profesionale, më tej të përvojës së jashtzakonshme kontemporane që ai kishte asimiluar në ShBA. Të gjitha etapat e fotografimit, qysh në modelim, shkrepje, larje, retushim e stampim përbëjnë një cikël të mbyllur, çdo hallkë e të cilit kishte rendësinë dhe përgjegjësinë e saj të veçantë.

Karakteristike për Sotirin është përdorimi i dritës natyrale të diellit. Për këtë, studioja e tij kishte një dritare të posaçme, madje ai u thoshte klientëve të tij të vinin në momentin që disku diellor të ishte në favor të realizimit të fotos. Fotot e Sotirit janë të larmishme në kontekst të kohës kur ai punoi, janë bardh'e zi, monokolor, sepia, të kuqëreme, jeshile, etj.

Kristaq Sotiri konsidrohet nga shumë studiues si një artist lirik, si Mioja në pikturë, apo si Lasgushi në poezi. Fotot më të realizuara të tij vlerësohen portretet e studiuara dhe të fotografuara në kontekst artistik, estetik e pathos të vacantë shpirtëror. Kompozimi figurativ, këndvështrimi optik, qëndrimi i figurës në marrëdhënie me dritën, qartësia dhe thellësia konvergjente e rrezeve të dritës, kontrasti i theksuar apo kalimi i butë hije-dritë, elementët psikologjikë të

personazhit ku spikat studimi i vëmendshëm i personazhit dhe gjetja e momentit e elementit tipik shprehës të karakterit, improvizimi luminar, plasticiteti, pathosi
shpirtëror i ekzaltuar, faktorët artistikë e estetikë e bëjnë Kristaq Sotirin një artist origjinal, individual, të perceptueshëm e, mbi të gjitha, një artist fotograf që vlerat e krijimtarisë së tij nuk janë momentale spontane, apo tranzitive, por do t'i rezistojnë kohrave të historisë së fotografisë shqiptare vetëm nëse me to do të sillemi paskëtaj më obligues, më ekzigjentë, më dashamirës, më të qytetëruar ndaj një pasurie të papërsëritshme siç është ajo e Kristaq Sotirit. Nëpërmjet fotove të Sotirit pasqyrohet niveli i prosperiteteit ekonomik, social, kulturor, intelektual, i mënyrës së përparuar të jetesës, të veshjes, të sjelljes, të lakonizmit, delikatesës, respektit ndaj emancipimit, modernitetetit, dëlirësisë e sidomos të marrëdhënies së femrës me realitetin shoqëror dhe fotografinë si një kujtim e një dëshmi reale për amibicjen e nivelin e saj përparimtar.

Ai është, së fundi, edhe Artist i Popullit.

2.George D. Boria (1903-1990) që në rininë e hershme tundohej nga kurreshtja, e panjohura, guximi, pasioni, enigma, aventura, ambicja e egoizmi dinamik, të cilat, me hir a pahir ia mundësuan ëndrrën amerikane nëpërmjet një udhëtimi romantik e optimist, por jo edhe pa bema sentimentale rinore drejt Kalifornisë, si dhe me plot ide e energji pikareske kryesisht në sferën e muzikës dhe të pikturës, të cilat iu bënë krah e e ndihën fillimisht për t'u inkuadruar në jetën amerikane(madje deri edhe prapa sipareve hollivudiane).

Shumë shpejt u orientua ndaj arsimimit dhe edukimit e, më pas, preferencat e tij fotografike e angazhojnë tërësisht në profesionin e fotografit, fillimisht si amator në disa periodikë e, më pas, si një mjeshtër në studion e tij profesionale në Los Anxheles dhe Uashington nga fundi i viteve '30 e fillimi i viteve '40.

Por viti 1942, falë edhe natyrës e karakterit të tij plot adrenalinë eksploruese, përcaktoi kthesën vendimtare në jetën e tij. I ofrohet vendi i fotografit në ushtrinë amerikane, ku, për disa vjet kreu disa misione fotografimi në Europë e në OKB, ndërkaq, më 1947 pranohet si fotograf civil në Shtabin Ushtarak Amerikan të Azisë Lindore që komandohej nga gjenerali i famshëm Dagllas MekArthur. Rifillojnë vite intensive të një angazhimi e pune profesionale prej një fotografi shumë të përkushtuar e prodhimtar, kamera e të cilit bëhet e pranishme thuajse në të gjitha mjediset e ngjarjet ushtarake amerikane në Lindje, si dhe në

ambientin shumë kompleks të jetës ekonomike e sociale të Japonisë pas kapitullimit të saj. Veprimtaria fotografike e George Borias përmblidhet kryesisht në një koleksion prej disa dhjetra mijra fotosh e negativash që, sot, ruhen në Qendrën Muzeore Douglas MacArthur në Norfolk të shtetit Virginia jo vetëm si dëshmi historike, një pjesë e të cilave është e njohur botërisht, por edhe si atribut i një prej fotografëve më prodhimtarë që ka lënë gjurmë mjeshtërie, identiteti, origjinaliteti e force shprehjeje me një gjuhë të pashlyeshme pamore memoriale, vërtetësie, pse jo edhe rekreative. Fotot e Borias janë përfshirë në disa botime kolektive ndërkombëtare dhe, së fundi, në Japoni janë botuar dy vëllime katalogësh dinjitozë me vepra të tij të realizuara në Japoninë e pas Luftës së Dytë Botërore. Fotografitë e Borias paraqitin jo vetëm enumeracionin e tyre sasior, por shprehin, mbi të gjitha, disa tipare të rëndësishme profesionale e artistike. Ato shquhen për realizëm të theksuar historik e jetësor, për pathos të theksuar humanizmi, për autentizëm, për dinamizëm, për perceptime e zhbirime të thella psikologjike, për dramatizëm, tragjizëm, për dhimbje, brengë, melankoli, trishtim, për raporte e kontraste të theksuara sociale, pse jo edhe për optimizëm, shpresë e besim për një të ardhme më të mirë të botës së shkatërruar nga luftrat. Ato zotërojnë popullaritet e afeksion të vecantë në opinionin japonez, korean, filipinas.

Boria mbaroi misionin e vet si fotograf në Lindje në vitin 1961. Gjatë kësaj kohe ai ka hapur dhe ka vënë në punë të parin laborator amerikan për fotografi me ngjyra dhe në këtë laborator ka realizuar shumë fotografi. Ai kthehet në ShBA në vitin 1961, por angazhohet sërish në disa projekte të Departamentit Amerikan të Shtetit, deri sa ngadalë e në mënyrë natyrale e ndërpret punën e tij për shkak të moshës.

Një kapitull të veçantë në jetën e G. Borias përbën pasioni i tij i koleksionistit, me ç'rast lidhet gjesti i tij filantropik për Korçën, qytetin e tij të lindjes. Me të hollat e kursyera gjatë gjithë jetës së tij, si dhe me një koleksion të pasur objektesh etnokulturore, historike e artistike që i kishte mbledhur në vendet e Azisë Lindore, u ndërtua në Korçë(pas vdekjes) sipas testamentit të tij, Muzeu i Artit Oriental "Bratko", duke lënë kështu edhe një gjurmë tjetër qytetarie e atdhedashurie.

George Boria i la historisë botërore të fotografisë gjurmë të pashlyeshme të dimensioneve planetare, dëshmi të pazëvendësueshme historike universal; ai i la vendlindjes së tij koleksionin dhe pasurinë e pasionit të tij artistik, prandaj edhe kujtimi i tij mbetet i rrethuar nga brerorja e mirënjohjes njerëzore.

3.Gjon Mili(1904-1984). *The last but not the least*(i fundit por jo më i vogli) – kështu e ka vlerësuar fotografin gjenial nga Korça studiuesi e albanologu i njohur kanadez Robert Elsie me rastin që ky ka botuar për fotografët e vjetër të Shqipërisë e Ballkanit juglindor.

Edhe për Gjon Milin historia e emigracionit fillon që kur ai ishte 5 vjeç, fillimisht në Rumani ku ai e kaloi adoleshencën duke u edukuar e shkolluar dhe duke u marrë me hobinë e tij që ishin paisjet elektrike, të cilat e tërhiqnin drejt enigmave të tyre të elektricitetit. Këtë pasion ai e materializoi duke studiuar në një prej universiteteve më të famshëm në këtë fushë në ShBA – Instituti i Teknologjisë, Massachusets – dega elektrike, ku ai e gjen veten shumë mirë.

Në kontakt me opinionin patriotik shqiptar, njëheresh, Gjon Mili do të përfshihej në lëvizjen pro-shqiptare dhe gjatë kësaj kohe do të jetë Faik Konica, i cili, duke nuhatur prirjet e Milit në fushë të fotografisë, e inkurajon atë të aktivizohet në këtë profesion shumë atraktiv në atë kohë. Dilemat e Gjon Milit nuk zgjatën shumë dhe ai, pas disa sprovave të suksesshme në këtë fushë, do t'i përkushtohej asaj deri në fund të jetës së tij të gjatë. Falë aftësive të tij profesionale e intelektuale, ai do të botojë fotot e veta në disa organe e periodikë amerikanë, por ajo që do të përcaktonte udhën e tij të suksesshme botërisht do të ishte bashkëpunimi me revistën e njohur "Life", e cila, veç fames që kishte, do r'ia rivitalizonte atë edhe nëpërmjet fotove interesante të Milit, në shumë raste edhe në kopertinën e saj.

Por suksesi botëror i Milit i dedikohet po aq shumë edhe njohjes e bashkëpunimit më 1937 me shkencëtarin vërsnik amerikan Herëlld Exherton, i cili punonte në laboratorin e ITM(i njëjti universitet ku kishte studiuar edhe Mili ynë) në fushën e zbulimit të metodave të ndriçimit artificial me fluks e frekuencë të lartë kuantike në disa degë të shkencave, ku mund të aplikoheshin ato, midis të cilave edhe në fushën e fotografisë. Bashkëpunimi Exherton-Mili shënon fillimin e një evolucioni të rëndësishëm e të vijueshëm në të ashtuquajturën "dritë stroboskopike"(drita e çastit, flesh) dhe shpejtësisë alternative të diaphragmës së aparatit fotografik, që i dhanë frymëmarrje, cilësi e zhvillime thelbësore teknikave e proceseve teknologjike e estetike të fotografive.

Me këtë zbulim e përdorim të fleshit elektronik të dritës, fotografia, veçanërisht ajo e sallave të mbyllura fitoi zhvillime të reja shumë produktive. Gjon Mili për shumë vite eksperimentoi dhe elaboroi fotografi sensacionale e që i dhanë atij një njohje e fame botërore. Qysh

më 1934 Mili kishte çelur ekspozitën e pare fotografike, përshtypjet e opinionet për të cilën i kishin dhënë nxitje pozitive për realizimin e fotografive të mëtejshme. Konvergimi i komponentit të zbulimit e aplikimit shkencor të dritës stroboskopike me tharmin e talentit magjik të Milit në fokusin e punës së tij avanguardiste, reflektoi duke ridimensionuar cilësisht e sasiorisht një trend të ri ndërkombëtar fotografik, që Gjon Milit i është njohur e atribuar me respekt e nderim botëror. Eshtë kjo arsyeja që ai njihet si njëri prej fotografëve më të mirë të të gjitha hapësirave e kohrave fotografike. Madje, atij i janë vënë shpesh edhe epitete të tilla ekstravagante si "shqiptari gjenial", "njeriu që ngrin lëvizjen", "fotografi që stopoi kohën", "fotografi i dritës", "magjistari i fotografisë", "Theolog i fotografisë", etj.

Edhe më pas, kur ai e ka përfunduar për më se 10 vjet punën eksperimentuese, ai vazhdon të "prodhojë" qindra e qindra fotografi me sens të theksuar artistik e estetik, të cilat e mbajnë në nivelet më të larta të krijimtarisë globale. Me shumë interes janë veçanërisht një cikël me foto që Mili i ka bërë piktorit spanjoll Pikaso duke vizatuar në errësirën e ajrit me një "laps" elektrik, foto që jo vetëm surprizuan opinionin artistik, por që vijojnë edhe sot të imitohen nëpërmjet teknologjive elektronike.

Personazhe të artit fotografik të Gjon Milit ishin ato të çdo mjedisi të aktivitetit human, të hapësirës gjeo-shoqërore, politikës, artit, shkencës, sportit, modes, nudove, fragmentit e detajit femëror, qindra e qindra portreteve të personaliteteve, sepse arti i tij ishte arti i niveleve të larta, arti elitar.

Gjon Mili ka sprovuar vetitë e aftësitë e tij edhe në filmin e shkurtër, që në atë kohë lëvrohej mjaft. Edhe pse një lloj "intermexoje" në punën e tij voluminoze fotografike, filmi i tij i vetëm "Jammin' The Blues", ku ai ishte regjisor, nuk kaloi pa lënë gjurmë eksperimentuese e cilësi të admirueshme rekreative, për shkak të të cilave ai u nominua më 1944 si pretendent për çmimin Oscar.

Biografia artistike e Gjon Milit është shumë e gjerë, shumë e pasur, shumë e çmueshme artistikisht. Ai mbetet figurë artistike e niveleve e dimensioneve botërore, enciklopedike, monografike, ekspozicionale, eksperimentuese dhe si një prej përfaqësuesve më të shquar e më të mirënjohur të diasporës shqiptare në të gjithë botën.

Mili ka botuar, gjithashtu, edhe disa libra, në qendër të të cilave është përvoja e tij jetësore e profesionale.

Një prej tipareve që i përbashkon të 3 fotografët e mësipërm

korçarë është, veç të tjerave, prodhimtaria e tyre shumë e madhe, ekstensive dhe shumë e larmishme. Fotot e tyre të printuara që ne njohim janë një pjesë e vogël nga arkivat e tyre monumentale që ruhen sot. Për këtë arsye mua më shkoi ndër mend që t'i vlerësoj ata me epitetin "ajzberg", pasi, ashtu si ajzbergu, ajo që soditim prej tyre është ende shumë pak në krahasim me atë pjesë që nuk e shohim dot, por që, dalëngadalë, do të zbulohet gjatë brezave të tjerë, për të plotësuar tablonë e madhe të historisë së fotografisë shqiptare.

BIBLIOGRAFI:

Andoni, B.: Në mbretërinë e fotografit Kristaq Sotiri, Revista Mapo

Wikipedia the free encyclopedia, Online

Encyclopedia of World Biography, 2008, Ads by Google. Online.

Balli. K. : "Edhe një here për fotografin shqiptaro-amerikan George D. Boria , Gazeta 55, 23 Prill dhe 24 Prill 2010, f. 21 dhe 22

Balli K. 27 Mars 2004, "Muzeu Oriental Bratko, Amaneti që s'e Treti Dheu", Gazeta "Korrieri" 27 Mars 2004, f. 14-15

Balli K."Herëlld Edgerton dhe Gjon Mili një binom drite dhe suksesi gjenial", Buletini Shkencor i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, Nr. 19, v. 2010 f. 157-178

Qerim Vrioni: Fotografia-Një Grusht Diell, 2005

Qerim Vrioni: "Gjon Mili, fotograf shquar shqiptaro-amerikan"

Vasil Qesari me artikujt: "Një Oskar për Gjon Milin" dhe "Magjistari" i fotografisë". Online

Maksim Zotaj: Gjon Mili, shqiptari i madh që shpiku blicin, Gazeta Metropol, Online.

LIFE magazine, 30/1/50: Picasso Paints in Lights, Online.

Robert Elsie: The first Photographers in Albania and the Southwest Balkans.

PREZANTIMI I AUTORËVE SHQIPTARË NGA MALI I ZI

MUZEU HISTORIK KOMBËTAR, TIRANË, MË 17. NËNTOR 2017

FJALËT PËRSHËNDETËSE

1. **Prof. Dr. Isuf KALO**
2. **Prof. Dr. Emil Lafe**
3. **Prof. Marenglen SPIRO,Sekretar Shkencor i AAAS**
4. **Dr. Dorian Koçi, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar**
5. **Dr. Gani Karamanaga, Kryetar i Bashkimit të Krijuesve Shqiptar në Malin e Zi**
6. **Safet Kurtagiq, Drejtor i Fondit për Pakica në Malin e Zi**

Tiranë, më 17.11.2017

Prof. dr. Klara KODRA / Tiranë

MBI TREGIMET E ANTON GOJÇAJ-t
TREGIME (SI) MIKRODRAMA

Anton Gojçaj bën pjesë në ata krijues poliedrikë që synojnë ta realizojnë individualitetin e vet krijues në shumë fusha, duke rrezikuar të mos godasin në shenjë asnjëherë ose ta thërmojnë talentin, po ai u ka bërë ballë sfidave që ka marrë përsipër, duke mbetur vetvetja në çdo gjini dhe në çdo zhanër, në poezi, në tregime, në roman, madje edhe në kritikë dhe në studime.

Përveç kësaj ai i përket një brezi letrar të pasur me talente si një yllësi e shumëngjyrshme, një brez letrar që synon drejt modernes në letërsi, po karakterizohet njëkohësisht nga vendosja e një lidhjeje me traditën, e cila nuk mohohet si në shumë lëvizje avangardiste, po vlerësohet për ato veçori që janë ende të gjalla dhe përmbajnë në vetvete një mundësi rinovimi. Këtë lidhje midis traditës dhe modernes, Gojçaj e ka të përbashkët me brezin e vet, po e realizon në mënyrë origjinale dhe shkrimtari e shpreh këtë prirje që e lidh me traditat më të mira të së kaluarës dhe e projekton drejt së ardhmes në tregimet e tij.

Në tregimet e Gojçajt vëmë re se fillesa epike, rrëfimtari, shartohet me fillesën dramatike, kështu që krijimet e tij në prozë janë jo rrallë mikrodrama, me një koncentrim të lartë veprimi në të cilin fshihet edhe psikologjizmi.

Në prozën e vet të shkurtër Gojçaj ndërthur vizatimin e karaktereve me pak vija shprehëse, si me laps karboni, duke respektuar vizatimin tradicional të personazhit me portretin e tij fizik dhe gjuhën e vet dhe copëzimin modern të karakterit që shpreh thërmimin e individualitetit njerëzor nën trysninë e rrethanave; ndërthur rrëfimtarin tradicional të gjithëdijshëm me rrëfimtarin në vetë të parë që i vështron personazhet nga jashtë dhe di po aq apo edhe më pak se ata.

Ky autor në disa tregime fshin dallimin e njeriut nga qeniet e tjera të gjalla, duke antropomorfizuar figura kafshësh dhe duke zbuluar shtazërinë në disa figura njerëzish. Në këtë mënyrë ai fshin edhe konturat që e ndajnë botën reale nga bota e fantazisë, meqenëse „vëllezërit më të vegjël“ të njeriut që jetojnë edhe ata një botë ndjenjash nganjëherë të pasur, pajisen edhe me aftësinë e mendimit që e ka vetëm

njeriu, kurse te njerëzit autori zbulon nëpër atë shtresë të fshehtë nënvetëdijeje të afërt me kafshërinë që super-egoja e njeriut e mohon. Kështu ndonjë tregim bëhet i afërt me fabulën, po dallon prej saj në saje të fillesës lirike që e afron me poezinë. Kështu ndodh në dy tregime karakteristike si „Atomet, shpirti, dashuria“ dhe „Lotët e qenit“, ku protagonistët e vërtetë janë kafshët, papagajt në tregimin e parë dhe qeni në tregimin „Lotët e qenit“.

Në këto tregime mishërohen ide si dashuria dhe liria, krenaria, humanizmi dhe dëshira për liri, bartës të të cilave çuditërisht bëhen kafshët si qenie të afërta me natyrën dhe që e ruajnë thesarin e vet të ndjenjave, të cilin njeriu i sotëm ia flijon lakmisë dhe egoizmit. Këto tregime janë të bazuara në antitezën midis kafshëve që ngrihen në lartësinë e njeriut dhe njeriut që zbret në nivelin e kafshëve. Papagajt e tregimit të parë të sjellin ndërmend heronjtë romantikë që flijoheshin për dashuri dhe liri dhe përfundonin në mënyrë tragjike se nuk i përshtateshin mjedisit.

Edhe qeni Lac, që vë mbi të gjitha krenarinë dhe solidaritetin me gjallesat e tjera, është një hero në përmasat e vogla të mikrobotës së vet dhe i kundërvihet të zotit të shpërfytyruar nga egoizmi dhe lakmia.

Në tregimet e tjera drama e personazhit fshihet në disa raste pas të zakonshmes, të përditshmes, si ndodh në tregimin me titullin ironik „Të pëlcasësh së qeshuri“ , heroi i të cilit është njeriu i vogël që lufton për mbijetesë, po është i aftë edhe për ndjenja të thella. Drama e tij merr tipare tragjikomike se bazohet në një keqkuptim. Djali keqkupton interesimin, ndjenjën e solidaritetit të një vajze, duke e ngatërruar me dashurinë. Është, pra, motivi tradicional i dashurisë pa përgjigje, por në kushtet e sotme, i ndërthurur me dramën e emigracionit.

Në tregimin „Porosia e një analfabeti“ personazhi kryesor portretizohet edhe në fjalën e rrëfimtarit në vetë të parë, që identifikohet me autorin. Është një personazh lidhja e të cilit e ngushtë me traditën, e bën sa qesharak edhe sublim. Ai është lidhur ngusht me armën, e ka gjymtyrë të trupit, gjë që ta përkujton poemën e Kadaresë „Përse mendohen këto male“. Ky personazh analfabet, po trim e krenar, u bindet ligjeve të pashkruara dhe për këtë sfidon ligjet e shkruara, duke rrezikuar dhe familjen e vet. Qëndrimi i autorit ndaj tij është ambivalent, admirues por edhe kritik. Ky personazh është mishërim i urtësisë popullore, po edhe i paragjykimeve patriarkale, është shqiptari tipik me vetitë e veta të larta, po edhe me kokëfortësinë dhe paaftësinë për t'u përshtatur, për t'u ndërgjegjësuar për të renë.

Një tipar thellësisht dramatik, i bazuar mbi atë pjesën e karaktereve, e shohim edhe te „Katarza e aktorëve“, ku vihen përballë njëri-tjetrit viktima dhe persekutori. Që të dy viktima të diktaturës, po edhe secili bartës i së vërtetës së vet, njëri të idealeve të larta – që diktaturës i pengon, tjetri të një dashurie të sinqertë por që errësohet nga xhelozia dhe çon në krimin e shkeljes së besës; që të dy të shkelur nga rrota e historisë, po pikërisht viktima duke falur denoncuesin arrin katarsisin dhe ndjenja e udhëheqjes së hakmarrjes ishte përligjur dhe nxit katarsisin edhe të tjetrit, i cili kupton kotësinë e urrjetjes së vet që e uli në nivelin e spiunit, po edhe vogëlsinë e tij ndaj forcave shoqërore me të forta se ai dhe e shndërron brejtjen e errët të ndërgjegjes së tij në pendim të vërtetë njerëzor.

Në ndonjë tregim protagonisti i cili qëndron më lart nga mjedisi, përbuzet prej tij siç ndodh te tregimi “Një pikëpyetje e padëshiruar në gjithësi”, mesazhi i të cilit është ambivalent. Protagonisti lufton për të vërtetën e vet deri në flijim, por a ekziston në fakt një e vërtetë e tillë për të cilën ia vlen të jetosh dhe të vdesësh? “Vazhdimi i llojit” që përkufizohet si kuptimi i jetës, a është një e vërtetë e tillë sociale-ekzistenciale? Mos vallë kriza e idealeve e bën heroizmin të panevojshëm? Janë pyetje që shtrohen, po nuk zgjidhen. Rrëfimtari në vetë të parë – autori e do dhe e admiron personazhin e vet të çuditshëm, por nuk është plotësisht i bindur që sfida e tij ndaj realitetit dhe bashkësisë së njerëzve është frytdhënëse.

Në disa tregime është e fortë fillesa lirike, si “Qengj i harruar natën në mal” që përshkohet nga dashuria mallëngjyese për të gjitha qeniet e gjalla, ose “Pako në pako” ku rikrijohet ngrohtësia e familjes në optikën fëmijërore, duke e lidhur me një episod ku njerëzorja ndërthuret me komiken.

Në tregimet e Gojçajt ka edhe një nënshtresë ironike që shkon nga humori deri te sarkazma, po ironia e tij nuk është shkatërruese, autori shkatërron për të krijuar. Ai, edhe nëse e ndjen thellë krizën e vlerave, vazhdon të besojë te vlerat si dashuria, kulti i punës, familja, trimëria. Këto vlera duket sikur janë larguar sot, por vazhdojnë të ekzistojnë dhe ai arrin t’i mishërojë përmes një forme me nivel të lartë estetik.

DR. Moikom ZEQO

VARREZAT NË ANË TË MALIT – ULQIN
Autor Mr. Ali ef. Bardhi

Tiranë, 5 dhjetor 2017: Libri "Varrezat në Anë të Malit – Ulqin" me autor Mr. Ali Bardhin), është botim i Art Club, Ulqin, 2016.
Është padyshim një botim i rëndësishëm shkencor i kulturës mortore të shqiptarëve të Anës së Malit, Ulqin në Republikën e Malit të Zi në harkun kronologjik fillimi i shekullit XVIII dhe në gjysmën e shekullit XX.
Projekti i këtij botimi është realizimi i një projekti për hulumtimin dhe studimin e varrezave të trevave të Anës së Malit, Ulqin, që nisi në 2012 dhe përfundoi në 2015, ku kanë dhënë ndihmesë edhe disa bashkëpunëtorë shkencorë si Ermal Nurja, Nail Draga, Behid Kanaqi, Gazment Kovaçi, Ismet Kallaba, fotografi Krenar Kurti etj.
Klad Levy Strosi, antropologu i madh francez ka thënë se kultura mortore me simbolikën e saj është ciklike dhe shpesh e konvertueshme në konceptimin botëkuptimor të jetës së një populli, ku edhe akulturimet alternative nuk e zhbëjnë dhe nuk e metamorfizojnë dot vetëdijen etnike të etnogjenezës.
Pra, shkëputjet historike nuk janë në hiatus, por në një bashkëveprim dhe sintezë nocionesh dhe praktikash ceremoniale dhe përfaqësuese.
Mbasi edhe unë, me modesti, kam bërë disa hulumtime për dëshmitë arkeologjike ilire dhe arbërore në hinterlandin e Ulqinit dhe të Shasit, për kulturën urbane si një fazë më cilësore dhe me atributin e rezultantes historike, mund të them se treva koncentrike shqiptare me tiparet qendrore të Ulqinit të shekujve është një imazheri e lexueshme e kontinuitetit të sigurt dhe të pandalur.
Me të drejtë mr.Ali Bardhi e ve në dukje në studimin e tij etnogjenezën, që nga neoliti, eneoliti, epoka e bronxit dhe hekurit e prehistorisë së etnosit ilir të cilët përfaqësohen me kulturën mortore të specifikuar me arkitekturat rrethore dhe konike të tumave, të quajtura dhe magile.
Zbulimi edhe në Antikitetin e Vonë të kulturës arbërore të hershme, që si terminus ashtë quem ka shekujt IX ose XI tregon për një unitet në diversitet me kulturën pagane mortore ilire me kulturën e krishterë mortore arbërore edhe në ornamenstikë dhe simbolikë.

Ulqini është një nga qendrat më tipologjike të qytetërimit iliro-arbëroro-shqiptar deri në vitin 1571 kur u fiksua në hartën e perandorisë osmane.
Ky fakt historik, duke mos e tjetërsuar etninë e shqiptarëve anas bëri një përshtatje dhe një konvertim edhe të kulturës mortore.
Nga kërkimet në terren për Anën e Malit gurvarri më i hershëm me mbishkrim i përket vitit 1707.
Në fakt mbishkrimet osmane brenda kështjellës së Ulqinit janë edhe më të hershme.
Autori Ali Bardhi ka kataloguar koleksionin prej 600 gurvarresh, duke trajtuar karakteristikat e gurit, të epigrafisë dhe të motiveve dekorative dhe simbolike. Paraprakisht ka një mungesë artefaktesh, ato të Principatës së Balshajve në shekullin XIV, të periudhës venedikase dhe të periudhës osmane, deri në shekullin XVIII.
Varret e ritit islamik janë vërejtur ndërkaq edhe në 25 fshatrat e besimit katolik të kishës së Millës, në Kllezën Nalt dhe në Fraskaniel.
Autori Ali Bardhi ka kërkuar dhe identifikuar edhe varret e Nizamëve (varre ushtarësh të rregullt osmanë, në dallim nga ushtarët rezervë), po pa epitafe.
Dy gurvarre të gjetura në varrezat e vjetra të xhamisë së Shasit, ku dokumentohet mbiemri Shasi (1199/1784 dhe 1206/1791), janë dëshmi vijimësie të gjeneratave të banorëve vendas.
Përsa i përket formës së kokës së gurvarreve tek meshkujt janë gjetur tri llojesh: çallmë, sarek, çallmë kavuk dhe fese.
Për gurvarret e femrave format janë të ndryshme.
Mbishkrimet janë në dy mënyra: gdhendje në gur, si dhe gdhendje e sipërfaqes së gurit për të nxjerrë shkronjat epitafike.
Gurvarret kanë edhe struktura dekorative me simbole të skalitura si Dielli (me gjashtë cepa) ylli apo vula (myhyri) i Sulejmanit, svastika, gjysmëhëna, ylli dhe Hëna, selvia, lule dhe simbole të tjera.
Lloji i shkrimit është shkrimi nesih dhe rrallë herë si sylys. Shëndet edhe duaja për të vdekurin.
Ja një shembull epitafik “Kunna mithlukum se-tekunune mithlena” - (“Ne ishim si ju e ju do të jeni si ne”)
Gurvarret kanë emra tradicionalë si Zogo, Syna, Hëna, Ujk, Pirro, Agush, Voca, Çik. Janë gjetur dhe emra të tjerë si Nika, Lika, Koka, Luka, Ceka, Hoti, Halli, Kurti, Gjeloshi, Kasneci, Lleshi, Demiri, Kovaci, Zoga, Pali, Ibroci, Aloja, Çapra, Dibra, Bajra, Pelinku, Elezi, Kraja, Dabi etj. Me këto gurvarre s’ka mbiemra me mbaresat sllave me iq dhe viq.

Përsa i përket datës në këto gurvarre përdoret kalendari hixhri, por ndodh që përdoret dhe kalendari julian (rumi), por edhe ai gregorian.
Por janë edhe 9 gurvarre në kalendarin miladi (me mbishkrime arabo-osmane të periudhës së vonë).
Përsa i përket simboleve është edhe motivi i gjerdanit i shpatës dhe i thikës.
Simbolet si shqiponja dhe ujku nuk i gjejmë në këto simbole mortore.
Shkronja Nun, e alfabetit arab, ka formën e gjysmëhënës dhe simbolizon ringjalljen.
Ylli gjashtëcepash (hekzagrami) është ylli i Solomonit, (Sulejmanit) por simbol i heraldikës së Balshajve deri dhe tek stema e Skënderbeut.
Hekzagrami dokumentohet, që në periudhën bizantine.
Tek gurvarret e femrave lulja është gjithashtu me gjashtë petale.
Simbol tepër i vjetër, që nga prehistoria është svastika, ose ylli në formë helike.
Simboli i shpatës është atribut mashkullor.
Selvia, ka shpesh një gjysmëhënë në majë.
Selvia në artin islam është dhe gishti tregues i Shenedetit (Dëshmisë)
Lulja e jetës, shpesh është simbol i përbërë prej rrathësh të mbivendosur.
Rregulli qëndron në simetrinë për të krijuar një formë gjeometrike të ngjashme me një lule.
Qendra e çdo rrethi përputhet me pikëprerjen e gjashtë rrathëve të tjerë, në të njëjtin perimetër.
Pozicioni i tyre krijon një strukturë gjashtëkëndore të brendashkruar në një rreth më të madh
. Lulja e jetës e gjetur në gurvarret e Trevës së Anës së Malit është në formë konvekse dhe në formë konkave (lugore dhe kodrinore).
Lulja e jetës është simbol në tempujt e Egjiptit (6000 vjeçare) në Spanjë, në Ballkan, Kinë, Japoni, Indi, si dhe në muzeumin (tyrben) e Haxhi Bektashit.
Punimi i Ali Bardhit nuk është subjekt arkeologjik, por kërkim profesional në terren, si dhe dëshmi epigrafike dhe traditës skulpturore dhe dekorative të gurvarreve.
Islami, si hebraizmi janë ikonoklastë për imazhin e njeriut.
Paraqitja e çallmave dhe feseve është më tepër dëshmi e llojit gjenetal njerëzor.
Në shekullin XVII udhëtari i njohur Evlija Çelebiu (1611-1684), biri i një argjendari në Stamboll vizitoi dy herë edhe trevat shqiptare.

Ai la dëshmi të pazëvendësueshme për monumente dhe dëshmi epigrafike në qytete kryesore si Gjirokastër, Elbasan dhe Berat.
Ai flet për një koleksion kronogramesh poetike dhe përdorimin e sistemit Etxheb.
Në shekullin XX orientalisti shqiptar Vexhi Buharaja, i nivelit europian, koleksionoi dhe transkriptoi qindra mbishkrime arabo-osmane me rëndësi kryesore.
Të mos harrojmë dhe një tjetër orientalist të shquar shqiptar nga Kosova Hasan Kaleshi.
Mr. Ali Bardhi është pasues i denjë i kësaj hullie studimore.
E uroj autorin për këtë studim të tij të vyer dhe tepër kompetent.

Dr. Olimbi VELAJ (Tiranë)

"NË DERË TË OBORRIT",

Gani Karamanaga sjell faktet e rrëfimet për kalanë e Ulqinit

Përmbledhja "Në derë të oborrit" e autorit Gani Karamanaga përmban kallëzime nga kalaja e Ulqinit. Që në nisje autori e saktëson se pretendimi i tij është pikërisht ky: të rrëfejë, të kallëzojë gjithçka për kalanë, atë vend që është zemra e Ulqinit dhe atë vend ku ai u rrit dhe që e njeh si një vendlindje krejt të veçantë.

Vërtet, për këdo që e njeh Ulqinin, qoftë si vizitor, qoftë si njeri kureshtar, qoftë si vendas e banor i qytetit, kalaja është pika e referimit dhe në përfytyrimin e secilit Ulqini vjen së pari përmes kalasë. Simbolika e kalasë si përfaqësuese dhe prezantuese e qytetit, nuk është një simbolikë e panjohur, ajo përkundrazi dominon historinë e mjaft qyteteve, sidomos në kulturën e Mesdheut dhe të Evropës. Duke datuar pesë shekuj përpara erës së re, kalaja e Ulqinit[71] (qyteti evidentohet nga autorët grekë e romakë që në fillmet e tij) shërben edhe si një pasaportë për gjurmët e mbijetuara të lashtësisë së qytetit.

Sapo e merr në dorë librin, teksa nis të lexosh faqet e para, menjëherë të vjen në mend një ngjashmëri me librin "Stambolli" të Orhan Pamukut, në të cilin ai risjell në vëmendjen e secilit, rrëfimet e veta për qytetin, duke ndërthurur letrarisht të gjitha faktet dhe kronikat, së bashku me përjetimet e kujtimet e veta. Në një këndvështrim ky libër i Gani Karamanagës ka ngjashmëri me librin e nobelistit turk. Nuk mund të thuhet se ngjan për nga mënyra si është shkruar, por nga mënyra si është konceptuar mund të pohohet se ngjan mjaft për nga qasja se si një bir i një qyteti autori ndjehet i lidhur me të dhe se si ai mëton të hedhë

[71] Gaius Plinius Sekundus e përmend Ulqinin në librin III te "Naturali Historiae" (Historia e natyrës): 144 a Narone amne C p. abest Epidaurum colonia. ab Epidauro sunt oppida civium Romanorum Rhizinium, Acruium, Butuanum, Olcinium, quod antea Colchinium dictum est, a Colchis conditum, amnis Drino superque eum oppidum civium Romanorum Scodra ab mari XVIII, praeterea multorum Graeciae oppidorum deficiens memoria nec non et civitatium validarum: eo namque tractu fuere. Labeatae, Senedi, Rudini, Sasaei, Grabaei; proprieque dicti Illyri et Taulanti et Pyraei retinent nomen. in ora Nymphaeum promunturium. Lissum oppidum civium Romanorum ab Epidauro C. p.

dritë mbi rrënjët e tij përmes gjithë kujtimeve dhe përshtypjeve, përmes marrëdhënieve njerëzore dhe trashëgimisë materiale e jomateriale.

Libri është konceptuar si një seri tregimesh, të cilat i lidh një fije e vetme: kalaja dhe njerëzit e saj. Autori na e shton interesin kur merr përsipër të flasë vetëm për kalanë, duke e ndriçuar historinë e saj dhe të banorëve të saj në çdo pikëvështrim të mundshëm. Kalaja, bërthama e pavdekshme qytetit dhe simboli i tij përgjatë gjithë ekzistencës, vjen në libër e evidentuar përmes përshtypjeve që kanë banorët e saj. Autori zgjedh ta kompozojë librin duke e parë kalanë si një territor të palëvizshëm, të pandryshueshëm, ashtu sikurse ajo është prej fillimit, ndërsa njerëzit janë ata që tregojnë historinë, duke krijuar kujtimet kohë pas kohe dhe duke u ndërruar ndër breza. Kompozimi i librit kështu e kthen në një skenë të palëvizshme kalanë dhe në një lumë breznish njerëzit brenda saj, të cilët janë shumë më jetëshkurtër se kalaja, por janë mjaft gjurmëlënës mbi të, përmes veprave të tyre të paharruara, që transmetohen në breza. Autori ka arritur ta japë shumë natyrshëm këtë lidhje të pashkëputur të njerëzve dhe kalasë, duke mos harruar kurrë lëvizjen dhe ndërrimin e përhershëm të njerëzve dhe statikën e përhershme të kalasë, si një monument që i tejkalon të gjitha kohërat.

Libri[72] ndahet në tetë kapituj: Kala e bekuar, Legjenda-Re, Detaria, Tërmeti, Fëmijëria, Lirike, Anekdota, Banorët e kalasë së Ulqinit. Në fund të librit janë përfshirë edhe tri recensione nga Asllan Bisha, Ardita Rama e Gjekë Gjonaj, ndërsa parathënien e ka shkruar Fadil Kraja.

Siç duket edhe nga emërtimet e kapitujve, autori merr përsipër të na udhëheqë drejt kalasë duke na e treguar atë nga jashtë dhe nga brenda, në kohën e shkuar dhe në kohën e tashme, me sytë e tij dhe me përshtypjet e ardhura tek ai përmes rrëfimeve të të parëve. Autori duket se u kushton rëndësi statistikave dhe dokumenteve, po aq sa mbresave dhe kujtimeve. Nisur nga kjo teksa lexon, të krijohet bindja se interesi i tij është t'ua tregojë kalanë atyre që nuk e njohin dhe t'ua ritregojë dhe rikujtojë atyre që e njohin, ose që janë banorë të saj. Kësisoj autori duket se ka kryqëzuar letërsinë me mitologjinë, folklorin, antropologjinë e sociologjinë. Teksa lexon e kupton se interesi i tij i shumanshëm ndaj gjithçkaje që i përket kalasë e ka çuar drejt një zhanri të çuditshëm, të papërcaktuar, por njëherësh shumëfunksional dhe që u shërben të gjithë lexuesve, pavarësisht me çfarë kulture ose informacioni ata qasen te ky libër. Le të kujtojmë një pasazh të shkurtër të Claude Levi Strauss, i cili teksa tregon se si u bë etnograf, saktëson dëshirën e tij për të rrokur të

[72] Gani Karamanaga, "Në derë të oborrit", Ulqin, 2017, f. 201-204.

tërën: "Etnografia më sjell një kënaqësi intelektuale: si histori që bashkon me dy skajet e saj atë të botës dhe timen, ajo zbulon njëkohësisht arsyen e tyre të përbashkët."[73]

Autori Karamanaga, duke mos qenë me profesion as antropolog, as etnolog e etnograf, e ka rrokur këtë plotëri intuitivisht, duke dashur që natyrshëm të rrëfejë gjithçka për kalanë. Kjo dëshirë për të treguar gjithçka, me të gjitha format e mundshme të rrëfimit dhe nisur nga të gjitha pikëveshtrimet e ndryshme në kohë e hapësirë, e afron autorin me një pozicion të antropologut, etnologut e folkloristit, pavarësisht se interesi i tij parësor është kallëzimi si tillë dhe jo kallëzimi i bërë nga njëri ose të gjithë profesionistët e këtyre fushave. Sidoqoftë, në çdo kapitull të bie në sy një material i bollshëm i mbështetur mbi rrëfimin e kujtimeve, fakteve, shifrave.

Nëse u referohemi kujtimeve, të cilat, duhet pohuar, zënë pjesën më të madhe të monografisë: A kemi të bëjmë me histori gojore, apo teksti i sjellë mbetet vetëm në kufijtë e kujtimeve dhe imazheve që ruan autori në kujtesën e vet? Ndoshta në një trajtim më të zgjeruar do të duhej të hetonim për këtë, megjithatë nuk mund të përjashtohet edhe këndvështrimi i historisë gojore[74], e cila në ditët tona po merr mjaft vlerë dhe po merret në konsideratë edhe nga historianët, përveçse nga gazetarët e shkrimtarët.

Libri është një kronikë përmes përjetimeve dhe rrëfimeve të vetë autorit, por edhe përmes historive të dëgjuara nga të tjerët. Me një korrektësi dhe skrupulozitet të admirueshëm, lexuesit i serviret hap pas hapi çdo detaj që na shpalos të plotë kalanë dhe banorët e saj.

Teksa dimë fakte nga historia dhe statistikat, ajo që na sjell Karamanaga është diçka krejt tjetër. Është historia e përjetuar nga secili. Është koha dhe gjurmët e saj mbi njerëzit. Breznitë, fejesat, martesat, vdekjet, tragjeditë, dashuritë dhe të papriturat më të thekshme të çdo familjeje dhe të çdo individi që la gjurmë me mënyrën se si jetoi dhe se si bashkëjetoi në kala.

---

[73] Claude Levi-Strauss, "Tropikët e trishtë", Verbamundi 9, etnologji, "Çabej", (botimi i parë: Librarie Plon, 1955), f. 55.

[74] Në "Collins English Dictionary" (HarperCollins Publishers) për historinë gojore përkufizimi është: histori gojore: kujtimet e njerëzve të gjallë rreth ngjarjeve ose kushteve shoqërore që ata kanë përjetuar, ruajtur, regjistruar si evidencë historike. Historia gojore u referohet kujtimeve, tregimeve, madje edhe këngëve dhe i studion ato duke i parë si një mënyrë për të komunikuar dhe zbuluar informacion rreth së kaluarës.

Banorët ndahen në ikës dhe pritës. Burra detarë që shkojnë larg, në dete të huaja, por që gjithmonë e kanë mendjen te shtëpia. Lajme për humbjet e tyre, ankth, pastaj mbijetesë. Histori të çifteve të ndara dhe të bashkuara, histori të familjeve të këqyrura nga brenda dhe nga jashtë. Banorë që mbeten në kala duke pritur. Gra, bija e nëna, që rrinë me sytë nga deti dhe që jo rrallë iu bie të gëzojnë pas maktheve. Aksidente në muret e kalasë, që jo të gjitha përfundojnë keq dhe kësisoj kalaja merr vlerë tjetër në sytë e secilit.

Libri duket si një udhërrëfyes i jetës materiale dhe shpirtërore të disa dekadave në kalanë 2500 vjeçare të Ulqinit. Në më pak se 200 faqe, mes dhjetëra fotosh të regjistruara përgjatë jetës së tij si banor i kalasë, Karamanaga bëhet një kronikan modern i kësaj pjese të qytetit, e cila është edhe pjesa më kuptimplote e Ulqinit.

Parë në një këndvështrim tjetër, përveç atij letrar, libri sjell përpara lexuesit fakte dhe detaje shumë domethënëse që na qartësojnë gati krejtësisht jetën e banorëve të kalasë, zakonet, mënyrën se si e perceptonin pasurinë, marrëdhëniet midis shtresave sociale, marrëdhëniet midis njerëzve brenda fisit e familjes, marrëdhëniet në shoqërinë e disa dekadave, të cilat janë jetuar dhe përshkruar nga vetë autori.

Është interesante se si jeta e një njeriu mes të afërmve, miqve, fqinjëve dhe kolegëve, papritur mund të kthehet në një subjekt rrëfimi jo vetëm për vete, por për njerëz të tjerë, lexues. Interesante, sepse autori ka arritur të tejkalojë të folurit për vete, duke cekur dhe duke ndriçuar vetëm pasazhe që kanë realisht vlerë edhe për të tjerët. Kësisoj ai nuk ka shkruar një libër nisur nga vetja dhe për vete, por ka shkruar një libër nga vetja për të gjithë. Secili mund të gjejë në këto kallëzime faqe të panjohura për banorët dhe qytetin, faqe historish të jetuara nga secili.

Tregimet fillojnë të hedhin dritë në një mënyrë shumëplanëshe, teksa autori nis me pozicionimin hapësinor të kalasë, me gjithë territorin që e kufizon atë, me ndërtimin, detajet arkitektonike, deri te flora e saj, të cilën autori nuk harron ta evidentojë, madje duke dhënë detaje shumë interesante, deri për bimët endemike që rriten në muret e kalasë: "Lulet bedençe rriten në bedenat dhe shkëmbinjtë e Kalasë. Janë të verdha, em një aromë të pakët.....Lulet bedençe janë autoktone nëpër bedenat në Kalanë e Ulqinit."[75]

Teksa kalon rrëfim pas rrëfimi, tregimet për kalanë nisin e marrin një formë shumë më të qartë dhe duket se rrëfimi është i tillë që të bën t'i

[75] Gani Karamanaga, "Në derë të oborrit", Ulqin, 2017, f. 14-15

përfytyrosh saktë vendet, njerëzit dhe situatat. Arrin të mendosh për vijimësinë e kalasë, për kujdesin dhe indiferencën ndaj ruajtjes së saj, për mënyrën se si brezat e tejçuan krenarinë për faktin e të qenit banor i kalasë dhe se si ata arrijnë të mbajnë lidhjet mes tyre edhe pas fatkeqësive natyrore, që i bënë të dilnin prej kalasë dhe të jetonin diku gjetkë në qytet, ose më larg, në emigracion.

Një vend të posaçëm në këtë kallëzime zë edhe religjioni, mënyra se si ishte e organizuar e besimtarëve praktikantë dhe sesi banorët myslimanë e ortodoksë bashkëjetonin në harmoni me njëri-tjetrin.

Kalaja shihet edhe si vendi i turizmit, ku në verë gjithçka ndërron faqe. Historitë e mjeteve lundruese, të pronarëve të tyre, rrëfimet për klubet e restorantet më të njohura të qytetit, rrëfimet për njerëzit që vijnë si turistë në qytet dhe lidhjet e tyre me vendasit, e bëjnë edhe më plotë tablonë e kalasë.

Duke ecur përmes kujtimeve të veta, autori na tregon përgjatë viteve se si jeta e tij dhe jetët paralele të banorëve ndryshuan. Ai na jep të qartë perceptimin në kohën e ish Jugosllavisë, në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe përmes detajeve na kujton peripecitë e njerëzve, që nuk janë aq personale, por që mbartin e dramën e të qenit shqiptar.

Jeta e njerëzve të kalasë trazohet po aq sa nga situata gjeopolitike, edhe nga fatkeqësitë natyrore. Rrëfimet për luftën e dytë botërore, rrëfimet për periudhën e ish Jugosllavisë, ndërthuren dikur edhe me rrëfimet nga tërmeti, më 1979. Gjithçka u trondit dhe dhimbja për viktimat e tërmetit e konfuzioni i një jete shumë të vështirë pas tërmetit vijnë në libër përmes detajesh që autori i referon si personale, por që janë përfaqësuese dhe tipike për secilin prej njerëzve që u dëmtua shpirtërisht dhe materialisht gjatë kësaj katastrofe natyrore. Por mbi të gjitha tërmeti rrezikoi edhe mbylljen e kalasë nga ana e autoriteteve. Por kundërshtimi i banorëve bëri që kalaja të mos reshtte kurrë së qeni e banuar, duke mos e ndërprerë për asnjë çast vijimësinë e saj si zona më historike dhe më simbolike e qytetit: "Tërmeti i rrënoi gati të gjitha shtëpitë në Kala. Ka pasur mendime që kalaja të mbyllej fare për banorët e saj. Por pati rezistencë të madhe."76

Duke qenë mjek dhe në kontakt të përhershëm me njerëzit, autori na sevir shumë tepër edhe nga përjetimet e çasteve midis jetës e vdekjes. Si një grua e moshuar e përjeton afrimin e vdekjes dhe se si ai bën shaka me pacientët, duke i pasur njëherësh edhe fqinjë.

Një vend të veçantë në libër zënë edhe anekdotat, të cilat të vendosura afër fundit të librit, e relaksojnë lexuesin dhe e bëjnë të mësojë më shumë për njerëzit e kalasë, sepse humori tregon mjaft për karakterin e njerëzve. I shkruar me shumë dashuri, nisur nga vetja, po jo vetëm për vete, libri lexohet me ëndje nga lexues të të gjitha moshave dhe jep një panoramë të plotë për kalanë e Ulqinit dhe banorët e saj.

Bibliografi:

Gani Karamanaga, "Në derë të oborrit", Ulqin, 2017

Claude Levi-Strauss, "Tropikët e trishtë", verbamundi 9, etnologji, "Çabej", (botimi i parë: Librarie Plon, 1955)

C. Plini Secundi, Naturalis historiae libri XXXVII, Mayhoff, Karl Friedrich Theodor; Jan, Ludwig von, Publication date 1875, Usage http://creativecommons.org/publicdomain/mark/1.0/

Collins English Dictionary, (HarperCollins Publishers), https://www.collinsdictionary.com/dictionary/english

Sazan GOLIKU (Tiranë)

TA KUNDROSH DETIN ME SYTË E FËMIJËS

Shkrimtari i mirënjohur për fëmijë Hajro Ulqinaku ka qenë dhe është një autor i dashur për lexuesit e vegjël. Ai mbetet një personalitet i krahut veriperëndimor të letërsisë shqipe. Ashtu si shumë shkrimtarë në botë që identifikohen me një gjini ose zhanër letrar, ose me një vend a hapësirë të caktuar, Hajro Ulqinaku njëjtësohet me detin dhe qytetin e tij, Ulqinin, nga cili ka marrë edhe mbiemrin.

Për këtë shkrimtar janë shkruar shumë recensione, shqyrtime kritike e analiza letrare nga kritikë e studiues të njohur në vatrat shqiptare dhe më tej, po vepra e tij të josh për vëzhgime të mëtejshme, për të zbuluar nga kënde të tjera vlera artistike, njohëse dhe edukative.

Përcaktimi i zhanrit të prozave të Ulqinakut është disi i vështirë. Në librat e tij kemi tregime me subjekt të zhvilluar, rrëfime legjendash e përrallash, përshkrime të një situate, një rit pune, skica peizazhi, proza poetike. Po edhe brenda një proze relativisht të gjatë gjejmë të shkrira elemente të ndryshme të këtyre prosedeve.

Deti dhe bregdeti, qyteti i lashtë piktoresk i Ulqinit e rrethinat e tij, fëmijët e banorët e tij, janë temat e subjektet, personazhet e sotme dhe të së kaluarës historike, janë legjendat e gojëdhënat popullore që gjithë së bashku krijojnë mozaikun e ndritshëm, të lëngshëm, por herë-herë edhe të zymtë, që kushtëzohet nga tragjeditë e pashmangshme detare e dramat e dhimbshme shoqërore.

Krahas bukurisë së detit, e përshkruar me dashuri e lirizëm, ky autor (brenda specifikës së letërsisë për fëmijë) vizaton si me akuarel botën e personazheve, fëmijë e të rritur, në bashkëveprim, në një ndërthurje organike dhe ekzistenciale. Në këtë mjedis e atmosferë ekzotike rrjedhin padukshëm edhe synimet e mendimet morale, pa e cenuar strukturën artistike të kësaj proze. Dhe kjo nuk është pak, kur në mbarë letërsinë tonë për fëmijë ende moralizimi eksplicit është sindromë e pakapërcyeshme.

Ashtu si gjithkund në botë në qytetet bregdetare fëmijët luajnë, notojnë, peshkojnë së bashku, çka pasqyrohet edhe në prozat e Ulqinakut. Solidariteti te këto personazhe shpreh shpirtin e natyrshëm human të fëmijëve tanë. Bota e fëmijëve në shkollë e jashtë saj,

marrëdhëniet mësues-nxënës, nxënës-nxënës, prind-nxënës janë pasqyruar me realizëm edhe në prozat që i trajtojnë rrëfimet brenda e jashtë shkollës dhe për problemet e mësimit.

Po çfarë e bën të dashur e tërheqëse për lexuesin e vogël prozën e Ulqinakut? Thjeshtësia e rrjedhshmëria e rrëfimit janë tipare të këndshme të stilit të këtij autori. Freskia e natyrshmëria e figurave stilistike në skicat poetike krijojnë mbresa estetike te lexuesit. Aventurat dhe të papriturat e ngjarjeve ngjallin tek ata kureshtjen e natyrshme.

Së fundi, në fondin e letërsisë artistike shqipe për fëmijë, prozat e Hajro Ulqinakut tingëllojnë si një poemë e freskët për detin e detarët e vegjël.

(*Sazan Goliku është pseudonimi letrar i shkrimtarit dhe kritikut Pandeli Koçi*)

Gjokë DABAJ

ZËDHËNËS DHE ZËMBROJTËS I SHQIPTARËVET NËN MAL TË ZI

Kur lexon librat e Gjekë Gjonajt, nuk mund të mos mrekullohesh prej punës së tij dhe nuk mund të mos e adhurosh atë njeri të palodhshëm. E them këtë, sepse e di fort mirë ç'do të thotë të jetosh në Republikën e Malit të Zi dhe të shkruah në këtë mënyrë. Me shkrimet e tij Gjekë Gjonaj i mban gjallë dhe i ringjall njerëzit e vendit të vet. Ai, me anë të shkrimevet, i mban gjallë dhe i ringjall gjer në përjetësi të gjitha trevat shqiptare që sot ndodhen nën Mal të Zi.

Kur e sheh në hartë atë pjesë toke shqiptare që shtrihet nga Çakorri deri te Ada në Grykë të Bunës e që dikush e ka quajtur figurativisht Rripi numër 2 i Gazës, të ngjan me ca mbetje gjeografike që zor se i hyjnë në punë dikujt. Mirëpo, kur e lexon lirin e Gjekë Gjonajt "Bijtë e Shqipes", zbulon aty një thesar njerëzor gati të pabesueshëm. Rron Kombi ynë edhe në ato ngastra toke, që ngjajnë në hartë me ca copa letrash të grisura! Rron dhe nxjerr thesare pa ndërprerë! Nxjerr ai vend i shqiptarëvet të atillë personalitete që edhe vende të mëdhenj s'i lindin e s'i rrisin dot!

Njerëzit që ka përshkruar Gjeka në këtë libër, janë aq shumë sa do të duhej një simpozium më vete për t'i pasqyrur e për t'i njohur vlerat e tyre jo me të gjitha veçoritë e hollësitë, por përsëri vetëm pjesërisht. Mendja dhe talenti i atyre njerëzve, i atyre malësorëvet tanë, kanë pushtuar sot edhe Amerikën. Nuk themi kanë mbërritur deri në Amerikë, por themi e kanë pushtuar Amerikën, sepse shumë prej tyre tashmë janë bërë, sidomos në fushën e biznesit, njerëz me peshë dhe gjurmëlënës në ambientet ku jetojnë. Por jo vetëm kaq. Ata janë njerëz që paranë e fituar nuk e ruajnë sënduqeve apo në skuta bankash, por e japin dhe e shpenzojnë edhe në të mirë të Kombit, prej të cilit kanë dalë dhe të cilit, edhe pse larg, vazhdojnë t'i takojnë e t'i shërbejnë.

Gjon Lulgjuraj (f.209), nga Llofka e Grudës, emigruar në SHBA që në moshën 18 vjeç, veprimtar i palodhshëm i çështjes shqiptare. I kthjellët

në përballjen me agjentët sërbo-malazias, të cilët as në SHBA nuk u hiqen qafet shqiptarëvet.
Kolë Zagreda (f.243) nga fshati Reç i Ulqinit, në shtëpinë e të cilit "njëzet e katër orë valon Flamuri Shqiptar". Larguar 12 vjeç për në SHBA dhe unë kam këtë shënim në fund të artikullit që ka shkruar Gjekë Gjonaj për këtë njeri: "Njëri ndër atdhetarët më të vetëdijshëm, që e koncepton Atdheun më saktë se shumë shqiptarë të tjerë që mund të gjenden edhe në krye të politikës."
Familja Jakaj (f.248), nga Ranoci i Klinës. "Shembull i sakrificës njerëzore për mbrojtjen e Kombit dhe Atdheut të vet." Për njërin nga pinjojtë e kësaj familjeje, Tomë Ndue Jakajn, Gjekë Gjonaj shkruan: "Ndihma e tij humanitare është e pranishme në shumë veprimtari bamirësie, si sponsorues i palodhur kudo që e ka kërkuar nevoja dhe kauza shqiptare".
Mark Gjonaj (f.309) nga Reçi i Ulqinit, lindur e rritur në SHBA, biznesmen i suksesshëm, pronar i qindra apartamenteve dhe personalitet në hierarkinë shtetërore të SHBA-së. Midis gjithë asaj që lexova për të, më bëri shumë përshtypje një thënie e tija: "Njeriu ka këto zgjedhje në jetë: (1) T'i pranojë gjanat ashtu si janë. (2) Të ankohet për problemet. (3) Të shpërvjeli mangët, t'i hyjë punës e t'i ndrrojë gjanat… Unë zgjodha të tretën."
Gjonajt e Reçit (f.335). Që të gjithë njerëz të punës dhe krenarë se janë shqiptarë. Gjekë Gjonaj shkruan: „Askush nuk mund të thotë se sa llogaritet pasuria e Gjonajvet të Reçit në Amerikë."
Anton Markola (f.323), shqiptari "që kujdeset për ndërtesën më të lartë në Manhatan", "78 kate të lartë me 350 banesa". Njeri me disa fakultete, "shembull i realizimit të ëndrrës amerikane".
Nick Markola (f.326), bankier. Është pak me thënë i suksesshëm. Ka qenë Zëvendëspresident në Benk of Amerika, një nga bankat më të mëdha në botë. Ka shërbyer si ekzekutiv i bankës së famshme Sitigrup (Citigroup), edhe kjo një nga bankat më të mëdha në SHBA dhe në botë, me filiale bankare e financiare në më shumë se 100 shtete të botës. Ka mbrojtur dy magjistratura dhe është analist i çertifikuar për menaxhim kapitali.
Njëzet faqet e para, nga f.11 deri në f.32, Gjeka ia ka kushtuar Flamurit tonë Kombëtar. Jo më kot ka ndodhur kështu. Flamuri Kombëtar Shqiptar nuk lejohet të mbahet lirshëm në Republikën e Malit të Zi. Nëse dëshiron ta përdorësh në ndonjë dasmë a me rast të ndonjë feste, je i detyruar të kërkosh leje. Duket se pikërisht të këtilla rrethana

diskriminuese e kanë shtyrë Gjekë Gjonajn t'ia kushtojë njëzet faqe pikërisht Flamurit, me titull të përgjithshëm "Dashuria për Famurin". "Flamuri ynë Kombëtar," thotë Gjeka, "radhitet ndër më të vjetrit nga flamujt që vazhdojnë të praktikohen". Pastaj citon Faik Konicën: "Flamuri ynë Kombëtar është nga më të drejtët, sepse asnjëherë nuk priu në mësymje të shqiptarëvet kundra (popujvet të tjerë)." (f.13) Pra, është edhe ndër më të vjetrit dhe është nga më të drejtët! Mirëpo, ç'e do?! Pushtetarët malazias duket se e kanë halë në sy Famurin tonë. "Përdorimi i simbolevet kombëtarë për shqiptarët (nën Mal të Zi) është mjaft i kufizuar", shkruan Gjeka. "As ligji aktual, por as ai që pritet të miratohet në parlamentin malazias, nuk lejon pëdorimin e lirë të simbolevet kombëtarë shqiptarë." (f.14)

Mbas kësaj, si për të vërtetuar se, megjithkëto, Flamuri Shqiptar rron e do të rrojë në viset ku jetojnë "Bijtë e Shqipes", Gjekë Gjonaj ka radhitur një varg faktesh, të cilët te shumë lexues mund të shkaktojnë habi. Më 1905-n, gjashtë vjet para se ky Flamur të ngrihej në Deçiq prej një skuadre heronjsh, është ngritur në Tivar. Pikërisht në Tivarin ku sot praktikisht nuk mund as ta përmendësh.

Në Tuz e Triesh ai Flamur është ngritur më 1906-n, pesë vjet para se historia e Kombit tonë të përjetonte në Bratilë të Deçiqit një nga epopetë e veta më madhështore. Të tre këta akte madhorë të ekspozimit të Flamurit tonë Kombëtar, në Tivar, në Tuz e në Triesh, nuk janë tjetër veçse preludi i aktit sublim të Deçiqit.

Në Deçiq, ndërkaq, më 6 prill 1911, do të ndodhte ajo që as heroizmi mrekullibërës i Zhan D'Arkës nuk do të mund t'i afrohej dhe as qëndresa gjëmëmadhe vetëflijuese e trimavet spartanë të Termopilës. Aty, të shtatë trimat e Kojës së Kuçit, Dokë Preçi, Gjeto Gjeka, Gjeto Toma, Kolë Doka, Tomë Uci, Kolë Uci dhe Mark Luca, ranë vetë, njëri mbas tjetrit prej plumbash të ushtarëvet osmanë, por Flamurin s'e lanë të rrëzohet. (f.80) Mbetet vetëm për t'u indinjuar: Këta shtatë heronj të Flamurit dhe të Kombit tonë, pse s'i kanë përmendoret, në Tiranë, në Vlorë, në Prishtinë, në Shkup, në Shkodër dhe në Podgoricë?! Them, në Podgoricë, sepse ata nga ajo anë ishin dhe se, si vetë malazezët, edhe ata kundër pushtuesvet osmanë kanë luftuar. Pse të mos vihej në Podgoricë një përmendore e tyre?

Detarët ulqinakë, sapo edhe në Vlorë u ngrit Flamuri i Kombit tonë, për të mos u rrëzuar kurrë më, e ngritën atë Flamur edhe mbi anijet e veta. Ndonjëri prej tyre guxoi ta çojë atë Flamur edhe në Tivar, në Tivarin e

pushtuar prej sllavësh tashmë mbi 30 vjet, por e pagoi guximin edhe me gjobë edhe me burg.
Në Hot, Grudë e Triesh më 1912-n dhe në Shtoj të Ulqinit po më 1912-n e 1913-n, valonte ky Flamur, tashmë triumfues në një pjesë të Shqipërisë, por jo triumfues pikërisht në këta vise ku ngritja e tij kish qenë ndër më të flaktat dhe ndër më të shtrenjtpaguarat! Qeveria monarkike sërbo-kroato-sllovene, në të vërtetë monarkia sërbe, do ta ndalonte atë për tridhjetë vjet, deri në kapitullimin e saj.
Por, sapo kapitulloi Jugosllavia Monarkike, më 1940-n, Flamuri ynë u shfaq përsëri. Në një vend që quhet Ullini i Egër, midis Ujmirit dhe Peçuricës, italianët vunë njëfarë kufiri, duke e lënë abuzivisht Tivarin jashtë së quajturës, gjithashtu abuzivisht, "Shqipëri e Madhe". Dhe pikërisht aty u ngrit edhe njëherë Flamuri i Kombit Shqiptar. Pastaj në Ulqin te Kisha e Shnozefit më 1941, ku u mblodhën shqiptarët pa dallim feje, dhe në Plavë e Gusi po kështu në vitin 1941. (f.15-19)
Sapo të dalë diku sado pak diell, shqiptarët janë të gatshëm t'ia tregojnë atij dielli Flamurin e tyre. Në korrik të vitit 1941 ngrihet Flamuri ynë edhe në krahinën e Shestanit dhe krijohet, në një mbledhje të popullit në Kishën e Shëngjergjit në Shestan të Poshtëm Komiteti Kombëtar Shqiptar, i cili dërgon në Tiranë një delegacion me kërkesën për t'iu bashkuar edhe Shestani shtetit shqiptar.(Krs. Gjokë Dabaj "Shestani" vëll II, f.544-546 dhe Gjoka Markov Daboviq "Pleme Shestani", f.252-254).
Vjen, mbas atij zgjimi sado të shkurtër të shpresavet tona në gjysmën e parë të vitevt 1940, ripushtimi dhe, për njëzet e tri vjet nën Jugosllavinë Komunite, Flamuri Kombëtar i këtyre anëve mbyllet sërish ndër arka, midis petkavet të nusevet e të plakavet.
Në vitin 1968 në Jugosllavinë Federative fillon të fryjë një lloj ere demokracie. Shqiptarët e këtyre viseve, të gatshëm si gjithmonë për ta dëshmuar veten, e nxjerrin edhe njëherë në shesh simbolin e Kombit të vet, sado që detyrohen ta ruajnë me pushkë në faqe. (f.21-24)
Unë po sjell këtu vetëm një episod nga ata që i përshkruan Gjeka dhe kjo besoj është e mjaftueshme për ta kuptuar shpirtin e shqiptarëvet që nuk vdes kurrë.
Myzafer Cungu, një fëmijë 7 vjeç, në përbërje të një grupi moshatarësh flamurmbajtës shtatë dhe tetëvjeçarë, paraklon nëpër rrugët e Ulqinit me Flamurin Shqiptar në duart e tija të vogla. Një milic i gjatë i del përpara grupit demonstrues dhe, natyrisht, fëmijët shpërndahen. Fëmijët shpërndahen, por emrat u shënohen dhe prindët e tyre thirren një nga një

në milici. Musa Cungu, i jati Myzaferit të vogël, detyrohet të paguajë 15 000 dinarë gjobë për "deliktin kriminal" të të birit. E paguan gjobën, por djalit tjetër, i cili lind pikërisht ato ditë, ia vë emrin Skënder, sepse fëmijët, në ballë parakalimit me Flamujt Kuq e Zi, kishin mbajtur edhe një portret të Skënderbeut, të vizatuar në një pëlhurë. (f.25-27)

"Flamuri për mua është dëshmi e besnikërisë ndaj Atdheut dhe ndaj Kombit. Unë jam shqiptar dhe s'mund të jem askush tjetër. Por më vjen keq që disa shqiptarë e mohojnë të qenurit shqiptar, duke mos ditur se çka janë. Unë nuk mund të pajtohem me ata që duan tjetrin më shumë se veten." Kështu thotë Palokë Shkreli, banues në Shtoj të Ulqinit, i pari që mori guximin të bëjë dasmën me Flamur Shqiptar, duke kaluar me të nëpër Tivar e nëpër Podgoricë. (f.32)

Faqet 85 deri në 193 (përfshirë aty edhe disa shkrime të Gjekë Gjonlekajt), Gjekë Gjonaj ia ka kushtuar Trieshit, trevës së tij të lindjes, me titull "Copëza historie nga vendlindja". Nxitur nga ç'lexova në këtë kapitull, unë po bëj tash një krahasim midis Trieshit dhe Shestanit. Për nga numri i banorëvet, Trieshi i Gjekë Gjonajt dhe Shestani im, në gjysmën e parë të sh.XX, janë thuajse barabar. Por rruga e tyre në këtë fragment kohe, nga mesi i sh XX e këndej, ka qenë me kahe të kundërta: Trieshi, i vetëpërcakruar për mbijetesë e rrjedhimisht edhe për zhvillim historik, Shestani i vetëpërcaktuar për të vdekur dhe për të mos lënë gjurmë në histori, përveç ndonjë përpjekjeje sporadike! Shpjegimi është fare i thjeshtë: Në vitet e Luftës së Dytë, edhe Trieshi, edhe Shestani, patën hapur shkolla në gjuhën shqipe. Mbas vitit 1945 Trieshi vazhdoi shkollimin e fëmijëvet të vet në gjuhën shqipe, Shestani, i sunduar nga ca njerëz miopë, edhe pse s'ish i detyruar, e pranoi shkollimin në gjuhën sllave. Rezultati: Shestanasit, sot, në shumicën e tyre janë drejt shkombëtarizimit. Pamja e shestanasvet, veçanërisht e atyre që jetojnë në Tivar e rrethina, del më qartë kur i krahasojmë me shestanasit e Zarës. Shestanasit e Zarës, shpërngulur prej këndej para 270 vjetësh, flasin ende arbërisht dhe nxjerrin dijetarë e njerëz të tjerë të shquar, shestanasit e Tivarit jo vetëm nuk flasin shqip, por i urrejnë shqiptarët duke i akuzuar madje edhe përbuzur, se "janë myslimanë". Ja çfarë bën në kohën tonë mosshkollimi në gjuhën e vet! E bën njeriun monstër!

Personalitetet që ka dhënë Trieshi, pikërisht falë përkushtimit ndaj Gjuhës Shqipe dhe ndaj Atdheut të Shqiptarëvet, janë të shumtë. Përfshirë të mëparshmit, Nikollë Ivanaj, Mirash Ivanaj dhe Athanas Gega, me të mëvonshmit Pashko Nikollë Gjokaj, Zef Gjokaj, Dr.Lukë Gjokaj, Kolë Cacaj dhe Gjekë Gjonlekaj, i njëemërti me Gjekë Gjonajn,

Trieshi hyn në radhën e konribuesvet më të dalluar në panteonin e Kombit Shqiptar.
Por cilët janë prijatarët e një të këtillë rezultati të lakmueshëm të një Trieshi të vogël në një cep të Shqipërisë?! Prijatarët janë ca njerëz të thjeshtë, që, me punën e tyre të përorëshme dhe të përditshme, u frymëzojnë fëmijëvet virtytet më të mirë njerëzorë, adhurimin ndaj Gjuhës së vet, adhurimin ndaj Atdheut të vet dhe nderimin ndaj të parëvet. Janë të pesë mësuesit, të cilët, mbas Luftës së Dytë Botërore, dhanë mësim në shkollën 8-vjeçare të Trieshit: Gjergj Hasanaj, Vasel Margilaj, Nua Lekoçaj (të cilin unë e kam pasur shok shkolle në Nikshiq, Gj.D.), Pjetër Gjuravçaj dhe Prelë Gegaj. Gjekë Gjonaj ka shprehur në këtë libër mirënjohje të veçantë ndaj këtyre mësuesve. Është e arsyeshme që krejt Kombi, me mënyrat përkatëse të vlerësimevet, ta shprehë edhe ai mirënjohjen, sepse nuk është e lehtë të predikosh atdhedashuri mu përpara dhëmbëvet shqiptarkërcënues të një bishe, e cila duket se s'ka ardhur për tjetër në këtë botë, veçse për të urrejtur shqiptarët.
Libri "Bijtë e Shqipes" është një fragment i Enciklopedisë Kombëtare Shqiptare. Personalitetet, jeta dhe kontributi i të cilëvet përshkruhen në faqet e këtij libri, janë të profilevet nga më të ndryshmit, por që të gjithë konvergojnë në një pikë: Ata, secili me mundësitë e veta dhe në mënyrën e vet, i shërbejnë Kombit Shqiptar. Prandaj dhe Gjekë Gjonaj, me të drejtë, e ka titulluar këtë libër "Bijtë e Shqipes".
Lexojmë këtu, njërin mbas tjetit, emra, jetë dhe veprimtari atdhetarësh të atillë, për të cilët ke përshtypjen se, sa herë marrin frymë, mendjen e çojnë te Gjuha Shqipe dhe te njerëzit që e flasin këtë gjuhë. Njerëz, fatkeqësisht, shpërndarë në gjashtë shtete në Atdheun e vet dhe në dhjetëra shtete jashtë Atdheut të vet.
Sheh Rasim Llolla, Gjekë Rudaj, Mark Kolë Dedëvukaj, Pretash Zekë Ulaj, Ismail Doda, Liri Buzuku, Zylfie Gjoni-Duraku, Hasan Salaj, Ejll Zagreda, Age Palaj, Liri Milla-Kodra, Tomë Berisha, Lukë Gjokaj, Arben Kurti, Fuat Nimani, Mirash Gojçaj, Preç Curanaj, Dan Xhurreta, Gjelosh Gjokaj, Emine Çunmulaj, Ilirjanë Gjoni, Pjetër Malotë Lulgjuraj, Kolë Gjonaj, Pashkë Gjonaj, Fatmir Gjeka, Rexhep Lika, Simë Dobreci, Bahri Brisku.
Midis gjithë këtyre dhe atyre që munda t'i përmend më parë, bëjnë shenjë edhe dy kryekontribues, dëshmi madhore se deri në ç'lartësi mund t'ia rrisë vlerën Kombit të vet edhe një njeri i vetëm: Dedë Gjo Luli dhe Dom Simon Filipaj.

Megjithkëto, lexuesit nuk mund të mos i mbetet mendja te njëri prej kapitujvet më trishtues të këtij libri: “Pse Trieshin e ka kapluar heshtja?!“. Shumica e shqiptarëvet, që i mbajnë gjallë historinë dhe krenarinë e këtyre pjesëve të Shqipërisë Veriperendimore, jeton sot jashtë Atdheut. Zogj që lindin e rriten jashtë folevet të veta! Kjo dukuri, tashmë, për fatin tonë të keq, nuk është tipar vetëm i pjesëvet që kanë mbetur përtej kufijvet të shtetevet tanë, por është pamje tragjike e krejt Atdheut tonë. Dhe, për këtë dukuri, për dukurinë e shpopullimit, sidomos të trevavet tona rurale, nuk mjafton vetëm të konstatojmë e të shqetësohemi. Është e domosdoshme që pjesa më e vetëdijshme e Kombit të marrë vendime, jo vetëm për ta shpëtuar Kombin, por, pse jo, edhe për ta ngritur atë në nivelin që e ka merituar me privime dhe me sakrifica të panumërt

Xhevat LLOSHI

NJË ROMAN ME RRËFIM TË VEÇANTË
“ Të gjithë të mitë “
nga autori Zuvdija Berisha (Hoxhiq)

Punën për të thënë dy fjalë rreth romanit *Të gjithë të mitë,* nga autori Zuvdija Berisha (Hoxhiq), ma lehtësoi mjaft takimi që pata në Panairin e Librit në Tiranë në mes të nëntorit 2017 me përkthyesin e tij shqip, Dimitrov Popoviq. Ai e kishte paraqitur romanin në Shkodër, më 23 shtator. Me një bujari të veçantë, ai ma dha kopjen e fjalës së vet në Shkodër dhe kështu e kisha të gatshme përmbledhjen e veprimtarisë dhe të veprave të autorit.

Akademiku Zuvdija Berisha është një ndër shkrimtarët më të njohur në letërsinë e Malit të Zi. Ka lindur në Guci më 1943, nga një familje bektashiane, e shpërngulur aty nga Kodralia e Deçanit. Është anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, në të cilën është pranuar në një ditë me Ismail Kadarenë.

Është një autor i shumanshëm, domethënë ka botuar:
— poezi, libri me titullin *Konaku i parë;*
— udhëpërshkrime dhe reportazhe *Një ditë e jetës;*
— ese *To je to (Kjo është kjo);*
— tregime *Gluva zvona (Kambanat e shurdhëta); Neko zove (Dikush thërret); Dimri;*
— romane *Viti i Gucisë; Ylli i Davidit; Të gjithë të mitë.*

Krijimet e tij kanë fituar çmimet më të rëndësishme të Malit të Zi për letërsinë dhe poezitë e tij janë recituar në manifestime të ndryshme. Ai shkruan në gjuhën e Malit të Zi, por lexuesi shqiptar e njeh mirë nëpërmjet përkthimeve të goditura shqip, si *Ylli i Davidit* me përkthyes Ramiz Kelmendin dhe *Viti i Gucisë* me përkthyes Zenun Çelajn. Jo vetëm kaq, por ky romani i fundit është përkthyer edhe polonisht, sllovenisht e italisht.

Romani *Të gjithë të mitë* na del kështu si i treti në një trilogji. Ndërkaq, lexuesi nuk do të ndjekë faqet e një romani me shtjellimin e zakonshëm. Është në trajtën e një vargu rrëfimesh e ndër ta secili qëndron më vete, duke pasur fillin lidhës të figurës së gjyshit, Cuf Berishës. Njëkohësisht, kjo zgjidhje i ka mundësuar që, aty ku e ka parë

interesante, të përfshijë si personazhe edhe figura të njohura të jetës kulturore, duke kaluar në trajtime në formën e reportazhit. Krahas kësaj, duke iu mbajtur rrëfimit letrar, i cili lejon mishërimin e fantazisë së bashku me riprodhimin e realitetit, por ndërkaq, ashtu si në veprat e realizmit magjik, përfshin edhe skena krejtësisht irreale, por që i lë pa e nënkuptuar se lexuesi do ta gjejë vetë se çfarë përfaqëson kjo e pabesueshme.

Megjithatë, ka edhe diçka më thelbësore, që i lidh në një shtjellë të vetme këto rrëfime. Këtë autori e ka shprehur që në titull, i cili mund të perifrazohej: *Që të gjithë ju jeni të mitë*, domethënë nuk më pengon asnjë faktor ndryshueshmërie, që t'ju quaj se ju kam afër dhe, nëpërmjet kësaj edhe ju jeni të afërt, dallimet nuk ka përse të shndërrohen në kundërshti mes jush. E vërteta është se ato dallime të natyrshme ndërmjet njerëzve të veçantë dhe popullsive të gjera, për fat të keq, jo shumë kohë më parë janë shfrytëzuar për t'i hedhur bashkësitë në ndeshje të përgjakshme njërën kundër tjetrës. Dhe për këtë nuk ka nevojë të bëhen ekskursione të largëta, mjafton vargu i luftërave në Jugosllavinë e mëparshme, të cilat përligjeshin me manipulime ideologjike çnjerëzore, domethënë duke hedhur kundër njëra-tjetrës bashkësi të ndryshme etnike, fetare, gjuhësore, kulturore. Kjo qasje jo vetëm e përshkon çdo episod, por në mënyrë simbolike, me një zgjidhje letrare, është shprehur edhe duke përfshirë pjesë në vargje pikërisht në tri gjuhë: serbisht, shqip dhe latinisht. Prandaj nuk mund të mos citohen këta rreshta: "Të gjithë në Ballkan janë të njëjtë: njerëzit, kafshët dhe zogjtë. Nuk mundemi me të tjerët, nuk mundemi me të vetët. Nuk munden as me veten."

Një kritik gërricës mund të kundërvihej pikërisht me faktin që përmenda më lart, duke nënvizuar se Ballkani ka qenë fushë grindjesh, aq sa prej kësaj ka lindur termi "ballkanizim". Mirëpo autori ynë jo vetëm është kundër vijimit të këtij pështjellimi historik, por nëpërmjet veprës së vet predikon pikërisht rrugën e shpëtimit, domethënë ndërgjegjësimin se jemi të gjitha tanët dhe me këtë ta kapërcejmë ecurinë e shëmtuar historike. Gjithashtu këtu ndërlidhet edhe vëmendja për të kaluarën, të cilën e mishëron më së miri figura e gjyshit. Domethënë, njohja e së kaluarës gjithashtu nuk na vlen për të ringjallur konfliktet, por për t'i kapërcyer ato, për të mos i përsëritur. Natyrisht, një përbërëse e këtij orientimi është edhe fryma bektashiane, ideja se gjithçka jo vetëm është krijesë e zotit, por edhe se krijuesi është i pranishëm në gjithçka, rrjedhimisht prej këndej buron respekti dhe

dashuria për të gjithë, edhe për ata brenda fisit tënd, edhe ata të fiseve të tjera dhe më përtej, edhe për ata përtej kufijve të tu.

Natyrisht, në ditë tona ndeshemi me një atmosferë, në të cilën shumë vlera të së kaluarës quhen të tejkaluara, duke mbërritur te vetë pakësimi i interesimit për letërsinë e për librin përgjithësisht. Vendin e vlerave të brendshme njerëzore e kanë zënë argëtimi i sipërfaqshëm, muzika e cilësisë së ulët, veset e shumëfishuara nga mundësitë e gjera që japin sot teknologjia dhe komunikimi, ndërsa të gjitha këto mund të përmblidhen me dy fjalë: celularët dhe drogat. Pikërisht në këto rrethana ka rëndësi të posaçme që zëri i shkrimtarit të mos heshtë, sepse do të gjenden njerëz që do ta dëgjojnë. Idetë ka rëndësi të madhe që të thuhen, të përsëriten, edhe atëherë kur duket se nuk ua vë veshin më njeri. Sepse po të mos veprohej kështu, do të ishim në një shkretëtirë shurdhërie.

Romani është shkruar në një gjuhë sllave, prandaj edhe po ta lexoja në origjinal, nuk do të isha në gjendje ta shijoja veçantinë stilistike, siç e shijon cilido në gjuhën e vet amtare. Megjithatë, nuk mund të lë pa e përmendur se përkthimi nga D. Popoviqi është me një dorë të sigurt të një përkthyesi me përvojë. Ai ka ditur ta ruajë gjatë gjithë shtjellimit kohën e shkuar të foljeve në përputhje me vetë natyrën e rrëfimit. Nganjëherë të krijohet përshtypja se kemi jehonën e rrëfimit të eposit tonë, po edhe disa veçori stilistike të krijimtarisë letrare të autorëve kosovarë. Ndërsa duke iu përmbajtur shqipes standarde, teksti është i kapshëm për gjithë lexuesit në gjuhën tonë. Kështu që përgëzimet i takojnë, natyrisht autorit, nga i cili pritet një vazhdë e pandërprerë krijimtarie, por edhe përkthyesit, që na i bën këto vepra pjesë të letërsisë shqiptare jo thjesht sepse personazhet e problematika janë shqiptare, por edhe sepse janë në gjuhën e saj shekullore.

Emil LAFE

"KRIJIME POPULLORE SHESTANASE". Ulqin 2017, 266 f. ose "Mjaltë nga Bleta shqiptare e Shestanit"

Është një gjë shumë domethënëse që folkloristi ynë i madh i Rilindjes Kombëtare, dorëmbari e mendjendrituri Thimi Mitko, i vuri titullin "Bleta shqiptare" përmbledhjes së tij me lëndë folklorike nga mbarë viset shqiptare, e cila u botua në Aleksandri të Egjiptit më 1878, atë vit kur u themelua edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ai libër pati atëherë jehonë të gjerë ndërkombëtare dhe shërbeu si dëshmi e pasurisë dhe njësisë së kulturës popullore shqiptare, si mbështetje për kërkesat dhe të drejtat politike për të cilat punoi e luftoi Lidhja. Emërtimi metaforik i librit të Thimi Mitkos do të thotë që letërsia popullore ose folklori është një krijimtari kolektive dhe e organizuar, ashtu siç është puna e bletës, dhe njëkohësisht fryti i kësaj pune është i ëmbël e i çmuar ashtu si vetë mjalti i bletës. Prandaj titullit të librit "Krijime popullore shestanase" të përgatitur ne dashuri e me rrahje zemre nga prof. Simë Gjon Dobreci, dëshiroj t'i shtoj si nëntitull "Mjaltë nga Bleta shqiptare e Shestanit".

Në Shqipëri emërtimet Shestani, Kraja dhe Ljarja janë të njohura sidomos nga mbiemrat e një vargu njerëzish të shquar në fusha të ndryshme të dijes, të artit e të sportit, të cilët e kanë rrënjën e trungut familjar nga ato vise. Me gjasë nga ato anë ka qenë edhe Gjon Buzuku, autori i të parit libër shqip të botuar (1555), i cili në atë mot të largët kreu një heroizëm intelektual, duke i zbardhur faqen kulturës letrare shqiptare. Në nderim të tij dhe po me atë frymëzim, një bir i atyre anëve, prof, Simë Gjon Dobreci, boton rregullisht prej fillimit të këtij shekulli revistën kulturore-shkencore të ilustruar bukur "Buzuku" (numri 48, qershor 2017). Ndonëse mjek nga profesioni, prof. Simë Dobreci ka një tërheqje të fortë për kulturën popullore dhe duket se jeton mes tingujve, fjalëve e ngjyrave të saj.

Libri "Krijime popullore shestanse" për të cilin kam kënaqësi të veçantë të them pak fjalë në tubimin e sotshëm, që i ngjan një sofre kulturore të shtruar nga vëllezërit e kolegët tanë matanë Bunës, është fryt i një mendimi dhe i një veprimi të vijueshëm të prof. Simë Dobrecit. Siç e thotë vetë në një parathënie të shkurtër të librit, krijimtaria popullore e shestanasve e ka gëzuar dhe entuziazmuar gjithmonë. Botimi

i saj në revistën "Buzuku", si edhe disa miq të afërt, i dhanë idenë dhe ia shtuan dëshirën për ta bashkuar atë lëndë folklorike në një libër të vetëm, në mënyrë që lexuesi ta ketë më lehtë të gjejë hojet me mjaltin e poezisë popullore të Shestanit.

Libri i ri i prof. Simë Dobrecit ka përmbajtje të pasur e të zgjedhur. "*E bëra këtë punë me vullnet e dashuri, - shprehet ai, - sepse kjo është pasuri e çmueshme që na e lanë të parët tanë."* Lënda kryesore është poezia popullore, që përbën kapitullin e parë të librit. Këtu përfaqësohen gati të gjitha gjinitë e saj: këngë dashurie (f. 13-44), këngë dasme (f. 45-64), këngë të barinjve (f. 65-67), këngë kurbeti (f. 68). vajtime (f. 69-80), këngë humoristike (81-84), këngë të reja (f. 85-94), këngë historike (119-140), balada e elegji (141-176), këngë të kreshnikëve (177-186). Por krahas tyre ka edhe një numër këngësh të krijuara në frymën e këngëve popullore nga autorë të njohur, si Hajrullah Koliqi, Pjetër Perkoliqi, Vinçenc Malaj etj. e ndër ta është edhe vetë doktor Sima, i cili ka një brengë të madhe e të përhershme: a do të mbijetojë gjuha shqipe ndër bashkëvendësit e tij shestanas, apo do të tretet pak nga pak? Për t'i trimëruar këta bashkëvendës, që valët e jetës i largojnë prej vatrave ose i fusin në rrjedha të tjera, ai shkruan në këngën e vet "Jam shestanas": *T'partë tonë shqyp kanë folë e knue,/ Daj si burra kanë qinrue,/E na lanë nji amanet:/M'é ruejtë gjuhën e vet*.

Kapitulli i dytë i librit përmban fjalë e shprehje të urta e të arta të urtësisë popullore shqiptare në përgjithësi e të shestanasve në veçanti, që shprehin në mënyrë të figurshme përvojën shekullore e filozofinë e jetës së tyre; më tej vijnë përshëndetje, urime, mallkime, emra familjesh e emra vetjakë karakteristikë për Shestanin. Në pjesën e fundit të librit gjejmë një hulumtim të prof. Simë Dobrecit rreth lashtësisë dhe autoktonisë së Shqiptarëve të atyre anëve, që ndodhen sot në Malin e Zi. Ky hulumtim është i mbështetur në dokumente historike e në dëshmi të tjera, çka vërehet qartë edhe nga bibliografia e pasur që e shoqëron hulumtimin. Kreu i fundit i librit ka si titull "Shestanasit ma në za" dhe përmban vlerësime e të dhëna për jetën dhe veprën atdhetare, kulturore e shpirtërore të disa burrave të shquar shestanas, si Lekë Perkolaj, Vinçenc Malaj, Zef Jankaj, Zef Tagaj, Pjetër Perkoliqi.

Librit ia ngrenë vlerën ilustrimet e shumta, që janë fotografi të hershme e të reja të viseve shestanase, të banesave, orendive e sidomos të veshjeve të bukura të vajzave, të grave e të burrave, po ashtu fotografi të tubimeve me raste të ndryshme festash, si dhe pamje nga punët e përditshme bujqësore e blegtorale. Këto ilustrime, krahas shpjegimeve e

komenteve, i japin librit edhe vlera etnografike.

Libri përmban kështu një lëndë me vlera të shumanshme shkencore për studiuesit e folklorit e të traditave popullore në vështrim të gjerë. Si studiues i gjuhës, kam vërejtur me kënaqësi se libri përmban edhe një lëndë të pasur për hulumtime dialektologjike. Prof. Simë Dobreci ka ruajtur këtu dukuritë fonetike e gramatikore të së folmes së Shestanit, po ashtu ka sjellë fjalë, kuptime, shprehje frazeologjike e mënyra të thëni me shumë interes për të zbuluar pasurinë dhe larminë e gjuhës popullore të atyre viseve periferike, që ruajnë edhe tipare të vjetra të shqipes.

Me këtë lëndë të pasur folklorike e me vlera artistike të spikatura, libri i prof. Simë Dobrecit i bën një shërbim të madh kulturës sonë kombëtare, njohjes më të mirë të visareve të kulturës popullore në ato treva të skajshme veriperëndimore të truallit të shqipes, ku falë interesimit të studiuesve nga të gjitha viset shqiptare, po dalin në dritë gjithnjë e më shumë elemente e dukuri të kulturës së lashtë e të pasur të banorëve autoktonë të tyre.

Libra të tillë kanë jo vetëm vlera shkencore e dokumentare, por edhe vlera edukative. Nëpërmjet tyre trashëgohet dashuria për tokën e të parëve, për traditat, doket e zakonet, për fisnikërinë e ndjenjave njerëzore. Libra të tillë ushqejnë optimizëm e dashuri për jetën, mirëkuptim e mirëdashje në familje, në gjini e në shoqëri, që janë aq të nevojshme për rrethanat e sotme, kur individualizmi e egoizmi kërcënojnë jetën shoqërore.

Duke përmbyllur këto shënime, shpreh bindjen se libri do të jetë i mirëpritur jo vetëm brenda bashkësisë së shqiptarëve në Malin e Zi, por në mbarë hapësirën shqiptare dhe në diasporë. Librave të tillë u duhet bërë jehonë, ata duhen bërë të njohur për të tërhequr sa më shumë lexues, e sidomos ndër brezat e rinj, në mënyrë që të mos shkëputen traditat e kulturës popullore që vijnë nga thellësia e shekujve.

Prof. Simë Gjon Dobrecit i shpreh me këtë rast përgëzimet e mia të çiltra për vullnetin e tij shembullor në hulumtimin e pasurive kulturore kombëtare, për frymëzimin atdhetar që përshkon krejt jetën e veprimtarinë e tij, për mbrojtjen e shqiptarësisë dhe të gjuhës shqipe atje ku ajo është e rrezikuar, për krenarinë e qenies Shqiptar, pasardhës i Ilirëve të lashtësisë dhe i Arbërve të Motit të Madh të Skënderbeut. Prof. Simë Dobreci është shembull i një intelektuali shqiptar të përkushtuar e të angazhuar për lartësimin e vlerave të kombit të vet. I uroj jetë të gjatë e shëndet të mirë, që të na japë edhe libra të tjerë të dobishëm për të sotmen e të nesërmen tonë.

Liridona SINISHTAJ

ÇMITIZIMI NË *FSHATI I HESHTJES* DHE KULLARËT E FUNDIT NË *LIGJI I MASKAVE*

Çmitizimi në *Fshati i heshtjes*

Lidhja dhe vetëdija jonë për tjetrin, i ndryshëm nga ne, dhe me historinë, shpesh krijohet përmes mitizimit. Historia, me të gjitha elementet shpirtërore dhe materiale, është lidhja jonë me të kaluarën, por sot, ajo ka nevojë për një ndërtim të ri të saj, duke e çmitizuar.

Në këtë mënyrë e kaluara paraqitet në romanin *Fshati i heshtjes* të autorit Mark Lucgjonaj, ku kjo e kaluar rrëfehet nga një turist i cili për ne nuk është edhe aq i huaj. Ai quhet Ludvig Nopça, i cili krijon marrëdhënie intertekstuale dukshëm të qëllimshme me udhëpërshkruesin e Shqipërisë së Veriut, Franz Nopça.

Autori, me këtë personazh të huaj, vendos një lidhje të re me traditën e kësaj letërsie, kurse narratori, përmes turistit të huaj, duke kujtuar dashurinë për gruan që i ka vdekur (Ilonën), krijon një ligjërim idealist për dashurinë.

Në fakt, njeriu normal duhet të dashurojë, të jetojë i lirë, të qajë, të qeshë, të bjerë e të ngrihet. Jo të ndjekë urdhëra nga ata që kanë një përvojë të përgjakshme e që e kanë jetuar jetën dhe tani i mësojnë të tjerët se si të mos vuajnë... Ata nuk i lejojnë që të heqin, sepse vetëm kështu njihet jeta. Nuk i lejojnë të dashurojnë, sepse kështu ata njohin dhimbjen e dhimbja të bën të jesh njerëzor.[77]

I ndodhur gabimisht në fshatin e heshtur, udhëpërshkruesi kthehet në një turist i cili duke rrëfyer atë që sheh paraqet marrëdhënien e çmitizimit të historisë në vendin e besës; i cili ndërtohet vetëm përmes topikave letrare. Askund nuk theksohet se është Malësia, por ligjërimi i personazheve, psikologjia e tyre, hapësira gjeografike, traditat nënkuptojnë Malësinë dhe malësorët, me elemente të vogla çmitizimi.

Përmes rrëfimit për kishat, rrënojat, liqenin, gojëdhënat etj., kërkohet të hidhet dritë mbi të kaluarën si vlerë e së sotmes.

Ky roman kërkon të thyejë heshtjen e kulturës, ndaj vendeve dhe figurave si prifti, që i dhanë dhe i lanë diçka fshatit i cili historikisht vetëm hesht:

[77] Lucgjonaj, Mark, Fshati i heshtjes, Naimi, Tiranë, 2015, f.8

Mbi një grumbull letrash një frat po shkruante brenda kishës pa dyer, pa dritare. Drita e kandilit dridhej lehtë teksa frati ndërronte fletët. Plaku nuk po u zinte besë syve për atë që po shikonte. Shiko, ai po shkruan, bërtiste Nopça, ai po shkruan diçka për fshatin tuaj, ndonjë histori. [78]
Duke mos emërtuar fratin, vendet dhe fshatin real, narratori fut në lojë lexuesin semantik dhe semiotik në të njëjtën kohë. Për lexuesin semiotik ky prift mund të jetë At' Anton Harapi ose At' Gjergj Fishta.
Ky fshat i heshtur bëhet emërtimi dhe personifikimi i banorëve të tij. Të gjithë janë të ftohtë, fjalëpak, të gjithë dinë gjithçka dhe asgjë. Ftohtësia dhe zymtësia e fshatit është e njëjtë si e njerëzve; ata janë njerëz të fortë si malet që heshtin, që kanë forcë të fshehin historitë e tyre të vogla, që brenda mbajnë tragjedi njerëzore të mëdha.
Nopça ishte ulur përballë vetvetes, përballë asaj që kishte mbetur nga ai.
Çfarë jam duke bërë këtu; një javë, një javë që rri mes njerëzve të humbur, me krime e mistere që askush nuk ua di fillimin ose fundin. Plaku, plaka, varreza, mite, legjenda, mistere, histori, vrasje. Mjaft! Do të shpëtoj, i tha vetes. Po, po, do të shpëtoj nga kjo katrahurë e çmendur, filozofi e çmendur fshatarake.[79]
Fshati i heshtjes është vendi i dëshmisë për të kaluarën e lavdishme të malësorëve, rrëfyes i dhimbjes që ka heshtja.
Rrëfimi çmitizues në roman na tregon se mitizimi i tepërt dhe mbyllja vret, ashtu siç janë të gjithë personazhet në *Fshati i heshtjes*, të vrarë.

Kullarët e fundit në *Ligji i maskave*
Lidhja jonë me të kaluarën gjithmonë fillon nga të parët, nga mënyra se si familjarët, vendlindja dhe historia na i paraqet.
Në këtë formë ndërtojmë shtyllën e identitetit të cilën e mbajmë për jetë me vete, disa duke u përpjekur për të harruar kurse disa duke kujtuar.
Për të Parët dhe për praninë e gjurmëve të tyre sot, rrëfehet në romanin *Ligji i maskave*, aty
rrëfehet për kujtesën dhe harresën, për identitetin dhe për trysninë kolektive, individuale dhe shpirtërore që përjetojnë pasardhësit e të *Parëve* dhe mënyra se si luftohen *Kullarët e fundit.*
Ligji i maskave, që në titull na jep shenjat e para të një simbolike universale të maskës, të vjetër po aq sa njerëzimi, gjatë rrëfimit nuk

[78] Fshati i heshtjes, po aty, f.97
[79] Fshati i heshtjes, po aty, f.127

kemi toponime apo kohë të caktuar rrëfimi, që të krijojmë koordinata të qarta, pra kronotopia e këtij romani është e papërcaktuar.
Narratori luan me rrëfimin pikërisht përmes Kullarëve, duke ia lënë në dorë lexuesit që të zbulojë dhe përjetojë bashkë me rrëfimin ngjarjet personale dhe individualeve të personazheve.
Aty portretizohen individë, situata dhe gjendje, si shqetësime të autorit për ndryshimet e përditshmë që kalojnë shqiptarët në Mal të Zi dhe akoma më shumë trysnia ndaj individit dhe botës së tij shpirtërore.
Të shumta janë linjat e rrëfimit, por ne u ndalëm te kullarët e fundit të të parëve.
Përmes Kullarëve, që janë sinomin i të parëve (Malësorëve) rrëfehet për luftën e vazhdueshme ndaj pushtuesve. Ky pushtim jepet përmes të gjithë brezave, por Kola, i moçmi, përfaqëson të kaluarën, kurse Aleksandri të tashmen dhe të ardhmen.
Romani është një revoltë e brendshme, një thirrje për të parë secili më shumë brenda vetës, për t'u përballur me fytyrat e vërteta që fshihen poshtë maskave, është thirrje për të mos harruar Kullat dhe Kullarët.
Aleksandri është personazhi idealist i cili pavarësisht përpjekjeve përfundon me maskë, vetëm që të mos largohet, sepse ikja është humbje për të.
Aleksandri e falënderoi shumë doganierin. Mori maskln në dorë, shikoi qiellin dhe, duke shtrënguar nofullat, vendosi maskën.[80]
Gjithmonë ka qenë dhe mbetet e fortë lidhja e malësorëve me të parët, edhe pse këtu kjo fjalë është polisemike; të parët tanë (paraardhësit), dhe të parët që kanë qenë aty (përherë), në vendin e gurit dhe të Kullave.
Aleksandri rrëfen për trazimet shpirtërore dhe identitare, jo vetëm të tij, por të të gjithë brezave që jetojnë në vendin e të parëve të tyre, aty ku ata, të parët, jetonin me moton: *Të parët në lindje-të fundit në vdekje! Tokë-Gurë-Pushkë!*
Kullarët![81]
Ndër fjalët e fundit në shtratin e vdekjes Kola thotë: *E dija, për besë, se do të vishnin një ditë këta gurë dhe do ta përdornin për të ndërtuar historinë e vet prej gënjeshtrash.* [82]
Prandaj në roman rrëfehet për shembjen e kullave, marrjen e gurëve dhe vdekjen e Kolës, i fundit nga kullarët.

[80] Lucgjonaj, Mark, Ligji i maskave, Naimi, Tiranë, 2017, f. 158
[81] Ligji i maskave, po aty, f.114
[82] Ligji i maskave, po aty, f.100

Ligji i maskave, ndërtohet nga personazhe origjinalë si: Plaku Kolë, Agroni, Lara dhe Eva, të cilët u japin formë ngjarjeve, e tipizojnë më shumë vendin dhe kohën për të cilën rrëfehet, ku i lihet në dorë lexuesit ta gjejë.

Ky roman është thirrje për të qenë vetvetja, me rrëfime që shprehin realitetin e asimilimit të shqiptarëve në Mal të Zi përmes zhbërjes se historisë (shembjes së Kullave), përmes maskave, sepse pas maskës mund të jetë edhe i yti, sepse Kulla mund të sulmohet vetem nga brenda dhe pikërisht për këtë pushtim na rrëfen Aleksandri.

FOTO ALBUMI

EXIT

EXIT

Shaban Hasangjekaj

LIQENIT TË PLAVËS I RREZIKOHET EKZISTENCA

Liqeni i Plavës me rrethinë, është vlerë natyrore me bukuri të jashtëzakonshme, i gërshetuar me florë dhe faunë të begatë dhe të llojllojshme. Gjendet në afërsi të qytezës së Plavës, mu rrëzë Alpeve Shqiptare, përballë Visitorrit kreshnik, në lartësi mbidetare prej 907 m.

Shtrihet në fushëgropën e Plavë-Gucisë, mu aty ku në luginën e lumit Luça vazhdon lugina e lumit Lim. Shkencëtarët pohojnë se është liqe glacial, ndër më të bukurit e këtij lloji në Evropë, i krijuar në kohën e akullnajave. Është liqeni më i madh malor i Malit të Zi, me sipërfaqe prej rreth 2 km^2 me thellësi mesatare prej 3,86 m, me temperaturë mesatare të ujit gjatë vitit prej $8,7^0$ C dhe me nivel të ndryshueshëm të

ujit varësisht nga sasitë e të reshurave gjatë stinëve të vitit, kur nivelin më të lartë e arrin në maj, kurse më të ulëtin në shtator. Deri sa temperatura e ujit në sipërfaqen e tij në muajin gusht arrin 20,22 ^{0} C, gjatë dimrit liqeni ngrihet dhe nëpër të mund të kalohet e madje edhe të rrëshqitet. Dikur uji i liqenit ishte i pastër dhe i tejdukshëm, madje deri në thellësinë prej 4 metrash.

Llojllojshmëria e botës së gjallë me florë dhe faunë të begatë, liqenin e bëjnë të njohur. Deri sa brezin rreth e përqark liqenit dhe pjesën e cektë të tij e karakterizon vegjetacioni i bujshëm i bimëve të llojllojshme barishtore, uji i tij është i pasur me peshq llojesh të ndryshëm, ndër të cilët veçohen: njomëza, trofta, mlyshi, lipeni, mustaku etj. Në të madje në vitin 1985 është zënë njomëza prej 41 kg, e cila në panairin e peshkimit në Novi Sad është shpallë për trofe botëror. Llojllojshmëria e fondit të peshkut ofron kushte të volitshme për peshkim, i cili është mjaft i zhvilluar. Liqeni është i begatë edhe me shpend të ndryshëm ndër të cilët dominon rosa e egër.

Liqeni i Plavës ofron kushte të volitshme edhe për sporte të ndryshme të ujit, të cilat në vitet e fundit janë gjithnjë e më të shpeshta dhe kanë karakter garues, madje të nivelit shtetëror dhe ndërshtetëror. Moli (trapi) statik, i ndërtuar para 22 vjetësh në pjesën veriore të tij, ka ngjallë aktivitetin rekreativ sidomos tek të rinjtë gjatë stinës së verës ku i kalojnë çastet më të këndshme të ditës.

Duke i pasur të gjitha këto parasysh, me të drejtë mund të thuhet se për Liqenin e Plavës janë të lidhura dhe të varura të gjitha orientimet zhvillimore, e posaçërisht ato në fushën e turizmit, hotelerisë dhe sportit ujorë, jo vetëm të qytezës së Plavës, por të tërë komunës e madje edhe të Malit të Zi.

Mirëpo, në shumë tubime relevante shkencore, simpoziume dhe tryeza të rrumbullakëta viteve të fundit janë dëgjuar paralajmërime, e madje janë bërë edhe apele publike që të ndërmerren masa sa më të shpejta preventive për mbrojtjen e tij, ngase seriozisht është rrezikuar nga

ndikimi i ca proceseve të shprehura natyrore në një anë dhe pakujdesia totale e faktorit njeri në anën tjetër.

Në këtë drejtim hulumtuesit shkencor kanë konstatuar se lumi Luça me vërshimet e veta në pellgun e Liqenit të Plavës deponon sasi të mëdha të materialit eroziv dhe të mbeturinave duke shtytur sasi të mëdha të ujit në drejtim të shtratit të lumit Lim i cili buron nga liqeni.

Fundi i liqenit si pasojë e fundërrimit të vazhdueshëm të lymit dhe mbeturinave të vegjetacionit bimor, të cilat veç e kanë përfshirë tërë sipërfaqen e tij po ngritet, e thellësia e tij e cila dikur ka qenë 9,15 m tani është për ca metra më e vogël. Edhe uji i lumit Lim, i cili gradualisht po e thellon shtratin e vetë, ka influenca negative në nivelin e ujit të liqenit, i cili po bëhet gjithnjë e më i cekët. Këtyre pasojave po u kontribuon edhe faktori njeri duke hedhur mbeturina vend e pa vend në brigjet e tij dhe duke ngritur objekte llojesh të ndryshme aty ku fare nuk e kanë vendin.

Kështu, gati janë të pamohueshme paragjykimet që me tempon e tanishëm të këtyre proceseve për afro 50 vjet ky liqe do të shndërrohet në kënetë të rëndomtë, e cila pastaj gradualisht do të shtirret dhe thahet.

Edhe pse masat për pengimin e këtyre shkaktarëve kërkojnë mjete të mëdha financiare, të cilat Komuna e Plavës e as shteti i Malit të Zi nuk mund t'i ndajnë nga buxheti i vetë, duhet të bëhen përpjekje që ky problem të zgjidhet sa më parë nëpërmes të donacioneve të ndryshme të organizatave relevante zhvillimore ndërkombëtare në mënyrë që të mbrohet ky margaritar me vlera të paçmueshme natyrore, i cili si i tillë Plavën por edhe Malin e Zi e bën të njohur në opinionin botëror.

Në Komunën e Plavës pohojnë se kohëve të fundit janë bërë kontakte me ca firma dhe institucione të jashtme të cilat eventualisht do të mund të vepronin rreth realizimit të këtij projekti. Shpresojnë se në këtë drejtim do të hasin në mirëkuptim dhe se planet e hartuara Komuna e Plavës do t'i konkretizojë.

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 17/2018, viti XVI, Ulqin

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi
Kryetar: prim. dr. Gani Karamanaga

Redaktor teknik:
Gazmend Çitaku

Kontakti
E-mail: ***bkshmz@yahoo.com***
Bashkëpunëtorëve u jemi mirënjohës për ndihmesa.
Artikujt duhet të jenë të regjistruar në WORD dokument.
Duhet të jenë të lekturuar dhe të korrektuar.
Nuk duhet të jenë të faqosur e as të dizajnuar.

Shtypi
PRESS STUDIO
ULQIN, 2018

Tirazhi
300 copë